15 Jackson, S., Martin, N., & Stocklinski, J. (2004). Families as partners: Parent teams and parent/family involvement. In E. T. Joyner, J. P. Comer, & M. Ben-Avie (Eds.), *Transforming school leadership and management to support student learning and development* (pp. 105-126). Thousand Oaks, CA: Corwin Press.

16 Carol R. Keyes. (2000). *Parent-Teacher Partnerships: A Theoretical Approach for Teachers*. ERIC.

17 PTA National Standards for family school partnerships.

dy arsye bazë. E para, familja është njohësja më e mirë e fëmijës, dhe e dyta: shkolla si institucion arsimor, njohëse e moshës shkollore, ka detyrën edukative të saj të cilën duhet ta realizoj si vlerë. Përgjatë punimit tonë kur përmendim shkollën ne përfshijmë dhe nënkuptojmë veçanërisht ministrinë, si organin më të lartë, si dhe organet qeveritare dhe institucionet e tjera si bashkëpunëtorë në edukimin e nxënësve. Shkolla nuk është e vetme në edukimin dhe arsimimin e nxënësve.

Në fokus të studimit tonë kishim njohjen me dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë, intensitetin e saj, pasojat, arsyet, etj.

Synimi kryesor i studimit tonë është ta bëjmë familjen armën më të fortë të shkollës për zgjidhjen e çdo problemi që ka të bëjë me nxënësin. Po kështu familja të jetë më shumë e përfshirë në shkollë për nxënësin në çdo aspekt, edhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, në mënyrë që të mos lejojmë që dhuna ndërmjet nxënësve të bëhet ndoshta dhe stil i sjelljes së tyre në shkollë. Synimi ynë synon të kuptojmë cilët janë faktorët që e përfshijnë më shumë familjen si bashkëpunëtorë në shkollë. Në sajë të intervistave të realizuara me familje, mësues, drejtorë të shkollave, ne identifikuam faktorët domethënës në bashkëpunim shkollë-familje. Këta faktorë janë: *mirëpritja e familjes nga ana e shkollës, komunikimi i drejtë mes familjes dhe shkollës, informimi i drejtë dhe i mjaftueshëm shkollë-familje, ndarja e detyrave mes familjes dhe shkollës, vendimmarrja e familjes në shkollë, mbështetja e suksesit të nxënësve nga shkolla, eksperiencia e mëparshme e familjes me shkollën dhe besimi i familjes te shkolla.*

Më pas ky studim gjeti nivelin e këtyre faktorëve në shkollën tonë. Në fokus të studimit ishte edhe ndikimi i këtyre faktorëve mbi nivelin e takimeve të familjes me shkollën.

Në studimin tonë fitojmë dy grupe të dhënash. Njëri që ka të bëjë me bashkëpunimin dhe tjetri me dhunën ndërmjet nxënësve. Lidhja ndërmjet tyre është konstatimi i korrelacionit ndërmjet numrit të takimeve shkollë-familje dhe faktorëve për bashkëpunim mes tyre, ata të cilët bëjnë që familja të jetë më e përfshirë në shkollë.

Duke qenë të vetëdijshëm se dhuna ndërmjet nxënësve është shumë e ndërlikuar, por nisur edhe nga bindja se ajo mund të parandalohet ose së paku niveli i saj të ulet (zbutet) falë bashkëpunimit midis shkollës dhe familjes, e kryem këtë studim i cili i shërben njohjes së dukurisë së dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, mundësisë së dhënies së rekomandimeve për nxënësit, prindërit dhe shkollën, dhe rritjes së ndërgjegjes publike për pasojat e dhunës mes nxënësve. Nga ana tjetër, studimi ka për qëllim rritjen e interesit dhe konsideratës për rëndësinë e faktorëve të lartpërmendur lidhur me përfshirjen më të gjerë të familjes në shkollë më qëllim parandalimin e dhunës mes nxënësve. Ne e konsiderojmë shumë të rëndësishëm realizimin e këtij studimi sepse shkolla nuk mund ti zgjidhë çështjet e edukimit duke qëndruar e izoluar nga bashkëpunimi me agjenci të tjera, si familja në radhë të parë. Prandaj dhe kërkohet përfshirja e saj në shkollë, e cila nënkupton pjesëmarrjen e familjes përmes komunikimit dhe takimeve për procesin mësimor, edukativ dhe atë arsimor të nxënësit.

1.2 QËLLIMI I STUDIMIT

Si të arrijmë që familja si partneri më ndihmues i shkollës në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, të jetë më e pranishme në atje? Cila mund të jetë praktika më e mirë për shkollën për një përfshirje më të gjerë të familjes në shkollë me synim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve? Në këtë studim bëjmë përpjekje për gjetjen e këtyre përgjigjeve të cilat do ti prezantojmë në kapitujt vijues. Pra, *qëllimi i studimit është të kërkojë rrugë të optimizimit të bashkëpunimit të shkollës me familjen për përballimin e dhunës ndërmjet nxënësve.*

Në funksion të këtij qëllimi prezantohen një sërë aktivitete të cilët kanë të bëjnë me njohjen e përmasave të dukurisë së dhunës ndërmjet nxënësve, si dhe njohjen dhe nxjerrjen në pah të faktorëve që përcaktojnë nivelin e bashkëpunimit të shkollës me familjen. Ndër faktorët e shumtë me ndikim në këtë proces, në studim evidentohen: mirëpritja e familjes nga shkolla, komunikimi shkollë familje, informimi i familjes nga shkolla, mbështetja e suksesit të nxënësve, ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes, vendimmarrja e familjes në shkollë, eksperiencia e mëparshme e bashkëpunimit të familjes me shkollën dhe besimi i familjes te shkolla.

1.3. OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Objektivat e studimit janë:

1. Evidentimi i nivelit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë
2. Eksplorimi i nivelit të bashkëpunimit të shkollës me familjen për përballimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.
3. Evidentimi i përvojave të mira në bashkëpunimin midis shkollës dhe familjes.

1.4. PYETJET KËRKIMORE

Çështjet e ngritura në këtë studim kanë të bëjnë me nivelin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë me tërë kompleksitetin e tij, sidomos me rolin e faktorëve në përfshirjen më të gjerë të familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Me rëndësi është të zbulojmë ndikimin e këtyre faktorëve në nivelin e takimeve mes shkollës dhe familjes. Bazuar në këtë fakt, studimi është përpjekur tu japë përgjigje këtyre pyetjeve:

1. Cilat janë format e dhunës ndërmjet nxënësve? Cilat janë përmasat e saj? Cilat janë arsyet? Çfarë pasojash ka përdorimi i dhunës ndërmjet nxënësve? Çfarë qëndrimesh mbahen ndaj dhunës ndërmjet nxënësve? A ekzistojnë programe që merren drejtpërdrejt me parandalimin, studimin, rehabilitimin, etj?
2. Cili është niveli i mirëpritjes së familjes në shkollë dhe çfarë korrelimi ka mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
3. Në çfarë niveli është komunikimi mes shkollës dhe familjes dhe çfarë korrelimi ka mes komunikimit dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;

4. A janë dhe në çfarë niveli janë të informuar familja nga shkolla për dhunën ndërmjet nxënësve dhe çfarë korrelimi ka mes informimit dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
5. Cili është niveli i ndarjes së detyrave të shkollës me familjen dhe në çfarë korrelimi qëndron ajo me nivelin e takimit të familjes me shkollën;
6. A është familja vendimmarrëse në shkollë dhe cila është marrëdhënia mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
7. Në çfarë niveli është besimi i familjes te shkolla dhe çfarë korrelimi ka mes tij dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
8. Cila ishte eksperiencia e familjes me shkollën dhe cila është tani marrëdhënia mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;

1.5. ÇËSHTJET E STUDIMIT

Ky studim merret me këto çështje kërkimore:

1. Evidentimi i treguesve kryesorë të dhunës ndërmjet nxënësve tek nxënësit e klasës së tetë të shkollës fillore në Kosovë.
2. Evidentimi i rolit të nivelit të mirëpritjes së familjes në shkollë në bashkëpunimin shkollë-familje.
3. Evidentimi i rolit të komunikimeve të mësuesve me familjen në bashkëpunimin shkollë-familje.
4. Evidentimi i ndikimit të informimit nga mësuesit për çështjet që lidhen me nxënësit në bashkëpunim shkollë-familje.
5. Evidentimi i ndikimit të ndarjes së roleve në bashkëpunimin shkollë-familje.
6. Evidentimi i ndikimit të mbështetjes së suksesit të nxënësve në bashkëpunim shkollë familje.
7. Evidentimi i problemeve të vendimmarrjes të mësuesve dhe të familjes në shkollë dhe ndikimi i tyre në bashkëpunimin shkollë-familje.
8. Evidentimi i efektit të eksperiencës së mëparshme në bashkëpunimin aktual të mësuesve me familjen.
9. Evidentimi i rolit të besimit të familjes te mësuesit në nivelin e bashkëpunimit të mësuesve me prindërit.

1.6. RËNDËSIA E STUDIMIT

Ky studim: “Bashkëpunimi shkollë- familje në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë” është i rëndësishëm për disa arsye:

1. Institucioni shkollorë nuk mund ta kryejë detyrën e ngarkuar me ligj duke punuar vetëm.
2. Familja nuk i arrin dot qëllimet e saj duke mos u interesuar për jetën e fëmijëve në shkollë
3. Kompleksiteti që krijon dhuna në shkollë është herë pas here çështja më e komplikuar për shkollën dhe familjen.

1.7. KONCEPTET KRYESORE TË STUDIMIT

"Shpjegimet terminologjike janë esenciale për tu kuptuar gjërat"¹⁸. Në këtë punim, termat e përcaktuara për të përcjellë kontekstin janë: dhunë, familje, shkollë, bashkëpunim, parandalim.

"Përkufizimi i dhunës përbën një çështje që ka vështirësitë e saj të cilat janë bërë të njohura në studimet e kryera për të"¹⁹. Gjatë studimit empirik ne hasëm vështirësi për shkak se kishim prindër, por edhe mësues, të cilët nuk përkufizonin qartë dhunën fizike dhe psikike. Mësuesit dhanë përgjigje sipërfaqësore madje edhe jo të sakta për dhunën. Hasëm edhe në mësues të cilët fyerjen ndërmjet nxënësve nuk e konsideronin dhunë.

Gjatë shfletimit të literaturës së huaj, por edhe të literaturës së botuar te ne, lidhur me trajtimin e dhunës ndërmjet nxënësve hasëm edhe termin bullizëm. "Bullizmi në mënyrë tipike i referohet sjelljes së nxënësve në shkollë" Westhues, K (2002)²⁰. Bullizmi nënkupton agresivitet fizik dhe kërcënim.

Për ta kuptuar dhunën në mënyrë më të plotë po e sqarojmë atë nga këndvështrime të ndryshme. Në fjalorin e gjuhës shqipe, kemi disa sinonime për nocionin dhunë. Aty dhuna si nocion ka domethënien e përdorimit të forcës, detyrimit, keqtrajtimit, teprimit, përdhunimit, vrazhdësisë, egërsisë, abuzimit, etj.²¹. Ndërsa, studiuesja Zuna, A, thotë se "dhuna mund të shpjegohet me fjalët: keqtrajtimit, forcë, përdhunë, përdhunim, shtrengim, detyrim, abuzim, teprim, shpërdorim etj"²².

Nocioni dhunë, në fjalorët psikologjik shpjegohet si: "veprim i qëllimshëm për ta detyruar tjetrin, me mjete fizike a psikike tu nënshtrohet interesave, synimeve e dëshirave të dikujt"²³.

Në "World Report on Violence and Health"²⁴ thuhet se dhuna, është përdorim i qëllimshëm i forcës fizike ose i fuqisë, i kërcënimit apo i përdorimit real të saj, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keq-zhvillim ose privim .

Një përkufizim të qëlluar mbi dhunën e gjejmë dhe në tekstin Family and community Involvement, ku thuhet se: "Dhunë do të thotë çdo fjalë, shikim, shenjë, ose akt që lëndon trupin, ndjenjat ose mendimet e një personi"²⁵

Ndërsa Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhunën e përkufizon si: "përdorim i forcës apo pushtetit, ose si një veprim a mosveprim në çdo mjedis, i kërcënuar, apo perceptimi real kundër vetes, ndaj një personi tjetër apo një grupi, një komuniteti që ka

18 Doracak për krijimin e mjediseve të sigurta jo të dhunshme e humane në shoqëri dhe në shkollë, KEC dhe UNICEF, Prishtinë, 2009, fq. 67

19 Tamo, A & Karaj, TH. (2005). Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri. Tiranë: Qendra e zhvillimeve humane, fq. 10

20 Westhues, K. (2002). At the mercy of the mob. *Canada's Occupational Health and Safety Magazine*, 18 (8), 30-36.

21 Akademia e Shkencës e Shqipërisë. Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë: *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005, fq. 234-235.

22 Zuna, a. (2008). *Dhuna në familje nën thjerrën pedagogjike*. Prishtinë: "Libri shkollor".fq.2

23 Nushi.P, *Fjalori i psikologjisë*, Prishtinë, 1987, fq.53

24 World report on violence and health, Etienne G. Krug, Linda L. Dahlberg, James A. Mercy, Anthony B. Zwi and Rafael Lozano (2002). World Health Organization, Geneva,f. 29.

25 Howard Adelman, Ph.D.Linda Taylor, Ph.D. (2007). *Family and community Involvement*.

gjasa, ose çon, ose ka gjasa të larta të rezultojë në vdekje, dëmtim fizik, psikologjik apo emocional, zhvillim ose privim” (International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies, 2008)²⁶.

Nocionin familje e gjejmë në përkufizime të ndryshme. Ndër arsytet që familja merr dimensione të ndryshme është se “në shekullin e kaluar, në të gjithë botën kanë ndodhur ndryshime dramatike rreth mënyrës së sjelljes në familje dhe modelit të ekzistimit të saj. Mirëpo këto ndryshime nuk i bënë të gjitha familjet të njëjta apo të përafërta në të gjithë botën. Fëmijët në botë përsëri rriten, jo vetëm me kushte shumë të ndryshme ekonomike, por rriten gjithashtu edhe në familje të ndryshme”²⁷.

Në fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe nocioni familje përkufizohet si: “Njësi e vogël e organizimit të jetës shoqërore”²⁸, duke nënkuptuar formën më të thjeshtë dhe primare të organizimit të jetës shoqërore.

Në “Fjalorin e Psikologjisë”, familja përkufizohet si: “Bashkësi e vogël individësh e formuar në bazë të martesës së burrit dhe gruas të caktuar. Burri e gruaja me anën e institucionit të martesës të kurorëzimit kanë vënë marrëdhënie psikologjike, morale dhe juridike ndërmjet tyre”²⁹.

Në studimin tonë në vend të termit prindër jo rastësisht ne kemi përdorur termin familje, nisur nga fakti se shkolla mund të bashkëpunojë edhe me anëtarë të tjerë të familjes. Një qasje të tillë e kemi hasur edhe tek (Batey, C, VITIN)³⁰, e cila preferon termin bashkëpunëtor, për faktin se “shumë fëmijë mund të jetojnë jo me prindër biologjikë, por me persona të tjerë: gjyshër, të afërm të largët, prindër që i kanë adoptuar, këshilltarë besnikë dhe miq ose shokë. Ka dhe fëmijë që jetojnë në institucione. Fjala bashkëpunëtorë mund t’i përfshijë të gjithë tipet e marrëdhënieve. Çdo pjesëtar i familjes mund të luajë një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet prindër-mësues”.

Në “Fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe” nocioni shkollë përkufizohet si “institucioni arsimor ku bëhet mësimi”³¹.

Në “Fjalorin e pedagogjisë”, gjejmë shpjegimin se nocioni shkollë në latinisht schola, nga greq. e vjetër – fjalë për fjalë, lexim, shpjegim i veprave shkencore³².

Në “Fjalorin e psikologjisë” shkolla si nocion shpjegohet si “institucion edukativo-arsimor, në të cilin organizohet veprimtaria e edukimit dhe arsimit të brezit të ri sipas planit dhe programit të caktuar në bazë të bashkëveprimit të arsimtarëve dhe nxënësve”³³.

Në Ligjin për Arsim të Kosovës, në nenin 1 nocioni shkollë përkufizohet “çdo institucion arsimor që ofron shërbime arsimore në nivel ISCED³⁴ 0, 1, 2 dhe 3”³⁵.

26 International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies, 2008.fq.5

27 The child An encyclopaedic companion, edited by Richard A.Shweder, The University of Chicago Press, Chicago and London, 2009, fq.333

28 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*. Tiranë. 2005. fq. 255

29 Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Fjalor i psikologjisë*, Prishtinë, 1987, fq.65

30 Batey, C, *Prindërit shpëtimtar të jetës*.

31 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005, fq. 258

32 Shefik Osmani, *Fjalor i Psikologjisë*, Tiranë, 1983, fq.647.

33 Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Fjalor i psikologjisë*, Prishtinë, 1987, fq. 285

34 “ISCED” do të thotë Klasifikimi i standardeve ndërkombëtare të arsimit 1997, i miratuar nga Konferenca e përgjithshme e UNESCO në sesionin e 29 –të saj në nëntor 1997.

35 Ligji “Mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë”. Nr. 2002/2.

Ndërsa Zuna. A, studiuese e devotshme e çështjes së bashkëpunimit të shkollës me familjen, nocionin shkollë e përkufizon kështu: “shkolla është institucion me organizim të veçantë, detyra themelore e së cilës është realizimi i qëllimeve dhe detyrave të procesit të edukimit³⁶.

“Parandalim do të thotë të shmangie e dhunës që në fillim” ³⁷(International Federation of Red Cross and and Redd Crescent Societies). Në punimin tonë kur përdorim këtë nocion kemi ndër mend shmangin e dhunës pa ndodhur ajo.

Në këtë punim, me parandalim ne nënkuptojmë parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, dhunë kjo e cila nuk ka ndodhur si dhe parandalimin e dhunës e cila ka ndodhur dhe tani e pengojmë të zhvillohet më tej.

1.8. KUFIZIMET E STUDIMIT

Ky studim mund të jetë i kufizuar nga faktorët e mëposhtëm:

1. Mësuesit mund të jenë të kujdesshëm në dhënien e informacionit në bashkëpunim me familjen. Është e vështirë ti shmangemi subjektivitetit të mësuesve në dhënien e përgjigjeve për bashkëpunimin mes tyre dhe familjes.
2. Gjithashtu kufizim në dhënien e sinqertë të përgjigjes mund të hasim edhe nga familja.
3. Kufizimet e studimit lidhen edhe me karakterin e vetë problemit. Duke pasur parasysh faktin se dhuna ndërmjet nxënësve manifestohet me përjetime të pakëndshme, nuk është e lehtë që nxënësit të flasin për dhunën me nxënësit e tjerë. Veç kësaj, ekziston dyshimi tek nxënësit lidhur me etikën profesionale të studiuesit se të dhënat e tij mund të mos mbeten konfidenciale, ndërkohë që është e pakëndshme të flitet për dhunën, etj.
4. Një kufizim i studimit lidhet me fokus grupet ku janë përfshirë nxënës të dhunshëm dhe nxënës të dhunuar, që ka përbërë rrezik për nxitjen e ngacmimeve ndërmjet tyre.
5. Një kufizim serioz është edhe mungesa e studimeve të detajuara për dhunën ndërmjet nxënësve tek ne.

Pavarësisht kufizimeve të lartpërmendura në këtë studim janë bërë përpjekje që problemi të operacionalizohet në çështje shumë konkrete dhe realiste.

1.9. PIKAT E FORTA TË STUDIMIT

Konsiderojmë këto pika të forta të studimit:

- Studimi është realizuar në të gjithë Kosovën dhe ka mbuluar një përqindje të madhe të shkollave, familjeve, nxënësve.
- Në dijeninë tonë si studiues, ky është studimi i parë në Kosovë që trajton parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë përmes përfshirjes – bashkëpunimit të familjes me shkollën.

36 Zuna.A & bashkëautorët. (2009). *Partneriteti shkollë-familje-komunitet*. “Libri Shkollor”. Prishtinë. fq.18

37 International Federation of Red Cross and and Redd Crescent Societies.

- Studimi realizohet përmes tre instrumenteve, dhe për rrjedhojë konsiderojmë se ka ofruar të dhëna të hollësishme dhe të besueshme.
- Studimi do ofrojë rrugëzgjdhje për një përfshirje më të gjerë të familjes në shkollë nëpërmjet të cilave shkolla do të përforcojë më tej bashkëpunimin me familjen.

1.10. STRUKTURA E PUNIMIT

Struktura e punimit përfshin gjashtë kapituj kryesorë.

Në kapitullin e parë paraqesim një hyrje për bashkëpunimin shkollë-familje, prezantohet problemi i studimit, duke vijuar me qëllimin e studimit tonë, objektivat e studimit, çështjet kërkimore të studimit, pyetjet e studimit, nocionet kryesore të cilat janë përdorur në punim, kufizimet e studimit dhe përmbillet me strukturën e punimit.

Kapitulli i dytë paraqet gjetjet e studimeve të ndryshme për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë duke përshkruar edhe gjetjet e studimeve të ndryshme për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Ky kapitull paraqet një rishikim të literaturës lidhur me teorinë dhe praktikën e bashkëpunimit të shkollës me familjen. Në këtë kapitull përfshihen edhe këndvështrimet e studiuesve të ndryshëm lidhur me praktikën e bashkëpunimit të shkollës me familjen për përballimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Ai na jep një pasqyrë të studimeve nga autorë të ndryshëm lidhur me dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë. Në këtë kapitull japim gjithashtu një përmbledhje të studimeve të autorëve për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Vend kyç në këtë kapitull zë përshkrimi dhe trajtimi i faktorëve të rëndësishëm në bashkëpunim shkollë-familje.

Në kapitullin e tretë prezantohet metodologjia e studimit për pjesën sasiore e më pas atë cilësore. Fillohet me strukturën e studimit, popullacionin dhe kampionin e pjesëmarrësve në studim, instrumentet e studimit, metodat e studimit, besueshmërinë e instrumentit dhe vlefshmërinë e saj. Në të përshkruhet procedura e mbledhjes së të dhënave, procedura e analizimit të të dhënave dhe etika e studimit.

Në kapitullin e katërt prezantohen gjetjet e studimit. Janë paraqitur gjetjet të cilat lidhen me pyetjet e studimit.

Në kapitullin e pestë, paraqiten diskutimet për gjetjet e studimit. Diskutimi i gjetjeve është zhvilluar duke bërë analizimin e gjetjeve të studimit cilësor mbi dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë dhe punën e shkollës në drejtim të parandalimit të saj. Vijohet me diskutimin e gjetjeve nga analizën statistikore të të dhënave sasiore për faktorët në përfshirjen e familjes në shkollë dhe bashkëpunim me familjen. Kapitulli është i ndarë në nënkapituj.

Në kapitullin e gjashtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur metodologjia e studimit, përmbledhja e diskutimeve dhe gjetjeve të studimit. Në këtë kapitull jepen gjithashtu edhe rekomandimet praktike dhe për studime të mëtejme.

2.1. HYRJE

Përgjatë shqyrtimit të literaturës fillimisht do të ndalemi në çështje të cilat kanë të bëjnë me dhunën mes nxënësve, si dhe teoritë dhe praktikën më të njohura në drejtim të parandalimit të saj, duke ofruar të dhëna mbi studimet e shumta lidhur me këtë çështje. Çështjet të cilat trajtohen përgjatë shqyrtimit të literaturës kanë të bëjnë sidomos me faktorët për përfshirjen më të mirë të familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, por dhe me studimet e ndryshme mbi dhunën ndërmjet nxënësve dhe ato për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

“Studimet meta-analitike përkitazi me lidhjet korrelative të efektivitetit të shkollave dhe të bashkëpunimit të tyre me familjen e prindërit e nxënësve tregojnë për ekzistimin e lidhjes pozitive korrelative ndërmjet këtyre dukurive pedagogjike”³⁸. Në fushën e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes për parandalim të dhunës mes nxënësve ende nuk është dhënë një kuptim i qartë për faktorët apo mekanizmat të cilët inkurajojnë prindërit për përfshirje në këtë drejtim, e që për ne këta faktorë janë: mirëpritja e familjes në shkollë, komunikimi midis shkollës dhe familjes, informimi, ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes, ndarja e përgjegjësisë shkollë-familje, vendimmarrja e familjes në shkollë, mbështetja e suksesit të nxënësve në shkollë, besimi i familjes te shkolla dhe anasjelltas, eksperiencia e familjes me shkollën. Qëllimi i këtij shqyrtimi është të kuptojmë se si e shohin autorët të ndryshëm ndikimin e këtyre faktorëve gjatë bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, duke krijuar në këtë mënyrë edhe një koncept dhe njohje më të qartë për ta.

Konteksti teorik i temës ka një strukturë të ndarë në dymbëdhjetë fusha.

Fillojmë me studimet e autorëve për dhunën ndërmjet nxënësve, pastaj me studime mbi parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve duke vijuar me shqyrtimin e literaturës për studime të kryera në fushën e parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

Më tej kalojmë në shqyrtimin e literaturës për secilin faktor të cilin ne si studiuese i kemi konsideruar të rëndësishëm e të domosdoshëm në bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Faktori i parë është mirëpritja. Në pjesën vijuese të shqyrtimit të literaturës ndalemi në këndvështrimin e autorëve të ndryshëm lidhur me komunikimin si faktor në bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes, duke vazhduar kështu me pjesën ku shqyrtohet literatura që sqaron çështjen mjaft të rëndësishme për bashkëpunimin; informimin që përcillet nga shkolla drejt familjes e më pas për mbështetjen e suksesit të nxënësve. Në pjesën vijuese të këtij kapitulli analizojmë

38 Hyseni, Mita, Salihaj, Pupovci. (2003). *Qeverisja dhe udhëheqja në arsim*. Si të bëheni udhëheqës i suksesshëm (udhëzues). Prishtinë.

qëndrimet e studiuesve të ndryshëm për vendimmarrjen e familjes në shkollë si faktori më delikat në këtë bashkëpunim. Megjithatë ne nuk i shmangemi ndarjes së detyrave mes shkollës dhe familjes, duke paraqitur qëndrimet e rekomandimet e studiuesve për këtë faktor në bashkëpunim. Në vazhdimësi të shqyrtimit të literaturës fokusohemi në analizën e qëndrimeve e të arritjeve të studiuesve për faktorin në bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes aq i rëndësishëm, i vlerësuar te mbështetja e suksesit të nxënësve në shkollë nga shkolla dhe familja, këndvështrimet e autorëve për këtë faktorë dhe studimet e tyre. Vazhdojmë me qëndrimet dhe studimet e autorëve lidhur me besimin e shkollës ndaj familjes dhe e përmbyllim me eksperiencën e mëparshme të familjes dhe shkollës.

2.2. TEORIA DHE PRAKTIKA E BASHKËPUNIMIT TË SHKOLLËS ME FAMILJEN

Shkolla ka filluar të funksionojë si një institucion i ngritur enkas për tu marrë me arsimimin dhe edukimin e fëmijëve, gjë të cilën prindërit nuk kanë mund ta kryejnë për një varg arsyeshe: mungesë kompetence, mungesë kohe, kosto e lartë, etj.

Shkolla si institucion është zhvilluar në vazhdimësi. Përgjatë zhvillimit të saj si institucion shkolla ka ardhur duke u ndërgjegjësuar gjithnjë e më shumë për pamundësinë e përballimit veçmas të detyrës së edukimit. Kështu ajo filloi përfshirjen e familjes brenda saj. Ekzistojnë programe me qasje të ndryshme lidhur me përfshirjen e familjes në shkollë përmes të cilave synohet parandalimi por dhe promovimi i sjelljes sociale pozitive.

“Në literaturë gjejmë se përfshirja e prindërve në shkollë daton nga viti 1920, ku kjo përfshirje ishte përqendruar si një çështje globale për fëmijët e shteteve”³⁹.

“Në vitet 1960 roli i familjes dhe shkollës në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve ishin të ndara dhe të dallueshme”⁴⁰. Ndërsa, “në vitin 1970 fillon lëvizja efektive në bashkëpunimin shkollë-familje, vite gjatë të cilave kishte mjaft debate në këtë drejtim”⁴¹.

Më 1980 janë dhënë prova evidente se prindërit ishin të rëndësishëm për suksesin në shkollë, ku shkolla mori iniciativa për krijimin e modeleve për një bashkëpunim të suksesshëm shkollë-familje⁴².

Më vonë, “duke u rritur ndjeshëm numri i nënave të arsimuara doli nevoja që të ndryshojë edhe mënyra se si mësuesit i shohin prindërit dhe si prindërit i shohin mësuesit, dhe si nëna përfshihet në edukimin e fëmijës”, (cituar në Amaral. D. 2003)⁴³.

Edhe tek ne, historikisht shkolla, familja dhe komuniteti shërbyen si shtyllë kryesore e shoqërisë kosovare (Koliqi, 2000)⁴⁴. Edhe sot, bashkëpunimi shkollë-familje është sa aktual aq dhe i rëndësishëm si për mësimdhënësin ashtu edhe për familjen dhe komunitetin, sidomos në këtë kohë, kur e dimë se kurrsesi shkolla nuk mundet dot t’ia

39 Amaral.D., (2003) *Parents Of Adolescents: The Relationship Between Of Parent Involvement And Parent Efficacy*. (Unpublished master dissertation) fq.13.

40 Po aty, fq. 21

41 Po aty, fq.21

42 Po aty, fq. 14

43 Po aty, fq. 14

44 Koliqi,H.(2000). *Historia e arsimit shqiptar II*. “Libri shkollor”. Prishtinë.

dalë e vetme me nxënësit, në këtë rrugë të gjatë ku “shkolla është okupimi kryesor në rreth 13% të 18 viteve të para të jetës”⁴⁵.

Nëse i hedhim një vështrim historik shkollës sonë do të shohim se familja ka qenë e përfshirë në shkollë në një masë shumë të vogël. Takimi i familjes me shkollën/mësuesit ka ndodhur vetëm gjatë takimeve/mbledhjeve me prindërit që zakonisht organizohen një herë në semestër. Ky raport ndryshon falë studimeve në fushën e bashkëpunimit shkollë-familje.

Përgjatë zhvillimit të saj shkolla ka arritur të ndërtojë praktika të shumta dhe të shumëllojshme bashkëpunimi me familjen. Disa nga këto praktika bashkëpunimi në shkollën tonë janë: takimet me prindërit, takimet individuale me prindër, mesazhet telefonike, telefonatat etj.

Mbledhjet e prindërve, realizohen ndërmjet familjes dhe mësuesit apo dhe shkollës (stafit të konsulencës). Këto mbledhje organizohen në nivel klase dy herë gjatë një semestri. Këto janë mbledhje informative, ku familja informohet për jetën dhe punën në shkollë, për suksesin/arritjet e nxënësit, për organizime të ndryshme nga shkolla etj. Këto takime kanë karakter të përgjithshëm. Kjo formë e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes është e paraparë edhe në ligjin për arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë⁴⁶. Këto takime ende kanë mbetur më të njëjtën tematike; shqyrtimi i suksesit dhe disiplinës së nxënësve. Ende shkolla jonë nuk e përfshin në mënyrë të mjaftueshme familjen në shkollë për çështje nga më të ndryshmet e as për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Kjo ende nuk është karakteristikë e shkollës sonë sot.

Takimet individuale me prindërit realizohen me iniciativën e shkollës (mësuesit, psikologut, mjekut...) ose të vetë prindit. Këto takime realizohen ndërmjet mësuesit dhe prindit apo prindërve (në çifte). Kjo është një formë e drejtpërdrejtë e kontaktit mes shkollës dhe familjes. Këto takime janë shumë konfidenciale dhe mundësojnë një bashkëbisedim mjaftë të hapur, të sinqertë, të besueshëm, etj. Duke krijuar kështu dhe afërsi më të madhe ndërmjet shkollës dhe familjes.

Vizita në shtëpi, është një nga praktikat e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes tek ne. Kjo mundësi bashkëpunimi mundëson marrjen e informacioneve nga familja për çështje në interes të shkollës, duke u njohur kështu më mirë me rrethanat familjare, marrëdhëniet e saj me nxënësin, etj.

Një formë bashkëpunimi/praktike tek ne është *dhe ajo e telefonatave*. Kjo praktikë e bashkëpunimit të familjes dhe shkollës mundëson këmbimin e “informacioneve fillestare apo dhe shtesë për ndonjë aktivitet duke filluar nga faza e përgatitjes, gjatë dhe pas realizimit të tij. Kjo vlen për ekskursionet, fushimet, shëtitjet, organizimet e garave apo veprimtaritë shkollore, komunitare e familjare, etj.”⁴⁷, Gjithashtu, telefonatat mund të realizohen edhe me kalendar të përcaktuar “një herë në muaj”⁴⁸.

Një praktikë bashkëpunimi mes shkollës dhe familjes tek ne është edhe *komunikimi me shkrim* në mënyrë elektronike përmes email-eve, mesazheve telefonike apo edhe

45 Evans, R.(2004). Family matters: *How school can cope with the crisis in child rearing*. San Francisco, CA: Jossey-Bass, fq 14.

46 Shih: Ligji “Mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë”. Nr. 2002/2.

47 Zuna-Deva, A & bashkëautorët. (2009). *Partneriteti shkollë-familje-komunitet, sfidë vijanoze*. “Libri shkollor” Prishtinë. fq.216.

48 Po aty, 217.

përmes postës. Komunikimi përmes internetit në ciklin e lartë të shkollës fillore gjen zbatim veçanërisht në Danimarkë dhe Itali, ku familja merr në vazhdimësi informacione për sjelljen e fëmijës në shkollë. Po kështu këtë mënyrë komunikimi e gjejmë sidomos në Kroaci, komunikim pothuajse ditor, ku familja kontribuon materialisht në këtë komunikim duke ofruar 4 euro në muaj si shërbim për shkollën. “Komunikimi përmes fjalës së shkruar është formë që i rezistoi kohës dhe po bëhet gjithnjë e më i qëndrueshëm sot”⁴⁹. Një mënyrë komunikimi me shkrim janë edhe *botimet e ndryshme* si revistat, broshurat dhe doracakët që i vihen në dispozicion familjes. “Broshurat i ndihmojnë prindërit të kenë një pasqyrë më të qartë për programin”⁵⁰. Ndërsa doracakët kanë funksion pasi ata “... përmbajnë informata të detajuara lidhur me programin”⁵¹. Ndërsa qëllimi i revistave, të cilat mund t’i ofrohen familjes është “... që të gjitha familjet të jenë të kyçura në program, ti marrin informatat e duhura për rastet e posaçme, ndryshimet në program, nevojën për vullnetarë si dhe lajme të tjera”⁵².

Mund të pohohet se në të gjithë këtë panoramë të mundësive të bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes, secila mundësi bashkëpunimi mund të shfrytëzohet me sukses në bashkëpunimin me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

2.3. PRAKTIKAT E BASHKËPUNIMIT TË SHKOLLËS DHE FAMILJES NË PËRBALLIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE

Bashkëpunimi efektiv mes shkollës dhe familjes në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve duhet të ndërtohet mbi një vizion të qartë. Nuk mund të imagjinohet se mund të arrihen rezultate gjatë këtij bashkëpunimi nëse shkolla nuk ka një strategji të përcaktuar veprimi në këtë drejtim, strategji gjithëpërfshirëse kundër dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, me të cilën nënkuptojmë përfshirjen e nxënësve, familjes dhe shkollës.

Strategjitë kundër dhunës ndërmjet nxënësve madje duhet të ekzistojnë edhe në nivel shtetëror. “Shkollat e përgjegjshme dhe të sigurta kanë plane dhe procedura në vend që të merren me sjellje të dhunshme dhe shkatërruese”⁵³. Në këtë pjesë të studimit do njihemi me disa nga programet e shkollës të cilat mund të zvogëlojnë rrezikun nga dhuna ndërmjet nxënësve dhe ta parandalojnë atë përmes strategjive të ndryshme, si zbatohen ato dhe cili është efektiviteti i tyre.

Një mënyrë trajtimi - parandalimi e dhunës tek nxënësit është *aplikimi i përbashkët i të dy planeve, ai psikoedukativ dhe ndërhyrja në shëndetin mendor* me qëllim parandalimin e agresionit të të rinjve në shkollë. Kjo qasje trajtimi arsyetohet me faktin se mësuesit dhe administratorët e shkollave nuk kanë trajnim psikologjik e mos të

49 Po aty, fq.217

50 Soros. (2000). *39 ide për kyqjen e prindërve në programin e dedikuar fëmijëve parashkollorë*. Tiranë. fq.6

51 Po aty, fq 6

52 Po aty, fq.6

53 Russell Skiba, Kimberly Boone, Angela Fontanini, Tony Wu, Allison Strussell & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: *Preventing School Violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning*. The Safe and Responsive School Project At The Indiana Education Policy Center. (2000). Fq.23.

flasim për parandalim të dhunës dhe vlerësim të rrezikut, pra ka nevojë të ngutshme për një program të tillë dhe kurrikulat të cilat mund të imponohen në mjediset të shkollës për zbatim nga mësuesit, personelit udhëzues Chris D. Erickson, Ph.D. & Monica M. Megivern, Ed.D. (2006)⁵⁴.

Një praktikë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve është edhe ajo *përmes artit*⁵⁵.

Të rinjtë, jashtë mbikëqyrjes nga të rriturit, janë të pambrojtur ndaj dhunës në komunitet dhe rekrutimit nga bandat gjatë orarit jo shkollor. Programet e artit për të rinjtë u ofrojnë atyre një mjedis të sigurt dhe konstruktiv. Vlerësimi i tre programeve të artit në shkollë qyteti për të rinjtë në rrezik ka evidentuar faktin se këto programe ndikojnë në uljen e rasteve me sjellje delikuede, rriten arritjet akademike, dhe ndikojnë pozitivisht në qëndrimet e nxënësve për veten dhe të ardhmen e tyre. Programe të tilla të artit rinor iu ofrojnë nxënësve një vend të sigurt dhe konstruktiv për të shkruar.

Ekziston një shumëllojshmëri qasjesh për trajtimin e dhunës tek nxënësit e testuar. Dy nga qasjet e suksesshme janë: a) trajnimi i aftësive për njohjen e sjelljes b) trajnimet për ndikimet nga efektet e ekspozimit të dhunës. Këto dy kategori qasjeje për parandalimin e dhunës bazohen në shpjegime të ndryshme teorike – njëra te të menduarit e çrregullt dhe tjetra te emocionet e trazuara. Këto dy qasje synojnë të parandalojnë dhunën duke ndërhyrë/trajtuar sjelljet e çrregulluara të nxënësve, Chris D. Erickson, Ph.D. a Monica M. Megivern, Ed.D. (2006)⁵⁶. Qasje kjo shumë e arsyeshme e shkollës për parandalimin e dhunës duke ditur se “ sjellja e dhunshme është një simptomë e zakonshme e shumë shqetësimeve të shëndetit mendor, që përfshin çrregullimet si pasojë e abuzimit me substancat, pasojat nga traumat, çrregullime të stresit post-traumatik, çrregullimet bipolare dhe çrregullimet opozitare sfiduese. Është e njohur se më pak se një në pesë prej të gjithë fëmijëve me çrregullime të shëndetit mendor janë diagnostifikuar apo trajtohen”⁵⁷. Kjo strategji ka për qëllim parandalimin e agresionit tek të rinjtë.

Programet për ndërhyrjen te ngacmimet e nxënësve janë pjesë e përpjekjes së përgjithshme për parandalimin e dhunës, të cilat synojnë të eliminojnë ngacmimin, të parandalojnë zhvillimin e problemeve të reja ngacmuese, të arrihen marrëdhënie më të mira mes kolegëve në shkollë, të krijohet klimë pozitive në shkollë, dhe të rritjet sjellja e kujdesshme ndaj viktimës së ngacmimeve nga bashkëmohatarët dhe të rriturit. Një përpjekje për reduktimin e dhunës tek nxënësit në shollë është dhe ajo përmes *planifikimit sistematik*. Kjo qasje maksimizon shanset për ndërhyrje të suksesshme dhe përfshin pesë elemente: a) identifikimi i problemit; b) kërkon të identifikohen programet dhe procedurat që adresojnë nevojat e nxënësve në të gjitha nivelet e ekspozimit të dhunës në shkollë. c) analizimi problemit, d) propozim i reagimit, e) implementimi i reagimit.

54 Chris D. Erickson, Ph.D. & Monica M. Megivern, Ed.D. (2006). *Persistently Safe School “Comparing Treatments For Aggression Among Youth Exposed To Violence”*.

55 Russell Skiba, Kimberly Boone, Angela Fontanini, Tony Wu, Allison Strussell & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: *Preventing School Violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning*. The Safe And.

56 Chris D. Erickson, Ph.D. & Monica M. Megivern, Ed.D. (2006). *Persistently Safe School “Comparing Treatments For Aggression Among Youth Exposed To Violence”*.

57 Chris D. Erickson, Ph.D. a Monica M. Megivern, Ed.D. (2006). *Comparing treatments for aggression among youth exposed to violence: Persistently Safe Schools: Collaborating with Students, Families, and Communities*, fq.160.

Një mënyrë parandalimi të dhunës është ajo përmes *kurrikulave*, duke e bërë parandalimin pjesë e tyre. Këto programe përfshijnë udhëzime dhe diskutime për të ndryshuar perceptimet, qëndrimet dhe aftësitë e nxënësve. Disa nga këto kurrikula kanë filluar të aplikohen nga mesi i vitit 1980 duke përfshirë zgjidhjen e konflikteve, parandalimin e dhunës dhe zgjidhjen e problemeve sociale. Qasja e kurrikulave të tilla është integruar në program më të gjerë. Këto kurrikula kanë dëshmuar ndryshime premtuese në sjelljet dhe qëndrimet e nxënësve .

Për parandalimin e dhunës mes nxënësve, si një mundësi të mirë për përfshirjen e familjes në këtë drejtim, në literaturë gjejmë edhe sugjerimin se shkolla mund të organizojë *grupe prindërishe*, strategji kjo ku prindërit diskutojnë së bashku çështje që kanë të bëjnë me sjelljen agresive të nxënësve. Grupet mund të formohen edhe me vëllezërit dhe motrat për të ndihmuar personat e përfshirë në sjellje të dhunshme. Gjyshërit gjithashtu janë të përfshirë në procesin e prindërimit. Ata mund të jenë partnerë me shkollën në këtë drejtim Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link (2001)⁵⁸.

Përpjekje tjetër e shkollës për parandalim të dhunës është “*Programi për zgjidhje kreative të problemeve*”, i cili gjithashtu ka dhënë rezultate pozitive. Programe të tilla janë dhe ato që përfshijnë parandalimin e dhunës, programet e ndërmjetësimit të moshatarëve, përmes kurrikulave, programet e ndërmjetësimit të kolegëve dhe të përmirësuarit e sjelljes në klasë. (Russell Skiba, Kimberly Boone, etj)⁵⁹. Kjo qasje realizohet përmes ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet moshatarëve. Një qasje e tillë ka për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes moshatarëve përmes pjesëmarrësve vullnetarë si dhe me ndihmën e një pale të tretë.

Miratimi i kolegëve, ose siç njihet edhe ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konflikteve është njëra nga strategjitë e parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Qëllimi i kësaj strategjie është zgjidhja e keqkuptimeve dhe mosmarrëveshjeve duke përfshirë në proces pjesëmarrësit vullnetarë dhe ndihmën e një pale të tretë neutrale të trajnuar (marrë te: Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës (2005)⁶⁰. Përdorimi i ndërmjetësimit të kolegëve mundet ndjeshëm të ndikojë mbi qasjen dhe zgjidhjen e konflikteve nga nxënësit. Nxënësit e përfshirë në ndërmjetësimin me moshatarët shpesh shprehin gatishmëri të madhe që t’i ndihmojnë miqtë, t’i shmangin ose zgjidhin problemet. Ky program është një ndërmarrje komplekse dhe suksesi në zbatimin e tij varet nga përshtatshmëria e planifikimit, trajnimit dhe monitorimi i programit. Para se të fillohet me këtë program duhet kemi parasysh se: Cilët studentë mund të jenë ndërmjetësues dhe si do zgjidhen? Kur dhe ku do të ndodhë ndërmjetësimi? I rëndësishëm është trajnimi i ndërmjetësuesve dhe trajnimi fillestar kërkon të paktën 12/13 orë angazhim. Ky program i mëson nxënësit të përdorin metoda për të zgjidhur konfliktet e tyre pa përdorim të dhunës (Russell Skiba, Kimberly Boone, Angela Fontanini, Tony

58 Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link. School Violence: “Partnerships with Families For School Reform”. Michigan Family Review. Vol.6, no 1. (2001).

59 Russell.S, Boone.K, Fontanini.A, Wu. Toni, Strussell. A. & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: *Preventing school violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning*. The safe And Responsive School Project At The Indiana Education Policy Center.(2000).

60 Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. (2005).

Wu, Allison Strussell & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson)⁶¹. “Si rezultat i kësaj metode të rinjtë aftësohen në mënyrë efikase dhe të sigurt për zgjidhjen e mospajtimeve dhe konflikteve (p.sh., keqtrajtimi, rrahja, ngacmimi verbal). Që të dy, si viktima dhe autori i veprës janë në gjendje të identifikojnë përgjegjësinë dhe detyrimet si mjet të vlerësimit të dëmshpërblimit. Procesi ka për qëllim të sigurojë që të gjithë pjesëmarrësit të ndjejnë se është arritur e drejta për të gjitha palët”.⁶² Kjo metodë promovon një ambient kulturor ku njerëzit ndiejnë ndaj njëri-tjetrit, dhe i përkushtohen konceptit të një komuniteti të drejtë (cituar në Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës).

Një praktikë tjetër për parandalimin e dhunës tek nxënësit është edhe *Programi Këshillues*. Është kjo një ndërhyrje e hershme parandalimi. Gjatë kësaj praktike duhet fillimisht të dimë se nuk mund të kemi sukses në këshillim pa këshilltarë të kualifikuar. Këshillimi do një angazhim afatgjatë. Disa programe raportojnë se koha e nevojshme është një vit. Këto programe organizohen vetëm nga shkolla me përfshirjen e prindërit dhe komunitetin. Suksesi i këshillimit ndryshon në varësi të problemit që trajtojmë. Këshillimi ka rezultuar i suksesshëm sidomos me nxënësit me depresion. “për nxënësit me sjellje asociale, këshillimi nuk ka gjasa të jetë efektiv, vendosja e nxënësve në një situatë këshillimi në grup, në fakt përbën problem” (marrë te: Russell. S, Boone. K, Fontanini. A, Wu. Toni, Strussell. A. & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson:)⁶³. Sfida më e madhe e shkollës për aplikimin e këtij programi është sigurimi i këshilluesve profesionistë dhe me kohë të mjaftueshme për këshillim. Që këshillimi të jetë komponent efektiv në parandalimin e dhunës, shkolla mund të angazhojë punonjësit social të shkollave, psikologët, këshilluesit, ose nga personeli ekzistues i shkollës, por duke iu dhënë kohë atyre t’i përballojnë detyrat e tjera në shkollë dhe të kalohet përqindja më e madhe e përpjekjeve të tyre në këtë program parandalues⁶⁴.

Rrethi kohor është një tjetër strategji për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Kjo qasje realizohet duke caktuar një kohe specifike çdo javë, ku mësimdhënësit dhe nxënësit së bashku ulen në formë rrethore dhe realizojnë diskutime dhe aktivitete të ndryshme. Rrethi kohor është i strukturuar mirë dhe secilit nxënës i mundësohet të flasë dhe diskutojë për çështjen e caktuar. Nxënësit të cilët nuk duan të flasin e angazhohen vetëm thonë “kalo”, dhe biseda vazhdon. Kur rregullat krijohen me anë të angazhimit aktiv të nxënësve, një rreth i tillë i menaxhuar mirë krijon një ambient pozitiv që mund të kundërveprojë ndaj dhunës dhe të lehtësojë një qasje të zgjidhjes së konfliktit (Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës (2005)⁶⁵. “Kjo strukturë bën të mundur që nxënësit e zhurshëm të presin radhën në vend që të

61 Russell Skiba, Kimberly Boone, Angela Fontanini, Tony Wu, Allison Strussell & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: Preventing School Violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning. The Safe And Responsive School Project At The Indiana Education Policy Center. (2000). fq.21.

62 Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. Unicef. 2005. Fq. 62.

63 Russell.S, Boone.K, Fontanini.A, Wu. Toni, Strussell. A. & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: *Preventing school violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning*. The safe And Responsive School Project At The Indiana Education Policy Center. (2000).

64 Po aty

65 Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. 2005.

reagojnë në mënyrë impulsive me deklaratën e dikujt tjetër, ndërsa nxënësve më të urtë u sigurohet një ambient i qetë dhe më produktiv për të folur” (cituar në Hulumtimi mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës)⁶⁶. Përparësi e madhe e kësaj strategjia është ajo se bën të mundur që nxënësit të shpalosin shqetësimet dhe vështirësitë vetjake të përjetuara nga anëtarët e grupit, rrit komunikimin mes anëtarëve të klasës, afirmon qartë forcat e secilit anëtar të grupit, bën të mundur që ata të eksplorojnë raportet me të rriturit dhe bashkëmoshatarët e tyre, si dhe zhvillon ndjenjën e bashkëjetesës⁶⁷.

Zero tolerancë është një qasje tjetër e shkollës për parandalimin e dhunës. Kjo në fakt është një strategji e hershme reagimi e cila konsideron shumë të rëndësishme reagimin e hershëm para se përçarjet e vogla të kalojnë në dhunë. Kjo strategji nuk nënkupton ndërhyrjen e ashpër dhe ndëshkimin por ule mundësinë për dhunë duke krijuar një klimë pozitive në shkollë. Mesazhi i kësaj strategjie është i fuqishëm për familjen duke bërë që ata të perceptojnë së shkolla ka qëndrim të ashpër ndaj krimit. Kjo qasje bëri të rritet pezullimi dhe përjashtimi nga shkolla i nxënësve por, nuk ka prova se pezullimi dhe përjashtimi janë efektivë në ndryshimin e sjelljes apo bëjnë që shkolla të jetë më e sigurt. Russell. S, Boone. K, Fontanini. A, Wu. Toni, Strussell. A. & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson (2000)⁶⁸. Kjo strategji shikohet me mjaft skepticizëm. Shkolla sot synon të bëjë nxënësit të duan atë, ndërsa pezullimi i tyre nga shkolla bie në kundërshtim me këtë synim.

Menaxhimi i zemërimit, është një alternativë/plan i cili i ndihmon nxënësit agresivë të ndryshojë perceptimet e tyre dhe të mësojnë sjelljet alternative në situata konflikti. Është plan për mësimin e vetëkontrollit të nxënësve në situata sociale, duke perceptuar veprimet e të tjerëve si më armiqësore nga seç janë në të vërtetë. Është kjo një strategji të cilën mund të aplikojmë me nxënësin në bashkëpunim me familjen e cila sigurisht do të bëjë që fëmijët të jenë të përmbajtur në mënyrën e reagimit ndaj tjetrit.

Plani i sjelljeve individuale. Është detyrim i shkollës të kryejë vlerësimin e sjelljes së nxënësve. Një vlerësim i tillë bëhet në shkollën tonë por, këtij vlerësimi i mungon vlerësimi funksional i nxënësve. “Në vlerësimin funksional, psikologu i shkollës apo konsulentët e edukimit special, përdorin intervistat apo listat kontrolluese dhe vëzhgimin në mënyrë që të kuptojnë sjelljet shqetësuese dhe të zhvillojnë një plan specifik për të adresuar sjelljet shqetësuese”⁶⁹. Ky plan është shumë funksional për nxënësit problematikë, si për ata me aftësi të kufizuara ashtu edhe për ata pa aftësi të kufizuara.

Metodat alternative disiplinore. Strategji alternative për përcaktim të masave disiplinore. Një panel i përbërë nga studentë dëgjon kundërvajtjet disiplinore dhe caktimin e pasojave. Më rivendosjen e drejtësisë, nxënësit të cilët kanë dëmtuar një nxënës tjetër janë të detyruar të përballen me viktimën e tyre dhe veprimet e tyre, dhe të përballen me veprimin e tyre. Kjo bëhet me qëllim rivendosjen e ndjenjës së drejtësisë

66 Po aty, fq. 62.

67 Po aty.

68 Po aty.

69 Russell Skiba, Kimberly Boone, Angela Fontanini, Tony Wu, Allison Strussell & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: Preventing School Violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning, (2000). fq. 25. The Safe And Responsive School Project At The Indiana Education Policy Center.

tek nxënësit, Russell. S, Boone. K, Fontanini. A, Wu. Toni, Strussell. A. & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson (2000)⁷⁰.

Alternativa e cilësimit. Problemet e disa nxënësve mund të jenë aq të rënda sa që nevojitet të vendoset një alternativë për edukimin e tyre afatgjatë. Alternativa e planifikuar dhe e koordinuar mund ti përmbushë nevojat e nxënësve.

Tek: Russell Skiba, Kimberly Boone dhe të tjerë (2000)⁷¹ gjejmë strategjinë: *Qasja e komunitetit si ekip:* Problemet e përçarjes dhe dhunës tek të rinjtë shpesh janë komplekse, si plagosja në shkollë. Në raste të tilla është shumë e rëndësishme që agjencitë arsimore, të shëndetit mendor, mirëqenies dhe ato të zbatimit të ligjit të veprojnë së bashku. Kjo praktikë e parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve përfshin një komunitet më të gjerë dhe për rezultat kërkon reagim të njëjtë nga komunitetet e caktuara për bashkëpunim. Kjo praktikë nuk përfshin vetëm familjen, por ajo është njëra nga komponentët.

Menaxhimi dhe ndërhyrja në kriza. Planifikimi është më i mirë se sa paniku. I gjithë personeli dhe agjencitë duhet të përgatiten tu përgjigjen krizave, njohuritë ti komunikojnë me të gjitha palët e interesuara dhe të përgatiten për tu marrë me pasojat e tragjedisë. "Në tragjedi të rënda kombëtare të menduarit shpejt si rezultat i trajnimit të duhur të koordinatorëve të sigurimit të shkollës mund të parandalojnë një tragjedi të rëndë ose humbjen e jetëve"⁷². Në planifikimin e përgjigjes ndaj krimeve duhet të kihen parasysh tre komponentë. I pari dhe më thelbësori është zhvillimi i planit të ndërhyrjes. Plani duhet të specifikojë anëtarët dhe rolin e ekipit, i cili i përgjigjet krizës dhe duhet të përshkruajë trajnimin dhe komunikimin. I gjithë stafi duhet ti dijë kodet e sinjalizimit të emergjencave dhe të kenë të qartë se çfarë lloj veprimi duhet ndërmarrë në varësi të sinjalit. Sistemi i komunikimit duhet të kontrollohet paraprakisht për tu siguruar se i gjithë stafi do të njoftohet për emergjencën. Plani duhet të specifikojë mënyrën se si duhet të mblidhen dhe raportohen faktet rreth incidentit. Plani i zhvilluar mirë duhet të ketë parasysh edhe veprimet në menaxhimin e medieve: ku do vendosen; kush do flasë me media; si do mbrohen nxënësit e prindërit, Russell Skiba, Kimberly Boone dhe të tjerë (2000)⁷³.

Një qasje në parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve është dhe ajo përmes kurrikulës mësimore, e cila vepron në këtë drejtim me kohë dhe në vazhdimësi. Në këtë drejtim i suksesshëm rezulton edhe implementimi i *kurrikulës për edukimin për shëndet dhe siguri*. Kjo strategji iu mundëson nxënësve të njohin dhe zhvillojnë aftësitë e tyre për shkathtësi të sjelljes dhe jetesë të sigurt. "Kurrikula e edukimit shëndetësor mund të jetë një komponent shumë i mirë në parandalimin e dhunës dhe lëndimet e pa qëllimta dhe të vetëvrasjes"⁷⁴.

70 Po aty

71 Russell Skiba, Kimberly Boone, Angela Fontanini, Tony Wu, Allison Strussell & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: *Preventing School Violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning*. The Safe And Responsive School Project At The Indiana Education Policy Center. (2000).

72 Po aty, 26

73 Russell Skiba, Kimberly Boone, Angela Fontanini, Tony Wu, Allison Strussell & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: *Preventing School Violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning*. The Safe And Responsive School Project At The Indiana Education Policy Center. (2000). Fq.25.

74 Barrios.L.C, Sleet D. A, Mercy. J.CDC School Health Guidelines to Prevent Unintentional Injuries and Violence. American Journal of Health Education. September/October. 2003. Volume 34. No.5. Fq.20

Siç e shohim, strategjitë e prezantuara nuk na ofrojnë dëshmi të qarta për efikasitetin e qasjeve të ndryshme. Prandaj, ne synojmë parandalimin e dhunës përmes përfshirjes së vazhdueshme të familjes në shkollë, strategji kjo e qëndrueshme për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Por, kjo sigurisht nënkupton se shkolla megjithatë duhet të ketë plane veprimi si edhe strategji për zgjidhjen e problemeve të dhunës ndërmjet nxënësve.

2.4. STUDIMET PËR DHUNËN NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Janë të shumta studimet për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë. “Studimet e para në fushën e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë u kryen në fund të viteve të 60-të të shekullit të kaluar në Suedi, dhe ky trend pastaj do të vazhdojë edhe në vendet e tjera skandinave, për shkak se dhuna në shkollë në këto vende ishte bërë problem dominant”⁷⁵.

Ndërsa analizat e para shkencore për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë janë bërë në vitet 80-të, dhe arsye ishte sidomos fakti se në Norvegji disa nxënës të shkollës fillore kishin kryer vetëvrasje për shkak të dhunës së ushtruar ndaj tyre nga bashkëmoshatarët, Marzeku, M. (2012)⁷⁶.

Dhuna është problem global. “Prezenca e dhunës ndërmjet nxënësve (moshatarëve) është konstatuar në gjithë botën dhe është hulumtuar kudo në Evropë, SHBA, Austri, Zelandë të Re, Japoni, etj. Sipas një pasqyre, rezultati për ekspozimin e dhunës që është fituar nga studimet e bëra në Austri, Angli, Finlandë, Gjermani, Norvegji dhe SHBA – luhetat nga 15% deri në 25%. (cituar nga Marzeku, M. 2012)⁷⁷,

Ndërsa në SHBA është realizuar një studim në nivelin kombëtar, ku janë përfshirë rreth 16.000 nxënës nga klasa e 6-të deri në të 10-tën, në të cilin del se rreth 30% e nxënësve janë përfshirë në dhunë të përsëritur, 13% si dhunues, 10,6% si viktimë, ndërsa 6% si viktimë dhe si dhunues (T, Nansel & Overpeck, M & Scheidt, P. 2001)⁷⁸.

Studimi i realizuar në Norvegji me nxënësit e grupmoshës 11-14 vjeç konstaton se më pak se 55% e nxënësve i keqtrajtojnë bashkëmoshatarët një herë në javë apo edhe më shpesh. Studimi gjen edhe se djemtë janë tre-katër herë më shumë dhunues se sa vajzat (Roland, E & Idsoe, Th. 2001)⁷⁹.

“Edhe në planin e gjerë ndërkombëtar rezultatet e studimeve dëshmojnë për prezencën gjithnjë në rritje të formave më të ashpra të dhunës në shkollë. Kështu, rezultatet e studimeve të bëra në vitet 2002/2002 në 5 vende, duke përfshirë edhe disa vende të rajonit, me më se 120.000 nxënës të moshës 11, 13 dhe 15-vjeçare treguan nivelin shqetësues të dhunës në shkollë. Rreth 34% të nxënësve të anketuar dëshmuuan se një herë i ishin ekspozuar dhunës – ndërkohë që ekzistojnë edhe dallime të mëdha ndërmjet shteteve. Përqindja e atyre të cilët ishin ekspozuar ndaj dhunës vetëm një herë luhetat në varësi nga shtetet/rajonet ndërmjet nxënësve të moshës 11 vjeç: 14%-63%,

75 Marzeku, M. (2012). *Dhuna ndërmjet nxënësve dhe tipologjia e saj*. Prishtinë. “Berati”. Prizren. fq.23
76 Po aty

77 Po aty, fq.31

78 T, Nansel & Overpeck, M & Scheidt, P. (2001). *Bullying Behaviors Among US Youth: Prevalence and Association With Psychosocial Adjustment*. Journal of Americal Association, 285(16), fq. 2094-2100

79 Roland, E & Idsoe, Th. (2001). *Aggression and bullying”Aggressiv behaviour”*.

ndërmjet 13-vjeçarëve: 17%-69, ndërmjet 15-vjeçarëve: 12%-61%. Prej tyre 11% i ishin ekspozuar dhunës deri në dy-tri herë në muaj. Përqindja e ekspozimit të shpeshtë ndaj dhunës luhetet në varësi të shtetit/rajonit: 4%-28% ndërmjet 11-vjeçarëve, 6%-36% ndërmjet 13-vjeçarëve dhe 2%-32% ndërmjet 15-vjeçarëve. Është konstatuar se ekspozimi ndaj dhunës zvogëlohet me rritjen e moshës, ndërsa në mes gjinive ndryshimet janë relativisht të vogla. Shqetësues është edhe numri i nxënësve të cilët pranojnë se i kanë keqtrajtuar të tjerët. Kjo përqindje, e cila është 35% për tërë mostrën, sillet varësisht nga shteti/rajoni, 9%-54% për 11-vjeçarët, 17%-71% për 13-vjeçarët dhe 19% - 73% për 15-vjeçarët. Në 20 nga 35 vende, dhuna ishte më e shpeshtë te moshë 13 vjeçare, ndërsa në 10 vende ajo rritet me rritjen e moshës. Ndërmjet dhunuesve kishte dukshëm më shumë djem se sa vajza. Edhe rrahjet janë treguar si relativisht të shpeshta: 39% e fëmijëve një herë në muaj janë rrahur gjatë një periudhe njëvjeçare, ndërsa 10% e tyre janë rrahur tri a më shumë herë. Sipas shkallës së dhunës në krye ishte Estonia, Groenlanda, Letonia, Lituania, Portugalia dhe Ukraina. Ndër vendet me më pak dhunë në shkollë ishte Çekia, Sllovenia, Suedia dhe Kroacia⁸⁰ (cituar në Marzeku, M. 2012).

Në Kosovë janë bërë disa studime mbi dhunën ndaj nxënësve në shkollat e Kosovës, por jo edhe dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë. Një studim është kryer për dhunën ndaj nxënësve në shkollat nga UNICEF, i cili kishte për qëllim të hetonte natyrën dhe shtrirjen e dhunës ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. Ky studim trajtoi dhunën ndaj fëmijëve nga arsimtarët, fëmijët e tjerë, si dhe dhunën nga prindërit. Për dhunën e ushtruar mbi nxënësit nga nxënësit e tjerë studimi ka gjetur se më pak se gjysma e nxënësve kanë deklaruar se të tjerët i përqeshin. Forma më e shpeshtë e dhunës nga bashkëmoshatarët është përqeshja dhe thirrja me emra fyes, e përjetuar nga gjysma e të rinjve. Rreth ¼ e të anketuarve janë lënduar fizikisht nga fëmijët e tjerë. Katër nga pesë fëmijët më të rritur kanë thënë se dhuna më e madhe paraqitet ndërmjet fëmijëve të klasave të ndryshme, duke treguar kështu se rivaliteti ndërmjet klasave mund të jetë një burim i dhunës në shkollë. 39% e fëmijëve deklaruan se ka pasur dhunë ndërmjet nxënësve nga e njëjta klasë. Nxënësit raportojnë se janë të frikësuar nga bashkëmoshatarët e tyre, të cilët janë të dhunshëm apo agresivë (zakonisht fëmijët më të fortë fizikisht). Në këtë studim, sa i përket dhunës fizike, 415 e të anketuarve kanë thënë se bashkëmoshatarët i kanë goditur ose kanë përdorur dhunë, ndërsa 58% e të anketuarve kanë thënë se kurrë nuk janë injoruar ose neglizhuar nga fëmijët tjerë. 13% e fëmijëve të anketuar kanë thënë se të paktën një herë janë prekur nga fëmijët e tjerë, ose janë puthur ose ju kanë hequr rrobat me force. Raport: Studim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. Maj-Shtator, (2005)⁸¹.

Ndërsa në doracakun⁸² e botuar nga KEC dhe UNICEF, i cili kishte për objektiv krijimin e rrjetit të fuqishëm mbrojtës që do të kontribuojë në parandalimin e dhunës dhe krijimin e mjediseve të sigurta jo të dhunshme në shoqërinë Kosovare dhe në shkollë, gjejmë se: në disa vende përcillet edhe dokumentohet numri i vetëvrasjeve

80 Marzeku, M. (2012), *Dhuna ndërmjet nxënësve dhe tipologjia e saj*. "Berati". Prizren. fq.33

81 Raport: Studim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. United Nations Children's Fund-UNICEF. Maj-Shtator, 2005.

82 Ky doracak është shkruar mbi bazën e disa projekteve që MASHT-i, UNICEF-i dhe KEC-i kanë realizuar në Kosovë nga viti 2002.

që janë pjesërisht edhe pasojë e keqtrajtimit të moshatarëve”⁸³. Në po të njëjtin tekst, ofrohen të dhënat nga studimi i realizuar në Kosovë ku raportohet se “keqtrajtimi i fëmijëve nga moshatarët e tyre paraqet problem në rritje në shoqërinë Kosovare.”⁸⁴.

Në studimin tonë vëmendje e posaçme i është kushtuar faktorëve të cilët ndikojnë në prezencën e dhunës ndërmjet nxënësve, preokupim ky edhe tek studiuesi Lockwood (1997)⁸⁵ i cili studioi faktorët që ndikojnë te dhuna ndërmjet nxënësve, si: marrëdhëniet midis antagonistëve, sekuenca e ngjarjeve në frekuentim, ku përfshihen qëllimet dhe arsyet e nxënësve të përfshirë në studim, gjithsej 110, në të cilin del se dhuna mes nxënësve ishte në nivelin 16% për sa i përket tipit, ku më të shprehura ishin fjalët fyese, gjuajtja me gjësende, shtyrjet, rrëmbimet, shpullat, goditjet me grusht, goditjet me objekte, kërcënimet me armë ose thikë. Më e shpeshta ishte goditja me grusht në dy të tretën e rasteve, përdorimi i thikës ndodhi më së paku në 2% të rasteve të shprehura në përqindje. Sa i përket vendndodhjes, rreth tre e katërta e incidenteve kanë filluar në shkollë. Rreth gjysma prej tyre janë zhvilluar në shkollë, palestër apo qendra rekreative. Sa i përket arsyes del se ishte për vetëmbrojtje apo për ti rezistuar kërkesave e antagonistit.

Një studim tjetër mbi faktorët që ndikojnë në shtimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë është ai i kryer nga “Grunseit et. al (2005) ku është gjetur se pavarësisht se shkolla ka pasur një ndikim të qartë në dhunën ndërmjet nxënësve, faktorët individualë dhe familjarë janë të lidhur me dhunën që ushtrohet në mjediset shkollore”⁸⁶.

Studimi tjetër mbi dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë trajton dhunën në totalin e nxënësve dhe vjen në përfundim se: “Përtej ndikimit të faktorëve individualë dhe kulturorë, në totalin e dhunës ndërmjet nxënësve, faktorët që lidhen me, menaxhimin, organizimin apo kulturën e një shkolle, bënë një ndryshim të rëndësishëm për gjasat që një nxënës të përfshihet në dhunë, ose sjellje të pahijshme në shkollë”⁸⁷.

Për dhunën ndërmjet nxënësve gjejmë dhe disa studime të tjera eksperimentale dhe jo-eksperimentale. Kështu, “në një studim jo eksperimental, studimi tregon se karakteristikat personale, besimet dhe qëndrimet, janë faktorë kyç nëse nxënësi përfshihet në sjellje të dhunshme”⁸⁸.

Në studimet e tij Grunseit gjen se, përdorimi i dhunës në familje ka ndikim të fortë mbi tendencën që një i ri të jetë i dhunshëm. Sipas tij këtu kemi të bëjmë edhe me prindër të cilët e tolerojnë sjelljen e dhunshme. Te ky studiues del edhe ky faktor që ndikon në prezencën e dhunës te nxënësit. Sipas Grunseit shkolla mund të bëjë shumë për tu parandaluar dhuna mes nxënësve, por ajo varet nga shkalla se sa është e përkrahur dhuna brenda familjes dhe më gjerë (cituar në Working together, 2012).

Në interesin tonë ishte të kuptojmë edhe faktin se dhuna manifestohet më shumë tek djemtë apo vajzat.” Dhjetë vitet e fundit, hulumtuesit kanë gjeneruar shumë studime

83 Doracak për krijimin e mjedisëve të sigurtë për të dhunshme e humane në shoqëri dhe në shkolla, KEC, UNICEF, Prishtinë, 2009, Fq.110

84 Po aty, fq. 110

85 Lockwood, D. (1997). *Violence Among Middle School and High School Students: Analysis and Implications for Prevention*. National Institute of Justice. October, 1997.

86 Working together. (2010). *An initiative of the Queensland School Alliance Against Violence*.

87 Po aty

88 Working together. (2012). *An initiative of the Queensland School Alliance Against Violence*

empirike të agresionit tek vajzat në disa disiplina të ndryshme (psikologjia zhvillimore, psikiatria e fëmijëve dhe kriminalistika). Shumica e studimeve kanë identifikuar sjellje të çrregulluara si një gamë e rëndë mendore”⁸⁹.

Në këtë drejtim është kryer një studim nga një grup autorësh ku, “në mesin e variablave të përfshira, problemi i ngacmimit del të jetë më i shpeshtë tek djemtë se sa te vajzat. Vajzat janë të përfshira më shumë në ngacmime psikologjike, ndërsa tek djemtë ngacmimi fizik është më i shpeshtë se tek vajzat”⁹⁰. Ndërsa, sa i përket moshës ngacmimi si sjellje është relativisht më i zakonshëm te fëmijët e të rinjtë se sa tek ata më të vjetër në moshë. (cituar në Pulido R., Martín Seoane G., Díaz Aguado M. J.2010)⁹¹.

Te studimi i Pulido R., Martín Seoane G., Díaz Aguado (2010)⁹², i cili kishte për qëllim të shqyrtonte rastet e situatave të dhunshme në një mostër përfaqësuese të realizuar me 1.635 studentë, variablat e matura ishin shpeshtësia e dhunës në shkollë dhe statusi i kolegëve. Situatat më të shpeshta të dhunës duket se janë ato verbale dhe të përjashtimit, duke vijuar me agresionet verbale dhe dhuna kundër pronave. Përqindja e atyre që vuajnë situata ekstreme (si abuzimi seksual, kërcënimi me armë) të dhunës janë më të ulëta, por serioziteti i këtyre situatave e bën atë shumë të rëndësishme.

Studimet e shumta për dhunën ndërmjet nxënësve tregojnë se dhuna ndërmjet nxënësve shkakton efekte negative në aspektin akademik, fizik, social, emocional e sidomos psikologjik të nxënësve. Pasoja këto afatshkurtra dhe afatgjata.

Studimet për dhunën gjithashtu tregojnë se nxënësit të cilët kanë përjetuar dhënë në shkollë shfaqin sjellje si: ankthi, trishtimi, vetmia, pasiguria. Kemi dhe të tillë të cilët shfaqin sjellje eksternalizuese si hiperaktiviteti dhe impulsiviteti. Disa shfaqin dhe sjellje të tilla që përfshijnë frustrim, pikëllim dhe zemërim. Veç të tjerash, të gjitha këto arsye e bëjnë të domosdoshëm bashkëpunimit shkollë-familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

2.5. STUDIMET PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE

Gjatë shqyrtimit të literaturës kemi hasur në studime të shumta për dhunën dhe parandalimin e saj, por, të pakta për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Kryesisht fokusi i parandalimit të dhunës binte mbi dhunën e mësuesve ndaj nxënësve dhe atë të familjes ndaj fëmijës. “Studimet aktualisht nuk tregojnë ndonjë program ose praktikë të veçantë për reduktimin e dhunës” (cituar nga Working Together, 2010)⁹³. “Si rezultat i arsyeve të ndryshme për bashkëpunim, ka shumë pak hulumtime dhe literaturë dhe pak literaturë të përgjithshme për bashkëpunimin midis shkollës dhe komunitetit, por

89 M.D. And Christopher Thomas, M.D 2004) *Recent Research Findings on Aggressive and Violent Behavior in Youth: Implications for Clinical Nancy Rappaport*. Journal of Adolescent Health .nr.35:260–277

90 : Pulido R., Martín Seoane G., Díaz Aguado M. J. *School violence roles and sociometric status among Spanish students* US-China Education Review, Jan. 2010, Volume 7, no.1 (Serial no.62) fq. 52.

91 Po aty, fq.52.

92 Pulido R., Martín Seoane G., Díaz Aguado (2010). *School violence roles and sociometric status among Spanish students*. Jan. 2010, Volume 7, No.1 (Serial No.62)

93 Working together. (2010). *An initiative of the Queensland School Alliance Against Violence*.

nuk ekziston asnjë katalog i plotë”⁹⁴. “Edhe pse të dhënat janë të rralla, një konkluzion i arsyeshëm nga kërkimet e në dispozicion është se bashkëpunimi shkollë-komunitet mund të jetë me efektivitet dhe me kosto efektive afatgjatë”⁹⁵.

Studimi i kryer nga Claire v.c; Scott, ; Katreena; Ellis; Wendy; Wolfe; David.A (2011)⁹⁶ u krye me N = 1,722; 52.8% femra, në 20 shkolla. Në këtë studim janë marrë informacionet bazë: p.sh., gjinia, përvojat e keqtrajtimit të fëmijës dhe sjellja e dhunshme në klasë. Studimi kishte për objektiv të konstatoj se fëmijët me historik keqtrajtimi a kanë tendencë manifestimi të dhunës, duke synuar të konstatojnë nëse pjesëmarrja në një program bazë të shkollës për parandalimin e dhunës në klasën e 9-të vazhdon të japë efektin e ndikimit në aktet e dhunshme tek të rinjtë me histori keq trajtimi. Dy vjet pas ndërhyrjes tek këta fëmijë, zbulohet se te këta fëmijë edhe pse është ndërhyrë, aktet e dhunës vazhdojnë të manifestohen. Fuqia e kësaj marrëdhënie ishte dukshëm më e ulët në shkollat ku është ndërhyrë.

Ndërsa, Bender, C.J.G & Emsilie, A (2010)⁹⁷, trajtojnë çështjen e parandalimit të dhunës mes nxënësve duke përfshirë stafin e shkollës, familjen dhe nxënësit. Ata përshkruajnë se si bashkëpunojnë anëtarët e stafit të shkollës, nxënësit, dhe prindërit për të parandaluar dhunën mes nxënësve në dy shkolla të mjedisit urban. Studim i tyre gjeti se në kundërshtim me besimin aktual, në mënyrë empirike nxënësit shprehën nevojën për mbështetjen e stafit të shkollës dhe këshillat e prindërve për tu përballur me presionin nga ana e bashkëmoshatarëve, i cili mund të rezultojë në veprimet e tyre agresive ose të dhunshme në shkollë.

Qasja e Rudolla, B (2011)⁹⁸ për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve është përmes strategjive të mësimdhënies, duke u përqendruar në vlerësimin dhe reflektimin në mënyrë në mënyrë që të nxitet të mësuarit efektiv nga ana e nxënësve dhe rritet performanca e tyre akademike.

Në studimin e tyre (John Lamanna, M. Ann Shillingford, Mary-Frances Parrish, and Rebecca Sheffield)⁹⁹ hulumtuan ndikimin e dhunës psikologjike në K-12 studentë dhe rëndësinë e partneriteteve bashkëpunuese ndërmjet familjes dhe shkollës për zvogëlim e efekteve dramatike nga ngacmimet mes nxënësve.

Për parandalimin e dhunës në shkollë, studiuesit Sugai dhe Horner, rekomandojnë kulturë pozitive shkollë dhe programe radikale kundër dhunës. Kjo përfshin ndërtimin e kulturave të kompetencave sociale të cilat mbështesin sjelljet pro sociale dhe maksimizojnë të mësuarit. Mjetet e auditimit që ndihmojnë personelin e shkollës dhe nxënësit të shqyrtojnë kulturën e tyre shkollë ose klimën si pjesë e një përgjigje ndaj dhunës studentore (cituar në Working together, 2010)¹⁰⁰.

94 Howard Adelman, Ph.D.Linda Taylor, Ph.D. (2007). *School family, and Community involvement*, fq.19-25

96 Claire v.c; Scott, ; Katreena; Ellis; Wendy; Wolfe; David.A (2011). *Impact of a universal school-based violence prevention program on violent delinquency: Distinctive benefits for youth with maltreatment histories Child Abuse & Neglect* 35 (2011) 393– 400

97 Bender, C.J.Gerda & Emsilie, Annemarie. (2010): *An analysis of family-school collaboration in preventing adolescent violence in urban secondary schools. Perspectives in Education*. Volume 28. Issue 3. Fq.55 - 69

98 Rudolla,B (2011). *Preventing school violence*. ERIC

99 John Lamanna, M. Ann Shillingford, Mary-Frances Parrish, and Rebecca Sheffield College of William and Mary: Counseling Group Curriculum for Parents on Bullying.

100 Working together. (2010). *An initiative of the Queensland School Alliance Against Violence*.

Një përpjekje tjetër për parandalimin e dhunës mes nxënësve është ajo përmes kurrikulave mësimore, të cilat ofrojnë strategji të shëndosha për parandalimin e dhunës, sipas të cilave vlerësimi i disa programeve ka sugjeruar se dhuna sistematike edhe e qëndrueshme – udhëzimi për parandalimin është një qasje premtuese që mund të kontribuoj në sigurinë e shkollës, në të cilën qasje autori konsideron sfidë të rëndësishme miratimin e programit të tillë si dhe faktin se duhet të gjendet një qasje në përputhje me nevojat e shkollës. (Russell. S, 2000)¹⁰¹.

Për parandalimin e dhunës te nxënësit në tekstin “Working together” mbahet qëndrimi se shkolla duhet ta bëjë këtë përmes reduktimit të mundësive që nxënësit të angazhohen në sjellje duke rritur vet kontrollin dhe lidhjet e tyre shoqërore. Maksimizimi në të mësuarit e nxënësve dhe në angazhim, modeli i sjelljes së duhur, dhe krijimi i një sistemi të drejtë dhe vetë disipline, rrisin besimin e nxënësve në vlefshmërinë e rregullave dhe ligjeve (Worcing Together”, 2010)¹⁰².

Kemi shumë studime të cilat fokusohen në bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes, por nuk kemi hasur studime të cilat kanë pasur në fokus parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve përmes përforsimit të bashkëpunimit shkollë -familje. Studimi i vetëm që është gjetur është ai i Keyes. C¹⁰³, i cili trajton faktorët që ndikojnë në bashkëpunimin shkollë-familje, si: shkalla e përputhjes së kulturës dhe vlerave të shkollës dhe familjes; forca sociale në punë e familjes dhe shkollës; si mësuesit e prindërit i shohin rolet e tyre.

Për parandalimin e dhunës mes nxënësve disa autorë rekomandojnë programet e ndryshme për prindërit. “Për shkak se studimet kanë treguar se disa nga faktorët më të rëndësishëm për dhunë kanë origjinë në familje” (cituar nga :Breunlin.d, Edwards.t, Heherington.j.)¹⁰⁴. Gjithashtu, Redd (1981)¹⁰⁵ gjeti se nxënësi ndikohet nga qëndrimi i prindërve rreth konfliktit. Në studimin e Lokwood. D (1997)¹⁰⁶ rekomandohet programi për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, sipas të cilit duhet të fokusohemi në mbikëqyrjen nga ana e të rriturit, duke përfshirë këtu mësuesit dhe nënat të cilët duhet të trajnohen për zgjidhjen e konflikteve, sepse ata janë ndërmjetësuesit më të mirë. Autori rekomandon programe për parandalimin e dhunës drejtuar dhe mësuesit i cili duhet të di se si ti trajtoj marrëdhëniet në klasë. Për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve autori rekomandon strategji specifike parandaluese, duke u nisur nga fakti se p.sh., edhe pse fyerjet dhe përgojimi janë sulme të vogla ato shihen si sjellje me rrezik për dhunën dhe duhet të trajtohen si pjesë e strategjisë, apo shokët ndërmjetësues të cilët shpesh janë të pranishëm në dhunë.

101 Russell.S, Boone.K, Fontanini.A, Wu. Toni, Strussell. A. & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: *Preventing school violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning*. The safe And Responsive School project At The Indiana Education Policy Center.(2000).

102 Worcing Together”. (2010). *An initiative of the Queensland School Alliance Against Violence*.

Russell.S, Boone.K, Fontanini.A, Wu. Toni, Strussell. A. & Indiana Education Policy Center & Reece Peterson: *Preventing school violence: A Practical Guide to Comprehensive Planning*. The safe And Responsive School Project At The Indiana Education Policy Center.(2000).

103 Carol R, Keyes. (2000).*Parent-Teacher Partnerships: A Theoretical Approach for Teachers*.ERIC.

104 Breunlin.d, Edwards.t, Heherington.: *Conflict resolution training as an alternative to suspension for violent behavior*.The Journal of Eeducation Research.July/August(2000).Vol.95No.6. Fq.351

105 Rend,R.J. (1981). *Administrators’ advice: Causes and remedies of sschool conflict and violence*. Nacional Association of Secondary school Princioals Bulletin. 12(2). 75-79.

106 Lockwood, D., (1997). *Violence Among Middle School and High School Students: Analysis and Implications for Prevention*. National Institute of Justice

Tek Johnson, S; Burke,J; Gielen, A (2000)¹⁰⁷ gjejmë një studim të realizuar nga Lindstrom. L, Burkw. J, Gielen. A ku konstatohet rëndësia relative e karakteristikave të mjedisit shkollor dhe ndikimit të tyre në rezultatet e dhunës. Studimi tregon rolin e mjedisit shkollor në parandalimin e dhunës, sidomos parandalimin në fillimin dhe reduktimin e ashpërsisë së dhunës në shkollë. Dhe më shumë se gjysma e deklaratave të mbledhura nga studentët vlerësuan karakteristikat mjedisore të shkollave si shumë të rëndësishme për fillimin, ndërprerjen dhe/ose ashpërsinë e dhunës në shkollë. Pjesëmarrësit në studim vlerësuan prirjet e vet nxënësve, prirjet për sjellje përçarëse dhe mjedisin jashtëshkollor si karakteristika më të rëndësishme për fillimin dhe rritjen e ashpërsisë së dhunës në shkollë.

Në përmbyllje të këtij nën kapitulli, mund të përfundojmë se janë të shumta strategjitë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, por, jo dhe ato në bashkëpunimin me familjen. Në këtë drejtim gjatë shqyrtimit të literaturës kemi hasur strategjitë e drejtuara në arritje të nxënësve.

2.6. FAKTORËT PËR BASHKËPUNIM TË SUKSESSHËM SHKOLLË-FAMILJE NË DREJTIM TË PARANDALIMIT TË DHUNËS NË SHKOLLË

Nisur nga fakti se nuk duhet të mjaftohemi vetëm me konstatimin se kemi dhunë ndërmjet nxënësve, dhe nxitur nga dëshira për gjetjen e rrugës për parandalimin e saj, mënyra më e mirë për parandalimin e dhunës mes nxënësve, që me kohë bën të zbulohet dhe të reagojmë ndaj saj është përmes përforsimit të bashkëpunimit të shkollës me familjen. Ndërsa faktorë të identifikuar nga studimi-intervistat me familjen dhe shkollën, të cilët bëjnë që ky bashkëpunim të jetë i suksesshëm, dolën: mirëpritja e familjes nga ana e shkollës, komunikimi i drejtë mes familjes dhe shkollës, informimi i drejtë dhe i mjaftueshëm shkollës-familje, ndarja e detyrave mes familjes dhe shkollës, vendimmarrja e familjes në shkollë, mbështetja e suksesit të nxënësve nga shkolla, eksperiencia e mëparshme e familjes me shkollën dhe besimi i familjes në shkollën.

Në këtë kapitull do i referohemi literaturës për rëndësinë e këtyre faktorëve në bashkëpunim me familjen.

2.6.1. *Mirëpritja e familjes nga shkolla - faktorët për përfshirjen e familjes në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.*

Bashkëpunimit cilësor shkollë-familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve fillimisht i paraprin mirëpritja. Kjo nënkupton faktin se familja kur është në shkollë duhet të ndihet se është pjesë e saj, ta shohë shkollën si vend që atyre “iu takon të jenë pjesë”, të gjithë të trajtohen njësoj pavarësisht nivelit të tyre arsimor, kulturor, social, etj. Shkolla duhet të jetë institucion mbështetës për fëmijët dhe familjet e tyre gjithashtu.

Fakti nëse familja nuk ndjehet e mirëpritur përbën burimin e barrierave të ndryshme

107 Johnson,S; Burke,J; Gielen,A. (2000). *Prioritizing the School Environment in School Violence Prevention Efforts*. Journal of school health. Amercan scool health asocaton.

mes shkollës dhe familjes. Ne këtë pjesë të punimit do përqendrohemi në konstatime te autorëve të ndryshëm për këtë faktor kaq të rëndësishëm në bashkëpunim të familjes me shkollën, por fillimisht do nisemi nga Ligji Mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë¹⁰⁸, në të cilin haset deri diku mirëpritja e familjes në shkollë në nenin 9 të tij, ku në paragrafin 9.3. paraqitet e drejta e prindërve mbi parashtrimin e ankesës për ambientin në institucionin arsimor. Çuditërisht në nenin në fjalë prindërit nuk trajtohen aspak si pjesë integrale e shkollës, por vetëm si reagues ndaj situatave të caktuara.

Arsyeja pse disa shkolla kanë bashkëpunim më të mirë se të tjerat, veç të tjerash ka të bëjë me mirëpritjen që shkolla i ofron familjes. Pranimi jo i mirë i familjes në shkollë i bën prindërit të jenë pjesë e saj ose të jenë jashtë shkollës. Një studim tregon se 75% e mësuesve duan që prindërit të përfshihen në shkollë dhe 74% e prindërve duan të jenë të përfshirë në shkollë Berger, (2000)¹⁰⁹. Sigurisht që përfshirja më e gjerë e prindërve përkatësisht e familjes në shkollë i bën ata të ndihen të mirëpritur, se shkolla i mban dyert e hapura për ta, Berger, (2000)¹¹⁰, në studimet e saj vërteton se familja ndihet e mirëpritur në shkollë nëse shkolla bën të mundur që stafi i saj të përbëhet nga njerëz të cilët bëjnë që vizitorët të ndjehen të mirëpritur.

Sylaj (2013), mirëpritjen e familjes në shkollë e konsideron si një nga faktorët parësorë për bashkëpunim në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Studiuesja konsideron se pikërisht "arsyeja përse disa shkolla kanë bashkëpunim më të mirë me familjen e të tjerat jo, varet nga mirëpritja që i ofrohet familjes nga shkolla"¹¹¹.

Gjithashtu, si çdo nxënës që është një personalitet më vete ashtu edhe çdo prind është një personalitet më vete. Në shkollë prindërit vijnë me nivele të ndryshme të shkollimit të tyre dhe me nivel të ndryshëm të kulturës pedagogjike, atëherë: "nëse shkolla dhe mësuesit arrijnë të njohin, kuptojnë dhe respektojnë diversitetin e ndjenjave të prindërve ndaj shkollës, në varësi të tyre, përvojat e veta shkollore, ajo ka me shumë gjasa të ketë sukses në ndërtimin e të paktën hapave të para të partneritetit" (Kreso, 2004)¹¹². Respektimi i diversitetit është një element të cilit i duhet kushtuar vëmendje në kuadër të mirëpritjes së familjes në shkollë. "Po sipas të njëjtit studiues, disa prindër do ta përjetojnë me gëzim mendimin e vizitës së ardhshme në shkollë, ndërsa të tjerët do jenë të frikësuar dhe në një farë mënyre të bllokuar nga njoftimi për takimin e radhës në shkollë. Është detyrë e shkollës të jetë shumë mirëpritëse duke ju krijuar familjeve të grupit të dytë emocione pozitive në shkollë.

Hulumtimet sugjerojnë se ekziston një lidhje midis përfshirjes së familjes në shkollë dhe mirëpritjes, ndërsa, ata mund të jenë të përfshirë nëse klima shkollore, dhe atmosfera sociale dhe e edukimit në shkollë - është ajo që i bën ata të ndjehen të mirëpritur, të respektuar, të besuar, të dëgjuar dhe të nevojshëm Debbie Ellis & Kendra Hughes, (2002)¹¹³. Gjithashtu edhe autori i librit "Effects of Parental Involvement in

108 Ligji "Mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë", nr. 2002/2.

109 Berger, E.H. (2000). *Parents as partners in education: Families and schools working together*. New Jersey: Merrill Publishing Company.

110 Po aty.

111 Sylaj (2013). "Welcoming families-important factors for cooperation between school and family to prevent violence among students by school". SEEU Review. Volume 9. No.1. fq.3

112 Kreso, A. P. (2004). *Koordinate obiteljskog odgoja*, Sarajevo. New Jersey: Merrill Publishing Company.

113 Debbie Ellis & Kendra Hughes, (2002). *Partnerships by design*.

Education” – Gudlaug, thekson se “përfitimet nga përfshirja e prindërve janë të shumta. Ai thekson gjithashtu rëndësinë që prindërit të ndjehen të mirëpritur dhe të respektuar në shkollë. Faktori kyç që mundëson përfshirjen e prindërit është krijimi i një klime shkollore ku prindërit shpesh të ftohen që të përfshihen në shkollë, dhe që prindërit ta perceptojnë se janë të mirëpritur”¹¹⁴.

Berger (2000)¹¹⁵ në studimet e saj vërteton se familja ndihet e mirëpritur në shkollë nëse shkolla bën të mundur që stafi i saj të përbëhet nga njerëz të cilët bëjnë që vizitorët të ndjehen të mirëpritur. Autorja mirëpritjen e familjes nuk e fokuson vetëm tek mësuesi, por dhe tek drejtuesi dhe i gjithë stafi i shkollës.

Duke ditur rëndësinë e prezencës së familjes në shkollë për bashkëpunimin me qëllim parandalimin e dhunës mes nxënësve në shkollë, atëherë në bashkëpunimin e shkollës dhe familjes duhet të kemi shumë kujdes për krijimin e një klime mirëprirëse të familjes në shkollë, e cila nxit besim mes shkollës dhe familjes¹¹⁶. Mirëprirja e familjes nga shkolla është një çështje mjaft komplekse, kompleksitet që manifestohet edhe në faktin se jo të gjithë prindërit trajtohen njësoj në shkollë “eliminimi i injorancës, diskriminimit në shkollën demokratike është një nga mundësitë që të gjithë të marrin pjesë në mënyrë domethënëse para se shkolla të përmbushë plotësisht sfidat e së ardhmes”¹¹⁷.

Në librin “Prindërit shpëtimtarë e jetës”, i autorit (Batey, C.)¹¹⁸ thuhet se prindërit, shpesh, ftohen të marrin pjesë në projektimin e strategjive për angazhimin e prindërve, sepse në fund të fundit, ata mbajnë barrën kryesore për edukimin e fëmijëve. Por, megjithatë, shpesh të tilla përpjekje dështojnë, sepse atmosfera në shkollë është e ftohtë dhe e papërshtatshme. Po i njëjti autor e konsideron drejtorin e shkollës si faktor të mirëprirjes së familjes në shkollë, i cili duhet së bashku me stafin e shkollës tu shpjegojë prindërve qëllimet e shkollës dhe mënyrat se si mund ata të ndihmojnë.

Për mirëprirjen e familjes në shkollë Voltz (1994) këshillon edukatorët tu drejtohen prindërve duke përdorur tituj të tilla si zoti, zonja, apo zonjusha “edhe pse përdorimi i emrave të parë në disa kultura mund të shihet si mjet për krijimin e organit kolegjal. Përdorimi i tonit të zërit që shpreh mirësjellje dhe respekt është gjithashtu i rëndësishëm”¹¹⁹.

Për përfshirjen e familjes në shkollë, bazuar kryesisht në literaturën psikologjike, Hoover-Dempsey dhe Sandler propozojnë tre burime kryesore të motivimit për përfshirjen e prindërve. Ndër ta, në fakt, i dyti pas besimit është perceptimi i prindërve për përfshirjen e tyre duke përfshirë ftesat nga ana e shkollës (p.sh. mirëprirja e shkollës) dhe ftesat e veçanta nga mësuesit dhe fëmijët (Green, C. L., Walker, J. M. T., Hoover-

114 Gudlaug Erlendsdóttir, (2010). *Effects of Parental Involvement in Education*, fq. 38

115 Berger, E.H. (2000). *Parents as partners in education: Families and schools working together*. New Jersey: Merrill Publishing Company.

116 Collaborative Family-School relationships for Children's Learning . Beliefs and Practices. *Virginia Department of Education*. 2002. http://www.doe.virginia.gov/support/student_family/family-school_relationships/collaborative_family-school_relationships.pdf . Pare me 08.04.2014

117 Berger, E.H. (2000). *Parents as partners in education: Families and schools working together*. New Jersey: Merrill Publishing Company.

118 Batey, C. *Prindërit shpëtimtarë të jetës*.

119 <http://www.adlit.org/article/21522>

Dempsey, K. V., & Sandler, H. (2007)¹²⁰. Ftesat si faktorë domethënës për mirëpritjen e familjes në shkollë, konsiderohen edhe nga disa autorë të tjerë "Ftesat nga mësuesit janë shumë të rëndësishme sepse ato tregojnë vlerën e prindërve" (Dempsey K., Walker J, Sandler H, Whetsel d, Green Ch, Wilkins A, Closson K.,2005)¹²¹.

Batey, C¹²² në librin "Prindërit Shpëtimtarë të Jetës" jep disa udhëzime lidhur me mirëpritjen e familjes në shkollë: familja të pritët me buzëqeshje nga drejtori dhe stafi; të hiqet ndrojtja dhe frika e prindërve; të vihet një tabelë në derën kryesore ose në korridor ku familjes t'i urohet mirëseardhje; lini një dhomë në dispozicion ku prindërit të takohen me njëri tjetrin; të shikohen prindërit kur flasin me njëri-tjetrin, etj.

Tek autori Erlendsdóttir. G. (2010)¹²³ gjejmë studimin e studiuesit Lindle i cili raporton se sipas prindërve të anketuar ata duan që mësuesit e tyre ti trajtojnë ata të barabartë dhe me respekt. Prindërit nuk e vlerësojnë qasjen profesionale dhe të ftohtë nga ana e mësuesit.

Si përfundim të shqyrtimit të literaturës mbi mirëpritjen e familjes në shkollë, bindshëm gjejmë studimet e studiuesve të lartpërmendur për domethënien e madhe të këtij faktori në bashkëpunim shkollë-familje, i cili në vetvete përfshin edhe parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

2.6.2. Komunikimi i shkollës me familjen - faktor i bashkëpunimit të drejtë mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Komunikimin e konsiderojmë faktor shumë të rëndësishëm në bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Mënyra e komunikimit të shkollës/mësuesve sidomos me nxënësit ndikon për një komunikim të drejtë mes nxënësve. Gjithashtu, edhe mënyra e komunikimit të familjes me shkollën ndikon në edukimin e nxënësve për komunikim të drejtë me nxënësit e tjerë. Ne do të trajtojmë komunikimin e shkollës drejtuar familjes.

"Në shkollat e sotme, po iu jepet prioritet marrëdhënieve mes prindërve dhe mësuesve, sepse së bashku profesionistët dhe familja kanë fuqi dhe ndikim të ndërsjellë në përvojën arsimore të fëmijës. Komunikimi është një faktor kritik që lidh shkollën me familjen. Kur realizohet në praktikë, komunikimi efektiv dhe pozitiv sjell bashkëpunim produktiv në emër të nxënësit. Gjithashtu, komunikimi i dobët mund të rezultojë në keqkuptime nga ana e prindërve dhe mund të pengojë krijimin e një marrëdhënieje efektive shtëpi – shkollë"¹²⁴.

120 Green, C. L., Walker, J. M. T., Hoover-Dempsey, K. V., & Sandler, H. (2007). *Parents' motivations for involvement in children's education: An empirical test of a theoretical model of parental involvement*. Journal of Educational Psychology, 99, 532-544.

121 Dempsey K., Walker J, Sandler H, Whetsel d, Green Ch, Wilkins A, Closson K., (2005): *Why do parents become involved? Research findings and implications*. Elementary School Journal, 106(2); 105-130

122 Batey, C. *Prindërit shpëtimtarë të jetës*

123 Erlendsdóttir. G. (2010). *Effects of Parental Involvement in Education*. M.Ed.Thesis University of Iceland School of Education.

124 Martin, Emma J., Hagan-Burke, Shanna: *Preventing School Failure*, Vol. 46, Issue 2. Fq.62. 2002

Komunikimi mes shkollës dhe familjes rezulton të jetë një faktor shumë i rëndësishëm në përfshirjen dhe bashkëpunimin e shkollës dhe familjes edhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve Sylaj (2012)¹²⁵. Në studimin e saj autorja vëren se mungesa e komunikimit të shkollës dhe familjes është një ndër barrierat që shkakton ky faktor në bashkëpunimin shkollë - familje. Ai duhet të shfrytëzohet për të ndërtuar një partneritet të suksesshëm mes familjes dhe shkollës për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve ndërsa “nuk ka bashkëpunim mes familjes, edukatorëve dhe anëtarëve të komunitetit nëse nuk ndodh komunikimi i dyanshëm në këtë drejtim i fokusuar tek përqendrimi në pikat e forta të prindërve (dhe nxënësve) dhe zgjidhjen e problemeve së bashku”¹²⁶.

Komunikimi është një çështje mjaft e ndërlikuar. Ai nuk përfshin vetëm të folurit, por përfshin edhe “të folurit, të dëgjuarit, reflektimin e ndjenjave dhe interpretimin e kuptimit të mesazhit” Berger, E.H. (2000)¹²⁷. Konsiderohet se gjuha e trupit përbën 93% të mesazhit. Ndërsa, Smith (1986) e përshkruan dëgjimin si “bazë për ndërveprim mes njerëzve”. Të dëgjuarit, sipas tij, dhe jo të folurit është forma më e përdorur e komunikimit me 45%, nga komunikimi verbal shpenzohet për dëgjim - të folurit 30%, të lexuarit 16 % dhe të shkruarit 9% (cituar tek Berger, E.H. 2000)¹²⁸. Atëherë, nëse mesazhi i dërguar nuk është interpretuar siç duhet nga ana e pranuesit atëherë kemi mungesë komunikimi. Por, në komunikim thelbësore nuk është të flasësh.

Në hulumtimet e tyre M. Ouimette, J. Feldman, R. Tung, N. Chamblin and S. Coyne. (2002)¹²⁹ evidentojnë dy pengesa të mëdha për krijimin e shkollave përfshirëse dhe mirëpritëse për të gjithë prindërit. Idetë e prindërve për rolin e duhur të tyre për shkollimin e fëmijëve dhe së dyti ekziston një mungesë komunikimi mes familjeve dhe shkollave mbi pritjet për përfshirjen e prindërve.

Studimi i realizuar nga KEC¹³⁰ në shkollat e Kosovës ka identifikuar dy pengesa të perceptuara për ndërtimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm shkollë-familje, e të cilat i ndan në dy kategori: 1. Pengesat për ti ofruar përkrahje familjes dhe 2. Pengesat për komunikimin shkollë- familje. Sipas këtij studimi komunikimi del të jetë faktori i cili pengon bashkëpunimin dhe realizimin e qëndrueshëm të tij.

Janë të shumtë studiuesit të cilët kanë pasur në fokus të interesit të tyre komunikimin mes shkollës dhe familjes. Në përgjithësi “studiuesit gjejnë se komunikimi efektiv mes shkollës dhe familjes dhe përfshirja e familjes në shkollë kanë qenë të lidhura me përmirësimin e sjelljeve të nxënësve në shkollë, e cila në vetvete kontribuon në arritjet e nxënësve” (cituar nga K. V. Hoover-Dempsey and Joan M. T. Walker. 2002)¹³¹.

125 Sylaj, V: Seminari ndërkombëtar “Për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. “Komunikimi, faktor i rëndësishëm në optimizmin e bashkëpunimit shkollë- familje”. Nr. 31/1. fq. 346. (2012). Prishtinë.

126 National Forum: How school and parents can work together to address bullying. (2012). fq. 2. Venue: Parliament House, Canberra Committee Room 1R1.”Australian Government”.

127 Berger, E.H. (2000). *Parents as partners in education: Families and schools working together*. New Jersey: Merrill Publishing Company.

128 Po aty

129 M. Ouimette, J. Feldman, R. Tung, N. Chamblin and S. Coyne: *Parent Involvement in the Boston pilot schools: Lesson from a Unique urban network*, 2002, fq.2.

130 Pupovci, D & Tafarshiku. (2008). N: Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë-një rrugë drejt ndryshimit.

131 K. V. Hoover-Dempsey and Joan M. T. Walker. (2002). *Family-School Communication*.fq.5

Autorë të shumtë nga fusha e komunikimit madje e shohin si faktor kyç në bashkëpunimin me familjen. Tek (Scott Mandel, 2007) gjejmë se komunikimi konsiderohet ndoshta çështja më e rëndësishme në bashkëpunimin mësues-familje. Komunikimi sigurisht që është zona më e përshtatshme me anë të së cilit prindërit duan të vënë kontakt me shkollën. Komunikimi pozitiv i prindërve thuajse gjithmonë jep rezultate pozitive në bashkëpunimin mësues-prind. Komunikimi negativ, i thjeshtëzuar apo i pamjaftueshëm pothuajse gjithmonë shpie në probleme gjatë gjithë vitit.

Studiuesit konsiderojnë se në komunikimin mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve është pa dyshim i rëndësishëm edhe mënyra se si realizojmë bisedën shkollë-prindër. Sigurisht që komunikimi në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve të jetë efektiv duhet të jetë gjithsesi pozitiv. Në këtë aspekt të domosdoshmërisë së komunikimit pozitiv të shkollës drejt familjes, “për anëtarët e familjes që duhet të besojnë se mendimet dhe ndjenjat e tyre janë të respektuara”, mësuesit duhet të angazhohen në komunikim të dyanshëm me anëtarët e familjes, i cili duhet të jetë pozitiv dhe përkrahës. Kur marrëdhëniet me familjet ndërtohen bazuar në një komunikim pozitiv, të shëndetshëm, problemet që mund të lindin gjatë vitit kanë më shumë gjasa të zgjidhen në mënyrë pozitive” (Ratcliff, Nancy, Hunt, Gilbert,)¹³².

Ndërsa, (Stacy Callender dhe Annie Hansen)¹³³ konsiderojnë se çelësi për të ndërtuar një marrëdhënie bashkëpunuese mes familjeve dhe shkollave, si në çdo marrëdhënie tjetër, është komunikimi i rregullt dhe efektiv, sipas të cilëve kjo kërkon të kemi në fokus gjatë ndërveprimit të mësuesve dhe shkollës si anën kualitative ashtu dhe atë kuantitative. Autorët kërkojnë që shkolla të jetë në kontakt me familjen gjithë vitin edhe pse numri i ndërveprimeve varet nga nevojat e fëmijës.

Si përfundim të këtij nënkapitulli mund të konstatojmë se nga shqyrtimi i literaturës për komunikimin e familjes me shkollën, ky faktor vlerësohet fuqishëm nga autorë dhe studiues të ndryshëm për përfshirjen e familjes në shkollë dhe sidomos në drejtim të ndërtimit të raporteve pozitive ndarjet shkollës dhe familjes. Për ne si studiues ai konsiderohet dhe supozohet të jetë ndër faktorët kryesorë për përfshirjen e familjes edhe në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë si dhe në nivelin e takimeve që do ketë familja dhe shkolla në këtë drejtim.

2.6.3. Mbështetja e suksesit të nxënësve - faktor domethënës në bashkëpunimin shkollë familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

Familja-prindërit bëjnë përpjekje të shumta për zhvillimin, edukimin dhe arritjet e fëmijës në shkollë. Angazhimi i familjes për suksesin e fëmijës nënkupton gjithçka bën familja për të mbështetur suksesin e fëmijëve, duke filluar nga udhëzimet e ndryshme në drejtim të arritjeve të larta, kontrollit të tij në të mësuar, të qenit avokat për ta kur iu lindin probleme dhe bashkëpunimi në mënyrë efektive me shkollën në këtë drejtim.

132 Ratcliff, Nancy, Hunt, Gilbert: *Building Teacher-Family Partnerships: The Role of Teacher Preparation programs*. Education, Vol. 129, Issue 3.2009.

133 Stacy Callender dhe Annie Hansen: *Family-School Partnerships: Information and approaches for educators*. (NASP)

Por, për arritje të larta të nxënësit nuk mjafton vetëm përkrahja e familjes. Asaj duhet ti paraprijë angazhimi profesional i shkollës në këtë drejtim. Ndërsa angazhimi i shkollës në mbështetje të suksesit të nxënësve në mësimet nënkupton se në radhë të parë ajo duhet të njohë standardet e vlerësimit, të njoftojë në vazhdimësi familjen për suksesin e nxënësit në shkollë, ti ofrojë familjes informacione në vazhdimësi për përmirësimin e nxënësit në shkollë, të kontaktojë familjen sa më parë për çdo ngecje të nxënësit në mësimet. Shkolla duhet ti motivojë nxënësit për të bërë më të mirën, të bëjë që familja të ndihet e mirëpritur për të marrë pjesë në ecurinë e fëmijës në mësimet.

Studiuesit Catalano, L & McKinney, thonë se mbështetja e suksesit të nxënësve duhet të shfrytëzohet për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në bashkëpunim me familjen, ku në këtë drejtim shkolla duhet të krijojë mjedise të sigurt të të mësuarit, pozitive, të paraqesë pritje të larta akademike dhe sociale por edhe të arritshme. Gjithashtu ajo mund të organizojë grupe sociale të cilat pengojnë manifestimin e agresivitetit ose dhunës p.sh. klubi akademik ose organizimet sociale¹³⁴.

Sipas Sylaj (2013)¹³⁵, “Të gjitha studimet në fushën e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes vërtetojnë se përfshirja e prindërve në shkollë është faktor për edukimin dhe arritjet e larta të nxënësve”. Autorja, shprehet se, kur flasim për arritjet e nxënësve, ato nuk janë sigurisht të njëjta. Kjo përbën dhe sfidën në bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes për mbështetjen e suksesit të nxënësve. Pse e konsiderojmë si sfidë? Shkolla duhet të përpilojë programe cilësore për arritje të larta të nxënësve, pjesa e parë e sfidës. Dhe, meqenëse arritjet e nxënësve siç thamë nuk janë të njëjta atëherë dhe strategjia e punës me familjen në këtë drejtim nuk mund të jetë e njëjtë. E dyta, familja sigurisht e konsideron shkollën përgjegjëse për suksesin e fëmijës, duke pritur mbështetje për arritjen e suksesit të fëmijës vetëm nga shkolla ndonjëherë dhe e fajëson atë duke i harruar detyrimet dhe përgjegjësitë e saj në mbështetje të suksesit të fëmijës.

Por, për të mos arritur deri te fajësimi dhe si rezultat pësimi të nxënësi, autori Schumm (2005)¹³⁶ konsideron se: “Nëse prindërit janë të mirinformuar dhe të pranishëm në jetën shkollore të fëmijëve të tyre, këta të fundit janë të motivuar dhe arrijnë rezultate më të mira”. Përderisa sukcesi i nxënësve dhe disiplina e tyre në shkollë është një tandem, ne konsiderojmë se mbështetja e suksesit të nxënësve nga shkolla është një faktor shumë me rëndësi dhe domethënës në përfshirjen e familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Takimet e familjes me shkollën për suksesin të vihen edhe në funksion të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

Janë të shumta studimet të cilat fokusohen te ndikimi i bashkëpunimit shkollë-familje për suksesin e nxënësve. “Shumë studime theksojnë një pikë të rëndësishme: pjesëmarrja e prindërve në arsim është e lidhur me arritjet e nxënësve. Një studim i Universitetit Stanford gjeti se duke përdorur prindërit si autorë u arritën ndryshime të rëndësishme dhe të menjëhershme në rezultatin IQ të fëmijëve”¹³⁷. Ndërsa, sipas

134 Christle, Christine A, Jolivette, Kristine, Nelson, C. Michael. (2000). Youth Agression and Violence: Risk, resilience and Prevention. ERIC.

135 Sylaj, V. Creative Education: “Supporting the success of students-one of the factor to optimize the role of the school through its cooperation with the family”. 2013. Vol.4, No.5, fq. 300.

136 Schumm, Jeanne Shay, (2005). *Si ta ndihmoni fëmijën për detyrat e shtëpisë*. “Botimet Max”, Tiranë.

137 Peterson, C. (2003). *Building family-School Partnerships to Improve Student Outcomes*. Lanham, MD: Scarecrow Press.

Berger, hulumtimet kanë zbuluar se, prindërit të cilët u ofrojnë përkrahje aktive fëmijëve të tyre kontribuojnë më shumë në suksesin e fëmijëve të tyre në shkollë, sesa ata që ofrojnë përkrahje pasive. Prindërit më pak efektivë në këtë drejtim, janë ata të cilët nuk mbështesin. Prindërit duhet ti ndihmojnë fëmijët e tyre si dhe ti inkurajojnë ata për të arritje (Berger, 2000)¹³⁸. Por, sigurisht që mbështetja e suksesit të fëmijëve-nxënës duhet jetë edhe nga shkolla, mbështetje kjo profesionale.

Joyce Epstein (1995,2001) i ka bazuar praktikat e saj në një model partneriteti e bashkëpunimi si dhe ndarje të përgjegjësive mes familjes dhe shkollës. "Ka shumë arsye pse shkolla, familja dhe komuniteti duhet të zhvillojnë partneritet. Ata mund të përmirësojnë programet dhe klimën shkollore, të ofrojnë shërbime dhe mbështetje për familjet, të rritin aftësitë e prindërve dhe lidhshimit, të lidhin familjet me të tjerët në shkollë dhe në komunitet, dhe të ndihmojnë mësuesit me punën e tyre. Megjithatë, arsyeja kryesore për të krijuar të tilla partneritete është të ndihmojë të gjithë të rinjtë të kenë sukses në shkollë dhe në jetën e mëvonshme"¹³⁹. Gjatë viteve, Epstein ka gjetur se angazhimi i prindërve është me rëndësi kritike për suksesin, por nuk ka prova se shkollat janë afruar ndopak më shumë, me njëra-tjetrën, përveç një pakice shkollash, që e kanë pasur si qëllim të tyre ta bëjnë këtë nëpërmjet trajnimit dhe mbështetjes së jashtme (Fullan, 2001)¹⁴⁰. Ndërsa, Deker¹⁴¹, konsideron se parashikuesi më i saktë i suksesit të nxënësve në shkollë nuk është statusi i të ardhurave sociale, por shkalla në të cilën familja e nxënësit është në gjendje të: 1) Krijojë një mjedis që inkurajon mësimin në shtëpi; 2) Komunikojë për pritshmëritë dhe arritjet; 3) Përfshihet më shumë në edukimin e fëmijës në shkollë dhe komunitet.

Në studimet e tyre për përfshirjen e familjes në shkollë, Henderson dhe Mapp, arritën në përfundim se "Dëshmia është konsistente, pozitive dhe bindëse, familjet kanë një ndikim të madh në arritjet e fëmijëve të tyre në shkollë dhe jetë"¹⁴². Hulumtuesit gjithashtu tregojnë se fëmijët prindërit e të cilëve: a) sigurojnë pritjet e larta dhe aspiratat; b) ndihmojnë dhe kontrollojnë detyrat e shtëpisë të fëmijëve; c) marrin pjesë në takimet me prindërit dhe në shoqatat prind-mësues; d) flasin me fëmijët e tyre për shkollën, kanë prirje të kenë nota të larta, performancë superiore në testet e përfundimtare. Catsambis & Beveridge (2001)¹⁴³.

Autorët Sheldon & Van Voorhis (2004)¹⁴⁴ kanë vënë re një ndërlidhje midis cilësisë së partneritetit dhe arritjeve të nxënësve. Shkollat me cilësi të lartë në programet e partneritetit raportojnë për vullnetarizëm më të madh të prindërve dhe pjesëmarrje të

138 Berger, E.H. (2000). *Parents as partners in education: Families and schools working together*. New Jersey: Merrill Publishing Company.

139 Epstein, J. L. (1995). *School, family community partnerships: Caring for the children we share*. *Phi Delta Kappan*, 76(9), 701-712.

140 Fullan, 2001

141 Deker, L.E., & Decker, V.A. (2003). *Home, school and community partnerships*. Oxford, UK: The Scarecrows Press.

142 Henderson, A. T., & Mapp, K. L. (2002). *A new wave of evidence: The impact of school, family and community connections on student achievement*. Southwest Educational Development Laboratory.

143 Catsambis.S & Beveridge, A.A. (2001). *Does neighborhood matter? Family, neighborhood, and school influence on eighth grade mathematics achievement*. *Sociological Focus*, 34, 435-457.

144 Sheldon, S. B., & Van Voorhis, F. L. (2004). *Partnership programs in U.S. schools: Their development and relationship to family involvement outcomes*. *School Effectiveness and School Improvement*, 15(2), 125-148.

tyre në ngjarjet e shkollës, përfshirje në procesin e vendimmarrjes, përfshirje më të gjerë në detyrat e shtëpisë së nxënësve-që kërkojnë ndërveprim, sesa shkollat me cilësi më të ulët të programeve. Duke parë rëndësinë e bashkëpunimit familje-shkollë për arritjet e nxënësve, duhet synuar që ai të jetë më efikas, sepse kjo ka ndikim dhe mbi vet kombin, sepse “kur familja, komuniteti dhe sistemi me vlerë është i fortë, shkolla është e fortë, më i fortë është dhe kombi”¹⁴⁵.

Madje sipas (Rich, D., 1987)¹⁴⁶, pjesëmarrja e familja ka tendencë të jetë më e gjerë dhe më e qëndrueshme kur anëtarët e familjes besojnë se pjesëmarrja e tyre është e lidhur drejtpërdrejt me performancën e fëmijëve të tyre.

Bazuar në të dhënat e lartpërmendura, konsiderojmë se këtë dëshirë e angazhim të familjes në drejtim të suksesit të nxënësve ajo mund ta shfrytëzojë edhe për parandalim të dhunës, sepse “përfshirja e familjes në shkollë me arsye arritjet e nxënësit, mund të jenë shumë të dobishme, përmes aktiviteteve dhe informacioneve të ndryshme edhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë”¹⁴⁷.

Si përmbledhje për këtë pjesë të shqyrtimit të literaturës, mund të themi se mbështetja e suksesit të nxënësit nga shkolla, ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe në drejtim të arritjeve më të larta të nxënësve dhe përfshirjes së familjes në shkollë. Kjo përfshirje ndjeshëm mund të ndikojë dhe të shfrytëzohet edhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Ky faktor bën që familja të jetë më shumë e pranishme në shkollë, partnere në edukimin emocional, fushën akademike të tij, dhe në zhvillimin social si dhe për ndërtimin e raporteve të drejta të nxënësit me nxënësit të tjerë. Ne si studiues supozojmë se ky mund të jetë një faktor me rëndësi në përfshirjen e familjes në shkollë, përfshirje që mund ta vëmë në funksion të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, duke ditur se sukcesi, disiplina dhe raporti i nxënësit me të tjerët është një tandem.

2.6.4. Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë

Familja është ajo e cila ka vullnetin dhe dëshirën për ta ndihmuar fëmijën, por ajo duhet të dijë si dhe ku duhet ta ndihmojnë fëmijën, mësuesit dhe shkollën, për çështje në përgjithësi dhe në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë në veçanti. Përkundër faktit se familja do medoemos ta parandalojë dhunën ndërmjet nxënësve, ajo ka të ngjarë se nuk di si ta bëjë këtë. Në interes të studimit tonë ishte veç të tjerash edhe fakti nëse i bëhen të ditura familjes detyrat ndaj shkollës për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve, si dhe nëse korrelojnë ndarja e detyrave dhe përgjegjësi mes këtyre të dyjave me nivelin e takimeve mes familjes dhe shkollës, duke supozuar se mungesa e efikasitetit në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve mund të jetë

145 Kreso, A. P. (2004) *Koordinate obiteljskog odgoja*, Sarajevo. New Jersey: Merrill Publishing Company.

146 Rich, D. (1987). *Schools and families: Issues and actions*. Washington, DC: National Education Association.

147 Sylaj, V.: “*Supporting the success of students-one of the factor to optimize the role of the school through its cooperation with the family*”. Creative Education. 2013. Vol.4, No.5, fq. 300.

pikërisht rezultat i mungesës së ndarjes së detyrave mes shkollës dhe familjes, e cila është domosdoshmëri.

Sigurisht që punët e planifikuara e të organizuara kryhen më me sukses sesa të pa menduarat mirë. Veç kësaj, punët e realizuara në bashkëpunim me të tjerët do jenë shumë më të lehta për t'u realizuar. Kjo ndodh dhe në bashkëpunim mes familjes dhe shkollës. Sipas Sylaj (2013)¹⁴⁸ studimet tregojnë se bashkëveprimi ndërmjet shkollës dhe familjes ndikon në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, kjo dhe është ndër arsyet që shkolla të promovojë përgjegjësinë e familjes për tu përfshirë në shkollë për të bashkëpunuar në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Kjo arrihet duke përfunduar faktorët e bashkëpunimit të shkollës dhe familjes e sidomos ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiave mes shkollë dhe familjes. Sidomos për familjen. Pse për të sidomos? Për faktin se jo të gjithë prindërit/familjet i dinë dhe i kanë të qarta detyrat që kanë para shkollës e fëmijëve të tyre nxënës. Prandaj kjo çështje, të njohurit fillimisht dhe ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes është çështje që kërkon qasje profesionale nga shkolla, por edhe gatishmëri nga ana e prindërve. Sipas një studimi të realizuar në Kosovë nga autorët Pupovci, D dhe Tafarshiku, N.¹⁴⁹ vërehet se ekziston një vullnet mjaft i mirë i prindërve për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në shkollë, por 39,7% të drejtuesve të anketuar deklarojnë se prindërit nuk angazhohen për të ndihmuar procesin e mësimdhënies dhe gjetjes së mënyrave të aftësimin për të kontribuar në procesin mësimor.

Për ne si studiuese ishte shumë i rëndësishëm vendi që zë çështja e ndarjes së detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes në legjislacionin e shkollës fillore, në Kosovë. Ne konsiderojmë se ky faktor duhet të përfshihet me shumë kujdes në legjislacion. Kjo është arsyeja përse i kushtuam një vëmendje të veçantë analizës së tij në këtë drejtim. Sa i përket anës legjislative, konstatojmë se çështja e ndarjes së detyrave mes shkollës dhe familjes nuk është paraparë në nivelin e duhur. Ligji nr. 2002/2, "Mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë"¹⁵⁰, në nenin 7 të tij paraqet arsimin e detyruar, ku në paragrafin 7.13 kërkohet nga familja që të njoftojë shkollën me shkrim për mungesat dhe në varësi të arsyes të lëshohet edhe leja përkatëse. Ky është element mjaft me rëndësi në drejtim të bashkëpunimit shkollë-familje. Por, kjo qasje bashkëpunimi bie disi në kontradiktë me nenin 7.15 në të cilin kërkohet gjobitja e familjes dhe dënimi, duke përjashtuar kështu frymën bashkëpunuese dhe ndërvepruese. Lëshimi i cili në këtë rast konsiderojmë se është bërë meqenëse është dashur të jetë paraparë çështja e njohjes së rrethanave të familjes për mungesat, apo dhe neglizhenca e familjes në fëmijën, e jo të kalohet menjëherë tek dënimi. Ky paragraf nuk lë hapësirë për bashkëpunim.

Neni 32 i këtij ligji trajton rregullat e shkollës, por jo dhe detyrat e detyrimet e prindërve. Nga ana legjislative prindit i jepet e drejta të ankohet menjëherë deri tek Ministria e Arsimit, por, nuk fillohet nga qasja e drejtë. Nuk specifikohen detyrat dhe detyrimet e familjes. Nga ana legjislative fokusi bie shumë konkretisht mbi këshillat ekzistuese të shkollave si, Këshilli i Prindërve, Këshillat e Shkollave, por jo dhe mbi

148 Sylaj, V (2013). "Factors that influence a greater involvement of the family in preventing school violence among students". International Journal of Multidisciplinary Thought: Nr.3.fq.221.

149 Pupovci, D & Tafarshiku, N. (2008). *Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë*, fq.34.

150 Ligji "Mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë". nr. 2002/2.

ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive shkollë- familje. Nuk kërkohet nga shkolla njohje e rrethanave të familjes, përse nuk është kryer njoftimi, ne nuk njohim shkaqet e neglizhencës nga ana e prindërve, ne nuk ia kemi dalë të punojmë për nxënësin.

Po ashtu, neni 17, paragrafi i dytë i tij, përshkruan përgjegjësinë e komunave, ku në një mënyrë komuna bëhet faktori kryesor i cili nxit bashkëpunimin mes mësuesve dhe prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore si dhe bashkëpunimin e institucioneve arsimore me familjen.

Kjo është njëra pikë e aspektit legjislativ, por në përgjithësi aspekti legjislativ nuk është bindës lidhur me frymën e bashkëpunimit shkollë-familje dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet tyre.

Në nenin 9 të ligjit nr. 2002/2, “Mbi arsimin fillor dhe të mesëm”, përcaktohen të drejtat dhe detyrimet shtesë të familjes, ku në paragrafin 9.2. i jepet familjes e drejta për ankesë, të cilën mund ta drejtojë nga mësuesi deri tek Ministria e Arsimit. Në këtë paragraf nuk është paraparë zgjidhja e situatës por menjëherë kalohet tek ankesa, duke mos ekzistuar kështu fryma bashkëpunuese. Vetë ligji me nenet e tij duhet të jetë një shembull i bashkëpunimit dhe ndërveprimit shkollë-familje. Një tjetër mangësi/pengesë në këtë bashkëpunim e hasim edhe tek paragrafi 9.3, në të cilin paraqitet e drejta e familjes për parashtrim ankese për ambientin në institucion. Ky nen familjen nuk e trajton si pjesë integrale të shkollës, por ai del të jetë më tepër reagues apo vëzhgues i situatës negative. E kundërta ndodh në paragrafin 9.4. në të cilin gjejmë elementin gjithëpërfshirës të familjes në zgjedhjet për anëtarë të Këshillit të Shkollës.

Si përmbyllje e këtij nënkapitulli mbi ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet shkollës dhe familjes, arrijmë në përfundimin se, ky faktor është i një rëndësie të madhe në drejtim të mbështetjes së arritjeve të nxënësve dhe në veçanti në bashkëpunimin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Ai është gjithashtu një faktor të cilit i duhet kushtuar vëmendje e veçantë në aspektin legjislativ. Në këtë pikë, konsiderohet se nuk është paraparë mjaftueshëm në aspektin legjislativ të vendit tonë për arsimin fillor dhe të mesëm.

2.6.5. Besimi i familjes te shkolla dhe anasjellas, faktor në bashkëpunim për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë

Padyshim se përfitues i bashkëpunimit familje - shkollë është nxënësi, ndërsa ky përfitim i nxënësve nga marrëdhënia e fortë e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes është i bazuar në zhvillimin e besimit mes familjes dhe shkollës. Kjo marrëdhënie mirëbesimi ndodh kur prindërit dhe mësuesit respektojnë njëri-tjetrin dhe besojnë në aftësitë e personit tjetër dhe vullnetin për të përmbushur përgjegjësitë e veta (Erlendsdóttir, G. 2010)¹⁵¹.

“Në terma të përgjithshëm marrëdhënia e besimit përfshin rrezikun, besueshmërinë, dobësinë dhe shpresën” (citar nga Corri Brewster & Jennifer Railsback)¹⁵². Një përkufizim më të saktë për besimin e japin Tschannen-Moran and Hoy’s (1998) tek

151 Gudlaug Erlendsdóttir (2010): *Effects of Parental Involvement in Education*. M.Ed. Thesis in Educational Administration

152 Corri Brewster & Jennifer Railsback, (2003): *Building trust with schools and diverse families*. fq.4

të cilët besimi përfshin dashamirësinë, besueshmërinë, kompetencën, ndershmërinë, sinqeritetin. (cituar nga Corri Brewster & Jennifer Railsback, 2003)¹⁵³.

Besimi i familjes te shkolla konsiderohet të jetë ndër faktorët më të rëndësishëm të përfshirjes së familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, por, sigurisht ky bashkëpunim duhet jetë i mirëfilltë, ndërsa “për të krijuar partneritete të mirëfillta me prindërit, marrëdhëniet e mirëfillta me ta duhet jenë të ndërtuara mbi një themel të besimit reciprok dhe transparenca (çiltërsia) së pari duhet të zhvillohet” (Espinosa, L. M. 1995)¹⁵⁴.

Besimi ndërmjet mësuesve dhe prindërve është element jetik në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve shkollë – familje. Jo se nuk mund të ndryshojë besimi ose riparohet ai por, “ndërtimi i marrëdhënieve të reja kërkon kohë. Gjetjet e studimit tregojnë se në nivelin e rritjes së besimit mes shkollës, rindërtimi i marrëdhënieve të reja në të cilat besimi ka qenë i dëmtuar mund të kërkojë kohë shumë më të gjatë” (cituar nga Corri Brewster & Jennifer Railsback.)¹⁵⁵.

Sipas Sylaj (2014)¹⁵⁶, besimin e familjes te shkolla dhe familjen i identifikon si faktorë shumë të rëndësishëm për bashkëpunimin dhe parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, sipas së cilës në këtë drejtim krijimit të marrëdhënies bashkëpunuese në këtë drejtim, pa dyshim, i paraprin shkolla. Ajo nxit te familja ndjenjen e efikasitetit të saj për bashkëpunim me shkollën në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, duke i dhënë rol familjes”. Autorja rekomandon aktivitete nga shkolla në drejtim të nxitjes së familjes për bashkëpunim në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë duke e identifikuar këtë faktor si domethënës në këtë drejtim.

Ndërsa, autorja tjetër Desforjes (2003) për përfshirjen e familjes në shkollë e konsideron të rëndësishëm besimin e familjes te shkolla. Sipas saj “dallimet mes prindërve në nivelin e përfshirjes janë të lidhura me nivelin social, varfërinë, shëndetin, dhe gjithashtu me perceptimin e prindërve për rolin e tyre dhe nivelin e besimit të tyre në përmbushjen e tij. Disa prindër shtyhen nga ndjenja e të vënit poshtë nga shkolla dhe mësuesit”¹⁵⁷.

Janë të shumta studimet të cilat flasin për rëndësinë e besimit të familjes te shkolla për bashkëpunim mes tyre. Një sondazh i kryer me 1.234 prindër dhe 204 mësues rreth besimit në marrëdhëniet mes familjes dhe shkollës nxjerr në pah një nivel të lartë të besimit, i cili ishte më i lartë në shkollën fillore e më i ulët në atë të mesme e të lartë (Adams, Kimberly S.; Christenson, Sandra L)¹⁵⁸.

153 Po aty

154 Espinosa, L.M. (1995). *Hispanic Parent Involvement in Early Childhood Programs*. Champaign, IL: ERIC Clearinghouse on Elementary and Early Childhood Education.(ERIC Digest EDO-PS-95-3).

155 Corri Brewster & Jennifer Railsback. (2003). *Building trust with schools and diverse families*. implications for *principals and teacher* Northwest Regional Fq.18.

156 Sylaj (2014). “Besimi i familjes në shkollën faktorë me rëndësi në bashkëpunim për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve”. Instituti Pedagogjik i Kosovës-Kërkime Pedagogjike. fq.13

157 Desforjes,Ch & Abouchar,A. (2003). *The Impact of Parental Involvement, Parental Support and Family Education on Pupil* fq.5.

158 Adams, Kimberly S.; Christenson, Sandra, L: *Trust and the Family-School Relationship: Examination of Parent-Teacher Differences in Elementary and Secondary Grades*. Journal of School Psychology, v.38 n.5 p. 477-97 (Sep-Oct 2000).

Autorët Adams. M. Curts, Forsyth. B. Patrick, Mitchell. M. Rozanne (2009)¹⁵⁹, në fokus të studimit të tyre kishin të kuptuarit e ngjarjeve të mëparshme dhe besimit të prindërve të shkolla. Gjetjet mbështesin konceptualizimin e besimit shkollor si një pronë kolektive të grupit të roleve të shkollave përmes normave afektive, njohëse dhe të sjelljes. Ndërsa autorët Christenson dhe Sheridan (2001) pretendojnë se besimi është parakusht në përpjekjen për përfshirjen e familjes në shkollë. Ata besimin e konsiderojnë si faktor madhor në marrëdhënien e krijuar. (Erlendsdottir. G, 2010)¹⁶⁰.

Përfitimi i nxënësve nga bashkëpunimi i fortë mes shkollës dhe familjes është i bazuar në zhvillimin e besimit mes mësuesit dhe familjes. Sipas Bryk dhe Schneider (marrë tek Erlendsdottir. G. (2010)., “kjo marrëdhënie mirëbesimi ndodh kur mësuesit dhe prindërit e respektojnë njëri-tjetrin dhe besojnë në aftësinë e personit tjetër dhe në vullnetin e tij/saj të mirë për përmbushjen e përgjegjësive”¹⁶¹. Konstatojmë se filozofia edukative e shkollës, familjes dhe më gjerë, bazimin e procesit edukativ në parimet diametralisht të kundërta midis këtyre faktorëve, edukimi i bazuar në metodat, mjetet dhe format plotësisht të kundërta, kriteret shumë të ndryshme të vlerësimit dhe qasja ndryshe ndaj vlerësimit të procesit të edukimit, shkakton klimë të papërshtatshme për edukimin e të rinjve. Klimë që prodhon dhunë socio-emocionale e psikike. Pasojat janë evidente, por janë evidente edhe shkaqet që e shkaktojnë dhunën në shkollë si edhe në mjediset tjera sociale ku jeton brezi i ri (Krasniqi, I & Zuna, A, 2012)¹⁶².

Studiuesit Adams, K.S., & Christenson, S.L (2002)¹⁶³ në studimin e tyre konstatuan se besimi ndikon në marrëdhëniet pozitive dhe produktive shkollë- familje. Në studimin e tyre, i cili kishte për qëllim të konstatojë se si ndikon besimi në përfshirjen më të gjerë të prindërve në shkollë, ata gjetën se prindërit kanë më shumë besim te shkolla se anasjellas. Gjithashtu, ata gjetën se prindërit që raportuan qëndrim të ulët apo mesatar ndaj shkollës, kanë qëndrime për përfshirje dhe angazhime të ulëta në shkollë. I njëjti studim gjen arsye të ndryshme nga shkolla dhe familja për rritje të besimit, ku i njëjti qëndrim në këtë drejtim ishte ai se çelësi i rritjes së besimit është komunikimi.

Ndërsa, Patrikakou & Weissberg (2000)¹⁶⁴, në studimin e tyre tregojnë se përfshirja e prindërve në shkollë e shtëpi rritet kur prindërit besojnë se shkolla përpiqet ti mbajë ata të informuar, kur vlerëson kontributin e tyre, dhe ofron sugjerime të veçanta për të ndihmuar fëmijët e tyre të mësojnë. Ndërsa krijimi i besimit të familjes te shkolla sigurisht përbën një sfidë për shkollën, besim ky i cili nuk krijohet shpejt, lehtë e mbi të gjitha ai duhet të ruhet.

Eccles dhe Harold (1996) identifikuan disa fusha të besimit nga ana e mësuesve

159 Adams.M. Curts, Forsyth.B.Patrick, Mitchell.M.Rozanne (2009): *The Formation of Parent-School Trust: A Multilevel Analysis*. EAQ

160 Erlendsdottir. G. (2010). Effects of Parental Involvement in Education, fq.33

161 Erlendsdottir. G. (2010). Effects of Parental Involvement in Education, M.Ed.Thesis University of Iceland School of Education. fq. 33

162 Krasniqi, I & Zuna,A. (2012): *Një shkollë pa dhunë.*” Libri Shkollorë”. Prishtinë.

163 Adams, K. S., & Christenson, S. L.(2002): *Trust and the family-school relationship: Examination of parent-teacher differences in elementary and secondary grades*. Journal of School Psychology, 38. p. 477-497

164 Patrikakou & Weissberg, (2000). Patrikakou, E.N., Weissberg, R.P. (2000). *Parents' perceptions of teacher outreach and parent involvement in children's education*. Journal of Prevention and Intervention in the Community,20(1-2), 103-119

që ndikojnë në përfshirjen e familjes në shkollë, si besimin rreth rolit të prindërve dhe mësuesve të cilët duhet të luajnë rol në edukimin e fëmijëve, besimin lidhur me faktin se ç’është përfshirja e prindërve (p.sh., pse prindërit janë të përfshirë) dhe besimin te njohuritë dhe aftësitë e tyre për të nxitur përfshirjen e prindërve Caspe, M. S. (2003)¹⁶⁵.

Ndërsa, një mënyrë tjetër për besim mes shkollës dhe familjes është dhe ajo që shkolla të iniciojë dhe zbatojë programe dhe politika me qëllim të të shprehurit dhe plotësimit në mënyrë serioze të nevojave të nxënësve. Dhe kështu shkolla fillon të krijojë një mjedis të tillë ku komuniteti fillon të krijojë besim te shkolla dhe stafi i saj (cituar në Brewster. C& Railsback, J. 2003)¹⁶⁶.

Besimi si faktor për bashkëpunim duhet të shtrihet në nivel shkollë dhe jo të nënkuptohet vetëm në raport me mësuesin. Në një sondazh të kryer nga Dunst et al., (1994), prindërve dhe profesionistëve të shkollës iu kërkua të listojnë karakteristikat e sjelljes dhe qëndrimeve që besohet se janë të rëndësishme në marrëdhënien prind-profesionistë të shkollës. Karakteristikat e prindërve dhe profesionistëve u renditën më vete dhe në mënyrë të kombinuar. Nuk kishte përputhje të konsiderueshme midis karakteristikave të renditura nga prindërit dhe profesionistët. Karakteristika e rangut më të lartë në grupin e kombinuar ishte “besimi”, e ndjekur nga komunikimi me respekt reciprok dhe ndershmëria (Brewster & Jennifer Railsback, (2003)¹⁶⁷.

Shumë bindës për ndikimin e besimit në bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes është dhe studimi 10-vjeçar në më shumë se 400 shkolla fillore të Çikagos. Bryk dhe Schneider (2002) arritën në përfundim se besimi mes mësimeve, drejtorëve, nxënësve dhe prindërve, është një parashikues i fortë për suksesin e nxënësve në shkollë. Sipas tyre, shkollat që tregojnë nivel të lartë besimi mes mësuesve dhe familjes dhe besim në përgjithësi, posedojnë karakteristikat e mëposhtme: ato kanë popullsi të qëndrueshme; minimale janë “tensionet racore dhe etnike” në mes të nxënësve, prindërve dhe stafit; dhe mësuesit janë në gjendje për tu siguruar prindërve dëshminë e qartë se “nxënësit janë të suksesshëm” Cori Brewster & Jennifer Railsback (2003)¹⁶⁸.

Që besimi i familjes te shkolla është shumë domethënës dhe motivues në përfshirjen e familjes në shkollë për parandalimin e dhunës mes nxënësve demonstron edhe nga një studim i realizuar me 136 prindër turq të klasave të dyta e të para lidhur me besimin e prindërve ndaj përfshirjes në shkollë. Rezultatet treguan se prindërit turq tentojnë dhe kanë besime motivuese për përfshirjen në edukimin e fëmijëve të tyre. Rezultatet e analizës së regresionit multilinear zbuluan se të ardhurat mujore të prindërve janë parashikuesi më i fuqishëm për përfshirjen e tyre. U gjet gjithashtu se prejardhja arsimore e prindërve ndikon te besimi dhe te vetë efikasiteti për t’i ndihmuar fëmijët e tyre për të pasur sukses në shkollë (Tekin. A 2010)¹⁶⁹.

165 Caspe, M. S. (2003). *How teachers come to understand families: The School Community Journal*, 13(1), 115- 131.

166 Brewster & Jennifer Railsback (2003). *Building trusting Relationships for school Improvement: Implication for principals and Teachers*. By Request Series. Northwest regional educational Lab., Portland. OR. Department of Education, Washington, DC., fq.21.

167 Po aty

168 Cori Brewster & Jennifer Railsback, (2003). *Building trust with schools and diverse families: Northwest Regional*.

169 Tekin, A. (2011). *Parents’ motivational beliefs about their involvement in young children’s education*, Early Child Development and Care. Vol. 181. No. 10, 1315–1329.

Ndërsa Green-Dempsey (2007) kanë kryer një hulumtim me prindërit e 374 fëmijëve të shkollës fillore dhe kanë raportuar se prindërit kanë besim të fortë te roli i tyre në përfshirjen për edukimin e fëmijëve. Në mënyrë të ngjashme Anderson dhe Minke (2007) ka kryer një hulumtim me pjesëmarrës me prejardhje të ndryshme dhe kanë gjetur se të anketuarit kanë qenë të prirur ta raportojnë rolin e besimit në përfshirjen e tyre në shkollë. Tekin. A. (2010)¹⁷⁰ e konsideron këtë faktor shumë domethënës për bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes me qëllim parandalimin e dhunës mes nxënësve.

Për përfshirjen e familjes në shkollë, bazuar kryesisht në literaturën psikologjike Hoover-Dempsey dhe Sandler, propozojnë tri burime kryesore të motivimit për përfshirjen e prindërve, ndër to janë: motivacionet relevante të besimit për përfshirjen e tyre dhe rolin e vetë prindërve për ti ndihmuar fëmijët në shkollë (Green, C. L., Walker, J. M. T., Hoover-Dempsey, K. V., & Sandler, H., 2007)¹⁷¹.

Por, shtrohet pyetja sesi duhet të ndërtohet besimi i familjes ndaj shkollës në drejtim të parandalimit të dhunës mes nxënësve në shkollë? Përgjigja më e shpeshtë që ofrohet nga literatura është besimi. Këtë e dëshmon sidomos studimi i Brewster dhe Railsback, të cilët konsiderojnë se familja duhet ti besojë mësuesve dhe anëtarëve të tjerë të stafit shkollor, me fjalë të tjera, ata duhet të besojnë se personeli i shkollës është i kualifikuar, i drejtë dhe i besueshëm. Në shumicën e rasteve ky besim ndërtohet me kalimin e kohës, bazuar në marrëdhëniet e qëndrueshme të palëve në fjalë, Cori Brewster & Jennifer Railsback, (2003)¹⁷².

Kur flasim për komunikimin si mundësi e rritjes së besimit të familjes te shkolla, kemi në mendje komunikimin e drejtë, thënë ndryshe, “shpesh komunikimi bëhet mjet i atakimit me pasoja të rënda që kanë ndikime të ndryshme mbi personalitetin e individit.¹⁷³

Për rëndësinë e besimit në marrëdhënien shkollë-familje flasin dhe Goddard, Tschannen-Moran dhe Hoy, (2001), të cilët kryen një studim me 47 shkolla fillore në një rreth të madh të shkollave urbane në Minded-it. Ky studim rezultoi në gjetjen e rëndësishme e cila lidhet me marrëdhënien mes shkollës dhe familjes e cila është ajo se arritja e nxënësve është më e lartë në shkollat ku mësuesit raportojnë besim më të madh në familjen. (Cori Brewster and Jennifer Railsback, 2003)¹⁷⁴.

Për rëndësinë e besimit në marrëdhënien shkollë-familje, shprehen dhe Tschannen-Moran (2001) kur ata “kryen një studim ku shqyrtohej lidhja mes nivelin të takimeve në shkollë dhe nivelit të besimit. Rezultatet tregojnë një lidhje të dukshme të bashkëpunimit mes mësuesve me drejtorin dhe besimit mes tyre, bashkëpunimit me kolegët dhe besimit

170 Po aty.

171 Green, C. L., Walker, J. M. T., Hoover-Dempsey, K. V., & Sandler, H. (2007). *Parents' motivations for involvement in children's education: An empirical test of a theoretical model of parental involvement*. *Journal of Educational Psychology*. 99, 532-544.

172 Green, C. L., Walker, J. M. T., Hoover-Dempsey, K. V., & Sandler, H. (2007). *Parents' motivations for involvement in children's education: An empirical test of a theoretical model of parental involvement*. *Journal of Educational Psychology*. 99, 532-544

173 Potera, I., Mehmeti, S., Gojani, H., Shala, L., (2012). *Dhuna verbale ndaj nxënësve*. “Instituti Pedagogjik i Kosovës”, Prishtinë.

174 Cori Brewster and Jennifer Railsback (2003). *Building trusting relationships for school improvement: implications for principals and teacher*

tek ta, bashkëpunimit me prindërit dhe besimit tek prindërit”¹⁷⁵.

Adams dhe Christensons (2000) realizuan një studim me përfshirjen e 1234 prindërve dhe 209 mësimdhënësve të cilët gjetën se si mësuesit ashtu dhe prindërit besonin se përmirësimi i komunikimit mes shkollës dhe familjes është faktori kryesor për rritjen e besimit mes shkollës dhe familjes (Cori Brewster and Jennifer Railsback, 2003)¹⁷⁶.

Për rëndësinë e komunikimit në nivelin e besimit të familjes tek shkolla ekziston një kritikë e rëndësishme në gjetjet e studimeve të bëra që dëshmojnë se besimi mund të rritet me komunikim më të shpeshtë, bazuar në të “dëgjuarit” dhe respektimin e prindërve (Adams, K.S., & Christenson, S.L., 2000)¹⁷⁷.

Në një studim të realizuar nga një grup ekspertësh të Institutit Pedagogjik të Kosovës theksohet se, kur flasim për komunikimin si mundësi e rritjes së besimit të familjes tek shkolla, kemi në mendje komunikimin e drejtë, thënë ndryshe, “shpesh komunikimi bëhet mjet i atakimit me pasoja të rënda, të cilat kanë ndikime të ndryshme në personalitetin e individit” (Potera, I., Mehmeti, S., Gojani, H., Shala, L., 2012)¹⁷⁸.

Si përmbyllje të nënkapitullit për besimin dhe rëndësinë e tij në bashkëpunim e familjes me shkollën për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, studimet e paraqitura më lart tregojnë se bashkëpunimi i shkollës dhe familjes ndikohet nga besimi i familjes te shkolla. Sipas disa studiuesve besimi është i ndërlidhur me faktorin komunikim.

2.6.6. Vendimmarrja e familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë

Nëse hedhim një vështrim historik mbi shkollën shohim se familja nuk ka qenë vendimmarrëse në shkollë.

“Në literaturë janë identifikuar disa karakteristika të partneritetit efektiv të cilat përfshijnë: respektin reciprok; besimin dhe ndershmërinë; të rënit dakord për qëllimet; planifikimin e përbashkët dhe vendimmarrjen”¹⁷⁹. Ndërsa vendimmarrja ka të bëjë me përfshirjen e prindërve në vendimet e shkollës dhe zhvillimin e prindërve udhëheqës dhe përfaqësues (G. Erlendsdóttir, 2010)¹⁸⁰.

Çështjen e vendimmarrjes disa autorë e ndërlidhin me marrjen e pushtetit. Ndër ta Morrow dhe Malin (2004) sugjerojnë se “pushteti në një marrëdhënie mund të zhvendoset kur njëra prej palëve merr më shumë vendimmarrje. Ata e përshkruajnë këtë lloj pushteti si fuqi (pushtet) të marrëdhënies, të dallueshëm nga pushteti personal. Ndërsa lidhja e pushtetit ka të bëjë me aftësinë për të ndikuar tek të tjerët. Përvojat që

175 Po aty, fq.8.

176 Cori Brewster and Jennifer Railsback, 2003. *Building trusting relationships for school improvement: implications for principals and teacher.*

177 Adams, K. S., & Christenson, S. L. (2000). *Family-School Relationship Examination of Parent-Teachers Differences in Elementary and secondary.*: Journal of School Psychology, Volume 38, Issue 5, September - October 2000, Pages 477-497.

178 Potera, I., Mehmeti, S., Gojani, H., Shala, L., 2012, (2012). *Dhuna verbale ndaj nxënësve* . “Instituti Pedagogjik i Kosovës”, Prishtinë.

179 Deb Keen: *Parents, Families, and Partnerships: Issues and considerations*, International Journal of Disability, Development and Education Vol. 54, No. 3, September 2007, pp. 339–349.

180 Gudlaug Erlendsdóttir, (2010). *Effects of Parental Involvement in Education.*

dekurajojnë pjesëmarrjen e prindërve në vendimmarrje mund të shkaktojnë çekuilibër në vendimmarrje Deb Keen, (2007)¹⁸¹. Një ndërlidhje të ngjashme e gjejmë edhe tek autorët, French dhe Raver (2001) sipas të cilëve ka pesë lloje të ndryshme të pushtetit që mund të ndikojnë mbi mënyrën se si njerëzit lidhen me njëri-tjetrin. Këto janë shpërblyese, detyruese, legjitime, referente dhe si dhe fuqia e ekspertit. Ndërsa çdo lloj pushteti mund ta shfrytëzojmë në marrëdhënien familje-shkollë, fuqia e ekspertit është një komponent kyç në këtë marrëdhënie kur prindi e kupton se mësuesi është ekspert”.¹⁸²

Sigurisht që vendimmarrja, marrja e pushtetit nga familja për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve kërkon të jetë e arsyeshme. Të kërkosht pushtet, do të thotë të ngresh dhe të fillosh t’i përgjigjesh pyetjes: Kërkoj pushtet për të ndryshuar, çfarë? Ndryshimi i forcave të pushtetit, në asnjë mënyrë nuk garanton ndryshimin e gjërave të tjera... Të kërkosht pushtet, pa bërë pyetjen “çfarë”, do të thotë që jo vetëm i bën dredha përgjigjes, por edhe i shmangesh kryesore dhe si pasojë do të arrish vetëm rezultate sipërfaqësore (Fullan, 2001)¹⁸³.

Në Kosovë vendimmarrja e prindërve rregullohet me anë të ligjit “Për arsimin fillor dhe të mesëm” të miratuar në vitin 2002. Neni 29 i ligjit¹⁸⁴ është neni i cili shumë qartë përcakton përgjegjësitë e vendimmarrjes. Një analizë e këtij neni na tregon se në pikëpamje ligjore vendimmarrja e prindërve në shkollë është mjaft transparente. Ky nen tregon se është rregulluar shumë mirë procesi vendimmarrjes dhe kërkimit të përgjegjësisë nga prindërit. Në nenin 29 të këtij ligji në mënyrë shumë të qartë përcakton mënyrën e themelimit të Këshillit të Shkollave, si organe parësore për nga rëndësia në drejtimin e shkollës, duke përfshirë kështu familjen në instancat më të larta të drejtimit të shkollës, si dhe duke përshkruar qartë të drejtat e këtij Këshilli. Familja bëhet pjesë e instancës më të lartë drejtuese të shkollës. Ky nen, në të gjithë paragrafët e tij parashikon mjaft mirë rolin e familjes në vendimmarrje dhe në kërkimin e përgjegjësive, nëse zbatohet, përndryshe kemi bërë shkelje të tij.

Sipas këtij ligji, bordi i shkollës me përfaqësues edhe nga prindërit, organizon gjithë veprimtarinë e shkollës. Drejtori ka funksionin e sekretarit pa të drejtë vote. Në bordin e shkollës janë 3 përfaqësues të prindërve dhe 5 përfaqësues të mësimitdhënësve me të drejtë të plotë vote.¹⁸⁵ Neni 16 i ligjit nr. 2002/2, “Mbi arsimin fillor dhe të mesëm”, i cili ka të bëjë me Komitetin e Prindërve të Arsimit të Kosovës, përfshin drejtpërdrejtë familjen në vendimmarrje, në organin e arsimit, në Ministrinë e Arsimit dhe Teknologjisë. Familja përmes këtij komiteti përfaqëson interesat e familjes në shkollë. Ky komitet dhe puna e tij pa dyshim që reflekton pozitivisht pjesëmarrjen e familjes në shkollë. Ky nen kërkon bashkëpunim aktiv të familjes me shkollën.

Sipas një studimi të KEC-it, bazuar në të dhënat e prindërve, shkolla nuk kërkon nga prindërit mendim për menaxhimin financiar të shkollës e as për menaxhimin e përgjithshëm të shkollës. Sipas studimit të KEC-it “të intervistuarit pajtohen se

181 Deb Keen, (2007). *Parents, Families, and Partnerships: Issues and considerations*, International Journal of Disability, Development and Education Vol. 54, No. 3, September 2007, pp. 339–349

182 <http://portalguide.tech4learning.ca/printpdf/11>.

183 Fullan, M. (2001). *New understanding of change in education*. Soros.

184 Shih: Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm, nr. 2002/2 fq.19-22.

185 Po aty

pjesëmarrja e prindërve në vendimmarrje bazohet në statusin e tyre social dhe vërehet si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. U raportua që prindërit të cilët vijnë prej grupeve me më pak të ardhura janë më të hapur në ofrimin e kontributeve financiare dhe donacioneve, por ata zakonisht nuk marrin iniciativa për përmirësim¹⁸⁶.

Në doracakun e botuar nga KEC & UNICEF, thuhet se: “Bashkëpunimi shkollë-familje është një nga 11 karakteristikat e shkollave efektive, të sigurta, humane dhe miqësore për fëmijët. Në procesin e bashkëpunimit krijohen kushte më të mira lidhur me sigurinë në shkollë ashtu dhe në familje. Është me rëndësi të madhe përfshirja e prindërve në veprimtarinë e shkollës dhe në vendimmarrje. Prindërit mund të jenë partnerë të dobishëm në procesin e ndihmës individuale ndaj nxënësve, mund të kontribuojnë në estetizmin e ambienteve shkollore, me mbajtjen e ligjëratave mbi tema të ndryshme, mund të ndihmojnë mësimdhënësit në zhvillimin e mësimin, mund të ndihmojnë këshilltarët për të drejtat e fëmijëve, mund të ndihmojnë komitetin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës¹⁸⁷”.

Batey, C¹⁸⁸ në tekstin e saj “Prindërit Shpëtimtarët e Jetës”, vlerëson se shkolla duhet të krijojë atmosferën e përshtatshme me qëllim që prindërit të marrin pjesë në hartimin e politikave dhe të vendimeve për zhvillimin e shkollës. Prindërit kanë dëshirë të ftohen në tavolinën e marrjes së vendimeve, bashkë me edukatorët. Prindërit kanë dëshirë të aktivizohen para se të merren vendimet lidhur me politikën arsimore.

Si konkluzion, konsiderohet shumë e rëndësishme vendimmarrja e familjes në shkollë. Fillimisht, përfshirja familjes në vendimmarrje është detyrim i shkollës që duhet të plotësohet. Shkolla me plotësimin e këtij faktori për bashkëpunim, i tregon familjes se ajo është shumë e rëndësishme për shkollën, se familja është një autoritet dhe se pa të nuk mund të merren vendimet. Nga ana tjetër, sigurisht që dobia është e dyanshme. Në shkollë na vijnë familje nga më të ndryshmet në aspektin profesional dhe të formimit dhe prezenca e familjes në vendimmarrje do të jetë një kontribut shumë i madh edhe për vetë shkollën.

2.6.7. Informimi i familjes nga shkolla për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë

Sipas Raffael, K., & Linda, M. (1999)¹⁸⁹, bashkëpunimi në arsim erdhi me qëllim shkëmbimin e informacionit midis familjeve dhe profesionistëve. Gjithashtu, edhe “studime të ndryshme shkencore theksojnë se nuk duhet pritur që prindërit të krijojnë njohuritë e duhura për ti ndihmuar fëmijët e tyre si nxënës, ose për të kontaktuar me shkollën/mësuesit, por se duhet të jetë shkolla ajo që i informon dhe përfshin prindërit nëpërmjet programeve të partneritetit shkollë-familje-komunitet¹⁹⁰”.

186 Pupovci, D & Tafarshiku, N, (2008). *Pjesëmarrja e prindërve në jetën e prindërve në Kosovë*. Prishtinë. fq. 45.

187 Doracak për krijimin e mjediseve të sigurta jo të dhunshme e humane në shoqëri dhe në shkollë, KEC dhe UNICEF, Prishtinë, 2009, fq. 34.

188 Batey, C. *Prindërit shpëtimtarët e jetës*.

189 Raffael, K., & Linda, M. (1999). *Improving home-school collaboration with disadvantaged families: Organizational principles, perspectives, and approaches*. School Psychology Review, 28(3), 448-469.

190 Fatmir Bezati & Rozeta Hoxhalari. (2011). *Përfshirja e prindërve në jetën shkollore*. Fq.4

“Shkollat duhet ti njoftojnë prindërit për standardet dhe lidhjen e tyre me programin mësimor, objektivat mësimore, metodat e vlerësimit, programet shkollore, kodin e disiplinës dhe progresin e nxënësve. Shkëmbimi i informacionit mund të realizohet përmes mjeteve të zakonshme”¹⁹¹.

Shkolla përveç informacionit që duhet ti ofrojë familjes për arritjet, detyrat, detyrimet e nxënësve, etj., duhet gjithashtu ta mbajë familjen të mirë-informuar edhe për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës. Është me rëndësi të jepet informacion në rastet e përdorimit të dhunës, por edhe më e rëndësishme është ti ofrojë asaj informacion edhe nga fusha e parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Familja mund të ketë informacion të pakët ose aspak lidhur me dhunën eventuale ndërmjet nxënësve.

Pra, kemi arsye të shumta për informimin e familjes nga ana e shkollës duke filluar nga njohja e familjes me detyrat dhe detyrimet në shkollë, njohja e tyre mbi rëndësinë e bashkëpunimit dhe mundësitë në këtë drejtim, për arritjet e nxënësit, sukseset, sjelljet, prirjet e veçanta, ndryshimet emocionale të fëmijës në shkollë, organizimin e aktiviteteve të ndryshme në shkollë, organizimin e vizitave të ndryshme shkollore, ekskursioneve e shumë e shumë arsye të tjera. Shohim se informimi është një proces i cili fillon nga regjistrimi fëmijës në klasë të parë dhe vazhdon gjatë gjithë kohës deri sa ai të përfundojë shkollimin. Veç kësaj, informimi është i domosdoshëm sepse nuk mund të kemi bashkëpunim të suksesshëm të shkollës me familjen pa unitet të fjalës dhe të veprimit.

Për rëndësinë e shkëmbimit të informacionit mes shkollës dhe familjes gjejmë se “informatat nga shkolla janë mjetet parësore me anë të cilave familja duhet të kuptojë suksesin apo dështimin e fëmijës në shkollë”¹⁹².

Për autorët (Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link, 2001)¹⁹³ informimi i shkollës në drejtim të familjes për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës është më se i domosdoshëm. Familjet, fëmijët e së cilës janë agresivë apo të dhunshëm brenda sistemit shkollor, e kanë këtë informacion nga shkolla, dhe ata e dinë më mirë se çdokush tjetër me çfarë strategjish mund të punohet me fëmijët e tyre. Ky informacion gjithashtu është shumë i nevojshëm për mësuesit e shkollave.

Jackson dhe Foshee (1998) kanë gjetur se fëmijët të cilët perceptojnë se prindërit e tyre kanë udhëzime të qarta, strukturë, përkujdesje dhe mbështetje prej tyre, ishin dukshëm më pak të angazhuar në veprime dhune me bashkëmoshatarët. Personeli mësimor mund të ofrojë arsim prindëror dhe mund t’u lehtësojë prindërve vendosjen e kufijve të qartë dhe mbështetjen e fëmijëve të tyre. Ky informacion mund të ndahet me prindërit e fëmijëve në çdo nivel të klasës. (Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link)¹⁹⁴. Ndërsa lidhur me ndihmën ndaj familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve dhe këtij faktori në këtë drejtim, autorët: (Timothy H. Brubaker,

191 National Coalition for Parent Involvement in Education. <http://www.ncpie.org/DevelopingPartnerships/>. Pare me: 22.01.2014.

192 Jarvis, Lori A. *Keep In Touch With Parents Via Email*. Action Research Project. imet.csus.edu/imet3/lori/eportfolio/myrol.html.html. Pare me 12.09.2013.

193 Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link. (2001): *School Violence: Partnerships with Families for School Reform*. Michigan family review. vol. 6, no. 1, Fall 2001

194 Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link, (2001). *School Violence: Partnerships with Families for School Reform*. Michigan family review. vol. 6, no. 1, Fall 2001.

Ellie Brubaker, Mary Link)¹⁹⁵, kërkojnë që kur flasim për informimin e familjes në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, prindërit është e këshillueshme që të udhëzohen edhe për lexim të literaturës në këtë drejtim (Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link)¹⁹⁶.

Dobitë e informimit të familjes nga shkolla janë të shumta dhe ato reflektojnë, çka është më e rëndësishme, te nxënësit. Për më tepër, informacionet e mjaftueshme që merr familja nga shkolla dhe punën që ajo bën, vetëm sa thellojnë bashkëpunimin mes familjes dhe shkollës. "Si profesionalizmi i mësuesve dhe njohuritë e prindërve për fëmijët e tyre mund të hapin rrugë për një partneritet efikas arsimor"¹⁹⁷. Ne konsiderojmë se përmes informimit mund të bëjmë shumë edhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Sipas një studimi të realizuar nga Gudlaug, të gjithë prindërit duan të informohen mbi mënyrën dhe personat me të cilët kalon kohën fëmija i tij ose saj jashtë shkollës, dhe shumica e prindërve del se e konsiderojnë vetën në raport të mirë me shkollën në këtë drejtim (G. Erlendsdóttir, 2010).¹⁹⁸

(Marrë nga: Stacy Callender, MA, & Annie Hansen, MA)¹⁹⁹, hulumtimet tregojnë se ekzistojnë mënyra të ndryshme sesi shkolla mund të ofrojë informacion mbi mundësitë e shumta për të ndikuar në nivelin e të mësuarit të fëmijëve. Megjithatë, familjet mund të kenë qasje më të kufizuar në këtë informacion se sa mësuesit. Shkolla mund të bëhet pikë shpërndarjeje e natyrshme e informacionit të rëndësishëm në ndihmë të fëmijëve. Shumica e familjeve dëshirojnë informacion specifik lidhur me aktivitetet që ata mund të bëjnë me fëmijët e tyre. Mësuesit mund të japin gjithashtu udhëzime të dobishme edhe për krijimin e mjedisit nxitës në shtëpi për suksesin e fëmijëve, si caktimin e kohës për detyrat e shtëpisë, angazhimin në lexim në kohën e lirë, eksplorimin e temave të ndryshme mësimore, si dhe kufizimin e kohës përpara ekranit apo video lojërave. Shkollat mund të ndajnë informacion në lidhje me shërbimet në komunitet dhe aktivitetet që kërkojnë mbështetje dhe mundësi shtesë për të mësuarit për të gjithë në familjen.

Pse janë të rëndësishme informacionet që i jepen familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve? Mësuesit marrin informacione nga familja, e në këtë mënyrë ata marrin edhe domethënien e tyre. Kështu, mësuesi peshon informacionet nga familja me njohuritë e tij, duke u mbështetur në tri pika referimi: Përvojën brenda familjes së tyre, familjet me të cilat kanë punuar në të kaluarën, njohjen e gjatë të fëmijës ose familjes së aktuar.

Studimi i KEC-it i realizuar në Kosovë tregon se prindërit nuk kanë marrë kurrë informacion nga shkolla mbi mënyrat sesi ta ndihmojnë fëmijën e tyre për të mësuar,

195 Po aty.

196 Po aty.

197 Dusi, P. The Family-School Relationships in Europe: A Research Review. *C E S P. Journal* . Vol.2 . No1. 2012. Fq.13-21. http://www.cepsj.si/pdfs/cepsj_2_1/cepsj_2_1_pp013_dusi.pdf Parë më 22.04.2012.

198 Gudlaug Erlendsdóttir, (2010). School Violence: Partnerships eith Families for School Reform. vol. 6, no. 1, Fall 2001.

199 Stacy Callender, MA, & Annie Hansen, MA: *Family-School Partnerships: Information and Approaches For Educators*. Helping Schildren at Home and School II: Handouts for Families and Educators. NASP.

për shkollën, rregullat dhe përmbajtjen e lëndëve. Sipas këtij studimi, shkollat nuk i ofrojnë familjes informacion as përciptazi mbi çështje si: shëndeti, droga, dhuna etj., e kur një gjë e tillë ndodh, informacioni iu dërgohet më shumë prindërve të përfshirë në strukturat e shkollës. Megjithatë, bazuar në këtë studim të Kec-it gjysma e prindërve deklarojnë se nuk kanë marrë informacion të shkruar nga shkolla për mbarëvajtjen e fëmijës, vlerësim të shkruar, raport notash, raporte përfundimtare²⁰⁰. Por, kur flasim për rëndësinë e këtij faktori në bashkëpunimin shkollë-familje, autorët Shalpey. K & Case. B (2004)²⁰¹. tërheqin vëmendjen që të kemi kujdes kur informojmë familjen lidhur me fëmijën, pasi duhet t'i shmangim fajësimet dhe të gjykuarit e familjes, por dhe të deklarojmë gjendjen qartë, shkurt dhe me shembuj konkret lidhur me sjelljen. Familja duhet ta kuptojë se zgjidhja e problemit nuk mund të ndodhë vetëm disa ditë ose javë pas dhënies së informacionit për fëmijën. Në këtë drejtim autorët rekomandojnë se gjatë dhënies së informacionit, paraprakisht duhet të kemi parasysh ndjenjat e prindit/familjes, pastaj të përpiqemi të përqendrohemi gjatë bisedës në zgjidhjen e problemit. Përsëri zgjidhja do të vijë pak me vonesë. Shohim se ky faktor është me shumë rëndësi, ndaj duhet të kihet parasysh ana delikate e tij.

2.6.8. Përvoja e familjes me shkollën, faktor për përfshirjen dhe bashkëpunimin e familjes me shkollën për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve

Prvoja e familjes me shkollën është ndër faktorët të cilin e konsiderojmë të rëndësishëm në bashkëpunimin e shkollës me familjen, bashkëpunim ky që diktohet edhe nga bashkëpunimi paraprak ndërmjet familjes dhe shkollës, “varet edhe nga vlerësimi kritik i përvojave paraprake”²⁰².

Prindërit në shkollë vijnë me përvoja të ndryshme. Kështu që kur krijojnë partneritete, edukatorët duhet të kenë parasysh se familjet kanë përvoja të ndryshme me shkollën. Ato mund të përfshijnë edhe përvoja negative me shkollën. Pengesa të tjera, të cilat ndoshta mund t'u dalin përpara anëtarëve të familjes gjatë përfshirjes në edukimin e fëmijëve të tyre, janë dhe prirjet e kufizuara për rolin e tyre në procesin arsimor, ndjenja e ulët e efikasitetit për të ndihmuar në suksesin e fëmijës në shkollë, si dhe perceptimi negativ për ftesat dhe mundësitë e përfshirjes. Familjet që nuk ndihen të lidhur me shkollën ose jo të mirëpritur në shkollë apo që nuk kanë qenë të ftuar nga fëmija i tyre ose shkolla për të marrë pjesë, mund të mos e kuptojnë rëndësinë e përfshirjes së tyre (nga: Stacy Callender, MA, & Annie Hansen).²⁰³

200 Pupovci, D & Tafarshiku. (2008). N: *Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë-një rrugë drejt ndryshimit.*

201 Shalpey.K & Case. B. (2004). *Building Partnerships with Parents.* Fq.6

202 Zuna-Deva, A & bashkëautorët. (2009). *Partneriteti shkollë-familje-komunitet, sfidë vijanoze.* “Libri shkollor” Prishtinë.fq.223.

203 Stacy Callender, MA, & Annie Hansen, MA: *Family-School Partnerships: Information and Approaches For Educators.* Helping Children at Home and School II: Handouts for Families and Educators. NASP.

Sipas, Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link, (2001)²⁰⁴ çdo prind ka pasur ndërveprime me shkollën. Familjet ose anëtarët e saj, nëse kanë pasur përvoja të mira me shkollën, ka mundësi që kur të ftohen të përfshihen lehtësisht në shkollë.

Ndërsa autorët: (Cori Brewster and Jennifer Railsback, 2003)²⁰⁵, konsiderojnë se: “anëtarët e familjes përvojat e të cilëve kanë qenë negative mund të mos ndihen rehat kur hyjnë në ndërtesën e shkollës ose nuk mund të mos besojnë se mësuesit e vlerësojnë kontributin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, me familjet të cilat kanë pasur problem me një mësues ose shkollë tjetër, fëmijët e tyre mund të venë në pikëpyetje vlerën e komunikimit me shkollën. Kjo vlen gjithashtu edhe për mësuesit përvoja e të cilëve është negative me familjen. Ata vënë në pikëpyetje vlerën e komunikimit me të tjerët”, ndërsa, “në përgjithësi përvoja e kaluar pozitive e familjes ka më shumë gjasa që ta ndihmojë të ndihet e mirëpritur dhe e pranuar si partnere”²⁰⁶.

Shkolla me përvojë të mirë në marrëdhëniet me familjen i lë një pasuri tejet të çmuar familjes. Prandaj dhe ky faktor konsiderohet shumë domethënës në bashkëpunimin shkollë-familje.

Si konkluzion, në këtë pjesë të fundit të shqyrtimit të literaturës mund të përmbledhim se, faktorët si: mirëpritja e familjes në shkollë, komunikimi i shkollës në drejtim të familjes, mbështetja e suksesit të nxënësve, vendimmarrja e familjes në shkollë, ndarja e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes, besimi i familjes te shkolla dhe anasjelltas, përvoja e familjes me shkollën, janë faktorë të cilët shumë studiues i konsiderojnë të rëndësishëm në bashkëpunimin ndërmjet familjes dhe shkollës. Ato kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe në përfshirjen e familjes në shkollë dhe bashkëpunimin e shkollës me familjen. Ne gjithashtu gjejmë se rëndësia e tyre është e pamohueshme edhe në drejtim të përfshirjes së familjes në shkollë me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Duke analizuar ndikimin e këtyre faktorëve në fusha të ndryshme, si në arritjet e nxënësve, sferën e tyre emocionale, ne e gjejmë të domosdoshme përfshirjen e familjes në shkollë dhe bashkëpunimin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

204 Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link) *School Violence: Partnerships with Families for School Reform*, Timothy H. Brubaker, Ellie Brubaker, Mary Link, vol. 6, no. 1, Fall 2001 Issue title: Families & Educational Reform

205 Cori Brewster & Jennifer Railsback. (2003). *Building Trust with Schools and Diverse Families*. Implications for principals and teacher Northwest Regional. Fq.15.

206 <http://www/digitalcommons.unl.edu>

Ky kapitull na mundëson të njihemi me metodën e studimit dhe tërë strukturën e saj. Kapitulli përshkruan kërkimin empirik.

Kapitulli është organizuar në shtatë komponentë: a) Dizajni i hulumtimit, b) Popullata dhe kampioni, c) Instrumentet e hulumtimit, f) Grumbullimi i të dhënave, g) Analiza e të dhënave, h) Metodatat e studimit, i) Besueshmëria dhe vlefshmëria, j) Etika e studimit.

3.1 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Qëllimi i studimit është të kërkojë rrugët e optimizimit të bashkëpunimit të shkollës me familjen për përballimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Ndërsa objektivat e studimit ishin:

1. Evidentimi i nivelit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.
2. Eksplorimi i nivelit të bashkëpunimit të shkollës me familjen për përballimin e dhunës mes nxënësve në shkollë.
3. Veçimi i përvojave të mira të bashkëpunimit të shkollës me familjen.

3.2 ÇËSHTJET DHE PYETJET E STUDIMIT

Pyetjet e studimit janë:

1. Cilat janë format e dhunës ndërmjet nxënësve? Cilat janë përmasat e saj? Cilat janë arsyet? Çfarë pasojash ka përdorimi i dhunës ndërmjet nxënësve? Çfarë qëndrimesh mbahen ndaj dhunës ndërmjet nxënësve? A ekzistojnë programe që merren drejtpërdrejt me parandalimin, studimin, rehabilitimin, etj?
2. Cili është niveli i mirëpritjes së familjes në shkollë dhe çfarë korrelimi ka mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
3. Në çfarë niveli është komunikimi mes shkollës dhe familjes dhe çfarë korrelimi ka mes komunikimit dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
4. A janë dhe në çfarë niveli janë të informuar familja nga shkolla për dhunën ndërmjet nxënësve dhe çfarë korrelimi ka mes informimit dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
5. Cili është niveli i ndarjes së detyrave të shkollës me familjen dhe në çfarë korrelimi qëndron ajo me nivelin e takimit të familjes me shkollën;
6. A është familja vendimmarrëse në shkollë dhe cila është marrëdhënia mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;

7. Në çfarë niveli është besimi i familjes te shkolla dhe çfarë korrelimi ka mes tij dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
8. Cila ishte përvoja e familjes me shkollën dhe cila është marrëdhënia aktuale mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;

Ndërsa çështjet kërkimore janë këto:

1. Evidentimi i treguesve kryesorë të dhunës ndërmjet nxënësve tek nxënësit e klasës së tetë të shkollës fillore në Kosovë.
2. Evidentimi i rolit të nivelit të mirëpritjes së familjes në shkollë në bashkëpunimin shkollë-familje.
3. Evidentimi i rolit të komunikimeve të mësuesve me familjen në bashkëpunimin shkollë-familje.
4. Evidentimi i ndikimit të informimit nga mësuesit për çështjet që lidhen me nxënësit në bashkëpunimin shkollë-familje.
5. Evidentimi i ndikimit të ndarjes së roleve në bashkëpunimin shkollë-familje.
6. Evidentimi i ndikimit të mbështetjes së suksesit të nxënësve në bashkëpunimin shkollë -familje.
7. Evidentimi i problemeve të vendimmarrjes të mësuesve dhe të familjes në shkollë dhe ndikimi i tyre në bashkëpunimin shkollë-familje.
8. Evidentimi i efektit të përvojës së mëparshme në bashkëpunimin aktual të mësuesve me familjen.
9. Evidentimi i rolit të besimit të familjes te mësuesit në nivelin e bashkëpunimit të mësuesve me prindërit.

3.3 METODA E STUDIMIT

Në studimin tonë përdorëm dy metoda kryesore: metodat sasiore të kërkimit dhe metodat cilësore të kërkimit. Arsyeja qëndron se ne në studimin tonë kemi për njësi të kampionit nxënës, mësues, drejtues të shkollave dhe familjen, dhe si rezultat duhej të mblidhnim lloje të të dhënave nga njësitë e përmendura. Kishim disa këndvështrime për çështjet e studiuara, si për dhunën ndërmjet nxënësve ashtu dhe për bashkëpunimin në përballje me të. Për të marrë përgjigje për çështjet dhe pyetjet e studimit nga këto njësi doli domosdoshmëria e përdorimit të metodave të përdorura.

3.3.1. Kërkimi sasior

Shkolla jonë përballet me vështirësi por dhe me probleme të ndryshme. Një prej tyre është edhe dhuna ndërmjet nxënësve në shkollë. Që të mund të përballohet në mënyrë të suksesshme dhuna ndërmjet nxënësve duhet të ekzistojë një bashkëpunim i mirë me familjen. Por si është ky bashkëpunim në shkollën tonë përbënte dhe preokupimin tonë si studiues. Me synim njohjen e këtij bashkëpunimi, si metodë kryesore të studimit kemi përdorur metodën e kërkimit sasior.

E kemi kryer studimin sasior me qëllim marrjen e perceptimeve dhe informacioneve për bashkëpunimin me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Pyetëtori na

mundësoi mbledhjen e informacioneve nga një zonë e gjerë gjeografike e vendit tonë. Për arsyen e fundit pyetësori konsiderohet shumë i përshtatshëm për aplikimin dhe marrjen e informacioneve.

Përmes pyetësorit ne morëm opinionet nga shkolla dhe familja mbi nivelin e bashkëpunimit mes shkollës dhe familjes, identifikuam numrin e takimeve ndërmjet mësuesit dhe familjes gjatë një viti shkollorë, duke marrë një kampion të madh nga një popullatë e shpërndarë në një zonë gjeografike të madhe rurale dhe urbane. Ne e vlerësojmë të përshtatshme këtë metodë për studimin tonë. Kemi përdorur analizat përshkruese, korrelacionale ndërsa rezultatet i kemi prezantuar të shoqëruara me shpjegime.

3.3.2. Kërkimi cilësor

Në studimin tonë vend me rëndësi zë edhe kërkimi cilësor me anën e të cilit studiuam perceptimet e shkollës, familjes dhe nxënësve për çështje të ndryshme të dhunës ndërmjet nxënësve; për çështje të ndryshme lidhur me bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes. Përdorëm intervista gjysmë të strukturuar dhe fokus grupin.

Përdorëm analizën interpretative. Interpretuam përgjigjet e të intervistuarave përmes përqindjeve dhe në disa raste cituam informatat fjalë për fjalë.

Metoda cilësore në studimin tonë ishte e domosdoshme për të njohur në thellësi problemin. Veç kësaj, përmes metodave cilësore mund të ndërtohet konstrukti social. Ndërsa, sipas Creswell, J. W. (2007)²⁰⁷ konstrukti social me metodat cilësore ndërtohet nga individët të cilët janë të përfshirë me botën që i rrethon.

3.4 VARIABLAT E STUDIMIT

Variablat të cilat janë marrë në shqyrtim në këtë studim janë:

Niveli i takimeve mes shkollës dhe familjes si variabël i varur, ndërsa, variabla të pavarura kemi faktorët si: Mirëpritja e familjes në shkollë; Komunikimi shkollë-familje, Informimi i shkollës drejt familjes dhe anasjelltas; Vendimmarrja e familjes në shkollë; Mbështetja e suksesit të nxënësit; Besimi i familjes te shkolla dhe anasjelltas, përvoja e familjes me shkollën, ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes.

Në rastin tonë numri i takimeve mes shkollës dhe familjes është variabël sasior, përderisa variablat e pavarura janë kualitative të rikoduara me kode numerike.

Në studimin tonë numri i faktorëve është treguesi sintetik për bashkëpunimin shkollë-familje, faktor ky real dhe i palëkundshëm i bashkëpunimit. Ndërsa, faktorët e lartpërmendur – variabël të pavarur janë ata të cilët dolën nga intervista me familjen dhe shkollën, faktorë këta të cilësuar për bashkëpunim dhe përfshirje më të gjerë të familjes në shkollë.

207 Creswell, J. W. (2007). *Educational research: planning, conducting and evaluating quantitative and qualitative research (3rd edition)*. New York: Prentice Hall.

3.5. DIZAJNI I STUDIMIT

Përmes studimit ne paraqesim situatën e dhunës dhe bashkëpunimin për përballje me të. Studimi është i tipit eksplorues. Ai eksploron bashkëpunimin e shkollës me familjen sipas mendimit të mësuesve, drejtorëve të shkollave, familjes dhe nxënësve. Në fakt, studimi merr formën e një rasti studimor i cili përshkruan gjendjen e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë dhe faktorët për përfshirjen e familjes në shkollë me qëllim përballimin dhe parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve..

Për kryerjen e studimit u përdorën metodologji mikse: studimi i literaturës, grumbullimi i materialit kontekstual, anketimi dhe intervistimi i subjekteve si dhe organizimi i fokus grupeve.

Përdorimi i këtyre metodologjive është parë i nevojshëm për të përballuar gjerësinë e opinioneve, përvojave, dhe praktikave mbi dhunën mes nxënësve dhe për të kuptuar sa zënë vend në bashkëpunim ndërmjet shkollës dhe familjes faktorë si: mirëpritja e familjes në shkollë, komunikimi i shkollës në drejtim të familjes, mbështetja e suksesit të nxënësve, vendimmarrja e familjes në shkollë, ndarja e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes, besimi i familjes te shkolla dhe anasjelltas, përvoja e familjes me shkollën, përfshirja e familjes në shkollë me qëllim bashkëpunimin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Në thelb ky studim është i kombinuar cilësor / sasior, me qëllim njohjen e problemit me tërë kompleksitetin e bashkëpunimit shkollë-familje. Ky është studim përshkrues, korrelacional.

Studimi përshkrues kryhet në ato raste kur nuk kemi studime të mëparshme, kur duam të zbulojmë tematika për kërkime të mëtejshme, kur duam të tregojmë se paraqitet gjendja në një situatë të caktuar, etj. Studimi përshkrues është studim shkencor dhe si i tillë rëndësi për aspektin shkencor ka zgjedhja e duhur e kampionit. Në këtë element e plotësojmë, pasi kampioni ynë i parë është prej 1493 subjektesh. Të dhënat e marra nga një kampion i tillë e mbështesin plotësisht studimin tonë përshkrues.

Për studimin e problemit ne na kanë ndihmuar statistikat përshkruese, kryesisht një kërkim sasior, me qëllim kuptimin e korrelacionit ndërmjet faktorëve dhe nivelit të takimeve shkollë-familje. Statistika përshkruese na mundësoi mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave, ato janë përshkruese dhe korrelacionale.

Arsyeja përse ne vendosëm të punojmë me statistikë përshkruese ishte fakti se kishim të bënim me krahasim mes qëndrimeve të familjes dhe shkollës në bashkëpunim me njëra-tjetrën, ndërsa dihet se statistika përshkruese mundëson shmangien e gabimeve njerëzore, në mënyrë që mos të ndikohet në rezultatet e studimit. Më tej, përmes statistikës përshkruese që përdorëm kishim mundësi më të mirë për paraqitjen e shpërndarjes së frekuencave në mënyrë tabelare, por dhe korrelacionale. Kjo solli qartësi në prezantimin e gjetjeve, të shoqëruara edhe me komente dhe interpretime.

Nisur nga natyra dhe qëllimi ynë në studim, deskriptivja më së miri na mundëson njohje të problemit tonë studimor.

Përdorëm dhe studimin korrelacional. Ndryshoret e përdorura në këtë studim kanë variancë të përbashkët. Me qëllim shqyrtimin e kësaj variance realizuam korrelacionin ndërmjet mirëpritjes së familjes në shkollë, komunikimit, informimit, ndarjes së

detyrave shkollë-familje, vendimmarrjes, ndarjes së pushtetit, besimit, mbështetjes së suksesit të nxënësve dhe përvojës me nivelin e takimeve shkollë-familje.

3.6 STUDIMI SONDAZH

Studimi ynë nisi me një studim sondazh me tre grupe të anketuarish: shkolla (mësuesi dhe drejtuesit e shkollave), familja dhe nxënësit. Përmes këtij sondazhi ne siguruam të dhëna paraprake për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë e cila mund të trajtohet përmes bashkëpunimit shkollë-familje.

Për grumbullimin e të dhënave në këtë studim sondazh realizuam intervistat gjysmë të strukturuar me mësuesit, prindërit / kujdestarët e nxënësve, drejtorët e shkollave dhe nxënësit. Konkretisht janë realizuar 39 intervista me prindër dhe 48 me mësues, 12 me drejtorë shkollash. Gjithsej 111 intervista të cilat na njohën me arsyet dhe qëndrimet e nxënësve, mësuesve, drejtuesve dhe familjes lidhur me dhunën dhe bashkëpunimin e shkollës me familjen. Intervistat mbuluan tema të tilla si: të kuptuarit e nocionit dhunë; llojet e dhunës, arsyet e dhunës; pasojat nga dhuna; informacionet për trajtimin e dhunës ndërmjet nxënësve në bashkëpunimin midis shkollës me familjen; nëse një bashkëpunim i tillë ka ndodhur, kush ishte iniciator, si dhe çështje të tjera. Në mënyrë që ta njohim problemin në thellësi kemi bërë dhe ndërhyrje në çështje të caktuara gjatë intervistimit.

Në këtë studim sondazh integruam dhe fokus grupin si një mundësi shumë e mirë për të depërtuar në thellësi të problemit të studimit. Pjesëmarrës në fokus grupet e studimit tonë janë nxënësit. U organizuan tri seanca me fokus grupe. Fokus grupi përbehej nga dy kategori nxënësish. Ata u identifikuan bazuar në intervistat me mësues dhe më pas u identifikuan disa nxënës të dhunuar të cilët na dërguan tek nxënësit e tjerë dhunues ose të dhunuar. Zbatuam metodën jo probabilitare të kampionimit, metodën e teknikës së kampionimit me metodën top dëbore. Identifikimin e tyre e bëmë përmes mësuesve dhe nxënësve. Kjo ishte karakteristika përcaktuese e të qenit pjesëtar i fokus grupit. Përbërja ishte homogjene. Gjithsej, në fokus grup u përfshinë 28 nxënës. Dy grupe me nga tetë nxënës dhe një me dymbëdhjetë nxënës. Fokus grupet u organizuan në dy shkolla të Prishtinës.

Çështjet e trajtuara në fokus grup ishin: çfarë nënkupton dhuna për nxënësit; çfarë lloje të dhunës fizike dhe psikike janë përdorur ndaj tyre; për çfarë arsye është ushtruar dhunë ndaj jush, ose, ju ndaj tyre; çfarë pasoja pati dhuna e ushtruar ndaj jush ose ndaj shokut, etj.

Realizimi i këtij studimi sondazhi na ndihmoi ne si studiues lidhur me qasjen për studimin e bashkëpunimit shkollë-familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Përveç kësaj ne u njohëm me dhunën ndërmjet nxënësve dhe dimensionin e saj, arsyet dhe qëndrimet e ndaj saj, etj. Megjithatë, të dhënat e fituara përmes tij nuk raportojnë për dhunën në nivel kombëtar në Kosovë.

3.7. POPULLATA DHE KAMPIONI I PJESËMARRËSVE NË STUDIM

Popullata e studimit tonë përbëhet nga nxënësit, drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe prindërit e klasave të teta të shkollës së mesme të ulët në Kosovë. Popullata është numerikisht e caktuar. Meqenëse është popullatë e madhe për të studiuar problemin aty jemi përcaktuar për variantin e mundshëm të studimit-kampionim.

Në studimin tonë popullata përbëhet nga drejtuesit e shkollave, mësuesit, familjet dhe nxënësit e klasave të teta të shkollave fillore të Kosovës. Kampioni ynë përbëhet në këtë mënyrë nga tri shtresa: familja, shkolla (mësuesit dhe drejtorët) dhe nxënësit. Numri i mostrës për çdo shtresë është bërë në mënyrë që të përmbushej formula $30/(2 * \text{numrin e rajoneve gjeografike})$.

Për përfaqësimin e kampionit shfrytëzuar statistikat e MASHT. Sipas statistikave të MASHT, në klasën e tetë të shkollës së mesme të ulët në Kosovë janë të përfshirë gjithsej 30088 nxënës, nga të cilët femra 15663 dhe 14425 meshkuj.

Për një përfaqësim më të gjerë, popullatën tonë në shkollë vendi e ndamë në 14 komuna. Pra, në kampionim ne përfshimë 14 komuna të Kosovës, përveç Prishtinës ku morëm dy shkolla për studim. Më pas, një shkollë nga një fshat i komunave të marra në studim, gjithsej 29 shkolla. Konkretisht në kampion përfshimë: Prishtinën, Gjilanin, Pejën, Prizrenin, Ferizajn, Dardanën, Rahovecin, Gjakovën, Mitrovicën, Podujevën, Fushë Kosovën, Therandën, Kaçanikun, Vushtrrinë. Në secilën komunë ne morëm një shkollë si kampion. Përzgjedhja e shkollës është bërë në mënyrë rastësore. Morëm shkollën më të afërt apo më të lehtë për tu gjetur. Intervistuar drejtuesit e shkollave, ndërsa mësuesit plotësuan pyetësorët. Përzgjedhja e mësuesve është bërë mes atyre që japin mësim në klasën e tetë dhe zgjodhëm mësuesit të cilët kontaktuar në mësonjëtoje ose sallën e mësuesve.

Për të marrë më shumë informacion lidhur me dhunën ndërmjet nxënësve përdorëm fokus grupin. Kampioni ynë në fokus grup përbëhet nga 28 nxënës të identifikuar si dhunues ose të dhunuar. Takimet me këta nxënës i realizuam pas përfundimit të orarit të mësimin në shkollë. Nxënësit e përfshirë në fokus grup ishin nga dy shkolla të Prishtinës. Përzgjedhja e nxënësve të përfshirë në fokus grup është bërë me ndihmën e mësuesve dhe nxënësve të cilët na dhanë preferencat e tyre. Është përdorur kampionimi "top dëborë". Sipas udhëzimit nga ana e mësuesve dhe nxënësve ne identifikuam shtatë nxënës dhunues të cilët më pas na dhanë emrat e nxënësve të tjerë dhunues dhe të dhunuar.

Për të marrë informacion mbi dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë me të gjitha karakteristikat e saj, ne realizuam edhe intervistat me familje, si dhe drejtues dhe mësues të shkollave. Shkollat ishin ato në të cilat shpërndamë edhe pyetësorët. Konkretisht, këto intervista u realizuan; 39 me prindër dhe 48 me mësues, 22 me drejtorë shkollash.

Kampioni final me të cilin dhe janë filluar analizat e studimit sasior ishte $N=1700$. Në studim u përfshinë 300 prindër nga shkollat e mjedisit urban, si dhe 300 mësues nga shkollat e mjedisit urban në Kosovë si dhe 400 prindër nga shkolla e mjedisit rural dhe po aq mësues, pra 400 të mjedisit rural, si edhe drejtorët e secilës shkollë ku përfshihen mësuesit dhe familjet e të dy mjedisëve. Pas pastrimit të tij kampioni final, në bazë të të cilit u bënë analizat e tij, ishte $N= 1520$, i cili përfshinte 298 familje të mjedisit

urban dhe 394 familje të mjedisit rural, 400 mësues të mjedisit rural dhe 299 mësues të mjedisit urban. Kampionim ky për të dhënat sasiore, dhe 111 njësi kampioni për të dhënat cilësore. Arsyeja përse është më i madh numri i të anketuarve tek mjedisi rural është sepse popullata në Kosovë është më shumë e shtrirë në këtë mjedis. Arsye tjetër, “duke pasur parasysh burimet e kufizuara evidente në komunitetin rural, bashkëpunimi shkollë-familje, mund të jetë veçanërisht i dobishëm për nxënësit në shkollat rurale”²⁰⁸. Nisur nga këto dy arsye, studimin empirik ne e shtrimë në nivel kombëtar në Kosovë.

Siç kuptohet, studimi analizoi faktorët që lidhen me bashkëpunimin e familjes me shkollën në një gjeografi të gjerë e cila përfaqëson gjithë popullatën e vendit. Për nga numri dhe shtrirja gjeografike, konsiderohet se është përfaqësues i gjithë komunitetit të shkollave fillore në Kosovë.

Për të arritur në gjetje të besueshme, popullata e studimit duhet të ndahet në grupe homogjene dhe secili grup duhet të ketë karakteristika të besueshme, sipas Cohen, Manion dhe Morrison (2001)²⁰⁹. Nisur nga kjo, në popullatën tonë të studimit kemi supozuar se të gjithë mësuesit dhe drejtorët kanë karakteristika të njëjta në aspektin profesional. Të gjitha shkollat drejtohen nga një drejtor. Të gjithë nxënësit janë të së njëjtës moshe, të klasës së tetë dhe me karakteristika përafërsisht të njëjta. Familjet po ashtu.

Gjithashtu, supozojmë se kemi homogjenitet edhe për sa i përket anës rajonale. Për të gjithë shkollat dhe familjet urbane supozojmë sa kanë karakteristika të njëjta, po ashtu edhe ato rurale. Bazuar në këtë element të homogjenitetit, analiza e përgjigjeve është bërë ndaras; analiza e të dhënave nga shkolla dhe familja urbane dhe ajo nga shkolla dhe familja rurale nisur nga fakti se kemi hasur në dallime të vogla në dimensionin rajonal. Në pjesën e diskutimit kryesisht është bërë një diskutim i përgjithshëm i rezultateve të arritura në studim.

Cohen, Manion dhe Morrison (2001)²¹⁰ pohojnë se e gjithë popullata duhet të ndahet në grupe homogjene dhe çdo grup të ketë karakteristika të krahasueshme. Në vazhdim unë kam supozuar se mësuesit kanë karakteristika të njëjta, pra në studim morën pjesë mësues nga shkolla të zonave rurale e urbane.

Në studimet përshkruese dhe korrelacionale, konsiderohet se përdoret 10% deri në 20% e popullatës së synuar, sipas Gay dhe Airasian (2003)²¹¹. Në studimin tonë bëmë këtë përfshirje në numrin të shkollave, familjeve, nxënësve dhe drejtorëve. Kjo përfshirje konsiderojmë se plotëson i kriteret për një përfshirje një përfshirje të duhur.

Realizimi i fazës së plotësimit të pyetësorëve është ajo e cila më së shumti zgjati në studim. Plotësimi i pyetësorëve është bërë në prani të studiuesit dhe bashkëpunëtorëve në studim.

Studimi filloi në shkurt 2013 dhe përfundoi në qershor të po atij viti.

208 Amanda L. Witte & Susan M. Sheridan (2011): Family Engagement in Rural Schools, fq.3,

209 Cohen, L., Manion, L. & Morrison, K. (2001). *Research Methods in Education*.

210 Po aty

211 Gay I. R. & Airasian, P. (2003). *Educational Research: Competencies for Analysis and Application*.

3.8. INSTRUMENTET E STUDIMIT

Ky nënkapitull përfshin një përshkrim të instrumenteve të përdorur me qëllim mbledhjen e të dhënave.

Në studim kemi përdorur si instrument kryesor pyetësin për mësuesit dhe pyetësin për familjen. Është realizuar intervista me drejtorë shkollash, mësues, familje dhe nxënës, si edhe gjetjet për dhunën ndërmjet nxënësve të marra përmes fokus grupit.

Në këtë pjesë të kapitullit për metodologjinë do ti sqarojmë në mënyrë të detajuar këto instrumente të cilat gjetën zbatim në studimin tonë.

3.8.1. Pyetësi

Pyetësin e përdorëm për mbledhjen e të dhënave sasiore. Arsyet pse e përdorëm pyetësin për mbledhjen e informacionit për këtë studim janë disa. Pyetësi është një qasje efikase për mbledhjen e të dhënave. Ai mundëson që të dhënat të mbledhen në një kohë të shkurtër dhe mund të mbulojë një popullsi të gjerë. Pyetësi gjithashtu i mundëson pjesëmarrësve të merren me pyetjet pa manipuluar përgjigjet (Creswell, 2003)²¹². Duke pasur parasysh edhe disavantazhet e tij pasi gjatë përdorimit të pyetësit ata nuk i japin pjesëmarrësve mundësinë që të jenë fleksibil dhe të ofrojnë mendimet dhe interpretimet e tyre (Creswell, 2003)²¹³. Për të shmangur këtë disavantazh të pyetësit gjatë mbledhjes së të dhënave për dhunën shfrytëzuam intervistën dhe fokus grupin, të cilat na krijuan mundësinë të marrim të dhëna kontekstuale cilësore.

Në studim është përdorur pyetësi i cili adreson pyetjet e studimit lidhur me faktorët e rëndësishëm për përfshirjen në vazhdimësi të familjes në shkollë, për bashkëpunim në përgjithësi, si edhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Si model për përpilimin e pyetësit është marrë pyetësi i përpiluar nga PTA (Organizata Ndërkombëtare për Përfshirjen e Familjes në Shkollë). Ky pyetësor përfshin këto standarde për përfshirjen e familjes në shkollë: mirëpritja e familjes në shkollë, mbështetja e suksesit të nxënësit, bashkëpunimi me komunitetin, pushteti. Mirëpo gjatë intervistave/bisedave, të cilat i realizuam me prindër, mësues dhe familjarë, u përpoqëm të gjejmë faktorët të cilët atyre u mungojnë në këtë bashkëpunim ose ata faktorë të cilët i bëjnë ata të bashkëpunojnë më shumë. Ne i identifikuam këta faktorë me rëndësi për përfshirjen e familjes në shkollën tonë si më poshtë: besimi i familjes te shkolla, ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes, përvoja e mëparshme e familjes me shkollën, vendimmarrja e familjes në shkollë, mirëpritja e familjes nga shkolla, mbështetja e suksesit të nxënësve, informacioni shkollë-familje. Bazuar në këto përgjigje ne identifikuam faktorët të cilët përcaktojnë nivelin e bashkëpunimit të shkollës me familjen. Ndër faktorët e shumtë me ndikim në këtë proces studimi evidentoi: mirëpritjen e familjes nga shkolla, komunikimin shkollë-familje, informimin e familjes nga shkolla, ndarjen e detyrave mes shkollës dhe familjes, vendimmarrjen e familjes në shkollë, përvojën e mëparshme të bashkëpunimit të familjes me shkollën dhe besimin e familjes te shkolla. Bazuar në intervistat me familjen dhe mësuesit, këto

212 Creswell.J.W. (2003). Research mesing: Qualitative, kuantitativ, and mixed methods approaches. (2nd ed.). Thousand Oaks, CA: Sage

213 Po aty.

duket se janë aspektet kyçe në bashkëpunimin shkollë-familje dhe në përfshirjen e familjes në shkollë.

Për këtë studim ne si studiues ndërtuam dy pyetësorë. Një për familjen dhe një për mësuesit. Në numrin e pohimeve të variablave, pyetësorët janë të njëjta, si ai për familjen ashtu edhe ai për mësues. Ngjashmëri kemi edhe në emërtimin e seksioneve.

Fillimisht, përpara se të realizohej mbledhja e të dhënave, realizuam një pilotim me variantin e parë të pyetësorit me rreth 60 të intervistuar. Pilotimi na bëri të evitojmë një pohim të pyetësorit në të cilin 80% e të intervistuarve nuk dhanë përgjigje, si dhe për tre seksione të përpiluara me përgjigje dikotomike, i shndërruam në shkallën Likert, për faktin se nga të gjithë të intervistuarit morëm përgjigje me po ose jo. Vlerësuam se përgjigje të tilla nuk na mundësojnë një perceptim objektiv.

Pyetësorët janë të strukturuar dhe përbëhen nga shtatë seksione. Seksioni i parë emërtohet “Mirëpritja e familjes në shkollë”, i cili na mundësoi të njihemi me perceptimet për mirëpritjen e familjes në shkollë si dhe të kuptojmë perceptimet e mësuesve për mirëpritjen që ata i ofrojnë familjes në shkollë. Kjo rubrikë përmban pesë indikatorë. Për këtë pyetje është realizuar kodimi në formën e shkallës, ku të intervistuarit janë përgjigjur me, “Plotësisht dakord”, “Dakord”, “I pavendosur”, “Jo dakord” dhe “Aspak dakord”.

Në seksionin e dytë janë matur perceptimet e të intervistuarve mbi komunikimin e familjes me shkollën dhe anasjellas. Kjo rubrikë përmban pesë indikatorë për matjen e komunikimit, si pyetësorin për familjen dhe atë për mësuesit, por sigurisht edhe pohimet jo të njëjta për këto dy grupime. Rubrika përmban një shkallë Likert me pesë nivele dakordimi.

Një shkallë me gjashtë indikatorë është përpiluar për të matur perceptimet e familjes dhe mësuesve për nivelin e informimit të familjes nga shkolla dhe ndërlidhjen e tij me nivelin e takimeve në shkollë. Rubrika përmban një shkallë Likert me pesë nivele: “Plotësisht dakord”, “Dakord”, “I pavendosur”, “Jo dakord” dhe “Aspak dakord”.

Në vazhdim të pyetësorëve janë përdorur katër indikatorë për të matur besimin e familjes te shkolla, ndërsa përmes pyetësorit për mësuesit matëm perceptimet e mësuesve për besimin e tyre nga familja. Edhe ky seksion vazhdon me një shkallë Likert me pesë nivele dakordimi.

“Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes” është seksioni i pyetësorit përmes të cilit matëm perceptimet e familjes dhe shkollës për faktin nëse bëhet ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes, në çfarë niveli është kjo ndarje dhe a është ndikues në nivelin e takimeve mes shkollës dhe familjes. Rubrika përmban pesë indikatorë, për matjen e të cilëve ndërtuam një shkallë Likert me pesë indikatorë.

Seksioni i cili përmban katër indikatorë me pohime jo të njëjta është “Vendimmarrja e familjes në shkollë”, e emërtuar kështu si në pyetësorin për familjen ashtu dhe në atë për mësuesit. Edhe për këtë rubrikë kemi shkallën Likert me pesë indikatorë për të dy pyetësorët, atë për familjen dhe atë për shkollën.

“Përvoja e mëparshme e familjes me shkollën” me gjithsej tre indikatorë për matjen e perceptimeve të familjes dhe mësuesve për përvojën e ndërsjellë të familjes dhe mësuesve për përvojat e tyre me njëri-tjetrin.

Pyetëtorët përmbillen me pyetjen për numrin e takimeve të shkollës me familjen gjatë një semestri. Pyetja është e tipit të hapur, në formë të shkruar, për të na mundësuar të njihemi me nivelin e takimeve të shkollës me familjen.

Shkallët Likert janë përcaktuar si një instrument i vetë raportimit ku çdo pjesëmarrës i përgjigjet një sërë pyetjesh rreth problemit në studim. Pyetjet lidhur me faktorët e rëndësishëm në bashkëpunim u vlerësuan në shkallë minimale.

Administrimi i pyetësorit është bërë në këtë mënyrë: fillimisht kryhet pikësimi i përgjigjeve të shkallës së tipit Likert (Plotësisht dakord, Dakord, Pjesërisht dakord, Jo dakord, Aspak dakord) dhe vendoset një numër për secilin tregues për çdo përgjigje, nga 1-5. Pasi realizohet kodimi, këto pyetje kodohen në formën e shkallës me tre nivele, në bazë të përgjigjeve të të intervistuarve si vijon: "Niveli i ulët", "Niveli i mesëm" dhe "Niveli i lartë".

Para se të aplikohet në studimin përfundimtar, pyetëtori është pilotuar me 30 mësues dhe 30 prindër, të cilët nuk janë përfshirë në studimin përfundimtar. Bazuar në këtë pilotim kemi hequr një pohim dhe një shprehje (avokues) dhe kemi korrigjuar disa gabime gramatikore.

3.8.1. 1. Analiza faktoriale e pyetësorit

Duke përdorur të dhënat e studimit, u krye një analizë faktoriale shpjeguese (main components, varimax rotation) te pyetëtori për familjen, e cila rezultoi me 8 dimensione që grupojnë treguesit. Në tabelën 1 dhe 2 janë paraqitur rezultatet e Analizës Faktoriale sipas metodës së Komponentëve Kryesorë dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX.

Përmes procedurës faktoriale, variablat manifeste janë kondensuar dhe janë fituar 8 faktorë latentë. Faktorët e fituar, përkatësisht dimensione latente, prezantojnë qëndrimet e prindërve në raport me shkollën dhe mësuesin dhe anasjellas.

Tabela 1 pasqyron treguesit e pyetësorit për familjen dhe ngarkesën e tyre. Faktori i parë përmban ndryshoret, të cilat kanë të bëjnë me mirëpritjen e familjes në shkollë, për matjen e perceptimeve të familjes lidhur me mirëpritjen e tyre nga shkolla. Faktori i dytë ka të bëjë me komunikimin e shkollës me familjen. Faktori i tretë përfshin ndryshoret të cilat kanë të bëjnë me informimin e shkollës drejt familjes dhe anasjellas. Faktori i katërt ka të bëjë me mundësinë e prindit për të ndjekur ecurinë e suksesit të fëmijës së tij me besimin që prindërit kanë tek shkolla, si dhe rëndësinë e pranisë së prindit në shkollë për suksesin e nxënësit si dhe shfrytëzimi i takimeve të tilla për bashkëpunimin me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Faktori i pestë përfshin ndryshoret ku përmendet përvoja e prindit me mësuesin e mëparshëm të fëmijës së tij, përkatësisht besimin e prindit të krijuar për mësuesin. Faktori i gjashtë përfshin ndryshoret që kanë të bëjnë me ndarjen e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Faktori i shtatë përfshin çështjet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e prindit në marrjen e vendimeve në shkollë. Pjesëmarrja në vendimmarrje. Takimet e prindit me mësuesin, sa shpesh bëhen ato dhe me iniciativën e kujt janë në kuadër të faktorit të tetë që është takimi i prindit me mësuesin. Analiza e tabelës na tregon se pohimet kanë kaluar vlerën e rekomanduar prej 6, që në këtë rast tregon se pohimet parashikohen nga secili faktor. Kemi domethënie

statistikore dhe variablat kanë një korrelacion mjaftueshmërisht të lartë për të siguruar baza të arsyeshme për analizat faktoriale. Më gjerësisht për analizën faktoriale shih Aneksin III.

Tabela 1 . Treguesit e pyetësorit për familjen dhe ngarkesa e tyre

a) Treguesit e mirëpritjes së familjes në shkollë

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë ndihem i mirëpritur në takimet që organizon mësuesi.	.819
2.	Mësuesi tregon respekt ndaj meje kur jam në shkollë.	.818
3.	Mësuesi me trajton njëllëj si prindërit e tjerë.	.764
4.	Mësuesi nuk bën dallime mes prindërve pavarësisht nivelit tonë arsimor, kulturor, material, etj.	.764
5.	Në shkollë kemi një sallë të caktuar ku mund të takohemi me mësuesin.	.445

b) Treguesit e komunikimit të familjes me shkollën

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Mësuesi na e bën të lehtë komunikimin me të.	.326
2.	Mësuesi rregullisht më informon për aktivitetet e ndryshme në shkollë.	.448
3.	Mësuesi komunikon me mua si familje në mënyra të shumfasishta p.sh. e-mail, website, takime me prindër, telefon, vizita në shtëpi etj.	.486
4.	Mësuesi më ndihmon në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me fëmijën tim.	.423
5.	Unë mund të takohem me mësuesin për fëmijën sa here kam nevojë.	.311

c) Treguesit e informimit të familjes me shkollën

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Mësuesi më ka njoftuar lidhur me programin (kurrikulën) e lëndëve mësimore.	.587
2.	Mësuesi më ka treguar se cilat janë mundësitë e bashkëpunimit (takimet me prindër, telefon, website, etj.	.474
3.	Mësuesi më ka njoftuar lidhur me politikat dhe rregullat e shkollës.	.779
4.	Mësuesi me ka ofruar informacion rreth ekzistencës dhe numrit të këshillave të prindërve në shkollë.	.834
5.	Mësuesi më ka informuar mbi funksionin e këtyre këshillave.	.838
6.	Unë e njoh (e kam lexuar) ligjin "Mbi arsimin fillor në Kosovë".	.706

d) Treguesit e mbështetjes së suksesit të nxënësit nga shkolla

Nr.	Ngarkesa	
1.	Mësuesi më informon në vazhdimësi për suksesin e fëmijës.	.507
2.	Mësuesi më kontakton vetëm kur fëmija ka probleme në mësim.	.257
3.	Fëmija im nxitet nga mësuesi të bëjë më të mirën në mësim.	.534
4.	Problemet e fëmijës me të nxënit i zgjidhim bashkë me mësuesin.	.714

5.	Çfarë është sukcesi i fëmijës suaj (shprehu me numër)	.536
----	---	------

e) Treguesit e besimit të familjes te shkolla

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë kam besim se shkolla do të bëjë më të mirën për fëmijën edhe pa bashkëpunimin tim.	.268
2.	Unë kam besim se shkolla do të më informojë lidhur me çdo ndryshim në suksesin e fëmijës.	.296
3.	Unë kam besim se shkolla do të më informojë lidhur me çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës.	.304
4.	Roli im si prind konsiderohet shumë i rëndësishëm nga mësuesi i fëmijës.	.462

f) Treguesit e përvojës së mëparshme të familjes me shkollën

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë si familje i kam vlerësuar shumë të dobishme takimet me mësuesin e mëparshëm të fëmijës.	.792
2.	Mësuesi i mëparshëm i fëmijës ka bërë më të mirën për edukimin dhe suksesin e fëmijës.	.848
3.	Mësuesi i mëparshëm i fëmijës ka reaguuar atëherë kur nuk i jam përgjigjur ftesës së tij për takim.	.687

g) Treguesit e ndarjes së detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Mësuesi mi ka bërë të qarta objektivat dhe detyrat që duhet të realizoj.	.502
2.	Mësuesi me ka bërë të qartë se problemet e fëmijës mund dhe duhet ti zgjidhim së bashku.	.549
3.	Mësuesi kërkon që nëse kemi probleme me shkollën jo me mësuesin duhet të takojmë drejtorin, psikologun...etj.	.463

h) Treguesit për vendimmarrjen e familjes në shkollë

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë marr pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme për shkollën p.sh. ndryshimet në plan-program, kodin e veshjes, politikat e shkollës.	.892
2.	Vendimet në shkollë merren pa me pyetur mua si prind.	.889

i) Treguesi për nivelin e takimeve të familjes me shkollën

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Sa herë brenda një semestri takoheni me mësuesin për fëmijën tuaj.	.881

Nga pikëpamja statistikore, të dhënat e gjetura nga anketimi i familjeve urbane dhe rurale janë domethënëse. Analiza faktoriale shpjeguese konfirmon dimensionalitetin e shkallëve të pyetësorit për mësuesit.

Në Tabelën 2. paraqiten rezultatet e Analizës Faktoriale sipas metodës së Komponentëve Kryesorë dhe rotacionit (ortogonal) VARIMAX, për pyetësorin e kryer me mësuesit nga mjediset urbane dhe ato rurale. Përmes procedurës faktoriale, variablat manifeste janë kondensuar dhe janë fituar tetë faktorë latentë. Faktorët e përfutur, përkatësisht dimensionet latente, prezantojnë qëndrimet e mësuesve në raport me familjen. Faktori i parë përfshin variablat që kanë të bëjnë me mirëpritjen e familjes në shkollë nga mësuesit duke rritur kështu bashkëpunimin me shkollën, prandaj ky faktor mund të emërtohet si: mirëpritja. Faktori i dytë përfshin ndryshoret lidhur me qëndrimet e mësuesit lidhur me komunikimin që ka me familjen dhe emërtohet, komunikimi. Faktori i tretë përfshin variablat për matjen e perceptimeve të mësuesve për informimin e tyre në drejtim të familjes. Faktori i katërt përmban variablat për ndarjen e detyrave shkollë-familje. Faktori i katërt përmban variablat lidhur me ndihmën dhe mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla, prandaj ky faktor mund të emërtohet si: mbështetja e suksesit të nxënësve. Faktori i pestë përfshin variablat e projektuar për matjen e mbështetjes së suksesit të nxënësve nga mësuesit. Faktori i gjashtë ka të bëjë me besimin nga perspektiva e mësuesve. Në faktorin e shtatë projektohen variablat që kanë të bëjnë me takimet dhe vendimmarrjen e familjes në shkollë sipas perceptimeve të mësuesve dhe në fund pyetja për shpeshësinë e takimeve gjatë semestrit, takimet e mësuesit me prindin. Më gjerësisht për analizën faktoriale shih Aneksin III.

Tabela 2 . Treguesit e pyetësorit për mësuesit dhe ngarkesa e tyre

a) Mirëpritja e familjes në shkollë

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë bëj që familja të ndjehet pjesë e shkollës.	.415
2.	Unë tregoj respekt ndaj prindërve kur janë në shkollë.	.536
3.	Unë të gjithë prindërit i trajtoj njësoj.	.688
4.	Unë nuk bëj dallime mes prindërve pavarësisht nivelit të tyre arsimor, kulturor, material.	.549
5.	Në shkollë kemi një sallë ku mund të takohemi me prindërit.	.661

b) Komunikimi i mësuesve me familjen

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë ua lehtësoj prindërve komunikimin me mua.	.315
2.	Unë komunikoj me familjen në mënyra të ndryshme p.sh., e-mail, vizita në shtëpi.	.448
3.	Unë i ndihmoj prindërit në zgjidhjen e problemeve të fëmijëve.	.548
4.	Prindërit mund të takohen me mua sa herë kanë nevojë.	.561

c) Informimi i familjes nga mësuesit

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë rregullisht i informoj prindërit për aktivitetet e ndryshme në shkollë.	.607
2.	Unë i njoftoj prindërit lidhur me programin (kurrikulën) e lëndëve mësimore.	.750
3.	Unë i informoj prindërit rreth ekzistencës dhe numrit të këshillave të prindërve në shkollë.	.837
4.	Unë e njoh dhe e kam lexuar ligjin mbi arsimin fillor në Kosovë	.750
5.	Unë iu flas prindërve mbi funksionin e këshillave të prindërve	.689
6.	Unë iu flas prindërve mbi mundësitë e bashkëpunimit me shkollën	

d) Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet shkollës dhe familjes

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë ua kam bërë të qarta prindërve objektivat dhe detyrat që duhet të realizojnë.	.641
2.	Unë ua kam bërë të qartë prindërve se problemet me fëmijën duhen zgjidhur në bashkëpunim.	.701
3.	Unë kërkoj nga prindërit që nëse kanë probleme me shkollën jo me mua si mësues të takojnë psikologun, drejtorin etj.	.677

e) Mbështetja e suksesit të nxënësve

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.		
2.	Unë u ofroj prindërve informacion të rëndësishëm lidhur me përmirësimin e suksesit të fëmijës.	.400
3.	Unë i informoj në vazhdimësi prindërit për suksesin e fëmijës se tyre.	.354
4.	Unë i njoh standardet e vlerësimit.	.658
5.	Unë i nxis nxënësit që të bëjnë më të mirën në mësim.	.657
6.	Problemet e fëmijës në procesin e të nxënies i zgjidhim në bashkëpunim me familjen.	.670

f) Besimi i mësuesve te familja

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Unë kam besim se familja e ka nën kontroll fëmijën në shtëpi.	.587
2.	Unë kam besim se familja do të më informojë lidhur me çdo ndryshim që vëren në suksesin e fëmijës.	.777
3.	Unë kam besim se familja do më informojë mbi çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës në mënyrë që të reagojmë njësoj për përmirësimin e saj.	.755
4.	Bashkëpunimi me familjen është i domosdoshëm për mua si mësues.	.536

h) Vendimmarrja e familjes në shkollë

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Prindërit marrin pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme për shkollën p.sh., ndryshimi në plan/program, kodin e veshjes, politikat e shkollës, etj.	.651
2.	Vendimet në shkollë merren duke i pyetur prindërit.	.531

i).Numri i takimeve me familjen gjatë një semestri

Nr.	Treguesit	Ngarkesa
1.	Sa herë takoheni me familjen gjatë një semestri.	.844

Nga pikëpamja statistikore, të dhënat e gjetura nga anketimi i mësuesve të shkollave urbane dhe rurale janë domethënëse. Analiza faktoriale shpjeguese konfirmon deminsionalitetin e shkallëve.

3.8.1.2 Vlefshmëria dhe besueshmëria

Sipas Fraenkel dhe Wallen (2003)²¹⁴, termi vlefshmëri i referohet “përshtatshmërisë, kuptimplotësisë, korrektësisë dhe dobisë nga një konkluzion”. Rezultatet nga ky studim mund të përsëriten nëse hulumtuesi përdor një popullsi dhe mostër të ngjashme.

Autorët Lankshear dhe Knobel (2004)²¹⁵ kërkojnë që studiuesit gjatë studimeve sasiore duhet të përdorin instrumente që nuk janë vetëm të vlefshëm por edhe të besueshëm. Këta studiues besueshmërinë e paraqesin si qëndrueshmëri të përgjigjeve në mbledhjen e të dhënave. Bazuar në të, një instrument konsiderohet i besueshëm nëse prodhon të njëjtin rezultat çdo herë që administrohet nga të njëjtët të pyetur.

Në studimin tonë janë përdorur pyetëtori – njëri për mësuesit dhe tjetri për familjen. Intervista është realizuar me nxënës, familje dhe shkolla. Fokus grupi me nxënës. Këto instrumente janë testuar fillimisht në 60 të pyetur, të cilët nuk janë përfshirë në studimin

214 Fraenkel, J. R. & Wallen, N. E. (2006). *How to Design and Evaluate Research in Education*. fq.158.

215 Lankshear, C & Knobel, M. (2004). *Handbook for Teacher Research*. McGraw-Hill Education.

përfundimtar. Pra, instrumentet fillimisht i pilotuam, i përmirësuam dhe i modifikuam. Konsiderojmë se ato janë të vlefshme dhe të besueshme.

Të dhënat cilësore lidhur me dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë i morëm nga pyetjet (e hapura) të studimit, fokus grupet e nxënësve dhe intervistat me nxënësit, mësuesit dhe familjen.

Ne kemi përcaktuar se niveli i besueshmërisë është 95%, me kufi gabimi 5%, sikurse shumica e studimeve të tjera. Pra, në kampionin me 1520 subjekte të cilët besohen në 95% të tyre dhe nëse gabohet, shkalla e gabimit është 5%. Për rrjedhojë, përfundimet tona të studimit në rastin më të keq të merren të vërteta në masën 90% për shkak të madhësisë së kampionit. Me këto karakteristika kampioni ynë teorik do duhej të ishte më i vogël në numër, thuhet dyfish nga ai që kemi. Po të llogarisim dhe parregullsi të caktuara (kjo është hipotetike) të kampionit dhe administrimin e pyetësorëve, atëherë pjesëmarrësit e “tepërt” (në kuptimin e mbikampionimit) arrijnë të kompensojnë çfarëdolloj mangësie që mund të ketë ardhur prej parregullsive të supozuara.

Në tabelën vijuese paraqesim vlerat e madhësisë së mostrës së nevojshme për të krijuar një diferencë gabimi prej $\pm 5\%$ për çdo proporcion të popullsisë. Gabimi në kampionim prej 5% me një besueshmëri prej 95%. Popullata (N). Madhësia e popullatës (S)

Tabela nr. 3. Madhësia e kampionit, niveli i besueshmërisë dhe gabimi në kampionim

Population Size	Confidence = 95%				Confidence = 99%			
	Margin of Error				Margin of Error			
	5.0%	3.5%	2.5%	1.0%	5.0%	3.5%	2.5%	1.0%
10	10	10	10	10	10	10	10	10
20	19	20	20	20	19	20	20	20
30	28	29	29	30	29	29	30	30
50	44	47	48	50	47	48	49	50
75	63	69	72	74	67	71	73	75
100	80	89	94	99	87	93	96	99
150	108	126	137	148	122	135	142	149
200	132	160	177	196	154	174	186	198
250	152	190	215	244	182	211	229	246
300	169	217	251	291	207	246	270	295
400	196	265	318	384	250	309	348	391
500	217	306	377	475	285	365	421	485
600	234	340	432	565	315	416	490	579
700	248	370	481	653	341	462	554	672
800	260	396	526	739	363	503	615	763
1,000	278	440	606	906	399	575	727	943
1,200	291	474	674	1067	427	636	827	1119
1,500	306	515	759	1297	460	712	959	1376
2,000	322	563	869	1655	498	808	1141	1785
2,500	333	597	952	1984	524	879	1288	2173
3,500	346	641	1068	2565	558	977	1510	2890
5,000	357	678	1176	3288	586	1066	1734	3842
7,500	365	710	1275	4211	610	1147	1960	5165
10,000	370	727	1332	4899	622	1193	2098	6239
25,000	378	760	1448	6939	646	1285	2399	9972
50,000	381	772	1491	8056	655	1318	2520	12455
75,000	382	776	1506	8514	658	1330	2563	13583
100,000	383	778	1513	8762	659	1336	2585	14227
250,000	384	782	1527	9248	662	1347	2626	15555
500,000	384	783	1532	9423	663	1350	2640	16055
1,000,000	384	783	1534	9512	663	1352	2647	16317
2,500,000	384	784	1536	9567	663	1353	2651	16478
10,000,000	384	784	1536	9594	663	1354	2653	16560
100,000,000	384	784	1537	9603	663	1354	2654	16584
300,000,000	384	784	1537	9603	663	1354	2654	16586

Burimi: Sample Size Table. 2006. <http://www.research-advisors.com/tools/SampleSize.htm> . Parë më 04.02.2014.

Për matjen e besueshmërisë është përdorur koeficienti Alpha Cronbach²¹⁶. Meqenëse ne kemi katër pyetësorë – një pyetësor për mësuesit nga mjedisi urban dhe një për mësuesit nga mjedisi rural. Më tej një për familjen nga mjedisi urban dhe një pyetësor për familjen nga mjedisi rural, atëherë do prezantojmë në vijim nivelin e besueshmërisë për secilin pyetësor nga të dy mjediset.

Për matjen e *Mirëpritjes* së familjes në shkollë është përdorur një shkallë e përbërë nga këto pohime: Unë ndjehem i mirëpritur gjatë takimeve me mësuesin e fëmijës; Mësuesi tregon respekt ndaj meje. Kur jam në shkollë për të trajtuar probleme të ndryshme lidhur me ngacmimet/dhunën mes nxënësve; mësuesi më trajton njëllë siç

²¹⁶ Koeficienti i Alpha Cronbach i besueshmërisë, që sipas Cortina, J.M. (1993), kuptimi i vlerave të Cronbach's alpha është: $\alpha \geq 0.9$ vlerësohet shkëlqyeshëm, $0.8 \leq \alpha < 0.9$ vlerësohet mirë, $0.7 \leq \alpha < 0.8$ vlerësohet e pranueshme, $0.6 \leq \alpha < 0.7$ vlerësohet e diskutueshme, $0.5 \leq \alpha < 0.6$ vlerësohet e varfër, $\alpha < 0.5$ vlerësohet e papranueshme.

trajton edhe prindërit e tjerë; mësuesi nuk bën dallime mes prindërve pavarësisht nivelit arsimor, kulturor, social. Në shkollë kemi një vend të caktuar ku mund të takohemi me mësuesit. Nga 298 të pyetur, 286 prej tyre janë përgjigjur në të gjitha pohimet e shkallëve. Nga analiza del se shkalla e mirëpritjes së familjes në shkollë tek familja urbane ka një konsistencë të brendshme të pranuar me koeficientin alfa të Kronbahut, të prezantuar në Aneksin II, Tabela 84. Nga vlerat e treguara të korrelacionit total të pohimeve të raportuara në tabelën e Statistikave Totale për shkollën e mirëpritjes, shohim se vlerat e secilit pohim janë mbi.3, tregues ky i shkallës ku çdo pohim lidhet me vlerën totale raportuar në Aneksin II, Tabela 85. Vlerat e secilit pohim shohim se janë mbi.3, tregues që tregon se pohimet nuk masin diçka tjetër. Për matjen e mirëpritjes së familjes rurale në shkollë janë përdorur të njëjtat pohime që janë përdorur edhe për familjen urbane dhe del se nga 394 të pyetur të gjithë janë përgjigjur në pohimet e kësaj shkalle, që do të thotë se shkalla ka një konsistencë të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .758. Ndërsa, vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 86, 87).

Për matjen e perceptimeve të mësuesve për *Mirëpritjen* që ata ia ofrojnë familjes, janë përdorur të njëjtat pohime për mësuesit e të dyja mjedisëve si atij urban dhe atij rural. Pyetjet ishin: Unë e bëj familjen të ndjehet pjesë e shkollës; Unë tregoj respekt ndaj prindërve kur ata janë në shkollë; Unë të gjithë prindërit i trajtoj njësoj; Unë nuk bëj dallim mes prindërve pavarësisht nivelit të tyre arsimor, kulturor apo social; A ka shkolla juaj një sallë të posaçme ku ju realizoni takimet me prindër? Tek mësuesit e mjedisit urban për këto pohime nga gjithsej 298 të pyetur dhe që të gjithë janë përgjigjur. Kjo shkallë ka një konsistencë të mirë me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .614. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3. (Shih Aneksin II, Tabela 88, 89). Ndërsa tek mësuesit e mjedisit rural, pyetjeve iu janë përgjigjur të gjithë të anketuarit. Konsistenca nuk është e pranuar. Alfa Kronbahu raportohet të jetë .442 por, vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3. (Shih Aneksin II, Tabela 90 dhe 91).

Matja e perceptimeve të të pyeturve nga familjet e mjedisit urban dhe atij rural për *Komunikimin ndërmjet familjes dhe shkollës* është kryer përmes këtyre pyetjeve: Mësuesi na e bën të lehtë komunikimin me të për probleme të ndryshme lidhur me ngacmimet/dhunën ndërmjet fëmijës tim dhe fëmijëve të tjerë; Mësuesi rregullisht me informon për aktivitetet e ndryshme në shkollë të cilat trajtojnë ngacmimet/dhunën ndërmjet nxënësve; Mësuesi komunikon me ne si familje në mënyra të shumfishta: (p.sh. me e-mail, telefon, website, takime me prindër, fletore pune, vizita në shtëpi, etj); Mësuesi më ndihmon ti zgjidh problemet që kanë të bëjnë me fëmijën tim dhe ndonjë fëmije tjetër; Unë mund të komunikoj me mësuesin sa herë kam nevojë për dhunën që ushtrojnë fëmijët e tjerë ndaj fëmijës tim. Tek familja urbane, nga gjithsej 298 të anketuar, për këtë pyetje kemi raportimet e 286 të anketuarve. Konsistenca është e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .768. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 92 dhe 93). Ndërsa, tek familja rurale nga 394 të anketuar gjithsej, të gjithë 394 të anketuarit u

janë përgjigjur pyetjeve për variablin e komunikimit të tyre me shkollën. Konsistenca është e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .765. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 94 dhe 95).

Matja e perceptimeve të shkollës nga mjedisi urban dhe ai rural për *Komunikimin ndërmjet familjes dhe shkollës* është bërë përmes këtyre pyetjeve: Unë ua bëj të lehtë prindërve komunikimin me mua; Unë komunikoj me prindërit në mënyra të ndryshme, si: e-mail, përmes telefonit, sms-ve, drejtpërdrejtë, etj; Unë komunikoj me prindërit për çdo problem (çështje) që lidhet me sjelljen e fëmijës; Prindërit mund të takohen me mua sa herë që kanë nevojë; Unë komunikoj me prindërit për çdo problem (çështje) që lidhet me sjelljen e fëmijës. Tek mësuesit e mjedisit urban nga gjithsej 298 të anketuar, për këtë pyetje kemi raportimet e 298 të anketuarve. Konsistenca është e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .647. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 96, 97). Ndërsa, tek shkolla rurale nga 400 të anketuar gjithsej, 400 prej tyre kanë dhënë përgjigje ndaj pohimit për variablin e komunikimit të tyre me familjen. Konsistenca është e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .676. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 98, 99).

Për të matur *Informimin e shkollës drejtuar familjes*, është përdorur shkalla me këto pohime: Mësuesi/kujdestari i klasës më ka treguar cilat janë mundësitë e bashkëpunimit (takimet me prindër, takimet individuale, telefoni, website, vizita në shtëpi); Mësuesi/kujdestari i klasës më ka njoftuar lidhur me politikat e shkollës në rastet e dhunës mes nxënësve në shkollë; Mësuesi/kujdestari i klasës më ka ofruar informacion për ekzistencën dhe numrin e Këshillave të Prindërve në shkollë; Mësuesi/kujdestari i klasës më ka folur për funksionet e këtyre Këshillave; Unë e njoh (e kam lexuar) ligjin “Mbi arsimin fillor në Kosovë”. Nga të gjithë të anketuarit - familjet e mjedisit urban 298 gjithsej, janë përgjigjur 86 të intervistuar. Shkallë kjo me konsistencë të brendshme të preferuar – koeficienti i alfa të Kronbahut të raportuar .817. Vlera e treguar e Korrelacionit total të pohimeve në Tabelën 100, 101 të Aneksit II tregon se vlerat e secilit pohim janë mbi .3 në bazë të të cilit raportohet se çdo pohim ka lidhje të mjaftueshme me vlerën totale të shkallës. Ndërsa bazuar në matjet e konsistencës së përgjithshme të shkallës, e cila na mundësoi matjen e informimit të familjes së mjedisit rural ndaj shkollës, nga gjithsej 394 të intervistuar të gjitha pohimeve të kësaj shkalle iu janë përgjigjur të gjithë 394 të intervistuarit. Koeficienti alfa Kronbah këtë shkallë e ka .852, konsistencë kjo e brendshme e preferuar. Ndërsa vlerat e Korrelacionit total të pohimeve janë mbi .3 pra, secili pohim ka lidhje të mirë me vlerën totale të shkallës (Shih aneksi II, Tabela 102 dhe 103).

Matja e konsistencës së përgjithshme të shkallës e cila realizoi matjen e perceptimeve të shkollës së mjedisit urban dhe rural për çështjen e *Informimit të familjes nga shkolla* ishte: Unë i kam treguar familjes se cilat janë mundësitë e bashkëpunimit me mua (takimet me prindër, takimet individuale, sms, e-mail, etj.); Unë e kam njoftuar familjen lidhur me

politikat e shkollës mbi rastet e dhunës mes nxënësve; Unë e kam njoftuar familjen mbi vendimet e shkollës lidhur me rastet e dhunës mes nxënësve; Unë i kam ofruar familjes informacion rreth ekzistencës dhe numrit të Këshillave të Prindërve në Shkollë; Unë e kam njoftuar familjen mbi funksionet e këtyre Këshillave; Unë e njoh (e kam lexuar) ligjin "Mbi arsimin fillor në Kosovë". Nga 298 mësues të intervistuar nga mjedisi urban pjesëmarrës në studim, pohimeve të kësaj shkalle iu janë përgjigjur të gjithë të pyeturit. Shkalla ka një konsistencë të brendshme të preferuar me koeficientin alfa të Kronbahut, e cila është .791. Vlerat e korrelacionit total të pohimeve të raportuara në tabelën e statistikave totale mbi shkallën e informimit janë mbi .3, tregues ky i mirë për lidhjen me vlerën totale të shkollës (Shih aneksi II, Tabela 104 dhe 105). Nga 400 mësues të pyetur nga mjedisi rural, të gjithë janë përgjigjur në pohimet e tyre lidhur me informimin në drejtim të familjes. Shkalla ka një konsistencë të brendshme të preferuar me koeficientin alfa të Kronbahut, e cila është .815. Vlerat e korrelacionit total të pohimeve të raportuara në tabelën e statistikave totale shkallën e informimit e kanë mbi .3, tregues ky i mirë i lidhjes me vlerën totale të shkollës (Shih aneksi II, Tabela 106 dhe 107).

Për matjen e perceptimit të familjes urbane dhe rurale mbi *Mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla*, kemi përfshirë këto pohime: Mësuesi/kujdestari i fëmijës tim më informon në vazhdimësi për suksesin e fëmijës; Mësuesi/kujdestari i klasës më kontakton vetëm kur fëmija ka probleme në mësim; Fëmija im nxitet nga mësuesit të bëjë më të mirën në mësim; Problemet në të nxënë, kur paraqiten te fëmija im, i zgjidhim bashkë me mësuesit. Për këto pyetje nga 298 të intervistuar, familje këto të mjedisit urban janë përgjigjur 286 të intervistuar. Kështu, raportohet një konsistencë e brendshme, e mirë. Koeficienti i Kronbahut në këtë rast është .723. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit total të pohimeve kanë dalë mbi 0.3 (Shih Aneksin II. Tabela 108 dhe 109). Ndërsa tek familja rurale kemi marrë perceptimet për pyetjet e lartpërmendura nga 394 të intervistuar ky të gjithë u janë përgjigjur pohimeve për mbështetjen e suksesit të fëmijëve të tyre. Koeficienti i Kronbahut në këtë rast është .851. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit total të pohimeve kanë dalë mbi 0.3 (Shih Aneksin II. Tabela 110 dhe 111). Lidhje kjo e mjaft e mirë me vlerën totale të shkollës.

Për matjen e perceptimeve të mësuesve se sa e *Mbështesin suksesin e nxënësve*, përpiluam këto pohime: Unë e informoj në vazhdimësi familjen për suksesin e nxënësit në shkollë; Unë kontaktoj familjen jo vetëm kur fëmija ka probleme në mësim; Unë e nxis nxënësin që të bëjë më të mirën në mësim; Problemet e nxënësit në të nxënë i zgjidhim bashkë me familjen. Për këto pohime morëm përgjigjet e 297 të intervistuarve nga totali 298. Kjo shkallë ka konsistencë të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .850 dhe në këtë rast me vlerat e Korrelacioneve Totale të Pohimeve të cilat raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II. Tabela 112 dhe 113). Morëm përgjigjet për këtë shkallë nga 399 të intervistuar nga gjithsej 400 të intervistuar. Besueshmëria e kësaj shkalle tek mësuesit e mjedisit rural doli të jetë .766. Ndërsa, gjithashtu, edhe vlerat e korrelacionit total të pohimeve raportohen mbi 0.3. (Shih Aneksin II, Tabela 114, 115).

Pohimet në bazë të të cilave matëm perceptimet e familjes së mjedisit urban dhe atij rural për *besimin e familjes te shkolla* ishin: Unë kam besim se shkolla do bëjë më

të mirën për fëmijën tim për të parandaluar dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë; Unë kam besim se shkolla se do të më informojë për çdo ndryshim në sjelljes të fëmijës tim ndaj fëmijëve të tjerë; Unë kam besim se shkolla se do të më informojë për çdo ndryshim në sjellje tek fëmijët e tjerë ndaj fëmijës tim; Roli im si prind konsiderohet i rëndësishëm nga mësuesi/kujdestari i fëmijës tim në bashkëpunimin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Nga 298 të intervistuar gjithsej, morëm përgjigje nga 286 të intervistuar. Konsistenca e kësaj shkalle doli e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar në Tabelën e Përshkrimeve .744 dhe me vlerat e Korrelacioneve totale të pohimeve të raportuara mbi 0.3 . Ndërsa nga 394 familje të mjedisit rural morëm përgjigje nga të gjithë të intervistuarit. Konsistenca e kësaj shkallë edhe tek familja rurale doli të jetë e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar 766. Vlera e korrelacionit total të pohimeve raportohet mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabelat:116, 117, 118, 119).

Për të marrë perceptimet e mësuesve të mjedisit urban dhe atij rural lidhur me *Besimin e shkollës te familja*, u krijua shkalla me këto pohime: Unë kam besim se familja do të më informojë lidhur me çdo ndryshim që vëren në suksesin e fëmijës së saj; Unë kam besim se familja do të më informojë për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës në mënyre që të reagojmë njësoj për përmirësim e saj; Unë kam besim se familja e ka nën kontroll fëmijën në shtëpi; Bashkëpunimi me familjen është i domosdoshëm për mua si mësues. Nga 298 subjekte gjithsej u janë përgjigjur pohimeve 296 të intervistuar. Konsistenca është e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .730. Gjithashtu, edhe vlerat e korrelacionit total të pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 120, 121). Ndërsa, nga 400 mësues nga mjedisi rural, morëm përgjigje nga 399 të intervistuar. Edhe tek mësuesit e mjedisit rural, Konsistenca është e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .792. Gjithashtu, edhe vlerat e korrelacionit total të pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 122, 123).

Për matjen e perceptimeve të familjes së mjedisit urban dhe atij rural për *Ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes*, hartuam këto pohime: Mësuesi kërkon nga unë që shqetësimet e caktuara të fëmijës tim me ndonjë fëmijë tjetër ti diskutojmë me shërbimin e konsulencës në shkollë (psikologun, pedagogun,...); Mësuesi/kujdestari i klasës m'i ka bërë të qarta objektivat dhe detyrat që duhen realizuar për parandalimin e dhunës eventuale mes fëmijës tim dhe fëmijëve të tjerë. Këtyre pohimeve u janë përgjigjur 296 mësues të mjedisit urban. Kjo nën-shkallë ka një konsistencë të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .730. Edhe në këtë rast vlerat e Korrelacioneve Totale të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 124, 125). Tek familja rurale, për perceptimet e saj lidhur me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive me shkollën morëm përgjigje nga 394 të intervistuar. Kjo shkallë tek familja rurale ka një konsistencë shumë të mirë me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .924. Edhe në këtë rast vlerat e Korrelacioneve Totale të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 126, 127).

Për të matur perceptimet e mësuesve për *Ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes*, ne ndërtuam një shkallë Likert me këto pohime: Unë kërkoj që shqetësimet e familjes për fëmijën që kanë të bëjnë me sjelljen e fëmijës dhe

të tjera ti diskutoj me shërbimin e konsulencës (psikologun, pedagogun,...); Unë ia kam bërë të qartë familjes detyrat dhe përgjegjësitë e saj të cilat duhet ti realizojë në bashkëpunim me mua për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Për matjen e perceptimit të mësuesve nga mjedisi urban janë përgjigjur 296 të intervistuar dhe kjo shkallë ka një konsistencë të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar 0.750 (Shih Aneksin II, Tabelat: 128, 129). Ndërsa tek shkalla e mjedisit rural matëm perceptimet nga 399 të intervistuar. Kjo shkallë është me konsistencë të mirë të alfa të Kronbahut të raportuar. Ndërsa për matjen e perceptimeve të shkollës urbane për ndarjen e detyrave ndërmjet tyre dhe shkollës, kemi pohimet e 399 të intervistuarve. Kjo shkallë ka një konsistencë të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar 0.792 (Shih Aneksin II, Tabela 130, 131).

Për të marrë perceptimet e familjes nga mjedisi urban dhe ai rural për *Vendimmarrjen e familjes në shkollë* këto pohime: Unë marr pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë që kanë të bëjnë me kurrikulën, kodin e veshjes, organizimin e vizitave të fëmijëve jashtë shkollës. Unë marr pjesë në vendimet që merren në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Tek familja urbane nga 298 të intervistuar, 286 i janë përgjigjur të gjitha pohimeve të shkollës. Kjo shkallë ka një konsistencë të brendshme të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .926. Tek familja rurale është përdorur shkalla me të njëjtat pohime dhe del se kjo shkallë ka një konsistencë të brendshme të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .884, duke marrë perceptimet nga 394 të intervistuar, pra të gjithë të anketuarit. (Shih Aneksin II, Tabelat: 132, 133, 134, 135).

Për të marrë perceptimet e mësuesve të mjedisit urban dhe atij rural për *Vendimmarrjen e familjes në shkollë* këto pohime: Familja merr pjesë në vendimet e rëndësishme në shkollë që kanë të bëjnë me kodin e veshjes, kurrikulën, vizitat e ndryshme, organizimet në shkollë...) dhe pohimi tjetër: Familja merr pjesë në marrjen e vendimeve e rëndësishme në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Tek mësuesit urbanë nga 298 të intervistuar, 286 i janë përgjigjur të gjitha pohimeve të shkollës. Kjo shkallë ka një konsistencë të brendshme të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .926. Tek mësuesit e mjedisit rural është përdorur shkalla me të njëjtat pohime dhe del se kjo shkallë ka një konsistencë të brendshme të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .884, duke marrë perceptimet nga 394 të intervistuar, pra të gjithë të anketuarit. Këto të dhëna gjenden të pasqyruara në Aneksin II, Tabelat: 136, 137, 138, 139).

Për matjen e *përvojës-eksperiencës së familjes me shkollën për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve* si tek familja urbane dhe ajo rurale është përdorur në pyetësorë shkalla me këto pohime: Unë si familje i kam vlerësuar si shumë të dobishme takimet me mësuesin e mëparshëm të fëmijës tim për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë; Mësuesi/kujdestari i mëparshëm i klasës së fëmijës tim ka bërë më të mirën për tejkalimin e problemeve eventuale mes fëmijës tim dhe fëmijëve të tjerë; Mësuesi/kujdestari i mëparshëm i klasës së fëmijës tim ka reaguar atëherë kur unë nuk

i jam përgjigjur ftesës së tij për takim. Nga 298 të intervistuar pjesëmarrës në studim, 296 të intervistuar u janë përgjigjur pohimeve të kësaj shkalle. Konsistenca është e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .892. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 140 dhe 141). Tek familja rurale, si dhe tek faktorët e tjerë pohimet për këtë shkallë janë të njëjta me ato të familjes së mjedisit urban. Nga 394 të intervistuarit pjesëmarrës në studim, 296 të intervistuar u janë përgjigjur pohimeve të kësaj shkallë. Konsistenca është e pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .763. Gjithashtu edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 142, 143).

Për matjen e perceptimeve të familjes urbane dhe rurale mbi *Nivelin e takimeve ndërmjet shkollës dhe familjes* kemi përdorur këtë pyetje: Sa është numri i takimeve tuaja me shkollën gjatë këtij semestri. Për këto pohime, nga 298 të intervistuar nga familje urbane morëm perceptimet e 296 të intervistuarve. Kjo shkallë ka një konsistencë të mirë me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .837. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 144, 145).

Për të njëjtat pohime të kësaj shkalle nga 394 të intervistuar nga familje rurale janë përgjigjur të gjithë të intervistuarit. Kjo shkallë ka një konsistencë të mirë me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .797. Gjithashtu, edhe vlerat e Korrelacionit Total të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 146, 147).

Për matjen e perceptimeve të shkollës mbi *Nivelin e takimeve të tyre me familjen*, si në pyetësoin e përpiluar për shkollën nga mjedisi urban ashtu dhe në atë të përpiluar për mjedisin rural kemi hartuar këtë pyetje të tipit të hapur: Sa herë brenda një semestri takoheni me prindërit/familjen, në mënyrë kolektive? Sa herë brenda një semestri takoheni me çdo prind/familje në mënyrë individuale? Këtij pohimi iu janë përgjigjur 298 mësues të shkollës urbane, pra të gjithë. Shkalla ka një konsistencë të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .818. Edhe në këtë rast vlerat e Korrelacioneve Totale të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 148, 149). Ndërsa tek shkolla rurale nga gjithsej 400 të intervistuar janë përgjigjur 400 të intervistuar, pra të gjithë. Shkalla ka një konsistencë të pranueshme me koeficientin alfa të Kronbahut të raportuar .731. Edhe në këtë rast vlerat e Korrelacioneve Totale të Pohimeve raportohen mbi 0.3 (Shih Aneksin II, Tabela 150, 151).

Për hulumtimin cilësor vlefshmëria dhe besueshmëria arrihet ndryshe krahasuar me hulumtimin sasior. Tek studimi cilësorë besueshmëria mund të merret duke kërkuar për shembuj të qëndrueshëm për të dhënat e fituara. Besueshmëria mund të luajë një rol më të vogël në të dhënat cilësore, vlefshmëria është një parashikues shumë më i fortë i saktësisë Creswell (2003)²¹⁷.

Studimi ynë ka përdorur disa strategji për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave cilësore. Në studimin tonë gjetjet i kemi mbështetur përmes procedurës së triangulimit.

217 Creswell, J. W. (2003). *Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approaches*. (2nd ed.). Thousand Oaks, CA: Sage.

Creswell (2003)²¹⁸ prek disa mënyra që përdoren për të kontrolluar vlefshmërinë dhe saktësinë e gjetjeve. Ato janë:

1. Burime të ndryshme për marrjen e informacioneve;
2. Duke përdorur anëtarë të kontrolluar për të përcaktuar saktësinë;
3. Duke bërë përshkrim të thellë të gjetjeve;
4. Të qartësohen paragjykimet që mund të vijnë në studim;
5. Informacioni negativ i cili është në kundërshtim me temat;
6. Kaloni kohë në këtë fushë;
7. Përdorni konferencë të moshatarëve;
8. Përdorni një auditim të jashtëm;

Në studimin tonë kemi përdorur dy metoda cilësore: fokus grupi, intervista. Qëndrimet për problemin e studimit i kemi marrë nga tre shtresa subjektsh: familja, nxënësit dhe shkolla, duke përdorur dhe metodën sasiore me qëllim mbështetjen e gjetjeve të studimit. Triangulimi është përdorur me qëllim forcimin e gjetjeve të studimit.

Çështjet e dala nga studimi i kemi biseduar hapur. Kemi pasur mjaft informacione negative, dhe ato i shfrytëzuam për të njohur dhe për tu thelluar edhe më shumë në problemin e studimit. Madje, studimi ynë cilësor na mundësoi që të njihemi më mirë me anët negative të trajtimit të dhunës ndërmjet nxënësve nga ana e shkollës.

Është bërë përshkrimi kontekstual me qëllim komunikimin e gjetjeve të studimit. Ndonjë paragjykim që mund të zërë vend në studim është diskutuar hapur. Informacionet e natyrës negative janë paraqitur në mënyrë të tillë që të mundësojnë thellësinë e të kuptuarit të problemit dhe të ofrojë mundësinë që të gjitha zërat të dëgjohen.

Një studim konsiderohet i vlefshëm nëse instrumentet e tij masin atë që pohojnë se masin dhe duhet të mos të kenë gabime logjistike në nxjerrjen e konkluzioneve. Konsiderojmë se hulumtimi ynë ka arritur një nivel të kënaqshëm vlefshmërie.

3.9 INTERVISTA

Për gjetjen e përgjigjeve të caktuara rreth dhunës ndërmjet nxënësve dhe bashkëpunimit të shkollës me familjen është përdorur intervista.

Në studim janë realizuar intervista me mësuesit, prindërit / kujdestarët e nxënësve, drejtorët e shkollave dhe nxënësit. Konkretisht janë realizuar 39 intervista me prindër dhe 48 me mësues, 12 me drejtorë shkollash. Gjithsej 111 intervista.

Me qëllim njohjen e arsyeve dhe qëndrimeve të nxënësve, mësuesve, drejtuesve dhe familjes lidhur me dhunën dhe bashkëpunimin e shkollës dhe familjes, në studim përdorëm intervistën, si metodën më të njohur të kërkimit cilësor pasi ajo siguroar material për analiza cilësore.

Intervista mund të jetë e strukturuar dhe gjysmë e strukturuar, madje në disa raste intervistat janë të pastrukturuara fare ose dhe zhvillohen në formë bisede me qëllim

218 Po aty, fq 196.

marrjen e sa më shumë informacioni nga i intervistuari (Mertens, 2005)²¹⁹. Në studimin tonë, intervistat ishin gjysmë të strukturuar duke mundësuar kështu një njohje më të mirë të dukurisë së studiuar, sidomos ato të realizuara me drejtorët e shkollave.

Është shfrytëzuar guida e përdorur për intervistimet e kryera dhe për grumbullimin e të dhënave për studimin e VACA (Violence against Children in Albania)²²⁰, e cila është përshtatur për studimin tonë. Intervistat kanë qenë gjysmë të strukturua dhe kanë mbuluar tema si: të kuptuarit e nocionit dhunë; llojet e dhunës, arsyet e dhunës; pasojat nga dhuna; informacionet për trajtimin e dhunës ndërmjet nxënësve në bashkëpunim midis shkollës dhe familjes; nëse ka ndodhur një bashkëpunim të tillë, kush ishte iniciatori, si dhe çështje të tjera, në mënyrë që ta njohim problemin në thellësi kemi bërë dhe ndërhyrje në çështje të caktuara gjatë intervistimit.

Siç shihet, pyetjet kanë të bëjnë me dhunën ndërmjet nxënësve dhe bashkëpunimin e shkollës dhe familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve, por ka dhe të tilla të cilat shoqërohen me pyetje që nxitnin të intervistuarin për përgjigje më të detajuara. Gjatë intervistave u bënë të gjitha pyetjet e përgatitura në varësi të personit që jepte sqarime²²¹ dhe pyetje të tjera shtesë me qëllim trajtimin më të detajuar të problemit. Kohëzgjatja e intervistave sillej nga 30 - 40 deri në 60 minuta. Kohëzgjatja ndryshonte në varësi të rastit.

3.10. FOKUS GRUPI

Duke ditur se ndërveprimet shoqërore studiohen shumë mirë përmes fokus grupit dhe me qëllim që të arrijmë të njohim më thellë dhunën ndërmjet nxënësve kemi përdorur metodën e fokus grupit. Si metode, fokus grupi krijon mundësinë që pjesëmarrësit në studim të analizohen në kontekstin e tyre duke evituar kështu dekontekstualizimin (Bryman, 2004)²²². Në kërkimet e fushës arsimore ai po gjen zbatim gjithnjë e më të gjerë (cituar nga Cohen, 2007)²²³, duke ndihmuar kështu që vetë pjesëmarrësit të përcaktojnë kuptimin e veprimeve të tyre.

Pjesëmarrës të fokus grupeve në studimin tonë janë nxënësit. U organizuan tri seance me fokus grupe. Fokus grupi përbehej nga këto dy kategori nxënësish. Ata u identifikuan në bazë të intervistave me mësuesit dhe më pas u identifikuan disa nxënës të dhunuar të cilët na dërguan tek nxënësit e tjerë dhunues ose të dhunuar. Aplikuam metodën jo probabilitare të kampionimit, metodën e teknikës së kampionimit me metodën top dëbore²²⁴. Identifikimin e tyre e bëmë përmes mësuesve dhe nxënësve. Kjo ishte karakteristika përcaktuese e të qenit pjesëtar i fokus grupit. Përbërja ishte

219 Mertens, D.M. (2005) *Research and Evaluation in Education and Psychology*; Integrating Diversity with Quantitative, Qualitative, and Mixed Methods 2nd ed. London: Sage Publication.

220 Shih shtojcën nr.II

221 Sqarimi ishte i nevojshëm sidomos për dhunën psikike-çfarë nënkuton saktë ajo, edhe pse tek një numër i vogël i të intervistuarve.

222 Bryman, A. (2004). *Social Research Methods* Oxford: Oxford University Press.

223 Cohen, L., Manion, L. & Morrison, K. (2007). *Research methods in Education*.(5th Ed). London: Routledge Falmer.

224 Cohen, L.Manion, L& Morrison, K. (2000). *Research Methods in Education* (5th Ed.). (Routledge Falmer, Taylor&Francis).

homogjene. Gjithsej u përfshinë 28 nxënës në fokus grup. Dy grupe me nga tetë nxënës dhe një me dymbëdhjetë nxënës. Fokus grupet u organizuan në dy shkolla të Prishtinës.

Takimet me fokus grupet u realizuan në mjediset e shkollave të nxënësve pjesëmarrës. Nxënësit u vendosën ballë për ballë. Regjistrimi i të dhënave u krye bëra nga asistentja jonë. Fillimisht nxënësit u prezantuan me qëllimin e organizimit të fokus grupit si edhe me arsyen pse ky fakt iu është paraqitur me shkrim të intervistuarve bashkë me të drejtat e tyre për tu tërhequr, e cila iu kërkua prindërve për ta nënshkruar për shkak të ndjeshmërisë që paraqet tema. Takimet zgjatën dy deri dy orë e gjysmë. Pjesëmarrësit në seancë diskutuan pa hezitim. Konsiderojmë se pyetjet tona nxitën ndërveprim mes anëtarëve të fokus grupit. Kjo mundësoi fleksibilitet të pyetjeve. Madje gjatë fokus grupeve ne arritëm ta njohim problemin e dhunës më në thellësi, sidomos lidhur me arsyet pse ndodh ajo. Të dhënat i regjistruam me shkrim. Konfidencialiteti i pjesëmarrësve është mbajtur në konsideratë.

Çështjet e trajtuara në fokus grup ishin: çfarë nënkupton dhuna për nxënësit; çfarë lloje të dhunës fizike dhe psikike janë ushtruar ndaj tyre; për çfarë arsye është ushtruar dhunë ndaj jush, ose, ju ndaj tyre; çfarë pasoja kishte dhuna e ushtruar ndaj jush ose tek shoku, etj.

3.11 ANALIZA E INSTRUMENTEVE

Fillimisht, pas grumbullimit të të dhënave ne bëmë pastrimin e tyre duke eliminuar të gjitha gabimet e mundshme në pyetësor. Ne kontrolluam të gjithë pyetësorët dhe bëmë eliminimin nga analiza të atyre elementeve që kishin 10% të pyetjeve pa përgjigje. Më pas, të dhënat i hodhëm në programin SPSS (Paketa Statistikore për Shkencat Sociale), e më tej bëmë rikontrollin e tyre duke eliminuar në këtë mënyrë çdo gabim të mundshëm gjatë hedhjes mekanike të të dhënave. Më pas bëmë analizën e të dhënave dhe vijua me kodimin e të dhënave duke i shndërruar të dhënat në simbole. Pas kësaj, krijuam totalin e shkallëve dhe rikodimin e tyre në nivelet, e ulët, e mesme, e lartë.

Analizën e të dhënave të fituara nga studimi e kemi kryer përmes kodimit dhe kategorizimit të të dhënave të fituara, me qëllim lehtësimin e interpretimit të tyre.

Intervistat u shqyrtuan një nga një. Pastaj krijuam grupimet e përgjigjeve për çdo pyetje. Pas kësaj u bë përmbledhja e të gjitha përgjigjeve të dhëna, dhe arritëm në një konkluzion më të përgjithshëm për çështjet të cilat kishin të bënin me dhunën. Gjetjet e të dhënave të fituara përmes intervistave janë analizuar në mënyrë shpjeguese. Përgjigjet e intervistave janë analizuar në thellësi dhe disa prej tyre janë prezantuar fjalë për fjalë.

Procedura e analizës së të dhënave të fituara përmes fokus grupit ishte e ngjashme me atë të intervistës. Filluam me analizën e përgjigjeve një nga një, më pas, i grupuam përgjigjet sipas ngjashmërisë së tyre. Për secilën pyetje të paraparë në fokus grup krijuam bashkësinë e përgjigjeve për të. Në fund të dhënat u interpretuan.

3.12 PROCEDURA E Mbledhjes së të dhënave

Të dhënat u mblodhën nga një grup pedagogësh të cilët paraprakisht u trajnuan për mbledhjen e të dhënave. Mbledhja e të dhënave filloi në tetor 2012 dhe përfundoi

në qershor 2013. Studimi është ndarë në tri faza. Në fazën e parë u bë shqyrtimi i literaturës lidhur me problemin. Në fazën e dytë u realizuan 60 intervista mbi bazën e të cilave u ndërtua pyetësi për prindërit dhe shkollën dhe ndërtimin e intervistave. Në fazën e tretë fillimisht u aplikuan pyetësorët, përmes të cilëve morëm gjetjet për faktorët të cilët i konsiderojmë të domosdoshëm në përfshirjen e familjes në shkollë me qëllim parandalimin e dhunës në shkollë, si dhe ndikues në nivelin e takimeve shkollë-familje. Pastaj, për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë u njohëm përmes intervistave dhe fokus grupeve. Para realizimit të anketimit, intervistave dhe punës me fokus grupe, u respektuan kërkesat për etikën e hulumtimit sasior dhe cilësor, si: konfidencialiteti, anonimiteti, pajtimi i personave të përfshirë, e drejta për privatësi dhe mundësi tërheqjeje.

Seancat e fokus grupit u mbajtën paradite në shkolla. Regjistrimi i përgjigjeve të subjekteve pjesëmarrës në fokus grup u krye nga një asistent (student i nivelit të studimeve master). Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në fokus grup arriti në 28. Një grup u formua nga 12 pjesëmarrës dhe dy të tjerë nga 14.

Intervistat me familjet u realizuan kryesisht pas përfundimit të takimit vjetor të paraparë në fund të semestrit dhe ato me mësuesit u realizuan gjatë kohës së mësimit. Gjithashtu, edhe intervistat me drejtorët e shkollave u kryen paradite gjatë kohës së mësimit.

3.13. PROCEDURA E ANALIZËS SË TË DHËNAVE

Studimi mbështetet në metodën e analizës logjike të të dhënave cilësore: fakte, besime, qëndrime. Analiza logjike, prej morisë së tyre, veçoi në fillim gjetjet më të përgjithshme dhe tipike e pastaj gjetjet specifike dhe atipike. Krahas kësaj, një sasi e konsiderueshme materiali të vjelë përmes anketimeve të kryera gjatë fazës së parë u përpunua në mënyrë dhe të dhënat e këtij informacioni u krahasuan me ato të analizës logjike të të dhënave cilësore. Të dhënat/gjetjet e studimit u analizuan përmes dy metodave: Analiza statistikore e të dhënave u përdor për të dhënat sasiorë dhe analiza e përmbajtjes së të dhënave u përdor për të dhënat cilësore.

Analiza statistikore e të dhënave përfshin përqindjet dhe koeficientin e korrelacionit. Të dhënat sasiorë u analizuan duke përdorur statistikat përshkruese.

Më pas, u krye studimi korrelacional përmes korrelacionit të Pirersonit për të konstatuar nëse ka pasur marrëdhënie të rëndësishme mes variablit të varur- nivelit të takimeve mes familjes me shkollën dhe faktorëve.

Të dhënat cilësore u analizuan dukë përdorur analizën kategorike dhe të interpretimit. Të dhënat sasiorë u analizuan përmes SPSS. Të dhënat u interpretuan duke përdorur statistikat përshkruese dhe statistikën korrelative.

3.14 PARIMET DHE ETIKA QË UDHËHEQIN STUDIMIN

Në këtë studim kemi pasur parasysh konsideratat etike përmes hapave konkretë në këtë drejtim. Studimi ynë është udhëhequr nga parimet morale të cilat përbëjnë studimin. “Etika e hulumtimit shoqëror ka të bëjë me krijimin e një marrëdhënie respekti

reciprok, në të mirë të të gjitha palëve, ku pjesëmarrësit janë të kënaqur të përgjigjen me sinqeritet, ku merren rezultate të vlefshme, dhe komuniteti i konsideron përfundimet konstruktive”²²⁵.

Që të arrihet deri tek vlefshmëria e rezultateve të studimit nevojitet besueshmëria dhe konsiderata etike ndërmjet studiuesit dhe pjesëmarrësve në studim, sidomos në hulumtimet cilësore. Pikërisht në këtë pjesë të studimit u fokusua tendenca jonë për të marrë në konsideratë etikën e hulumtimit, duke bërë përpjekje për objektivitet. Ndërsa “në hulumtimin cilësor objektivitet nuk do të thotë kontroll i variablave. Përkundrazi, kjo do të thotë hapje, një gatishmëri për të dëgjuar dhe “për ti dhënë zë” anketuarit, goftë ky individ apo organizatë” Strauss & Corbin (1998)²²⁶.

Para se të fillojmë pjesën empirike, mbledhjen e të dhënave të studimit, kërkua miratimin e institucioneve të cilat u përfshirë në studim. Paraprakisht morëm lejen zyrtare nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, leje kjo për kryerjen e pyetësorëve në shkollat e Kosovës dhe për realizimin e intervistave dhe fokus grupit. Për nxënësit pjesëmarrës në studim, veç lejes së lartpërmendur, ne morëm leje paraprakisht nga drejtuesit e shkollave të nxënësve të përfshirë në fokus grup. Nxënësve të përfshirë në fokus grup iu ofruam me shkrim fletë miratimin etik, në të cilin janë paraqitur: qëllimi i studimit; a paraqet rrezik përfshirja e tyre në studim; çfarë ndodh me informacionet e marra nga ta; a mund të tërhiqem nëse ndërroj mendje, e drejta për tërheqje nga fokus grupi, dhe në fund nënshkrimi i prindit.

Rëndësi të veçantë i kushtuam edhe çështjes së jo identifikimit/konfidencialitetit. “Praktika konvencionale dhe kodi etik përkrah mendimin se masat mbrojtëse duhet të mbrojnë privatësinë dhe identitetin e subjekteve në studim” Punch (1994)²²⁷. Subjekteve pjesëmarrës në studim iu kërkua që të ishin të sinqertë gjatë dhënies së përgjigjeve duke iu sqaruar se anketimi i tyre do të ruante plotësisht anonimat. Edhe pse pyetësorit i paraprin pjesa sqaruese, fillimisht të anketuarve, iu është sqaruar përse po realizohet studimi dhe çfarë do të bëjmë me të dhënat, duke ju sqaruar se ai përdoret për qëllime akademike. Fillimisht morëm miratimin për përfshirjen e personave në studim e cila ishte me vullnetin e tyre të lirë. Të anketuarve iu bënë sqarime mbi arsyet e realizimit të një studimi të tillë. Më pas i siguroam pjesëmarrësit për konfidencialitetin e tyre duke treguar gjithnjë respekt për personat e përfshirë në studim. Përpara se pjesëmarrësit të plotësonin të dhënat e pyetësorit apo të intervistoheshin, atyre iu bë e qartë natyra vullnetare të pjesëmarrjes në studim si edhe mundësia e tërheqjes nga studimi nëse nuk kishin dëshirë të merrnin pjesë në të.

Ky kapitull përshkruan dhe interpreton të dhënat e mbledhura për këtë studim. Kapitulli paraqet së bashku të dhënat sasiore dhe cilësore të marra nga familja, shkolla dhe nxënësit. Këtu paraqiten edhe diskutime, interpretime dhe vlerësime lidhur me rezultatet e studimit për pyetjet kërkimore të parashtruara.

225 Mathews, B. & Ross, L. (2010). Metodatat e hulumtuimit-Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Tiranë. CDE, fq.71

226 Strauss, A., & Corbin, J. (1998). *Basics of qualitative research: Techniques and procedures for developing grounded theory*. Thousand Oaks, CA: SAGE Publications. fq. 43.

227 Punch, M. (1994). Politics and ethics in qualitative research. In N. K. Denzin & Y. S. Lincoln (Eds.), *The handbook of qualitative research* (pp. 83-97). Thousand Oaks, CA: Sage. fq.92

Pyetjet kërkimore nga të cilat është udhëhequr studimi ishin:

- Cilat janë format e dhunës ndërmjet nxënësve? Cilat janë përmasat e saj? Cilat janë arsyet? Çfarë pasojash ka përdorimi i dhunës? Çfarë qëndrimesh mbahen ndaj dhunës? A ekzistojnë programe që merren drejtpërdrejt me parandalimin, studimin, rehabilitimin, etj?
- Cili është niveli i mirëpritjes së familjes në shkollë dhe çfarë korrelimi ka mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- Në çfarë niveli është komunikimi mes shkollës dhe familjes dhe çfarë korrelimi ka mes komunikimit dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- A janë dhe në çfarë niveli janë të informuar familja nga shkolla për dhunën ndërmjet nxënësve dhe çfarë korrelimi ka mes informimit dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- Cili është niveli i ndarjes së detyrave të shkollës me familjen dhe në çfarë korrelimi qëndron ai në nivelin e takimit të familjes me shkollën;
- A është familja vendimmarrëse në shkollë dhe cila është marrëdhënia mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- Në çfarë niveli është besimi i familjes te shkolla dhe çfarë korrelimi ka mes tij dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- Cila është përvoja e familjes me shkollën dhe cila është aktualisht marrëdhënia mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;

Duke përdorur këto pyetje kërkimore si premisë për studim, ky kapitull ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë njihemi me format e dhunës ndërmjet nxënësve, qëndrimet ndaj saj, arsyet e përdorimit, ekzistencën apo jo të programe që merren drejtpërdrejt me studimin, parandalimin, dhe rehabilitimin. Në pjesën e dytë njihemi me bashkëpunimin e shkollës me familjen për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve.

Studimi është eksplorues, por dhe korrelacional, ku kemi të bëjmë me marrëdhënien shkak pasojë ndërmjet ndryshoreve. Në studim morën pjesë gjithsej 1520 të intervistuar dhe bazuar në përgjigjet e tyre matëm nivelin dhe marrëdhënien e faktorëve të cilët i konsiderojmë të domosdoshëm me qëllim përfshirjen e familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, si dhe u njohëm me dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë me tërë kompleksitetin e saj.

Nga pikëpamja statistikore të dhënat janë domethënëse.

4.1. DHUNA FIZIKE NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Gjetjet tregojnë se format e dhunës fizike ndërmjet nxënësve, të deklaruara nga nxënësit, mësuesit dhe prindërit, janë goditja me shqelm, shtytja, shkulja e flokëve, goditja me objekte në trup, goditja me grusht, etj. Studimi evidenton faktin se dhuna fizike është mjaft e përhapur ndërmjet nxënësve.

Formë mjaft e shpeshtë e dhunës ndërmjet nxënësve është ajo e goditjes me grusht 12,47% , formë e cila zakonisht fillon me shtyrje dhe vijohet me goditjen me grusht.

Nga të dhënat del se 35% e nxënësve të intervistuar kanë përjetuar shtytje nga nxënësit e tjerë. Shkulja e flokëve 5.15, goditja me shqelm 7.54%.

Forma në e shpeshtë është shtytja "kjo ndonjëherë ndodh edhe në formë shakaje, por në një rast nga shtytja "për shaka" një nxënës rrëzohet nga shkallët dhe pëson dëmtime të rënda në dorë". Studimi zbulon edhe gatitjen me objekte si formë të dhunës mes nxënësve, përmasat e së cilës janë nga 7.5-9.24%.

Nga të gjithë të intervistuarit nxënës, 65% prej tyre shprehen se dhuna fizike ndërmjet nxënësve përdoret më pak se ajo psikike. Të njëjtin qëndrim mbajnë si mësuesit dhe familja.

Studimi zbulon se dhuna është dukshëm më e theksuar ndërmjet nxënësve meshkuj ku 66% e nxënësve shprehin një qëndrim të tillë, por jo të pakta janë të dhënat edhe për ekzistencën e dhunës tek vajzat. Madje 12 nga mësuesit e intervistuar deklarojnë se ajo është e theksuar sa tek nxënësit djem ashtu edhe tek nxënëset vajza. *Gjetjet sugjerojnë vëmendje më të madhe mbi këtë çështje.*

Studimi zbulon se dhuna fizike ndërmjet nxënësve në shkollë është mjaft e përhapur. 48% e nxënësve deklarojnë se kanë përjetuar dhunë ndërmjet nxënësve. Ndërsa për sa i përket faktit se ku kryhet ajo morëm disa përgjigje. Më e shpeshta është se ajo kryhet në oborr të shkollës, orën e edukatës fizike e sidomos gjatë pushimit të madh (i cili zgjat 10 minuta). Shtrohet pyetja: Si injorohet ky fakt nga shkolla?

Në vend të dytë është ora e edukatës fizike. Ndërkohë që ajo quhet lënda e edukatës-kulturës fizike, gjatë saj më së shumti manifestohet dhuna fizike ndërmjet nxënësve? Një arsye kjo për një studim të mëtejshëm. Studimi ynë identifikoi se brenda tre muajve të semestrit të dimëror të vitit 2013 kanë ndodhur tre raste të dhunës ndërmjet nxënësve dhe arsimtarëve të edukatës fizike. Dy nga këto shkolla ndodhen në kryeqytet.

Ndërsa kur diskutuam për arsyen përse pikërisht në orët e edukatës fizike, përgjigja më e shpeshtë e nxënësve është se:

*" mësime të mëdha nuk janë prezent në oborr gjatë zhvillimit të orës së mësimi."
dhe tjetra, " varet nga mësime të mëdha".*

Mund të supozojmë se edhe vet arsimtarët në një farë mënyre janë nxitës të dhunës ndërmjet nxënësve, përderisa atë e manifestojnë këtë në raport me nxënësit.

Ajo që bie në sy gjatë intervistimit është fakti se nxënësit flasin pa hezitim për dhunën mes tyre, duke të krijuar përshtypjen se ata kanë nevojë ta trajtojnë këtë çështje. Madje, gjatë bisedës me fokus grupet, ata e shihnin të pamjaftueshme kohën e rezervuar për këtë bisedë. Me sa duket nxënësve iu mungojnë takimet për tu shprehur e pse jo për të marrë informacion për këtë çështje.

Gjatë bisedave me fokus grupet gjejmë se fëmijët janë të gatshëm të shprehen lidhur me dhunën në familje, por jo me kujdestarin ose drejtorin e shkollës. Ata kanë frikë të bisedojnë me kujdestarin e klasës, pasi i tremben largimit ose përjashtimit nga shkolla. Për rrjedhojë, pjesërisht nuk kryhet denoncimi i dhunës, pra nuk reagohet, ndërkohë që “ mos reagimi ndaj dhunës, do të thotë pajtim me të ”²²⁸

4.2. DHUNA PSIKOLOGJIKE NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Është fakt i njohur se dhuna psikologjike është më vështirë të identifikohet se dhuna fizike. Këtë e hasëm tek të intervistuarit pjesëmarrës në studimin tonë. Jo të gjithë ishin në gjendje ta dallonin dhunën psikologjike. Kishim subjekte të cilët edhe fyerjen e konsideronin reagim momental por jo dhunë.

Raportuesit e dhunës, nxënësit, mësuesit, drejtuesit dhe familja, deklarojnë se format më të përhapura të dhunës psikologjike ndërmjet nxënësve janë: fyerjet, mbajtja e mërisë, kërcënimet e ndryshme, përdorimi i nofkave të ndryshme. Duket se dhuna psikologjike ndërmjet nxënësve në shkollë është jo pak e dendur. Del se dhuna ndërmjet nxënësve në shkollë më shumë është e natyrës psikike. Ndër këto forma prijnë: fyerjet me 53%. Kërcënimet e ndryshme ne 22.8%, përdorimi i nofkave të ndryshme 36.87%. Rreth gjysma e nxënësve të intervistuar e kanë përjetuar dhunën psikike.

24 nga 28 nxënës të përfshirë në fokus grup konsiderojnë se dhuna psikike është më e pranishme se ajo fizike, pra dominon krahasuar me atë fizike.

Në deklaratimet e nxënësve të përfshirë në fokus grupe dhe nxënësve të intervistuar, kemi përputhje në qëndrimet e tyre. *Dhuna psikike dominon mbi atë fizike.*

Nxënësit e përfshirë në fokus grupe dhunën e përqendrojnë në atë psikike. 85% e nxënësve të përfshirë në fokus grupe japin përgjigje vetëm për dhunën psikike, duke mos anashkaluar as rastet për dhunën fizike. Problem shqetësues nga fokus grupet gjatë një seance doli rasti i një nxënësi të vlerësuar si dhunues, i cili u shpreh se nga kujdestarja e klasës dhe drejtuesi i shkollës atij iu ndërrua paralelja në çdo muaj gjatë tre muajve shkollorë. Ky fakt del se lëndon sferën emocionale të nxënësit ndërsa shkolla demonstroi joprofesionalizëm, pasi nuk vepron drejt në aspektin pedagogjik.

“ Unë e kisha të vështirë të miqësohesha me nxënësit e paraleleve të tjera..... pastaj të gjithë arsimtarët sapo hynin në orën e mësimit më kujtonin se duhet të sillesha mirë përndryshe nuk do të më dërgonin në paralelen time..... kjo ishte e vështirë për mua, por aspak nuk frikësohesha, ndërsa shikoja se nxënësit e tjerë kishin frikë prej meje” (nxënës).

Biseda me nxënësin na bën të supozojmë se madje dhe vetë mësuesit kanë ushtruar dhunë psikike ndaj tij. Nëse nxënësi konsiderohej problematik, a thua nuk paraqiste problem për nxënësit e tjerë? Jemi të sigurt që po.

Studimi ynë gjen se dhuna seksuale nuk është e pranishme ose është e pranishme fare pak ndërmjet nxënësve në shkollat tona. Ndoshta edhe për shkak të ndrojtjes për të folur rreth saj. Ne kemi identifikuar vetëm katër raste të përjetimit të dhunës seksuale.

²²⁸ Doracak për krijimin e mjedisëve të sugurta jot ë dhunshme e humane në shoqëri dhe në shkollë, KEC dhe UNICEF, Prishtinë, 2009, fq. 124

Për sa i përket dhunës psikike, intervistat me familjarët gjejnë se ata i kushtojnë më shumë vëmendje dhunës fizike. Dhuna psikike del në vend të dytë. Nga familjet e intervistuar, 88% prej tyre bisedën e zhvillojnë rreth dhunës fizike.

4.3. REZULTATET MBI ARSYET E PËRDORIMIT TË DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve është e domosdoshme njohja e arsyes së dhunës ndërmjet nxënësve.

Të pyetur për arsyet e përdorimit të dhunës ndërmjet nxënësve, ajo që prin si në intervistën me nxënës, familjen ashtu dhe me shkollën, është egoja e nxënësve. Shkaku pse tek nxënësit kjo arsye del të jetë 42,7%. lidhet me filozofinë se nxënësit nuk respektojnë standardet e sjelljes së duhur / të drejtë (nuk sillen mirë me nxënësit e tjerë), ndërkohë që edhe 17,88% e tyre dhunën e shohin si mjet disiplinues "të bërit më të mirë" për disa nxënës.

Arsyeja e dyte që renditet në hulumtimin tonë del të jetë interneti, kryesisht facebook-u. Kjo arsye prin tek familja, krahasuar me arsyet tjera. Ky rrjet social, thonë nxënësit e intervistuar, shërben si nxitës i dhunës. Zakonisht fyerjet, keqkuptimet, interpretimet e fjalëve fillojnë aty dhe pastaj përfundojnë me dhunë. Madje nga 28 të përfshirë në fokus grupe, 19 prej tyre i konsiderojnë si arsye të parë rrjetet sociale dhe lojërat elektronike. Në rrjetet sociale përdoren shumë shprehje fyese, edhe ndërmjet vajzave, deklarojnë ata. Nxënësit pjesëmarrës në fokus grupe perceptojnë se fjalori i tyre nxit dhunë.

"Kohën më të madhe të komunikimit e bëjmë në internet. Zënkat fillojnë aty"(nxënës).

Një tjetër,

"Arsye e parë është interneti. Tek djemtë janë ngacmimet për vajza të ndryshme"(nxënëse).

5 nga 9 nxënësit e parë në fokus grup, pra 55% paraqesin si arsye ngacmimet për vajzat. Në fokus grupin e dytë arsye dominuese del të jenë debatet verbale mes nxënësve, nga 8 nxënës të përfshirë 7 prej tyre, pra 77% japin një arsye të tillë. Dhe në fokus grupin e tretë, 5 të intervistuar perceptojnë se djemtë debatojnë për vajzat dhe zakonisht këto debate fillojnë në internet/rrjetet sociale.

"Edhe tema kryesore ndër ne është interneti, çështjet në të..." (nxënës)

Jo përqindje të madhe, por evidente, përbën edhe "xhelozia për nota" si shkaktar i përdorimit të dhunës mes nxënësve. Sipas raportimit të nxënësve, kjo është një arsye e manifestimit të dhunës mes nxënësve.

“Kemi raste kur nxënësit reagojnë përse vetëm disa nxënës të caktuar ftohen në aktivitete të ndryshme në shkollë p.sh. programe të shkollës, gara të ndryshme etj. (Mësuese).

“ Një shoqja jonë nuk është e shkëlqyer në të gjitha lëndët, por arsimtarët bazohen te notat e tjera për ti vënë notën në lëndën e tyre, ajo nuk i meriton të gjitha pesat”(Nxënëse).

Ose, qëndrimi i dy nxënësve të tjera:

“Arsimtarët zakonisht pyesin në fillim të semestrit nxënësit kinse më të mirë, pastaj ata nxënës bien në gjumë dhe përsëri mbesin më të mirët”.

Një besim tjetër, arsye kjo e dhunës ndërmjet nxënësve nxjerrë nga shkolla, është ai se nxënësve më tepër iu flitet për të drejtat e tyre dhe shumë pak ose aspak për detyrat që ata kanë. Këtë qëndrim e shprehin 34% e mësuesve. Ata vlerësojnë se edhe ky fakt është një element i cili e “toleron” dhunën mes tyre. Një mësues i cili është para pensionit thotë se

“.....e kam madje të vështirë edhe ngritjen e zërit ndaj nxënësve, fillojnë menjëherë të thonë se nuk kam të drejtë. Kështu nuk ishte më pare në shkollën tonë.”

Tek mësuesit është shumë i përhapur mendimi se “ngacmimet dhe dhuna tek nxënësit vijnë si rezultat i moshës së pubertetit”. Gjatë intervistave me mësues, ne si studiuese patëm përshtypjen se ata ndihen të pafuqishëm në parandalimin e saj.

Ndërsa 11 nga nxënëset e intervistuar konsiderojnë se arsye të dhunës tek vajzat janë thashethemet për dikë. Një arsye tjetër del të jenë edhe simpatitë apo të dashurat. Madje sipas fokus grupeve kjo del të jetë arsyeja më e shpeshtë e dhunës ndërmjet djemve. Kjo dhunë shprehen se fillon në rrjetin social, zakonisht në facebook, dhe pastaj kalon në dhunë fizike.

Nga mësuesit e intervistuar, 28 prej tyre konsiderojnë se nxënësve iu është dhënë liri e tepruar. Edhe ne mësuesit nuk e kemi të lehtë të kuptohemi me ta. Ndërsa, 17 prej mësuesve konsiderojnë se nxënësve iu flitet më shumë për të drejtat e shumë më pak për përgjegjësitë e tyre, gjë që iu jep në një farë mënyre edhe një arsye më shumë që çon drejt dhunës.

“Krijohet tek ata vetëdija se kanë të drejtë edhe për ngacmime, dhunë” (mësues).

Arsye shumë e përhapur është edhe hakmarrja qoftë për vëllain apo shokun. Në disa raste madje krijohen “banda”, siç i quanin nxënësit, të cilat përballen mes tyre. Dhuna del se ka si arsye edhe hakmarrjen. Madje, në një rën nga shkollat ku realizuam bisedën në fokus grup me nxënësit, kuptuam se në një rast tre shokë përfunduan në spital pasi u rrahën me një bandë armike, rrahje kjo e organizuar në periferi të qytetit.

Gjithashtu, nga fokus grupi dhe intervistat del që edhe krenaria të jetë arsye e dhunës ndërmjet nxënësve. Është mjaft i përhapur qëndrimi “ Kush është ai?!” Arsye del të jetë edhe tendenca e nxënësve për krijimin e identitetit personal.

Nuk janë të paktë të intervistuarit, sidomos mësuesit, që arsye të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë të konsiderojnë edhe kushtet në shkollë dhe rreth saj, p.sh një nga psikologët e një shkolle në kryeqytet thotë se fakt shumë shqetësues është mos ekzistenca e rrethimit të shkollës. Si rezultat i saj në oborr të shkollës mund të futen edhe nxënës “të huaj”. Ndërsa njëri nga drejtorët e intervistuar raporton se në oborin e shkollës së tij, si rezultat i mungesë së rrethimit, gjinden edhe shiringa të cilat lihen natën aty nga nxënës ose narkomanë të tjerë.

12 nga mësuesit e intervistuar konsiderojnë se arsye përbën dhe fakti se hapësira në shkollë është tejet e vogël/ngushtë për numrin e nxënësve në shkollë. Hapësirat nuk janë në raport me standardet e një shkolle bashkëkohore. Ndërsa njëri prej prindërve të intervistuar thotë se edhe mjedisi në shkollë nuk është i këndshëm dhe nxitës për mësim, madje edhe depresiv. Kjo mund të jetë një ndër arsyet e dhunës. Lidhur me këtë arsye gjejmë një studim të realizuar nga Johnson.S, PhDa Burke.J, PhD, Gielen. A. ScD, ScM, sipas të cilit “më shumë se gjysma e 132 deklaratave të marra nga nxënësit e kanë cilësuar si karakteristike kryesore shumë të rëndësishme për fillimin, ndërprerjen dhe/ose ashpërsimin e dhunës në shkollë. Pjesëmarrësit identifikuan mjedisin jashtë shkollor si karakteristike të rëndësishme për inicimin dhe rritjen e ashpërsisë së dhunës që ndodh në shkollë”²²⁹.

Në kohën kur ne realizonim bisedën me fokus grupet, në njërin prej ditëve, zëvendës drejtoresha e shkollës na njoftoi se kishte ndodhur që disa nxënës disa ditë radhazi, kishin kërkuar në oborin e shkollës “haraç” nga disa nxënës të tjerë përmes kërcënimit. Dukuri kjo jo e theksuar por evidente.

24 mësues të intervistuar e konsiderojnë edhe familjen të jetë arsye për dhunë. Janë të rralla rastet kur nxënësi nga një familje e interesuar për suksesin e tij në shkollë të përjetojë dhunë nga nxënës të tjerë. Kjo arsye na nxit edhe më shumë për ngritjen pedagogjike të familjes.

Qëndrimi i mësuesve ndaj nxënësve del të jetë një nga arsyet e nxitjes së sjelljes së dhunshme tek nxënësit, që konsiderohet si e tillë nga 14 prej prindërve të intervistuar. Mësuesit sipas tyre shprehin ashpërsi dhe komunikim jo të drejtë me fëmijët.

“ Merrni me mend nëse fëmija çdo ditë komunikon me mësues të pandërgjegjshëm, si të mos përçojnë ata frustrimin tek fëmija në pubertet!” (nënë).

Një arsye të tillë e hasim edhe në bisedën me fokus grupet, të cilët tregojnë se brenda një jave në shkollën e tyre u hasën me dy reagime të dhunshme nga ana e mësuesve. Njëra prej tyre, mësuese e edukatës fizike, e kishte gjuajtur me shuplakë një nxënës gjatë orës së mësimi pasi ajo e kishte thirrur në emër atë e jo arsimtare. Nxënësja reagon në të njëjtën mënyrë ndaj arsimtares dhe është i tmerrshëm fakti që u desh ndërhyrja e shokëve-nxënësve për ti ndarë. Rast tjetër është ai i një arsimtari, i cili si dënim i kishte vendosur nxënësit çamçakëz në flokë. Të nesërmen, nxënësi vjen në shkollë me flokët e qethura plotësisht si rezultat i çamçakëzit. E mos të flasim për fjalët

229 Johnson.S, PhDa Burke.J, PhD, Gielen. A. ScD, ScM : *Prioritizing the School Environment in School Violence Prevention Efforts*. Journal of School Health. American School health Association. June 2011, Vol. 81, No. 6, fq. 331

fyese dhe ofenduese ndaj nxënësve të cilat nuk ishin të pakta. Mësuesi del të jetë faktor i mundshëm i dhunës.

Dihet mjaft mirë se fëmija e formon sjelljen e dhunshme nga fëmija i dhunshëm. Kjo ndodh edhe me mësuesin. Nga mësuesi i dhunshëm mësohet dhuna. Ky komunikim i vrazhdë i mësuesve mund të bëhet model i sjelljes së dhunshme te fëmijët, apo dhe burim frike. Këtu del dhe një çështje tjetër mjaft serioze; kontradikta mes vlerës individuale dhe asaj shoqërore, kur shkolla tjetër thotë e tjetër bën. Sjellje të tilla jo etike që kanë të bëjnë me më themeloren, njerëzoren, mjerisht lënë gjurmë tek nxënësit. Si pasqyrohen mësues të tillë në mendjen e nxënësve?!

Hasim edhe në shqetësimin se komunikimi jo i duhur drejt nxënësve vjen edhe nga ana e punonjësve të shkollës.

“Më shumë duhet të kihet kujdes në komunikimin me punëtorët e higjienës në shkollë, se sa me mësuesin” (prind)

Shkolla funksionon si bashkësi, ky fakt nuk del të jetë një tregues i mirë në këtë drejtim

Intervistat zbulojnë një çështje mjaft shqetësuese edhe faktin se një pjesë e dhunës psikike ndërmjet nxënësve nuk raportohet në familje ose shkollë. Arsye e mos denoncimit duket se është fakti i mungesës së informacionit tek nxënësit për dhunën psikike, për pasojat që vijnë prej saj, mirëpo, ky mos-denoncim, mos vallë bën që dhuna ndërmjet tyre të “mbetet në këmbë”? Ndërsa, gjatë bisedës me fokus grupet (nxënësit të cilët kanë përjetuar dhunë ose ata të cilët kanë ushtruar dhunë), arsye të mos denoncimit dalin dy fakte krejt kontradiktore. Njëri, se ata nuk kanë frikë nga shkolla e as nga familja dhe tjetri, se cili do jetë dënimi për ta.

“Po nëse më largojnë nga shkolla, si reagojnë prindërit”(nxënës).

Për një gjë jemi të sigurt. Nxënësve iu mungon informacioni për dhunën si dukuri. Gjatë intervistave me nxënës dhe me fokus grupet, ata mendonin se e njohin konceptin dhunë, në fakt rezultoi se ata nuk ishin në gjendje ta përkufizonin nocionin dhunë. Atyre iu mungonte informacioni edhe për pasojat e dhunës. Një pjesë kanë informacionin, por ai nuk është specifik. Kur jemi tek informacioni, përmes intervistës me familjen dhe shkollën dhe fokus grupit me nxënës, ne kuptojmë se arsye e dhunës ndërmjet nxënësve del të jetë dhe fakti se nxënësit nuk marrin informacion për pasojat ndaj tyre në rast dhune. Ndërsa, njëri nga drejtorët e shkollave konsideron se:

“dhe vetë rregullorja juridike nuk i përcakton në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve në shkollë. Nëse analizojmë ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë nuk hasim në ndonjë kuptimësi të mjaftueshme në këtë drejtim”. (drejtor).

Mungon krijimi i vetëdijes së nxënësit për efektet anësore të dhunës psikologjike. Këtë pohim e bazojë në faktin se në studimin tonë raportuan raste jo të pakta kur nxënësit

kanë përdorur dhunë ndërmjet tyre duke mos ditur se si lë gjurmë ai fakt në psiken e nxënësit. Madje një fakt të tillë e gjejmë edhe tek vet mësuesit, përderisa kishim raste kur shtytja nuk konsiderohej dhunë fizike, apo edhe kur debatet mes nxënësve nuk konsideroheshin problem për mësuesit. Përderisa ende ekziston arsyetimi: "... ata janë të rinj ...". Mungon vetëdijesimi i nxënësve dhe mësuesve për dhunën.

Ajo që bie në sy gjatë intervistave është fakti se nxënësit flasin pa hezitim për dhunën mes tyre. Të krijohet përshtypja se ata kanë nevojë ta trajtojnë këtë çështje. Madje, gjatë bisedës me fokus grupet ata e shihnin të pamjaftueshme kohën e rezervuar për këtë bisedë. *Me sa duket nxënësve iu mungojnë takimet për tu shprehur e pse jo për të marrë informacion mbi këtë çështje. Ata shprehnin dëshirë të bisedonin për dhunën.*

4.4. REZULTATET PËR QËNDRIMET MBI DHUNËN FIZIKE DHE ATË PSIKOLOGJIKE NDËRMJET NXËNËSVE

Të dhënat e studimit tonë gjejnë se shumica dërmuese e të intervistuarve mendojnë se dhuna fizike është më e dëmshme se sa dhuna psikologjike. 33% e mësuesve shprehin një qëndrim të tillë dhe 48% e familjes. 12% e drejtuesve të shkollave e konsiderojnë dhunën fizike më të dëmshme se atë fizike, dhe 39% prej tyre e konsiderojnë atë psikike më të dëmshme. Qëndrimet e drejtuesve në këtë dallim dallojnë nga ato të familjes dhe shkollës. Nën ndikimin e këtyre qëndrimeve supozojmë se nuk njihen pasojat për dhunën ndarjet nxënësve tek familja dhe shkolla.

Besimi "*Kush e lyp e gjen*" është mjaft i përhapur tek nxënësit.
"...ai më ka ngacmuar me fjalë disa herë, e ka lypur"(nxënës)

Megjithëse ka një farë vetëdije se dhuna ka pasoja negative, informacioni për pasojat e dhunës fizike, dhe sidomos asaj psikologjike, është i pakët, i kufizuar dhe jo specifik.

Qëndrim mjaft i përhapur tek familja është ai se "edhe ne na kanë ngacmuar kur ishim nxënës".

Tek mësuesit nuk e hasim një qëndrim të tillë. Mes tyre dy nga qëndrimet më të përhapura janë: i pari, se ata bëjnë shumë në drejtim të moslejimit të dhunës ndërmjet nxënësve, dhe i dyti, se fajin e ka tërësisht familja.

Arsye e cila lidhet me dhunën është edhe humbja e vetëkontrollit nga ana e nxënësve.

Shqetësues del fakti se të intervistuarit deklarohen se dhuna është e dëmshme, se ajo duhet ndaluar, por nuk kanë informacion dhe habiten kur bisedohet rreth parandalimit të saj. Çuditërisht, një gjendje të tillë e hasim edhe tek mësuesit. Vërejmë një "pa fuqi" në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Një mësues madje shprehet:

“ Edhe ne në kohën tonë jemi ngacmuar mes njëri-tjetrit”, apo një tjetër mësues “Vështirë të dilet në fund me këtë gjeneratë”, apo dy prindër kanë qëndrimin se “dhuna ndërmjet nxënësve pak alarmohet”.

4.5. REZULTATET LIDHUR ME PASOJAT NGA DHUNA FIZIKE DHE PSIKIKE NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Studimi zbulon se pasojat nga dhuna e përjetuar mes nxënësve është më shumë e natyrës psikologjike. Pasojat psikologjike të dhunës ndërmjet nxënësve ngacmojnë nivelin e përgjithshëm të funksionimit emocional të nxënësve, duke kultivuar sjellje të dhunshme. Bazuar në gjetjet, ato janë të sferës emocionale të nxënësve, e cila manifestohet me pasigurinë e tyre. Specifikisht: 17.82% e tyre pohojnë se kanë pasur në mendje të largohen nga shkolla. Kjo do të thotë se kemi “dëmtim” të fushës emocionale si rezultat i dhunës së përjetuar. Manifestimi i parë është mëria “prishja ndërmjet njëri-tjetrit”, e cila pa dyshim që do të lerë gjurmë. Më tej, ndërhyrja e shokëve tjerë, krijimi i grupimeve dhe çifteve. Ndërsa janë të pakta rastet e të tërhequrit në vetvete. 1.8 % e nxënësve të intervistuar pohojnë se vetëvrasja u ka shkuar ndërmend të paktën një herë dhe të shumtën katër herë. 72% e nxënësve ndihen të pasigurt në shkollë. Kjo flet për një pasojë të theksuar të dhunës ndërmjet nxënësve.

“ Një shoqe është injoruar zakonisht nga shokët e klasës dhe familja e ka dërguar në një shkollë tjetër” (nxënëse).

Shqetësues del fakti se nxënësit, por dhe familja, nuk kanë informacion të mjaftueshëm për pasojat e dhunës psikologjike.

Gjatë intervistave kuptojmë se një pjesë e formave të dhunës mes nxënësve nuk raportohet tek familja dhe shkolla. Atëherë del se këtu mund të kemi pasoja të mëdha nga dhuna mes nxënësve, dhe ky konflikt mund të përsëritet si hakmarrje apo ngacmimi do mbetet në kokën e nxënësit për një kohë të gjatë, duke penguar në këtë mënyrë aktivitetin e tij.

Ndër disa raste një nënë rrëfen se:

“ Djali im është ngacmuar fizikisht me një tjetër. Ky konflikt ka zgjatur për njëfarë kohe deri sa rastësisht ajo njoftohet nga nëna e një shokut të tij”.

Nga ky dhe pohime të tjera të ngjashme me të, del se jo të gjitha rastet denoncohen në shkollë dhe familje. Sigurisht që kjo ndodh për shkak të frikës ose seriozitetit të shkollës në trajtimin e tyre.

Një rast i identifikuar lidhur me pasojat e dhunës ndërmjet nxënësve është ai i një nxënësi i cili si rezultat i goditjeve të marra nga disa nxënës të dhunshëm, kishte përjetuar dëmtim të rëndë në kokë, dhe tani kohë pas kohe humbte ndjenjat në shkollë.

Studimi nuk ka mundur të kënaqet plotësisht me gjetjen e pasojave nga dhuna ndërmjet nxënësve. Janë evidentuar disa, por nuk konsiderojmë se i kemi gjetur

mjaftueshëm, ndoshta për faktin se pasojat më shumë manifestohen në sferën emocionale dhe për to nuk flitet shumë.

4.6. REZULTATET PËR ÇËSHTJEN NËSE EKZISTOJNË APO JO PROGRAME QË MERREN DREJTPËRDREJT ME PARANDALIMIN, STUDIMIN, REHABILITIMIN?

Dhuna ndërmjet nxënësve në shkollë ndalohet me ligj, por studimi zbulon se nxënësve iu mungon informacioni i duhur mbi pasojat e dhunës mes tyre. Shkolla nuk e përmbush në këtë pikë detyrën e saj. Në njërën nga shkollat e kryeqytetit mësuesit mjaftohen me faktin e disa informacioneve që figurojnë në ndonjë tabelë në korridor, por që është tepër e pamjaftueshme. Gjetjet sugjerojnë vëmendje më të madhe në këtë çështje.

Intervista me prindër tërheq vëmendjen se shkolla duhet të kontaktojë më shumë me familjen.

“Ata mund të na informojnë për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës. Sot kemi internetin, telefonin, por për ngacmime ata nuk na kontaktojnë, vetëm kur problemi bëhet shumë serioz” (prind)

Shqetësues në studim del edhe fakti se shkolla jonë nuk ka organizuar ndonjë takim të posaçëm për të diskutuar me prindërit mbi çështjet e dhunës ndërmjet nxënësve. Kur u parashtrua pyetja për organizime të tilla nga shkolla ata shprehin entuziazmin për pjesëmarrje në takime të tilla. Familja shprehet se:

“Shkolla ne na fton vetëm në dy takimet e parashikuara gjatë semestrit.”

duke shprehur entuziazmin për pjesëmarrje në takimet e tilla. 85% e familjeve e shprehin një qëndrim të tillë.

Familja do që shkolla të jetë më e përgjegjshme dhe fleksibël në këtë çështje. Siç është shprehur një prind në intervistë: “Shkolla mund të justifikohet se ne nuk i përgjigjemi ftesës, por në të vërtetë ne duam të takohemi për të diskutuar së bashku lidhur me dhunën dhe kjo mund të bëhet pas pune apo pasdite dhe në mbrëmje”.

“Unë nuk di që ndonjëherë të kemi biseduar mbi çështjen e parandalimit të dhunës, madje as në takimet e rregullta me kujdestarin klasës” (prind).

“Unë e këshilloj fëmijën që të mos ngacmohet me fëmijët e tjerë, por nuk paskam dëgjuar se shkolla mund të organizojë takime të posaçme për këtë çështje apo konferenca ku mund të marrim informacion nga ajo” (prind).

Familja kërkon më shumë vëmendje për këtë çështje nga shkolla dhe shprehe interesim të madh për të merë informacion nga shkolla mbi dhunën ndërmjet nxënësve.

Me pak fjalë, familja konsideron se mund të ndikojë shumë në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve përmes bashkëpunimit me shkollën. Është i përhapur qëndrimi se:

“Sigurisht se si familje ne mund të kontribuojmë me idetë, mendimet dhe propozimet tona”.

Nga ana tjetër, gjatë intervistës mësuesit japin qëndrimin e tyre se:

“ne e kontaktojmë familjen për çdo rast dhune”, dhe se “ka shumë raste kur familja nuk i përgjigjet ftesës sonë si shkollë”.

Intervistat me drejtorët zbulojnë se nuk është organizuar asnjë trajnim për mësues e drejtorë shkollash për rëndësinë e përfshirjes së familjes në shkollë, e as rreth parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

Nga intervistat me familje del se ato duan të jenë më shumë të përfshira në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Ndër prononcimet e shumta për këtë çështje është dhe ky:

“Ne jemi të zënë me punë, por le të jenë këto takime të pasdites, pse jo?”(prind).

Nga 39 familje të intervistuar, 70% prej tyre thonë se iu mungon informacioni për parandalimin e dhunës mes nxënësve, ndërsa nuk kemi familje të cilat deklarojnë se janë përfshirë në ndonjë aktivitet shkollor për parandalimin e dhunës në shkollë. Edhe nga ana e mësuesve dhe drejtuesve, intervistat na bëjnë të kuptojmë se shkolla nuk ka strategji, nuk ka organizuar asnjë aktivitet për parandalimin dhunës ndërmjet nxënësve. Në 88% të familjeve të intervistuar hasim me një qëndrim të tillë. Tek mësuesit kemi qëndrimin “ne mundohemi të kontaktojmë me familjen”, por konkretisht nuk shprehen për ndonjë aktivitet real në këtë drejtim.

Tek familja gjejmë dëshirën për një bashkëpunim më të thelluar me shkollën për këtë çështje. Tek ata hasim dhe shqetësimin në drejtim të dhunës ndërmjet nxënësve. Ata duan më shumë bashkëpunim me shkollën në këtë drejtim. Secili prind i intervistuar ka shprehur dëshirën dhe gatishmërinë për bashkëpunim me shkollën me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Ato, shkolla dhe familja, fajësojnë njëra-tjetrën lidhur me parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Por, sigurisht që faji qëndron tek shkolla. Ajo nuk guxon të neglizhojë madje as mosinteresimin e familjes, nëse ekziston, por të gjejë rrugë ta sjellë atë familje në shkollë, fëmija nxënës i së cilës mund të paraqesë rrezik në të ardhmen.

Gjetjet e studimit tregojnë se shkolla dhe familja bashkëpunojnë në rastet e dhunës ndërmjet nxënësve në mënyrë jo të drejtë. Shkolla bashkëpunon me familjen për arritjen e suksesit por jo dhe në drejtim të parandalimit të dhunës. Këtë pohim e bazojmë në faktin se rastet e dhunës mes tyre zgjidhen marrëveshje mes shkollës dhe familjes. Kjo zbulon se konfliktet mes nxënësve nuk trajtohen në thellësi dhe në mënyrë të drejtë. Këto raste zgjidhen pasi të ketë ndodhur dhuna. Intervistat e kryera gjatë studimit zbulojnë se shkolla nuk ka programe për trajtimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Atëherë del se problemet zgjidhen në mënyrë jo profesionale. Këtu nuk bëhet fjalë për bashkëpunimin

me qëllim parandalimin e dhunës në shkollat tona, edhe pse të gjithë e dimë “se më mirë është të parandalosh se sa të shërosh”. Shkolla jonë nuk ka strategji për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë .

Intervistat nxjerrin në pah çështjen shqetësuese se shkollës sonë i mungon qasja këshilluese dhe rehabilituese për fëmijët të cilët kanë përjetuar dhunë dhe ata të cilët kanë ushtruar dhunë mbi nxënësit e tjerë.

Si mjet parandalimi të dhunës në shkollën tonë është përfshirja e policisë në sigurinë e shkollës. Është e kuptueshme se policia me dhe pa uniforma është e pranishme në shkollë gjatë gjithë kohës sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit. A thua siguria në shkollë është detyrë e policisë? Sigurisht që jo. Ne ngulim këmbë për bashkëveprimin e faktorëve edukativë në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, por jo në ekspozimin e policisë në shkollë. Madje, kjo mund të nxisë dhunë. Gjatë bisedës me fokus grupet, ne kuptojmë se gjatë një konflikti mes nxënësit dhe mësuesit, policia reagoi duke e marrë mësuesin të tërhequr për krahu. Jemi të sigurt se ky fakt vetëm sa nxit dhunë tek nxënësit. Shkolla në vend që t’i edukojë fëmijët për parandalimin e dhunës, ajo përkundrazi po e nxit atë.

Analiza e intervistave me mësuesit dhe drejtorët e shkollave tregon se shkolla jonë nuk organizon qoftë dhe takime të posaçme me familjet për të diskutuar mbi parandalimin e dhunës mes nxënësve, aq më pak të organizoj seminare, tribuna, kurse, apo mundësi të tjera me prindërit për parandalimin e dhunës mes nxënësve. Përfundimisht, dhuna ndërmjet nxënësve në shkollë nuk trajtohet në mënyrë të drejtë dhe serioze, nuk trajtohet në tërë kompleksitetin e thellësinë e saj. Kjo ndodh pasi shkolla nuk ka programe për trajtimin e dhunës. Shkollës sonë i mungon strategjia për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, pavarësisht se kemi studime edhe pse mjaft sipërfaqësore që raportojnë se dhuna ndërmjet nxënësve në shkollë është shqetësuese. Del se asnjë shkollë nuk ka strategji për parandalimin e dhunës. Kemi reagim të shkollës vetëm pasi ndodh dhuna, si edhe kemi bashkëpunim me familjen pasi ka ndodhur dhuna, por jo dhe për parandalim të saj.

4.7. REZULTATET LIDHUR ME NIVELIN E TAKIMEVE TË SHKOLLËS DHE FAMILJES.

Sigurisht se me rëndësi është cilësia e takimeve mes shkollës dhe familjes. Por, a thua mund të pritet cilësi vetëm nga një, dy apo tre takime mes mësuesit dhe familjes gjatë një semestri? Sigurisht që jo. Nisur nga nevoja dhe rëndësia e kontakteve me mësuesin për suksesin e nxënësve, bazuar në nevojën për njohjen në vazhdimësi me sjelljen e fëmijës në shkollë, vështirësitë që mund të hasë fëmija në situata të ndryshme arsimore dhe emocionale e shumë e shumë arsye të tjera, ne e konsiderojmë shumë të rëndësishëm nivelin e takimeve mes familjes dhe shkollës.

Analiza e frekuencave për numrin e takimeve të familjes me shkollën brenda një semestri që paraqiten në tabelën 4 na bën të kuptojmë se tek familja e mjedisi urban kemi takime të pakta me shkollën. Siç vihet re, nga gjithsej 298 të anketuar gjatë studimit, 286 prej tyre u janë përgjigjur pohimeve për këtë faktor. Nga këta, 62.8%

prej tyre vlerësojnë se takimet me shkollën janë të pamjaftueshme, dhe nga kjo analizë vetëm 5% e tyre e paraqesin atë në nivel të lartë.

Më pas u kryhen analizat për nxjerrjen e mesatareve dhe devijimet standarde për perceptimin familjes urbane lidhur me nivelin e takimeve të saj me shkollën.

Tabela 4. Qëndrimet e familjes së mjedisit urban për numrin e takimeve të tyre me shkollën.

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme	e ulët	187	62.8	65.4	65.4
	e mesme	84	28.2	29.4	94.8
	e lartë	15	5.0	5.2	100.0
	Total	286	96.0	100.0	
mungon	Sistem	12	4.0		
Total		298	100.0		

Janë kryer edhe analizat për mesataren dhe devijimin standard për pohimin lidhur me nivelin e takimeve të shkollës me familjen dhe nga raportimi i tabelës 5 kuptohet se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së nivelit të takimeve sipas familjes së mjedisit urban ishte 1.3986 (DS .58807).

Tabela 5. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes së mjedisit urban lidhur me numrin e takimeve të tyre me shkollën.

	N	Minimum	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Numri i takimeve të familjes me shkollën	286	1	3	1.3986	.58807

Çështja del mjaft kontradiktore. Analiza e frekuencave të tabelës 3 na bën të kuptojmë se mësuesit e të njëjtit mjedis e vlerësojnë nivelin e lartë të numrit të takimeve ndërmjet saj dhe familjes. Nga gjithsej 298 subjekte të cilët u janë përgjigjur pohimeve të pyetësorit për numrin e takimeve shkollë-familje, 118 prej tyre e paraqesin atë të nivelit të lartë, 80 të anketuar konsiderojnë se ajo është e nivelit të mesëm dhe 23 e ulët. Ndërsa përgjigja mesatare në pohimin e kategorisë së numrit të takimeve sipas mësuesve nga shkollat e mjedisit urban sipas pasqyrimit të tabelës 7 është 1.6544 ndërsa DS =.47638

Tabela 6. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për numrin e takimeve të tyre me familjen.

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme	e ulët	23	7.7	7.7	7.7
	e mesme	80	26.8	26.8	34.6
	e lartë	118	39.6	39.6	74.2
		58	19.5	19.5	93.6
		19	6.4	6.4	100.0
	Total	298	100.0	100.0	

Tabela 7. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban lidhur me numrin e takimeve të tyre me familjen.

	N	Minimum	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Numri i takimeve të shkollës me familjen	298	1	5	2.8993	1.01002

Tabela 8 na informon se numri i takimeve mes familjeve të mjedisit rural dhe shkollës sipas qëndrimit të së parës del të jetë i nivelit të mesëm. Nga gjithsej 394 të anketuar, 82% e paraqesin të tillë, 18% e perceptojnë të nivelit të ulët dhe nuk kemi të anketuar të cilët e perceptojnë si të lartë numrin e takimeve me shkollën.

Tabela 8. Qëndrimet e familjes rurale lidhur me numrin e takimeve ndërmjet tyre në shkollë.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme	e mesme	323	82.0	82.0	82.0
	e ulët	71	18.0	18.0	100.0
	Total	394	100.0	100.0	

Më pas janë kryer analizat për nxjerrjen e mesatareve dhe devijimet standarde lidhur me perceptimin e familjes rurale për numrin e takimeve të tyre me shkollën. Në tabelën 9 jepen këto të dhëna: përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së numrit të takimeve sipas familjes së mjedisit rural ishte 3.03 ndërsa DS del të jetë 2.223.

Tabela 9. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit rural për numrin e takimeve të tyre me shkollën.

	N	Minimum	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Numri i takimeve të familjes me shkollën	394	3	20	3.03	2.223

Për sa i përket perceptimeve të mësuesve të mjedisit rural për nivelin e takimeve të tyre me shkollën, sipas statistikave në tabelën 10, kuptojmë se mësuesit e mjedisit rural e perceptojnë si të nivelit të mesëm nivelin e takimeve mes tyre dhe familjes. Nga 400 mësues, 96% shprehin qëndrimin se niveli i takimeve të tyre me familjen është i mesëm, dhe 3,5% prej tyre e vlerësojnë atë nivel si të ulët.

Tabela 10. Qëndrimet e mësuesve të shkollës rurale lidhur me numrin e takimeve të tyre me familjen.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja cumulative
E vlefshme	e ulët	11	3.5	100.0	100.0
	e mesme	389	96.5		
Total		400	100.0		

Sipas të dhënave të tabelës 11, përgjigja mesatare në pohimin e kategorisë së numrit të takimeve sipas mësuesve të shkollave të mjedisit rural ishte 2.8275 (DS .87731).

Tabela 11. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural lidhur me numrin e takimeve të tyre me familjen.

	N	Minimum	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Numri i takimeve të shkollës me familjen	400	1	7	2.8275	.87731

Nga analiza e gjetjeve të studimit kualitativ na bëhet e ditur se familjet deklarojnë kryesisht se takohen me shkollën 2-3 herë gjatë një semestri. Grupi tjetër i familjeve takohet një herë në vit dhe të tjerë shkojnë në shkollë vetëm kur ftohen nga mësuesi në mënyrë individuale, edhe në këto raste jo gjithmonë. Konstatojmë se familja e viziton shkollën kryesisht dhe pothuajse vetëm në fund të semestrit ose në fillim të tij. Shumica deklarojnë se takohen me shkollën në fund të semestrit kryesisht në ato raste kur fëmijët kanë patur probleme. Ky është një tregues se përfshirja e familjes në shkollë është minimale.

Në mungesë takimesh, intervistat zbardhin faktin se familjes i mungon informacioni për dhunën ndërmjet nxënësve. Nga familjet e intervistuar, 77% u shprehën për një shqetësim të tillë. "Unë nga vajza ime kam kuptuar se ajo dhe një shoqja e saj ngacmohet prej njëfarë kohe. Fola me kujdestarin dhe ai më tha se nuk e ka marrë serioze këtë çështje," (prind). Nga ana tjetër, mësuesit mendojnë se ata i ofrojnë familjes një informacion të mjaftueshëm në këtë drejtim.

Ishin të shumtë mësuesit të cilët raportojnë se kanë pasur shumë pak apo nuk kanë pasur kontakt me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Një pjesë e tyre madje thonë se edhe familjet fëmijët e të cilëve janë problematikë, edhe në rastet kut lajmërohen, nuk vijin. Këtë na e demonstroi tabela në vijim.

"Pikërisht me familjet e fëmijëve problematikë kemi problem. Ata nuk lajmërohen vetëm kur marrin masa paralajmëruese nga shkolla, madje disa as në këto raste" (drejtor shkollë shkollë).

"Unë kam shumë problem me njërin prej nxënësve, por çdo herë kur e kontaktoj të atin e nxënësit ai justifikohet se është i zënë, nëna ankohet se ka vjehrrën e sëmurë dhe shumë detyrime të tjera. Unë nuk mund ti takoj prindërit e këtij nxënësi. Krahasuar me kujdesin prindëror, madje nxënës i mirë është". (kujdestar i klasës)

Gjatë intervistave me drejtorët e shkollave vërehet mungesa e ndonjë dëshmie për bashkëpunimin me familjen në drejtim të parandalimit. Nuk hasëm në asnjë iniciativë nga shkolla për ndonjë program apo veprimtari në bashkëpunim me familjen, në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, minimalisht lidhur me informimin dhe parandalimin e dhunës. Ajo që bie në sy gjatë intervistave me drejtorët e shkollave ishte mungesa e trajtimit profesional të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Jo mirë qëndron shkolla për sa i përket parandalimit, madje mund ta konsiderojmë situatën si alarmante.

Nga ana tjetër, familjet e intervistuar shprehën të gatshme për të kontaktuar shkollën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, duke mos anashkaluar se ata janë të zënë me punë, por kërkojnë që shkolla në këtë drejtim të jetë më fleksibël lidhur me orarin e takimeve. Si ilustrim të këtij pohimi po paraqesim një nga shumë qëndrimet e dhëna nga familjet:

"Jam e gatshme dhe me shumë dëshirë të takohem me shkollën për të diskutuar rreth sjelljes dhe raportit të fëmijës tim në shkollë, qoftë pasdite e pse jo dhe në mbrëmje".

"Edhe ashtu ne jemi shumë të zënë me punë dhe nuk po mundemi sa duhet t'i kemi nën kontroll fëmijët, ndërsa çdo ditë po dëgjojmë për dhunën mes tyre. Mësuesit dinë më shumë dhe i kanë ata nën kontroll".

Si përfundim, nisur nga këto të dhëna del se niveli i takimeve mes shkollës dhe familjes është i ulët dhe nuk përdoret për trajtimin dhe parandalimin e dhunës ndërmjet

nxënësve. Konsiderojmë se, tek familja ekziston gatishmëria për bashkëpunim me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Ndërsa, nëse synojmë dhe supozojmë si të domosdoshëm numrin e takimeve për të pasur një kontakt të pandërprerë mes shkollës dhe familjes, atëherë del se ky numër i takimeve është shumë i ulët. ***Ne dhe këtu e identifikojmë (e gjejmë) kazusin e parë në bashkëpunimin e shkollës me familjen. Shkolla nuk takohet mjaftueshëm me familjen. Gjejmë një kulturë jo bashkëpunuese të shkollës me familjen.*** Përveç kësaj, ***del se as ky bashkëpunim nuk shfrytëzohet për parandalimin e rasteve të dhunës. Ky bashkëpunim shfrytëzohet për marrjen e notave të nxënësve dhe për të diskutuar sjelljet e tyre.***

Bazuar në këtë fakt që ofrohet nga gjetjet e studimit tonë, ne u përpoqëm të kuptojmë faktorët të cilët mundësojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e familjes me shkollën në përgjithësi dhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në veçanti.

Përgjigjen e kësaj pyetjeje do e prezantojmë në nënkapitujt në vijim ku do të paraqesim gjetjet lidhur me këtë çështje.

4.8. REZULTATET LIDHUR ME MIRËPRITJEN E FAMILJES NË SHKOLLË PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE

Çështja e parë hulumtuese: Evidentimi i rolit të nivelit të mirëpritjes së familjes në shkollë në bashkëpunimin shkollë-familje.

Gjatë shqyrtimit të literaturës kuptojmë se në bashkëpunimin e shkollës me familjen një vend me rëndësi zë mirëpritja e familjes në shkollë. Mirëpritja del se është një nga faktorët shumë domethënës në përfshirjen e familjes në shkollë edhe në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

Gjatë intervistave formale, me qëllim identifikimin e faktorëve për përfshirjen dhe bashkëpunimin e familjes në shkollë, mirëpritja ishte faktori i parë për nga rëndësia i përcaktuar nga familja. Në interes të studimit tonë, ishte konstatimi i nivelit të këtij faktori në shkollë dhe marrëdhënia e tij me nivelin e takimeve që do ketë familja me shkollën. Faktori është analizuar si në shkollat e mjedisit urban dhe në ato të mjedisit rural, së bashku me familjet e përfshira në ato shkolla, me qëllim matjen e perceptimit të familjes dhe mësuesve për nivelin e mirëpritjes së familjes në shkollë dhe marrëdhënies së saj me nivelin e takimeve shkollë-familje.

Për nivelin e mirëpritjes së familjes në shkollë, fillimisht është realizuar analiza e frekuencave të pohimeve të familjes së mjedisit urban. Në këtë këndvështrim analizat e variablave të mirëpritjes së familjes urbane nga shkolla tregojnë për një nivel të lartë të mirëpritjes. Të dhënat në tabelën 12 raportojnë një situatë të tillë. Nga gjithsej 298 familje të anketuara, 79.9% prej tyre e perceptojnë mirëpritjen të një niveli të lartë, 20.1% e familjeve, mirëpritjen e tyre nga shkolla e konsiderojë të nivelit mesatar. Nuk kemi familje të cilat e konsiderojnë si të ulët nivelin e mirëpritjes së tyre nga shkolla. Rezultatet tregojnë bindshëm se familja e mjedisit urban ndihet e mirëpritur në shkollë.

Tabela 12. Qëndrimet e familjes së mjedisit urban për mirëpritjen e saj në shkollë.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e mesme	60	20.1	20.1	20.1
	e lartë	238	79.9	79.9	100.0
	Total	298	100.0	100.0	

Janë kryer gjithashtu analizat edhe për nxjerrjen e mesatareve për variablat, të cilat përbëjnë faktorin e mirëpritjes së familjes në shkollë. Tabela 13 na bën të ditur se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mirëpritjes së familjes sipas mësuesve në shkollën e mjedisit rural ishte 2.9965 (DS. 05913). Ekuivalente midis plotësisht dakord dhe dakord në shkallën Likert.

Tabela 13. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit urban për mirëpritjen e familjes në shkollë.

	N	Minimum	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Mirëpritja e familjes në shkollë.	298	2	3	2.9965	DS. 05913

Interesi ynë ishte të shqyrtojmë edhe qëndrimet e familjes rurale për mirëpritjen e tyre në shkollë. Nga tabela e mëposhtme nr.14 rezulton se familja e mjedisit rural ndihet e mirëpritur nga shkolla. 97% e familjeve nga totali prej 394 pjesëmarrës shprehën se mirëpritja e tyre nga shkolla është e nivelit të lartë, dhe vetëm 3% prej tyre e konsiderojnë mirëpritjen të nivelit të mesëm. Qëndrimi i familjes së mjedisit rural është i njëjtë me familjen e mjedisit urban për sa i përket mirëpritjes. Në të dyja mjediset familja ndihet e mirëpritur nga shkolla dhe konsiderohet si pjesë e saj. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mirëpritjes së familjes sipas familjes së mjedisit rural ishte 2.9695 (DS. 17206).

Tabela 14. Qëndrimet e familjes së mjedisit rural për mirëpritjen e saj në shkollë

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e mesme	12	3.0	3.0	3.0
	e lartë	382	97.0	97.0	100.0
	Total	394	100.0	100.0	

Tabela 15 Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes së mjedisit rural për mirëpritjen e saj në shkollë.

	N	Minimum	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Mirëpritja e familjes në shkollë.	382	2	3	2.9695	.17206

Studimi i të dhënave të tabelës 16 zbulon se qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural tregojnë se mirëpritja është faktor domethënës i nivelit të kontakteve mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës mes nxënësve. 94% e mësuesve paraqesin një qëndrim të tillë. Nga 299 të anketuar, 286 prej tyre mirëpritjen e tyre nga shkolla e perceptojnë të nivelit të lartë. 16 prej tyre të nivelit të mesëm, nga totali 299. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mirëpritjes së familjes sipas mësuesve në shkollën e mjedisit rural ishte 3.0000 (DS. 00000).

Tabela 16. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural për mirëpritjen e familjes në shkollë.

		Frekuencat	Përqindje	Përqindje e vlefshme	Përqindje kumulative
E vlefshme	e ulet	1	.3	.3	.3
	e mesme	16	5.3	5.4	5.7
	e lartë	282	94.0	94.3	100.0
	Total	299	99.7	100.0	
Mungon	Sistem	1	.3		
Total		300	100.0		

Tabela 17. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural lidhur me mirëpritjen e familjes në shkollë.

	N	Minimum	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Mirëpritja e familjes në shkollë	299	3	3	3.0000	.00000

Qëndrimi i mësuesve të mjedisit urban për mirëpritjen e familjes në shkollë është “i lartë”. Atë e konsiderojnë të lartë 95.8% e prindërve të anketuar. Vetëm 10.6% e tyre e konsiderojnë atë të nivelit mesatar. Ndërsa vihet re se nuk kemi mësues të mjedisit urban të cilët konsiderojnë se nuk e mirëpresin familjen në shkollë. Këto informacione paraqiten në tabelën 18. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mirëpritjes së familjes sipas mësuesve në shkollën e mjedisit rural ishte 2.79 (DS. 401).

Tabela 18. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për mirëpritjen e familjes në shkollën me qëllim parandalimin e dhunës mes nxënësve në shkollë.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme	e mesme	33	10.6	11.0	11.0
	e lartë	266	85.3	89.0	100.0
	Total	299	95.8	100.0	
Mungon	Sistem	13	4.2		
Total		312	100.0		

Tabela 19. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban lidhur me mirëpritjen e familjes në shkollë.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Numri i takimeve të shkollës me familjen	299	12	25	2.79	.401

4.9. REZULTATET E STUDIMIT PËR MBËSHTETJEN E SUKSESIT TË NXËNËSVE, FAKTOR KY ME RËNDËSI NË BASHKËPUNIMIN SHKOLLË-FAMILJE NË DREJTIM TË PARANDALIMIT TË DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË.

Çështja e dytë hulumtuese: Evidentimi i rolit të nivelit të mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkollë në bashkëpunimin shkollë-familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Në vijim, tabela 20 pasqyron qëndrimet e gjithsej 285 familjeve të anketuara në mjedisin urban lidhur me mbështetjen e suksesit të fëmijëve të tyre nga shkolla. 84.9% e perceptojnë mbështetjen e suksesit të nxënësve nga ana e shkollës të nivelit të lartë, vetëm 10.7% e tyre këtë mbështetje e konsiderojnë të nivelit mesatar. Ndërsa, përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mbështetjes së suksesit të nxënësve sipas familjes së mjedisit urban është 2.99 (DS=.059).

Tabela 20. Qëndrimet e familjes së mjedisit urban për mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e mesme	32	10.7	11.2	11.2
	e lartë	253	84.9	88.8	100.0
	Total	285	95.6	100.0	
Mungon	Sistem	13	4.4		
Total		298	100.0		

Tabela 21 Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit urban lidhur me mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Mbështetja e suksesit të nxënësve nga shkolla	285	14	40	2.99	.059

Për variablin “mbështetja e suksesit të nxënësve” janë realizuar analizat e përgjithshme të frekuencave dhe të dhënat në tabelën 22 na bëjnë të qartë se familja e mjedisit rural e konsideron të lartë mbështetjen e suksesit të fëmijëve të tyre nga shkolla. Gjithsej, 91.4% e prindërve nga 394 familje të anketuara, shprehin një qëndrim të tillë. Tregues ky i lartë i mbështetjes së suksesit të fëmijëve në shkollën e mjedisit rural. Vetëm 7.9% e familjes e konsideron të nivelit të ulët këtë mbështetje dhe 8% të nivelit të mesëm.

Tabela 22. Qëndrimet e familjes së mjedisit rural për mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	3	7.9	7.9	8.6
	e mesme	31	8	.8	.8
	e lartë	360	91.4	91.4	100.0
	Total	394	100.0	100.0	

Gjetjet e studimit nga statistikat përshkruese tregojnë nivel të lartë të mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla sipas familjes së mjedisit rural, ndërsa përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mbështetjes së suksesit të nxënësve del të jetë 2.960 (DS. 317).

Tabela 23. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit rural lidhur me mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Mbështetja e suksesit të nxënësve	394	9	25	2.960	.317

Jo vetëm qëndrimi i familjes, por edhe ai i shkollës ishte i domosdoshëm për studimin tonë, për sa i përket mbështetjes së suksesit të nxënësve nga ana e mësuesve. Statistikat e tabelës 24 tregojnë se nga gjithsej 297 mësues të mjedisit urban, 94% e tyre shprehen se mbështesin lart suksesin e nxënësve dhe vetëm 5.4% e tyre konsiderojnë se mbështetja e suksesit të nxënësve nga mësuesit është e nivelit mesatar, 3% e tyre e vlerësojnë atë të ulët, përqindje kjo e vogël ndaj totalit të të anketuarve. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mbështetjes së suksesit të nxënësve tek mësuesit e shkollës urbane ishte 2.9394 (DS. 25275).

Tabela 24. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për mbështetjen e suksesit të nxënësve.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	1	.3	.3	.3
	e mesme	16	5.4	5.4	5.7
	e lartë	280	94.0	94.3	100.0
	Total	297	99.7	100.0	
Mungon	Sistem	1	.3		
Total		298	100.0		

Tabela 25 Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban lidhur me mbështetjen e suksesit të nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Mbështetja e suksesit të nxënësve	297	1	3	2.9394	.25275

Tabela 26 jep të dhënat e marra lidhur me mbështetjen e suksesit të nxënësve nga mësuesit e mjedisit rural, ku 91.4% prej tyre shprehen se e mbështesin atë në nivel të lartë. Gjetja tjetër është se vetëm 7.9% e tyre konsiderojnë se mbështetja e suksesit të nxënësve nga mësuesit është e nivelit mesatar, dhe 8% e ulët.

Tabela 26. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural për mbështetjen e suksesit të nxënësve.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	3	.8	.8	.8
	e mesme	31	7.9	7.9	8.6
	e lartë	360	91.4	91.4	100.0
	Total	394	100.0	100.0	

Për të analizuar perceptimet e mësuesve të mjedisit rural janë analizuar statistikat përshkruese, dhe në bazë të të dhënave të tabelës 27 kuptohet se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mbështetjes së suksesit të nxënësve tek mësuesit e mjedisit rural është: 2.957 (DS. 2142).

Tabela 27 Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural lidhur me mbështetjen e suksesit të nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Numri i takimeve të shkollës me familjen	394	9	25	2.957	.2142

4.10. REZULTATET E STUDIMIT PËR BESIMIN E FAMILJES TE SHKOLLA, FAKTOR KY NË BASHKËPUNIMIN SHKOLLË-FAMILJE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE

Çështja e katërt hulumtuese: Evidentimi i rolit të besimit të familjes te mësuesit në nivelin e bashkëpunimit të mësuesve me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

Tabela nr. 28 është një përmbledhje e përqindjeve të kampionit për besimin e familjes te shkolla e mjedisit urban. Nga tërë kampioni i përfshirë, 83.2% e tyre deklarojnë se besimi i tyre te shkolla është i nivelit të lartë, 12.8% te mesëm dhe nuk kemi familje e cila e konsideron atë të nivelit të ulët. Bazuar në këto analiza konstatojmë se familja e mjedisit urban e percepton si të lartë besimin e saj te shkolla.

Tabela 28. Qëndrimet e familjes së mjedisit urban për besimin e saj te shkolla për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve.

		Frekuencat	Përqindjet	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e mesme	38	12.8	13.3	13.3
	e lartë	248	83.2	86.7	100.0
	Total	286	96.0	100.0	
Mungon	Sistem	12	4.0		
Total		298	100.0		

Çështja përse një përqindje e kampionit nuk ka besim te shkolla duhet të eksplorohehet në një studim tjetër, duke pasur parasysh edhe interesin e shkollës për njohjen e arsyeve që ka familja.

Për të analizuar këtë variabël janë kryer analizat për statistikat përshkruese, ku sipas tabelës 29 kuptojmë se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së besimit të familjes së mjedisit urban te shkolla është: 2.8671 (DS=.34003).

Tabela 29 Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes së mjedisit urban lidhur me besimin e saj te shkolla.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Besimi familjes në shkollën	286	2	3	2.8671	.34003

Të dhënat statistikore të tabelës 30 paraqesin këtë nivel të besimit të shkollës së mjedisit urban te familja: 87% e mësuesve e perceptojnë të ulët besimin e tyre ndaj familjes 21% të mesëm, nga gjithsej 298 të intervistuar. Gjetjet e paraqitura në tabelën 31 na bëjnë të ditur se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së besimit të shkollës së mjedisit urban te familja është: 2.384 (DS=.22265).

Tabela 30. Qëndrimet e shkollës së mjedisit urban për besimin e saj te shkolla për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	262	87.9	100.0	100.0
	e mesme	36	12.1		
Total		298	100.0		

Tabela 31. Statistikat përshkruese për qëndrimet e shkollës së mjedisit urban për besimin e saj te familja.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Besimi i familjes në shkollën	298	1	3	2.384	.22265

Tabela 32 pasqyron nivelin e besimit që ka familja e mjedisit rural te shkolla/puna e saj. Besimi i familjes te shkolla paraqitet të jetë në nivel të lartë, ku 99,3% e mësuesve raportojnë për një nivel të tillë, besim ky bindshëm i nivelit të lartë. Ndërsa përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së besimit të familjes së mjedisit rural te shkolla sipas familjes së atij mjedisi është: 1.4924 (DS=1.24839), gjetje këto të paraqitura në tabelën 33.

Tabela 32. Qëndrimet e familjes së mjedisit rural për besimin e saj te shkolla për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e lartë	400	99.3	100.0	100.0
Mungon	Sistem	0	0		
Total		400	100.0		

Tabela 33. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit rural për besimin e saj te shkolla.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Besimi i familjes në shkollën	400	1	3	1.4924	1.24839

Tabela 34 na mundëson të kuptojmë besimin e shkollës së mjedisit rural te familja sipas perceptimeve të mësuesve. Nga 397 mësues gjithsej, 91.3% e tyre e perceptojnë të lartë besimin e tyre te familja, 5.5% të mesëm dhe 2.2% e ulët. Ndërsa përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së besimit të mësuesve te familja sipas mësuesve të mjedisit rural është 2.8586 (DS=.52532), gjetje këto të paraqitura në Tabelën 35.

Tabela 34. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural për besimin e tyre te shkolla për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	9	2.2	2.2	2.2
	e mesme	22	5.5	5.5	8.7
	e lartë	368	91.3	91.3	100.0
Total		399	100.0	100.0	

Tabela 35 Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural për besimin e tyre te familja.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Besimi i mësuesve te familja	399	7	23	2.8586	.52532

4.11. REZULTATET E STUDIMIT PËR KOMUNIKIMIN SHKOLLË-FAMILJE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE

Çështja hulumtuese: Evidentimi i rolit të komunikimit të mësuesve me familjen në bashkëpunimin shkollë-familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Tabela 36 tregon frekuencat duke raportuar se 72.2% e familjeve të mjedisit urban shprehin qëndrimin se komunikimi i shkollës me familjen është i nivelit “të mesëm”, nga gjithsej 300 familje të anketuara. Të nivelit të lartë e konsiderojnë 24.8% e familjeve dhe vetëm 2.2% prej tyre e konsiderojnë atë si “të ulët”. Bazuar në këto të dhëna, komunikimi i shkollës së mjedisit urban me familjen sipas qëndrimeve të familjes është në nivelin mestar. Nga Tabela 37 raportohet se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së komunikimit të familjes me shkollën e mjedisit urban ishte 2.89 (DS=3.02).

Tabela 36. Qëndrimet e familjes së mjedisit urban për komunikimin e tyre me shkollë.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	9	2.2	2.3	2.3
	e mesme	191	72.2	72.8	75.0
	e lartë	100	24.8	25.0	100.0
	Total	300	99.3	100.0	
Total		300	100.0		

Tabela 37. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit urban për komunikimin e tyre me shkollën.

	N	Mesatarja	Devijimi Standard
Komunikimi i shkollës e familjen	400	2.89	3.02

Nga tabela 38 kuptojmë se familja e mjedisit rural e vlerëson në nivel të lartë komunikimin e shkollës me të. Rezulton se: 90.6% e familjeve, komunikimin e shkollës drejt tyre e deklarojnë “të lartë”, 9.4% “të mesëm”, nga gjithsej 394 pjesëmarrës në studim. Për nivelin e ulët nuk kemi perceptime. Nuk kemi familje e cila e konsideron të nivelit “të ulët” komunikimin e shkollës në drejtim të familjes. Sipas të dhënave të tabelës 39 përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së komunikimit të familjes me shkollën e mjedisit urban ishte 2.90 (DS= .292).

Tabela 38. Qëndrimet e familje së mjedisit rural për komunikimin e shkollës në raport me familjen.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	i mesëm	37	9.4	9.4	9.4
	i lartë	357	90.6	90.6	100.0
	Total	394	100.0	100.0	

Tabela 39. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes së mjedisit rural për komunikimin e tyre me shkollën.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Komunikimi shkollës me familjen	394	12	25	2.90	.292

Në shkollat e mjedisit urban rezulton se 88.3% e kampionit të përbërë nga mësuesit e shkollave urbane, në bazë të analizës së variablave, shprehen se kanë komunikim “të lartë” me familjen. 11.4% e tyre komunikimin me familjen e kanë në nivelin “e mesëm”, 3% “të ulët”, nga totali i 298 subjekteve pjesëmarrës në studim. Gjetjet reflektojnë nivel të lartë të komunikimit të shkollës së mjedisit urban drejt familjes. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së komunikimit të familjes me shkollën e mjedisit urban ishte 2.879 (DS=336). Rezultatet në tabelën 40, 41.

Tabela 40. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për komunikimin e tyre drejt familjes.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	1	.3	.3	.3
	e mesme	34	11.4	11.4	11.7
	e lartë	263	88.3	88.3	100.0
	Total	298	100.0	100.0	

Tabela 41. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për komunikimin drejt familjes.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Komunikimi i shkollës me familjen.	298	1	3	2.879	.33661

Të dhënat statistikore në tabelën nr.42 pasqyrojnë qëndrimet e shkollës së mjedisit rural për komunikimin që ajo ka me familjen. Sipas këtyre gjetjeve del se ky komunikim është i nivelit mesatar. Nga gjithsej 400 të anketuar, 72% e tyre thonë se komunikimi i tyre drejt familjes është i nivelit mesatar. 2.2% e tyre e vlerësojnë të nivelit të ulët dhe vetëm 24.8% të nivelit të lartë dhe ajo që dominon është niveli i mesëm me 72.2%. Del se komunikimi i shkollës drejt familjes në mjedisin rural është i nivelit mesatar. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së komunikimit të shkollës së mjedisit rural me familjen ishte 2.227, (DS=.470).

Tabela 42. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural për komunikimin e tyre drejt familjes.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	9	2.2	2.3	2.3
	e mesme	291	72.2	72.8	75.0
	e lartë	100	24.8	25.0	100.0
	Total	400	99.3	100.0	
Mungon	Sistem	0	0		
Total		400	100.0		

Tabela 43. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural për komunikimin e tyre me familjen.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Komunikimi i shkollës me familjen.	400	1	3	2.227	.47042

4.12. REZULTATET E STUDIMIT PËR INFORMIMIN E FAMILJES NGA SHKOLLA, FAKTOR ME RËNDËSI NË DREJTIM TË PARANDALIMIT TË DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË.

Çështja e pestë hulumtuese: Evidentimi i ndikimit të informimit të familjes nga mësuesit për çështjet e nxënësve në bashkëpunimin shkollë-familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

Rezultatet e studimit tonë tregojnë se familja e mjedisit urban e vlerëson të nivelit të mesëm informimin e saj nga shkolla. Vetëm 3.2% e familjeve urbane e vlerësojnë informimin e shkollës në nivel të lartë, ndërsa 62.5% e tyre e konsiderojnë atë të nivelit të ulët dhe 30% të nivelit të mesëm. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së informimit të familjes nga shkolla sipas familjes së mjedisit urban ishte 2.6294 (DS. 55160). Gjetje këto të prezantuara në Tabelat 44 dhe 45.

Tabela 44. Qëndrimet e familjes së mjedisit urban për informimin e saj nga shkolla

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e mesme	95	30.4	31.7	35.0
	e ulët	195	62.5	65.0	3.3
	e lartë	10	3.2	3.3	100.0
	Total	300	96.2	100.0	
Mungon	Sistem	12	3.8		
Total		312	100.0		

Tabela 45 Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit urban për informimin e saj nga shkolla.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Informimi shkollë familje.	312	1	3	2.6294	.55160

Nga të dhënat e tabelës 46 rezulton se 64.8% e mësuesve të mjedisit urban e konsiderojnë të nivelit "të mesëm" informimin, të cilin ata ia ofrojnë familjes. 22.5% prej tyre e konsiderojnë atë "të lartë", 12.8% të nivelit "të ulët". Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e mësuesve konsiderojnë se informimi i tyre drejtuar familjes është në nivelin mesatar. Jo i lartë. Sipas tabelës 47 kuptohet se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së informimit të familjes sipas mësuesve në shkollat e mjedisit urban ishte 2.0973 (DS. 58654).

Tabela 46. Qëndrimet e mësuesve së mjedisit urban për informimin familjes

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	38	12.8	12.8	12.8
	e mesme	193	64.8	64.8	77.5
	e lartë	67	22.5	22.5	100.0
	Total	298	100.0	100.0	

Tabela 47. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për informimin e tyre drejt familjes.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Informimi shkollë familje.	298	1	3	2.0973	.58654

Më pas, në interes të studimit sigurisht ishte edhe qëndrimi i familjes së mjedisit rural për nivelin e informimit që ata kanë nga shkolla. Sipas gjetjeve të dhëna në tabelën nr.48, 36.5% e familjeve e konsiderojnë të nivelit "të ulët" informimin e tyre nga shkolla, 28.4% prej tyre e konsiderojnë të nivelit "të lartë" dhe 34.8% "të mesëm". Shohim se informimi i familjes nga shkolla tek familja e mjedisit rural ka pak dallim mes nivelit "të mesëm" dhe atij "të ulët", ndërkohë që dominon niveli "i mesëm". Familja e mjedisit rural e konsideron të nivelit mesatar informimin e shkollës drejt saj. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së informimit të familjes sipas familjes së mjedisit rural ishte 2.0178 (DS. 84647).

Tabela 48. Qëndrimet e familjes së mjedisit rural për informimin e saj nga shkolla.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e mesme	137	34.8	34.9	34.9
	e lartë	112	28.4	28.5	63.4
	e ulët	144	36.5	36.6	100.0
	Total	393	99.7	100.0	
Mungon	Sistem	1	.3		
Total		394	100.0		

Tabela 49. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit rural për informimi e shkollës

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Informimi shkollë familje	395	1	3	2.0178	.84647

Edhe mësuesit e mjedisit rural shprehin qëndrim të njëjtë me atë të familjes së po këtij mjedisi, sipas tabelës 50. Ata e konsiderojnë të nivelit të mesëm informimin e familjes nga shkolla. Sipas gjetjeve tek mësuesit e mjedisit rural, nga gjithsej 315 mësues të cilët u janë përgjigjur pohimeve të këtij variabli, 117 nga mësuesit ose shprehur në përqindje 17.9.0% shprehin qëndrimin se informimi i familjes nga shkolla është në nivelin “e mesëm”. 193 mësues, do të thotë 29.0% e konsiderojnë atë të nivelit “të lartë” dhe 1.2% “të ulët”. Sipas këtyre të dhënave del se shkolla e mjedisit rural nuk e informon familjen në nivel të mjaftueshëm. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së informimit të familjes sipas mësuesve në shkollën e mjedisit rural sipas tabelës 51 kuptojmë se ishte 2.5968 (DS. 52272).

Tabela 50. Qëndrimet e shkollës së mjedisit rural për informimin e familjes.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	5	1.2	1.6	1.6
	e lartë	193	29.0	37.1	38.7
	e mesme	117	17.9	61.3	100.0
	Total	315	78.2	100.0	
Mungon	Sistem	88	21.8		
Total		403	100.0		

Tabela 51. Statistikat përshkruese për qëndrimet e shkollës së mjedisit rural për informimin e familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Informimi shkollë familje	315	1	3	2.5968	.52272

Këtu kemi jo përputhshmëri të perceptimeve. Sipas gjetjeve të studimit, familjet e të dyja mjedisëve shprehen se nuk informohen në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Përderisa mësuesit e perceptojnë ndryshe këtë çështje, sipas tyre familja merr informacionin e mjaftueshëm nga shkolla mbi çështjet që lidhen me familjen dhe nxënësit.

Analizat e variablave na çojnë drejt identifikimit të mangësive të cilat bëjnë që ky faktor të mos jetë në nivelin e duhur, por ndërkohë gjejmë edhe arsyen e parë se si familja informohet prej shkollës përmes Këshillit të Prindërve, arsimtarëve etj, por ajo nuk informohet mbi funksionin e këtyre këshillave. Kjo do të thotë se ky informacion

është jo i plotë, formal dhe si rrjedhojë jo funksional. Nga gjithë shkollat e anketuara del se 176 mësues e kanë lexuar Ligjin për Arsim të Kosovës. Kjo do të thotë se mësuesit nuk e njohin aspektin ligjor. Edhe tek familja hasim një numër shumë të vogël të atyre që kanë informacionin e duhur ligjor, por këtë e konsiderojmë më pak shqetësuese në raport me mësuesit të cilët detyrimisht duhet ta njohin atë. Ndërsa të gjithë drejtorët e anketuar del se e njohin aspektin ligjor. Gjithashtu, kemi identifikuar se shkolla nuk i ofron familjes informacionin e duhur mbi format dhe mundësitë e bashkëpunimit mes tyre. Shqetësim kryesor në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve përbën fakti se shkolla nuk i ofron familjes informacion të vazhdueshëm lidhur me çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës.

4.13. REZULTATET PËR PËRVOJËN E FAMILJES ME SHKOLLËN PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Çështja hulumtuese: Evidentimi i efektit të përvojës së mëparshme në bashkëpunimin aktual të mësuesve me familjen.

Në tabelën 52, jepen frekuencat për qëndrimet e familjes urbane lidhur me përvojën e saj me shkollën. 59.7% e familjeve të mjedisit urban nga gjithsej 286 të anketuara, e konsiderojnë të nivelit “të lartë” përvojën e tyre të mëparshme. 34.2% “të mesme” dhe vetëm 2% “të ulët”. Del se sipas familjes së mjedisit urban përvoja e mëparshme me shkollën ishte e nivelit të lartë. Përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së përvojës së familjes me shkollën bazuar në pohimet e familjes urbane ishte 2.6094 (DS. 53166). Përmbledhje këto të Tabelës 53.

Tabela 52. *Qëndrimet e familjes urbane për përvojën e saj me shkollën në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve*

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	6	2.0	2.1	2.1
	e mesme	102	34.2	35.7	37.8
	e lartë	178	59.7	62.2	100.0
	Total	286	96.0	100.0	
Mungon	Sistem	12	4.0		
Total		298	100.0		

Tabela 53. *Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes së mjedisit urban për përvojën e tyre me shkollën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.*

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Përvoja e familjes me shkollën	286	1	3	2.6094	.53166

Në tabelën 54 kemi të dhënat e frekuencave mbi përvojën e familjes së mjedisit rural me shkollën, nga e cila del se nga gjithsej 394 familje, 257 prej tyre e vlerësojnë në nivel të lartë përvojën me shkollën, 120 prej tyre ose shprehur në përqindje 30.5% e vlerësojnë të nivelit “të mesëm”, 257 familje, pra 65.2% e perceptojnë të nivelit “të lartë” përvojën e tyre me shkollën dhe vetëm 4.3% të nivelit “të ulët”. Bazuar në rezultatet e studimit konstatojmë se përvoja e familjes me shkollën është e nivelit të lartë. Analizat përshkruese të paraqitura në tabelën 55 na mundësojnë të kuptojmë se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së përvojës së familjes me shkollën bazuar në pohimet e familjes rurale ishte 2.6091 (DS .57027).

Tabela 54. Qëndrimet e familjes rurale për përvojën e saj me familjen në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	17	4.3	4.3	4.3
	e mesme	120	30.5	30.5	34.8
	e lartë	257	65.2	65.2	100.0
	Total	394	100.0	100.0	

Tabela 55 Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjeve të mjedisit rural për përvojën e tyre me shkollën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Përvoja e familjes me shkollën	394	1	3	2.6091	.57027

Sipas familjes së mjedisit urban dhe atij rural, përvoja e përparshme mes shkollës dhe familjes nuk është një faktor domethënës për nivelin e parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

4.14. REZULTATET E STUDIMIT PËR NDARJEN E DETYRAVE MES SHKOLLËS DHE FAMILJES PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Çështja hulumtuese: Evidentimi i ndikimit të ndarjes së roleve në bashkëpunimin shkollë-familje.

Nga 298 pohimet e familjes së mjedisit urban, kuptojmë se 38.6% e tyre deklarojnë se ndarja e detyrave mes tyre dhe shkollës është e nivelit të ulët”, 37.2% e tyre informimin drejt familjes e konsiderojnë “te mesëm” dhe 24.2% e tyre e konsideron atë “të lartë”. Bazuar në këto analiza konstatojmë se nuk kemi dallime të theksuara

mes nivelit të mesëm dhe atij të ulët. Në vazhdim jepen të dhënat lidhur me mesataren dhe devijimin standard del se mesatarja është 2.73(DS. 494). Këto gjetje të studimit paraqiten në Tabelat 56 dhe 57.

Tabela 56. Qëndrimet e familjes së mjedisit urban për ndarjen e detyrave mes familjes dhe shkollës

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	115	38.6	38.6	38.6
	e mesme	111	37.2	37.2	75.8
	e lartë	72	24.2	24.2	100.0
	Total	298	100.0	100.0	

Tabela 57 Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes së mjedisit urban për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi me shkollën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi	298	1	3	2.73	.494

Bazuar në përgjigjet e pyetësorëve të shkollës së mjedisit urban del se ndarja e pushtetit mes familjes dhe shkollës është në nivel “të lartë”, ku 72.1% e shkollave e konsiderojnë të këtij niveli, 21.5% thonë se është në nivelin mesatar dhe vetëm 2.6% në nivel të ulët.

Tabela 58. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për ndarjen e detyrave mes saj dhe shkollës.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	8	2.6	2.7	25.0
	e mesme	67	21.5	22.3	2.7
	e lartë	225	72.1	75.0	100.0
	Total	300	96.2	100.0	
Mungon	Sistem	12	3.8		
Total		312	100.0		

Për të analizuar perceptimet e mësuesve të mjedisit urban mbi ndarjen e pushtetit mes familjes dhe shkollës janë realizuar analizat për statistikat përshkruese dhe kuptohet se përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së ndarjes së detyrave mes shkollës dhe familjes sipas mësuesve të shkollave të mjedisit urban ishte 1.8557 (DS ..78022). Raportime këto të tabelës 59.

Tabela 59. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi me shkollën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi	298	1	3	1.8557	.78022

Analizat statistikore në tabelën 60 tregojnë se nga gjithsej 394 familje të mjedisit rural të anketuara, 15.2% prej tyre deklarojë se ndarja e detyrave mes familjes dhe shkollës është e nivelit “të lartë”, 19.8% konsiderojnë se ajo është e nivelit “të mesëm” dhe 65.0% deklarojnë se ajo është “e ulët”. Bazuar në këto analiza konstatojmë se familjet e mjedisit rural e konsiderojnë të nivelit të ulët ndarjen e detyrave mes saj dhe shkollës. Del se kjo ndarje e detyrave dhe detyrmieve nuk është në nivelin e duhur. Mesatarja është 1.502 (DS=.74564).

Tabela 60. Qëndrimet e familjes së mjedisit rural për ndarjen e detyrave mes saj dhe shkollës.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	256	65.0	65.0	65.0
	e mesme	78	19.8	19.8	84.8
	e lartë	60	15.2	15.2	100.0
	Total	394	100.0	100.0	

Për të analizuar perceptimet e familjes së mjedisit rural mbi ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi mes familjes dhe shkollës rurale u krye analiza e statistikave përshkruese dhe kuptohet se përgjigja mesatare për pohimet e kësaj kategorie tek familja rurale ishte 1.8557 (DS ..78022). Raportime të Tabelës 61.

Tabela 61. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit rural për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi me shkollën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi.	394	1	3	1.502	.74564

Shkolla e mjedisit rural e vlerëson lart këtë faktor dhe ndikimin e tij në nivelin e takimeve të tij me shkollën ku 60 prej të intervistuarve deklarojnë se ky faktor është i nivelit “të lartë”, 78 “të mesëm” dhe 265 të intervistuar si të “të ulët”. Përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi sipas mësuesve në

shkollën e mjedisit rural ishte 6.2525 (DS 2.24307), sipas pasqyimit e tabelës 62.

Tabela 62. Qëndrimet e shkollës së mjedisit rural për ndarjen e detyrave mes saj dhe mësuesve

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	262	65.5	65.5	65.5
	e mesme	78	19.5	19.5	85.0
	e lartë	60	15.0	15.0	100.0
	Total	400	100.0	100.0	

Tabela 63. Statistikat përshkruese për qëndrimet e shkollës së mjedisit rural për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi me shkollën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Numri i takimeve të shkollës me familjen.	400	2	11	6.2525	2.24306

Për sa i përket ndarjes së detyrave mes familjes dhe shkollës për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, ky faktor është domethënës për familjen e mjedisit urban, për mësuesit e atij mjedisi dhe familjen e mjedisit rural, por rezulton se nuk ka ndikim në nivelin e takimeve mes familjes dhe shkollës për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, pra është pa vlerë statistikore.

4.15. REZULTATET E STUDIMIT PËR VENDIMMARRJEN E FAMILJES NË SHKOLLË ME QËLLIM PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE

Çështja hulumtuese: Evidentimi i problemeve të vendimmarrjes të mësuesve dhe të familjes në shkollë dhe ndikimi i tyre në bashkëpunimin shkollë-familje.

Nga të dhënat e tabelës 64 konstatohet se familja e mjedisit urban e percepton të ulët vendimmarrjen e saj në shkollë. Nga 298 familje të anketuara, 52% prej tyre e vlerësojnë "të ulët" vendimmarrjen e tyre në shkollë dhe 48% e perceptojnë atë të nivelit të mesëm.

Tabela. 64. Qëndrimet e familjes së mjedisit urban për vendimmarrjen e tyre në shkollë.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e mesme	143	48.0	100.0	100.0
Mungon	e ulët	155	52.0		
Total		298	100.0		

Për të analizuar këtë variabël janë kryer analizat për statistikat përshkruese, sipas së cilave përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së vendimmarrjes së familjes në shkollë tek familja urbane ishte: 5.2273 (DS =2.5739). Raporte këto të Tabelës 65.

Tabela 65. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes së mjedisit urban mbi vendimmarrjen e tyre në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Vendimmarrja e familjes në shkollë	286	2	10	5.2273	2.5739

Tabela 66 reflekton rezultatet statistikore të cilat tregojnë se familja e mjedisit rural percepton se shkolla i merr vendimet me pëlqimin e familjes. Nga gjithsej 394 të anketuar, 86 prej tyre ose (21.8%) shprehin qëndrimin se vendimmarrja e familjes në shkollë është e nivelit “ të lartë”, 54 ose (13.7%) prej tyre e konsiderojnë “të ulët” pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje.

Tabela. 66. Qëndrimet e familjes së mjedisit rural për vendimmarrjen e tyre në shkollë.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e ulët	54	13.7	38.6	38.6
	e lartë	86	21.8	61.4	100.0
	Total	140	35.5	100.0	
Mungon	Sistem	254	64.5		
Total		394	100.0		

Nga gjetjet e paraqitura në tabelën 67 kuptohet se përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së vendimmarrjes së familjes në shkollë tek familja rurale është: 3.5888 (DS= 1.90312).

Tabela 68. Statistikat përshkruese për qëndrimet e familjes të mjedisit rural për vendimmarrjen e tyre në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Vendimmarrja e familjes në shkollë	394	2	10	3.5888	1.90312

Analizat statistikore të tabelës 69 tregojnë se nga gjithsej 298 mësues të mjedisit urban të anketuar, 68.5% e mësuesve (204 mësues) deklarojë se vendimmarrja e familjes në shkollë është e nivelit “të lartë”, 31.6% (94 mësues) konsiderojnë se ajo është e nivelit “të mesëm”.

Tabela 69. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për vendimmarrjen e familjes në shkollë.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e lartë	204	68.5	68.5	68.5
	e mesme	94	31.5	31.5	100.0
	Total	298	100.0	100.0	

Statistika përshkruese mbi përgjigjen mesatare për pohimet e kategorisë së vendimmarrjes të familjes sipas mësuesve të shkollave të mjedisit urban bazuar në të dhënat e tabelës 70 është .3154 (DS. 46547).

Tabela 70. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit urban për vendimmarrjen e familjes në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Vendimmarrja e familjes në shkollë	298	1	3	.3154	.46547

Sipas perceptimeve të mësuesve të mjedisit rural, vendimmarrja e familjes në shkollë është e nivelit të mesëm. Nga 258 mësues, 54.8% e tyre e vlerësojnë të nivelit “të mesëm” vendimmarrjen e familjes në shkollë, ndërsa 9.2% (37 mësues) prej tyre e vlerësojnë të nivelit “të lartë”. Mesatarja del të jetë 3.965 ndërsa DS=2.27024.

Tabela. 71. Qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural për vendimmarrjen e familjes në shkollë.

		Frekuencat	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
E vlefshme	e mesme	221	54.8	85.7	85.7
	e lartë	37	9.2	14.3	100.0
	Total	258	64.0	100.0	
Mungon	Sistem	145	36.0		
Total		403	100.0		

Tabela 72. Statistikat përshkruese për qëndrimet e mësuesve të mjedisit rural për vendimmarrjen e familjes në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

	N	Minimin	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
Vendimmarrja e familjes në shkollë	258	2	23	3.9625	2.27024

Si konkluzion në fund të kësaj analize mund të pohojmë se shkolla nuk i kushton vëmendjen e duhur vendimmarrjes së familjes, ndërkohë që nga ana tjetër ajo ndikon mbi nivelin e përfshirjes së familjes në shkollë.

Tabela në vijim, nr.74 paraqet në mënyrë të përmblëdhur nivelin e faktorëve që ndikojnë si tek familja ashtu dhe shkolla e të dy mjediseve.

Tabela 74. Statistikat përshkruese të përmblëdhura për nivelin e faktorëve në bashkëpunimin shkollë- familje

Nivelet			N	I ulët	I mesëm	I lartë
Mësuesit e mjedisit urban	Numri i takimeve.		289	7.7%	26.8%	
	Mirëpritja e familjes në shkollë.		299		10.6%	85.3%
	Komunikimi shkollë-familje.		298	3%	11.4%	88.3%
	Informimi i familjes nga shkolla.		297	12.8%	64.8%	22.5%
	Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes.		300	2.6%	21.5%	71.5%
	Mbështetja e suksesit të nxënësve.		298	3%	5.4%	94.0%
	Vendimmarrja e familjes në shkollë.		298	87.9%	31.5%	68.5%
	Besimi i shkollës te familja.		298		12.1%	

Mësuesit	Mësuesit e mjedisit rural	Numri i takimeve.	400	3.5%	389%	
		Mirëpritja e familjes në shkollë.	299	3%	5.3%	94.0%
		Komunikimi shkollë-familje.	400	2.2%	72.2%	24.8%
		Informimi i familjes nga shkolla.	315	1.2%	17.9%	29.0%
		Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes.	400	65.5%	19.5%	15.0%
		Mbështetja e suksesit të nxënësve.	394	8%	7.9%	91.4%
		Vendimmarrja e familjes në shkollë.	258	2.2%	54.8%	9.2%
		Besimi i shkollës te familja.	399		5.5%	91.3%
Familja	Familja e mjedisit urban	Numri i takimeve.	286	62.8%	28.2%	
		Mirëpritja e familjes në shkollë.	298		20.1%	79.9%
		Komunikimi shkollë-familje.	300			
		Informimi i familjes nga shkolla.	300	62.5%	30.4%	3.2%
		Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes.	298	38.6%	37.2%	24.2%
		Mbështetja e suksesit të nxënësve.	285		10.7%	84.9%
		Vendimmarrja e familjes në shkollë.	298	52.0%	48.0%	
		Besimi i shkollës te familja.	286	2%	12.8%	83.2%
	Përvoja me shkollën.	298		34.2%	59.7%	
	Familja e mjedisit rural	Numri i takimeve.	394	18.0%	82.0%	97.0%
		Mirëpritja e familjes në shkollë.	394		3.0%	90.6%
		Komunikimi shkollë-familje.	394		9.4%	28.4%
		Informimi i familjes nga shkolla.	393	36.5%	34.8%	15.2%
		Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes.	394	65.0%	19.8%	
		Mbështetja e suksesit të nxënësve.	394	7.9%	8%	91.4%
		Vendimmarrja e familjes në shkollë.	140	13.7%		21.8%
Besimi i shkollës te familja.		400		30.5%	99.3%	
Përvoja e mëparshme me shkollën.	394	4.3%		65.2%		

4.16. REZULTATET E STUDIMIT PËR MARRËDHËNIET NDËRMJET FAKTORËVE SI: MIRËPRITJA E FAMILJES NË SHKOLLË, KOMUNIKIMI SHKOLLË-FAMILJE, INFORMIMI I FAMILJES NGA SHKOLLA, NDARJA E DETYRAVE MES SHKOLLËS DHE FAMILJES, MBËSHTETJA E SUKSESIT TË NXËNËSVE, VENDIMMARRJA E FAMILJES NË SHKOLLË, VENDIMMARRJA E FAMILJES NË SHKOLLË, BESIMI I SHKOLLËS TE FAMILJA, PËRVOJA E MËPARSHME E FAMILJES ME SHKOLLËN DHE NIVELIT TË TAKIMEVE SHKOLLË-FAMILJE.

Në këtë pjesë do të prezantohen rezultatet e studimit për marrëdhëniet mes faktorëve dhe nivelit të takimit shkollë-familje.

Pasi konstatuam nivelin e secilit faktor në shkollat tona, në vijim do të paraqesim

rezultatet e analizës korrelacionare²³⁰ dhe koeficientin Cronbach's alpha²³¹ ndërmjet mirëpritjes së familjes në shkollë dhe nivelit të takimeve shkollë-familje tek familja dhe shkolla e mjedisit urban dhe rural.

Tabela 75. Korelacionet ndërmjet mirëpritjes dhe nivelit të takimeve shkollë-familje

		N	r	p
Mësuesit	Mësuesit urbanë	289	.876	.000
	Mësuesit rural	400	.785	.000
Familja	Familja urbane	286	.985	.001
	Familja rurale	394	.624	.001

Marrëdhënia ndërmjet mirëpritjes së familjes në shkollë dhe nivelit të takimeve të shkollës me familjen bazuar në perceptimet e familjes së mjedisit urban është vlerësuar përmes vlerësimit të forcës korrelacionale të këtyre të dyjave. Analiza korrelacionale tregon se tek familja e mjedisit urban, mirëpritja e familjes në shkollë dhe numri i kontakteve mes familjes dhe shkollës janë dy ndryshore të cilat kanë marrëdhënie të fortë ($r=.985$ dhe $p< 0.01$) si dhe ndikim të një shkalle të lartë besueshmërie. Mirëpritja supozohet të jetë nxitëse e takimeve shkollë-familje sipas qëndrimeve të familje së mjedisit urban. Analiza e pohimeve të rigrupuara për mirëpritjen e familjes në shkollë sipas mësuesve të mjedisit urban na ndihmon të kuptojmë nëse ajo ka ndikim te niveli i takimeve të saj me shkollën gjatë semestrit. Kjo gjë prezantohet në tabelën 75 sipas së cilës këto dy ndryshore korrelojnë pozitivisht dhe kanë domethënie statistikore të rëndësishme ($r= .876$ $p < 0.01$). Rezulton se mirëpritja e familjes në shkollë sipas perceptimeve të mësuesve të mjedisit rural ndikon në nivelin e takimeve me familjen

Mirëpritja e familjes në shkollë, sipas familjes së mjedisit rural është faktor me ndikim të fortë në nivelin e takimeve shkollë-familje ($r = .624$, $p< 0.01$). Si rrjedhojë mund të themi se mirëpritja e familjes në shkollë është faktori që priret të rritë përfshirjen e familjes së mjedisit rural në shkollë. Ai përforcon nivelin e takimeve shkollë –familje në një shkallë të lartë. Shqyrtoam gjithashtu edhe marrëdhënien mes mirëpritjes dhe nivelit të takimeve të familjes dhe shkollës, ndërkohë që tabela 75 na bën të qartë se sipas perceptimeve të mësuesve të mjedisit rural, mirëpritja e familjes në shkollë përmirëson nivelin e takimeve të shkollës me familjen. Ky ndikim vlerësohet përmes (Pearson coefficient), i cili tregon se mirëpritja e familjes në shkollë ndikon mbi nivelin e takimeve mes shkollës dhe familjes ($r = .785$, $p< 0.01$).

230 Davis (1971), vlerat e koeficientëve të korelacionit kanë këtë domethënie: mbi .70 tregon lidhje shumë të fortë; .50 - .69 tregon lidhje të rëndësishme; .30 - .49 tregon lidhje të moderuar (mesatare); .10 - .29 tregon lidhje të dobët; .00-.09 tregon lidhje të parëndësishme.

231 Spas Cortina, J.M. (1993), kuptimi i vlerave të Cronbach's alpha është: $\alpha \geq 0.9$ vlerësohet shkëlqyeshëm, $0.8 \leq \alpha < 0.9$ vlerësohet mirë, $0.7 \leq \alpha < 0.8$ vlerësohet e pranueshme, $0.6 \leq \alpha < 0.7$ vlerësohet e diskutueshme, $0.5 \leq \alpha < 0.6$ vlerësohet e varfër, $\alpha < 0.5$ vlerësohet e papranueshme.

Tabela 76. Korrelacionet ndërmjet komunikimit dhe nivelit të takimeve shkollë-familje.

		N	r	p
Mësuesit	Mësuesit urbanë	298	.891	.001
	Mësuesit ruralë	400	.016	.744
Familja	Familja urbane	300	189*	.000
	Familja rurale	394	.126*	.001

Tabela nr.76 pasqyron ndërlidhjen korrelacionale ndërmjet komunikimit të shkollë dhe familjes dhe nivelit të takimeve ndërmjet tyre për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, i cili del të jetë ($r= 189^* p < 0.01$). Ndërlidhje kjo e dobët por statistikisht e rëndësishme. Nga Tabela 76 vihet re se ndërlidhja korrelacionale ndërmjet komunikimit mes shkollës dhe familjes, sipas familjes rurale dhe nivelit të takimeve ndërmjet tyre, del të jetë ($r= .126^* p < 0.01$). Ndërlidhje kjo e dobët por statistikisht e rëndësishme.

Ndërlidhja korrelacionale mes komunikimit dhe nivelit të takimeve sipas perceptimeve të shkollës së mjedisit urban është: ($r= .891^* p < 0.01$). Ndërlidhje kjo shumë e lartë dhe me domethënie statistikore dhe që pasqyrohet nga Tabela nr. 76. Tabela nr. 76 na informon se ndërlidhja korrelacionale mes komunikimit dhe nivelit të takimeve sipas perceptimeve të shkollës rurale është: ($r= .016, p = .744$). Ndërlidhje kjo e dobët dhe statistikisht e pa rëndësishme.

Tabela 77. Korrelacionet ndërmjet informimit dhe nivelit të takimeve shkollë-familje.

		N	r	p
Mësuesit	Mësuesit urbanë	297	.133*	.001
	Mësuesit ruralë	315	.152**	.000
Familja	Familja urbane	300	.336*	.000
	Familja rurale	393	.249**	.001

Ndërsa tabela nr. 77 na bën të kuptojmë se ndërlidhja korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe informimit tek familja e mjedisit urban del të jetë: ($r=.336 p < 0.0$). Ndërlidhje kjo e moderuar dhe statistikisht e rëndësishme. Studiuam edhe ndërlidhjen korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe informimit sipas shkollës së mjedisit urban dhe të dhënave të tabelës 77 dhe mësuam se ajo është: ($r=. 133^*, p < 0.00$). Ndërlidhje kjo e dobët, por statistikisht e rëndësishme

Më pas u krye analiza korrelacionale për të parë se si lidhen informimi me nivelin e takimeve shkollë-familje. Ndërlidhja korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe informimit sipas familjes së mjedisit rural del të jetë: ($r=. 249^{**}, p < 0.00$). Ndërlidhje kjo e dobët, por statistikisht e rëndësishme. Këto të dhëna gjenden në tabelën nr. 77. Për sa i përket ndërlidhjes korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe informimit sipas shkollës së mjedisit rural të pasqyruara në tabelën nr.77 ai del të jetë: ($r=. 152^{**}, p < 0.00$). Ndërlidhje kjo e dobët, por statistikisht e rëndësishme.

Tabela 78. Korrelacionet ndërmjet ndarjes së detyrave mes shkollës dhe familjes dhe nivelit të takimeve shkollë-familje.

		N	r	p
Mësuesit	Mësuesit urbanë	300	.246**	.003
	Mësuesit ruralë	400	.194*	.000
Familja	Familja urbane	298	.184*	.010
	Familja rurale	394	.467*	.000

Ndërlidhja korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe ndarjes së detyrave mes shkollës dhe familjes sipas familjes urbane: ($r = .184^{**}$, $p < 0.00$). Ndërlidhje kjo e dobët, por statistikisht e rëndësishme. Siç vihet re edhe nga tabela nr. 8, ndërlidhja korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe ndarjes së detyrave mes shkollës dhe familjes sipas shkollës urbane është: ($r = .246^{**}$, $p < 0.00$). Ndërlidhje kjo e dobët, por statistikisht e rëndësishme.

Tabela nr. 78 informon se ndërlidhja korrelacionale mes ndarjes së detyrave të familjes dhe shkollës dhe nivelit të takimeve sipas familjes së mjedisit rural është: ($r = .476$, $p < 0.00$). Statistikisht e rëndësishme. Për t'i dhënë përgjigje ndërlidhjes korrelacionale mes ndarjes së detyrave të familjes dhe shkollës dhe nivelit të takimeve është realizuar analiza korrelacionale, sipas së cilës ndërlidhja mes këtyre dy variablave është: ($r = .194$, $p < 0.00$), rezultate këto sipas Tabelës 78.

Tabela 79. Korrelacionet ndërmjet mbështetjes së suksesit të nxënësve dhe nivelit të takimeve shkollë-familje

		N	r	p
Mësuesit	Mësuesit urbanë	298	.988	.000
	Mësuesit ruralë	394	.794	.003
Familja	Familja urbane	285	.889	.001
	Familja rurale	392	.568	.000

Për të verifikuar ndikimin e mbështetjes së suksesit të nxënësve mbi numrin e takimeve të familjes me shkollën, morëm në analizë dy variabla: nivelin e takimeve, variabël i varur; dhe mbështetjen e suksesit të nxënësve, variabël i pavarur. Analiza korrelacionale tregon se mbështetja e suksesit të nxënësve vlerësohet të jetë ndikues në nivelin e takimeve tek familja e mjedisit urban. Këtë ndikim e kuptojmë nga tabela 79, sipas së cilës këto dy ndryshore korrelojnë pozitivisht dhe kanë një domethënie statistikore të rëndësishme ($r = .889$, $p < 0.01$).

Ndërsa, sipas të dhënave të tabelës 79 kuptojmë se ndërlidhja korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla tek familja e mjedisit rural është: ($r = .568$, $p < 0.01$).

Tabela 79. Pasqyron se ndërlidhja korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla sipas perceptimeve të mësuesve të

mjedisit urban del të jetë: ($r=.988$ $p < 0.01$). Sipas të dhënave të Tabelës 79, ndërlidhja korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe mbështetjes së suksesit të nxënësve tek mësuesit e mjedisit rural del të jetë: ($r=.794, 876$ $p < 0.13$).

Tabela 80. Korelacionet ndërmjet vendimmarrjes së familjes në shkollë dhe nivelit të takimeve shkollë-familje

		N	r	p
Mësuesit	Mësuesit urbanë	298	.447**	.000
	Mësuesit ruralë	258	.250**	.000
Familja	Familja urbane	298	.364*	.024
	Familja rurale	140	.364*	.001

Analiza korrelacionale është kryer për të parë nëse ekziston ndonjë marrëdhënie ndërmjet vendimmarrjes dhe përfshirjes së familjes në shkollë. Sipas pasqyrit të Tabelës 80 kuptohet se marrëdhëniet e vendimmarrjes së familjes në shkollë me nivelin e takimeve sipas qëndrimeve të familjes urbane është substanciale por statistikiisht domethënëse. Vendimmarrja e familjes në shkollë, bazuar në perceptimet e familjes rurale ka një lidhje substanciale me numrin e takimeve mes shkollës dhe familjes ($r=.364$, $p < 0.01$) dhe me domethënie statistikore sipas të dhënave të Tabelës 80.

Për sa i përket analizës korrelacionale, vendimmarrja e familjes në shkollë, sipas perceptimeve të mësuesve të mjedisit urban, ka një lidhje substanciale me numrin e takimeve mes shkollës dhe familjes ($r=.447^{**}$ $p < 0.00$), me domethënie statistikore. Sipas analizës korrelacionale të kryer, vendimmarrja e familjes në shkollë sipas perceptimeve të mësuesve të mjedisit rural ka një lidhje substanciale me numrin e takimeve mes shkollës dhe familjes ($r=.250^{**}$, $p < 0.00$), me domethënie statistikore.

Tabela 81. Korelacionet ndërmjet besimit të shkollës të familja dhe anasjelltas dhe nivelit të takimeve shkollë-familje

		N	r	p
Mësuesit	Mësuesit urbanë	298	.070	.230
	Mësuesit ruralë	399	.096	.055
Familja	Familja urbane	286	.127*	.001
	Familja rurale	394	.127*	.036

Në Tabelën 81, jepen të dhënat mbi ndërlidhjen korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe besimit të familjes së mjedisit urban të shkollës për parandalim e dhunës ndërmjet nxënësve, e cila del të jetë: ($r=.125^*$ $p < 0.01$). Marrëdhënien korrelacionale ndërmjet besimit dhe nivelit të takimeve shkollë-familje, sipas perceptimit të mësuesve të mjedisit urban, e kuptojmë përmes Tabelës 81, e cila demonstroi se sipas perceptimeve të mësuesve të mjedisit urban, besimi të familja nuk është ndikues mbi besimi në familjen në numrin që pritet të kenë ata me familjen. ($r=.070$ $p = .230$).

Më pas, është analizuar edhe ndërlidhja korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe besimit të familjes te shkolla për parandalimin e dhunës ndarjet nxënësve tek familja e mjedisit rural, e cila është: ($r=.127^*$, $p < 0.01$), gjetje këto të pasqyruara në Tabelën 81. Sipas perceptimeve të mësuesve të mjedisit rural të paraqitura në Tabelën 81. kuptojmë jo-ndikueshmëri të besimit të mësuesve tek familja në nivelin e takimeve me familjen, ($r=.096$, $p=.055$).

Tabela 82. Korelacionet ndërmjet përvojës së familjes me shkollën dhe nivelit të takimeve shkollë- familje.

		N	r	p
Familja	Familja urbane	298	.125*	.001
	Familja rurale	394	.082	.105

Janë kryer gjithashtu edhe analizat korrelacionale për të kuptuar ndërlidhjen mes nivelit të takimeve dhe përvojës së familjes me shkollën. Nga Tabela 82 pasqyrohet se ai është: ($r=.027$, $p = 0.645$). Statistikisht e pa rëndësishme. Në vazhdim jepen dhënat për ndërlidhjen korrelacionale mes nivelit të takimeve dhe përvojës së familjes me shkollën sipas familjes rurale, e cila është: ($r=.082$, $p = .105$). Statistikisht marrëdhënie e parëndësishme.

Tabela në vijim në mënyrë të përmbledhur paraqet gjetjet për mardhënien ndërmjet faktorëve si: Mirëpritja e familjes në shkollë, Komunikimi shkollë-familje, Informimi i familjes nga shkolla, Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes, Mbështetja e suksesit të nxënësve, Vendimmarrja e familjes në shkollë, Besimi i shkollës te familja, Përvoja e mëparshme e familjes me shkollën dhe niveli i takimeve shkollë-familje

Tabela 83. Rezultatet e marrëdhënies ndërmjet faktorëve si: Mirëpritja e familjes në shkollë, Komunikimi shkollë-familje, Informimi i familjes nga shkolla, Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes, Mbështetja e suksesit të nxënësve, Vendimmarrja e familjes në shkollë, Besimi i shkollës te familja, Përvoja e mëparshme e familjes me shkollën dhe niveli i takimeve shkollë-familje.

		N	r	p
Mësuesit e mjedisit urban	Mirëpritja e familjes në shkollë	299	.876	.000
	Komunikimi shkollë-familje	298	.891*	.001
	Informimi i familjes nga shkolla	297	.133*	.001
	Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes	300	.246**	.003
	Mbështetja e suksesit të nxënësve	298	.988	.000
	Vendimmarrja e familjes në shkollë	298	.447**	.000
	Besimi i shkollës te familja	298	.070	.230
Mësuesit Mësuesit e mjedisit rural	Mirëpritja e familjes në shkollë	299	.785	.000
	Komunikimi shkollë-familje	400	.016	.744
	Informimi i familjes nga shkolla	315	152**	.000
	Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes	400	.194*	.000
	Mbështetja e suksesit të nxënësve	394	.794	.013
	Vendimmarrja e familjes në shkollë	258	.250**	.000
	Besimi i shkollës te familja	399	.096	.055
Familja e mjedisit urban	Mirëpritja e familjes në shkollë	298	.985	.001
	Komunikimi shkollë-familje	300	.189*	.000
	Informimi i familjes nga shkolla	300	.336*	.002
	Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes	298	.184*	.010
	Mbështetja e suksesit të nxënësve	285	.889	.001
	Vendimmarrja e familjes në shkollë	298	.323*	.024
	Përvoja e mëparshme e familjes me shkollën	286	.027	.064
Besimi i shkollës te familja	286	.125*	.001	
Familja Familjet e mjedisit rural	Mirëpritja e familjes në shkollë	394	.624	.001
	Komunikimi shkollë-familje	394	126*	.001
	Informimi i familjes nga shkolla	393	.249**	.000
	Ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes	394	.467*	.000
	Mbështetja e suksesit të nxënësve	394	.568	.000
	Vendimmarrja e familjes në shkollë	140	.364*	.001
	Përvoja e mëparshme e familjes me shkollën	400	.082	.105
Besimi i shkollës te familja	394	.127*	.036	

Gjatë 15 viteve të fundit sistemi arsimor i Kosovës i është nënshtruar ndryshimeve të mëdha. Këto ndryshime kanë qenë të shumta dhe të fushave të ndryshme, si aftësimi profesional i mësimdhënësve, reforma e kurrikulës mësimore, etj. Ndërkohë, ashtu siç jemi shprehur në fillim të punimit, nuk kemi gjetur fakte që shkolla jonë si dhe organet e tjera si Ministra e Arsimit, Kuvendi Komunal, të kenë hartuar politika për parandalimin e dhunës në shkollë, aq më pak për bashkëpunimin me familjen. Kjo problematikë vjen si pasojë e mungesës së aktiviteteve dhe strategjive në këtë drejtim. Në këtë reformë nuk është përfshirë çështja e bashkëpunimit me familjen.

Nëse familja nuk bashkëpunon me shkollën për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, atëherë vështirë se shkolla mund t'ia dalë e vetme. Së dyti, kjo përfshirje duhet të jetë konstante dhe jo sporadike.

Studimi ynë është një përpjekje për një shkollë me qasje profesionale në përfshirjen dhe bashkëpunimin me familjen, me theks për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve dhe si një përpjekje për të identifikuar faktorët të cilët bëjnë të mundur që familja të jetë e përfshirë brenda shkollës në mënyrë të vazhdueshme.

Ky kapitull përfshin diskutimet për gjetjet, shoqëruar edhe më interpretime të rezultateve për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollat e Kosovës, për nivelin e takimeve të shkollës me familjen, si dhe për të kuptuar nëse faktorët për përfshirje më të gjerë të familjes në shkollë ndikojnë për parandalimin e dhunës. Ky kapitull na pajis me të dhëna të rëndësishme në drejtim të përfshirjes dhe bashkëpunimit të shkollës dhe familjes në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

5.1. DISKUTIME PËR NIVELIN E TAKIMEVE SHKOLLË-FAMILJE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Gjetjet e studimit evidentojnë faktin shqetësues se pavarësisht qasjes reformatore shkolla jonë rezulton se ka një numër minimal takimesh me familjen. Studimi gjen se ai numër kufizohet në një ose dy takime gjatë semestrit. Të pakta ishin përgjigjet për më shumë takime në semestër. ***Ky përbën kazusin e parë të identifikuar lidhur me bashkëpunimin e shkollës me familjen; numrin e pakët të takimeve.***

Ne jemi të vetëdijshëm se numri nuk përcakton cilësinë, por ai është tregues i kontakteve nga të cilat zhvillohet bashkëpunimi si dhe i mungesës së bashkëpunimit të mjaftueshëm shkollë -familje.

Ndërsa, për sa i përket takimeve në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve, fenomen ky shqetësues, nuk kemi të tilla. Studimi evidenton se takimet realizohen pasi të ketë ndodhur problemi. Bashkëpunimi mbetet në fushën e trajtimit, por jo të parandalimit. Sigurisht që ne nuk mendojmë të anashkalohet qasja në drejtim të trajtimit, por parandalimi kërkon një qasje shumë më serioze nga shkolla, si dëshmitare dhe përgjegjëse edhe pse jo e vetme e dhunës ndërmjet nxënësve.

Familja e mjedisit urban, nivelin përfshirjes së saj në takimet me shkollën e percepton të nivelit të ulët. Nga 298 të anketuar, 62% e perceptojnë të nivelit "të ulët" nivelin e takimeve me shkollën, 28% "të mesëm", dhe vetëm 5% si "të lartë". Këto të dhëna paraqiten në Tabelën 4. Sipas familjes së mjedisit urban, niveli takimeve me familjen është i ulët.

Ndërmjet perceptimeve të familjes dhe shkollës për këtë çështje, kemi jo përputhshmëri. *Mësuesit e të njëjtit mjedis* e vlerësojnë të nivelit të lartë numrin e takimeve ndërmjet shkollës dhe familjes. Tabela nr. 6 na informon se nga gjithsej 298 subjekte, 118 prej tyre e paraqesin atë të nivelit "të lartë", 80 të anketuar e konsiderojnë atë të nivelit "të mesëm" dhe 23 prej tyre e perceptojnë si "të ulët".

Sipas *familjes së mjedisit rural*, numri i takimeve mes saj dhe shkollës, sipas qëndrimit të së pares del të jetë e nivelit "të mesëm". Nga gjithsej 394 të anketuar, 82% e paraqesin të tillë, 18% e perceptojnë të nivelit "të ulët" ndërkohë që nuk kemi të anketuar të cilët e perceptojnë si të lartë numrin e takimeve me shkollën.

Ndërsa statistikat e paraqitura në Tabelën 10 na bëjnë të ditur se *mësuesit e mjedisit rural* e perceptojnë të nivelit të mesëm nivelin e takimeve mes tyre dhe familjes. Nga 403 mësues, 96% shprehin qëndrimin se niveli i takimeve të tyre me familjen është "i mesëm", dhe 3,5 e vlerësojnë "të ulët" atë nivel. Nuk kemi perceptime që ai të jetë në nivel "të lartë" nga asnjë mësues i anketuar.

Gjetjet e studimit tregojnë se niveli i takime mes shkollës dhe familjes është i njëjtë si në mjedisin urban ashtu dhe në atë rural, me dallime jo të theksuara, dhe kryhet përmes një, dy deri tre takimeve gjatë semestrit. Qëndrimet e familjes për këtë nivel të takimeve rezultojnë ti pohojnë edhe mësuesit. Këto rezultate të studimit tregojnë se niveli i takimeve ndërmjet familjes dhe shkollës është i nivelit "të ulët".

5.2. DISKUTIME PËR MIRËPRITJEN E FAMILJES NGA SHKOLLA ME QËLLIM PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Në këtë kontekst do të diskutohen gjetjet lidhur me pyetjen e parë të kërimit: Cili është niveli i mirëpritjes së familjes në shkollë dhe çfarë korrelimi ka mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën?

Për këtë pyetje është përdorur statistika përkruese dhe korrelacionale. Mirëpritja e familjes në shkollë, mbështetja e suksesit të nxënësit dhe besimi, dolën të jenë faktorët parësorë në bashkëpunimin e shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

Nga analizat e të dhënave sasiore rezulton se familja e percepton mirëpritjen e saj nga shkolla të nivelit të lartë. Një qëndrim të tillë shpreh edhe shkolla. Ajo del të jetë e nivelit të lartë në shkollat e dy mjediseve bazuar në perceptimet të familjes. 79% e *familjeve të mjedisit urban* e perceptojnë të nivelit “të lartë” mirëpritjen e tyre në shkollë, ndërsa 97% e *familjeve rurale* e perceptojnë të nivelit “të lartë” mirëpritjen e tyre në shkollë nga ana e shkollës. Kuptojmë se familjet e të dyja mjediseve ndihen të mirëpritura në shkollë, me një diferencë jo të theksuar mes tyre. Edhe pse mirëpritja e tyre nga shkolla tek familja urbane është e nivelit të lartë, në atë rurale ky nivel del të jetë edhe më bindës.

Nga ana tjetër, rezultatet e studimit tregojnë se edhe mësuesit e të dyja mjediseve konsiderojnë se i ofrojnë mirëpritjen e duhur familjes lidhur me bashkëpunim me shkollën. Në këtë pikë gjejmë pajtueshmëri. 95.8% e *mësuesve të mjedisit urban* konsiderojnë se mirëpritja e familjes nga shkollë është e nivelit “të lartë” ndërkohë që 94% e *mësuesve të mjedisit rural* pohojnë se mirëpritja e familjes nga shkolla është e nivelit të lartë. Këto statistika paraqiten në Tabelën 16 dhe 18.

Ndërsa përgjigja mesatare në pohimet e kategorisë së mirëpritjes së *familjes së mjedisit urban* nga shkolla është: 2.8671 (DS=.34003). Tek *mësuesit e mjedisit urban* përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së mirëpritjes së familjes në shkollë është 2.9695 dhe (DS=.17206). Për sa i përket diferencave midis përgjigjeve për mirëpritjen e familjes në shkollë sipas qëndrimeve të familjeve urbane dhe perceptimeve të mësuesve nga i njëjti mjedis, nuk rezulton të ketë diferenca të rëndësishme nga pikëpamja statistikore.

Ndërsa përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së mirëpritjes së *familjes së mjedisit rural* nga shkolla është: 2.9695 (DS=.17206). Ndërsa tek *mësuesit e mjedisit rural* përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së mirëpritjes së familjes nga shkolla është 3.0000 dhe (DS=.00000). Edhe për sa i përket diferencave midis përgjigjeve për mirëpritjen e familjes nga shkolla sipas qëndrimeve të familjes rurale dhe perceptimeve të mësuesve nga i njëjti mjedis, nuk rezulton të ketë diferenca të rëndësishme nga pikëpamja statistikore. Diferenca nuk hasen edhe për sa i përket mjedisit urban dhe atë rural. Këto statistika paraqiten në Tabelat: 15, 17.

Nuk ekzistojnë dallime të konsiderueshme të rezultateve për sa i përket mjedisit urban dhe atij rural. Tek shkolla dhe familja e të dy mjediseve, perceptimi i familjes dhe shkollës për mirëpritjen e familjes në shkollë është relativisht i ngjashëm, dhe del të jetë i lartë.

Analiza e variablave të mirëpritjes së familjes në shkollë dhe nivelit të takimeve të shkollës dhe familjes tregon ndikimin që ka mirëpritja e familjes nga shkolla mbi numrin e kontakteve mes familjes dhe shkollës. Koeficientet e korrelacionit tregojnë se mirëpritja e familjes nga shkolla është faktori që më së shumti ndikon në nivelin e takimeve të shkollës me familjen në të dyja mjediset. Ky ndikim është i një shkale të lartë besueshmërie statistikore ($r=.624$, $p < 0.01$ tek familja urbane), ($r=.876$, $p < 0.01$ tek mësuesit e shkollës urbane) ($r=.624$, $p < 0.01$ tek familja rurale) dhe ($r=.785$, $p < 0.01$ tek mësuesit e shkollës rurale). Vlerat e përshkruara më lart tregojnë se tek të dyja mjediset, mirëpritja e familjes në shkollë dhe numri i kontakteve mes familjes dhe

shkollës janë dy ndryshore të cilat kanë marrëdhënie të fortë dhe statistikiqsh janë të rëndësishme. Këto të dhëna paraqiten në Tabelën: 74.

Nga të dhënat statistikore lidhur me marrëdhënien e mirëpritjes dhe nivelit të takimeve mes shkollës dhe familjes konstatohet se nuk kemi dallime të dukshme ndërmjet mjedisit urban dhe atij rural. Në shkollat e të dyja mjedisve ky faktor, pra mirëpritja ndikon në nivelin e takimeve të familjes me shkollën. Madje ky është ndër faktorët më domethënës në këtë drejtim si tek mjedisi urban dhe te ai rural. Studimi gjen se ky faktor është i pari sipas rëndësisë në përfshirjen e familjes në shkollë.

Në drejtim të matjes së mirëpritjes së familjes në shkollë, njëra nga pyetjet e pyetësorit tonë ishte: a ka shkolla një vendtakim (sallë) të veçantë ku familja mund të takohet me mësuesin? Është shqetësuese fakti që vetëm në dy shkolla (njëra në kryeqytet) ekzistojnë salla që bëjnë të mundur takimet familje-mësues. Kjo do të thotë se shkolla nuk ka një vend mirëpritës për takimet me familjen. Takimet realizohen kryesisht në korridore ose në oborrin e shkollës. Pyetja e parë që shtrohet: A mund të jenë produktive këto takime? Dhe e dyta: A ndihen vërtet të mirëpritura familjet në shkollë kur mungon një vendtakim i parashikuar për ta si shenjë mirëpritjeje? Ku qëndron serioziteti i shkollës dhe organeve kompetente në këtë pikë?

Edhe pse shkolla dhe familja mbajnë një qëndrim të tillë, niveli i mirëpritjes së tyre është i lartë. Në parim, për ne si studiues ky rezultat ishte i papritur. Si mund të ndihet familja e mirëpritur në atë masë pa një vendtakim të caktuar në shkollë për familjen dhe a thua janë produktive takimet në ato pika takimi? - Jo.

Gjatë vëzhgimeve të kryera në shkolla të bie në sy pamja jo tërheqëse e tyre. Vetëm në tri shkolla hasëm një ambient frymëzues, mirëpritës, dhe me klimë pozitive. Këta faktorë sigurisht që ndikojnë dhe më tej në nivelin e mirëpritjes së familjes në shkollë. Ata do të bënin të mundur që familja të jetë më e pranishme në shkollë për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve.

Nga intervistat me drejtorët dhe mësuesit e shkollave doli se shkolla nuk organizon aktivitete me familjen përveç takimeve me prindër që janë të detyrueshme sipas Ligjit për Arsim të Kosovës. Ai parashikon dy takime në semestër si edhe dy takime individuale. Këto janë disa prej arsyeve që na shtynë të mendojmë seriozisht për përforcimin të këtij faktori të rëndësishëm për bashkëpunim me familjen. Megjithatë, rezultatet e studimit tregojnë se mirëpritja e familjes në shkollën tonë është e lartë.

Si konkluzion i këtyre rezultateve të studimit konstatohet se shkolla jonë i krijon mundësi familjes që të ndihet e mirëpritur në shkollë. Ky konstatim në fakt vërteton qëndrimin e shkollës se ajo e mirëpret familjen në shkollë.

5.3. DISKUTIME PËR MBËSHTETJEN E SUKSESIT TË NXËNËSVE, FAKTOR NË BASHKËPUNIMIN PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE.

Në lidhje me këtë çështje ne adresuam këtë pyetje kërkimore: Cili është niveli i mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla dhe a ndikon ai në nivelin e përfshirjes së familjes në shkollë?

Në literaturë gjejmë rëndësinë e pa mohuar të këtij faktori për arritjet e nxënësve. Ne si studiuese e konsiderojmë atë si shumë të rëndësishëm për përfshirjen e familjes në shkollë dhe bashkëpunimin e saj me shkollën për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Pse? Ky faktor është arsyeja kryesore e takimeve mes shkollës dhe familjes. Atëherë, përse të mos shfrytëzohen këto takime në funksion të parandalimit të dhunës dhe të mbajtjes nën kontroll të sjelljes dhe raporteve ndërmjet nxënësve në shkollë?

Në vijim do të pasqyrojmë rezultatet e studimit për nivelin e këtij faktori në shkollën tonë dhe ndikimin e tij mbi përfshirjen e familjes në shkollë.

Mbështetja e suksesit të nxënësve nga shkolla është kryer duke analizuar përgjigjen për çështjen nëse njoftohet familja në vazhdimësi për suksesin e fëmijës së tij. Interes përbënte dhe të kuptuarit nëse ajo merr vetëm informacion për notat e nxënësit apo edhe informacione të dobishme lidhur me ecurinë mësimore të nxënësit. Më tej ka interes edhe të kuptojmë nëse nxënësit motivohen nga mësuesit dhe shkolla për të bërë më të mirën, si dhe nëse arrin shkolla ta përfshijë familjen në shkollë për mbështetjen e suksesit të fëmijës. Dhe më në fund, duke ditur se sukcesi shkon paralel me disiplinën, a shihen këto dy çështje të ndara, apo theksi bie vetëm tek sukcesi i nxënësve.

Studimi ynë zbuloi se mësuesit e mjedisit urban e mbështesin fuqishëm suksesin e nxënësve në shkollë pasi konsiderojmë se ky faktor rrit nivelin e përfshirjes së familjes në shkollë dhe bashkëpunimin mes shkollës dhe familjes me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, si dhe është ndër faktorët me më shumë ndikim në këtë drejtim. Gjetjet mbi mbështetjen e suksesit të nxënësve nga mësuesit e mjedisit urban reflektohen në Tabelën 24 në kapitullin “Rezultat e studimit”, nga e cila kuptojmë se 94% e mësuesve të mjedisit urban e perceptojnë të nivelit “të lartë” mbështetjen e suksesit të nxënësve nga ana e mësuesve.

Në interes të studimit tonë ishte të kuptojmë dhe qëndrimin e mësuesve të mjedisit rural për mbështetjen e suksesit të nxënësve nga ana e tyre. Studimi ynë konstatoi se mësuesit e shkollave të këtij mjedisi konsiderojnë se mbështesin fuqishëm suksesin e nxënësve nga shkolla. Madje, nuk kemi mësues i cili të konsiderojë se mbështetja e suksesit të nxënësve është në nivel të ulët. 91.4% prej tyre shprehin qëndrimin se e mbështesin fuqishëm suksesin e nxënësve në shkollë. Gjetjet mbi mbështetjen e suksesit të nxënësve nga mësuesit në shkollën rurale reflektohen në Tabelën 26.

Por, çfarë qëndrimi ka familja në këtë drejtim? Qëndrimin e familjes së mjedisit urban e kuptojmë në kapitullin “Rezultatet e studimit”, sipas së cilës nga 285 familje të anketuara del se 84.9% e tyre e perceptojnë të nivelit “të lartë” mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla, me përgjigje mesatare 2.999 dhe DS= .059. Konstatojmë se familja e mjedisit urban konsideron se sukcesi i fëmijëve të tyre mbështet nga shkolla duke e konsideruar këtë mbështetje të nivelit të lartë me dallime të parëndësishëm prej 10% më pak se familja e mjedisit rural.

Ndërsa nga 394 familje të mjedisit rural, 91.4% prej tyre e perceptojnë gjithashtu të nivelit të lartë mbështetjen e suksesit të fëmijëve të tyre nga shkolla. Këto të dhëna paraqiten në Tabelën 22.

Studimi ynë gjen se sukcesi i nxënësve, nga shkolla e të dyja mjediseve, mbështetet në nivel të lartë. Madje del se ky faktor është faktori më i realizuar nga shkollat e të dyja mjediseve bazuar në qëndrimet e mësuesve dhe të familjes.

Qëndrimi i familjes korrespondon me qëndrimin e shkollës për mbështetjen e tyre ndaj suksesit të nxënësve, prandaj dhe nga rezultatet e studimit merr rendësi të vecantë çështja që ky faktor të shfrytëzohet për përfshirjen e familjes në shkollë dhe thellimin e bashkëpunimit të shkollës me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Në vijim do të paraqesim një diskutim të përmbledhur mbi mesataren dhe devijimin standard për pohimet e kategorive të mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla tek familja dhe shkolla e mjedisit urban dhe atij rural. Përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla sipas *familjes së mjedisit urban* të shkolla është: 2.99 (DS=.059), minimumi del të jetë 1 dhe maksimumi 40. Ndërsa tek *mësuesit e mjedisit urban* përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla si përgjigje të pohimeve është 2.9394 dhe (DS=.25275) me minimumin 1 dhe maksimumin 3. Për sa i përket diferencave midis përgjigjeve të mbështetjes së suksesit të nxënësve sipas qëndrimeve të familjes urbane dhe perceptimeve të mësuesve të të njëjtit mjedis nuk rezultojnë të ketë diferenca të rëndësishme nga pikëpamja statistikore.

Ndërsa tek *familja e mjedisit rural* përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla, mesatarja si përgjigje të pohimeve është 2.960 dhe (DS=.317) me minimumin 9 dhe maksimumin 25, ndërsa tek *mësuesit e të njëjtit mjedis* përgjigja mesatare si përgjigje ndaj pohimeve është 2.957 (DS. 2142) me minimumin 9 dhe maksimumin 25, ashtu si tek familja rurale. Nuk rezultojnë të ketë diferenca statistikore.

Analiza dhe vlerësimi i rezultateve të marra nga studimi ynë empirik identifikuan marrëdhënien ndërmjet mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla dhe nivelit të takimeve të shkollës me familjen për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, marrëdhënie e rëndësishme si për familjen dhe për shkollën. Gjetjet janë: ($r= .889$, $p < 0.01$ tek familja urbane), ($r= .568$, $p < 0.01$ tek familja rurale) dhe ($r = .793$, $p < 0.01$ tek mësuesit e shkollave rurale). Përfundimisht, nga analiza e rezultateve të studimit, mbështetja e suksesit të nxënësve ndikon për një nivel më të lartë të takimeve dhe përfshirjes së familjes në shkollë. Këto rezultateve raportohen në Tabelën 74.

5.4. DISKUTIME PËR BESIMIN E FAMILJES TE SHKOLLA DHE ANASJELLASMEQËLLIMBASHKËPUNIMINPËRPARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE

Diskutimet për pyetjen kërkimore: Cili është niveli i besimit të familjes të shkolla dhe anasjelltas dhe a ndikon ai në nivelin e takimeve shkollë-familje? Për këtë pyetje është përdorur statistika përshkruese dhe ajo korrelacionale.

Studime të ndryshme dëshmojnë mbi ndërlidhjen e këtij faktori - besimit- me arritjet më të larta tek nxënësit, komunikimin më të drejtë shkollë-familje. Ndërsa, gjetjet e studimit tonë tregojnë domethënien e këtij faktori për familjen për një përfshirje më të lartë të saj në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

Gjatë shqyrtimit të literaturës, duke parë rëndësinë që paraqet besimi në përfshirjen dhe bashkëpunimin e suksesshëm mes shkollës dhe familjes, besimi i familjes te shkolla del se është një armë shumë e rëndësishme në duart e shkollës. Në familjet e të dyja mjedisëve, besimi i familjes te shkolla është i nivelit të lartë. Përputhje hasim tek perceptimet e mësuesve të mjedisit rural për besimin e tyre te familja, por kjo nuk manifestohet edhe tek mësuesit e mjedisit urban.

83.2% e të gjithë kampionit të marrë nga *Familja e mjedisit urban* deklarojë se besimi i tyre te shkolla është i nivelit “të lartë”. 12.8% e familjes e percepton “te mesëm” nivelin e besimit të tyre te shkolla, ndërkohë që nuk kemi asnjë familje e cila e konsideron atë të nivelit të ulët. Bazuar në këto analiza, konstatojmë se familja e mjedisit urban e percepton të lartë besimin e saj te shkolla.

Niveli i besimit të *mësuesve të mjedisit urban* te familja dhe puna e saj për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve paraqitet të jetë i ulët. 87% e mësuesve të mjedisit urban e perceptojnë “të ulët” besimin e tyre ndaj familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. 21% “te mesëm”, nga gjithsej 298 të anketuar.

Familja e mjedisit urban ka besim te shkolla dhe puna e saj për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, ndërsa shkolla e të njëjtit mjedis nuk paraqitet të ketë besim te familja për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Arsyeja e këtij dallimi në perceptime midis palëve mund të jetë e ndryshme. Supozojmë se familja ka besim në profesionalizmin e shkollës, ndërsa shkolla është skeptike për familjen dhe punën e saj për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Besimi i shkollës te familja sipas perceptimeve të *mësuesve të mjedisit rural* gjejmë se është: nga 397 mësues gjithsej, 91.3% e tyre e perceptojnë “të lartë” besimin e tyre te familja, 5.5% “te mesëm” dhe 1.95 “të ulët”. Këto gjetje paraqiten në Tabelën 45. Ndërsa Tabela nr. 34 tregon se të gjitha *familjet e mjedisit rural* të anketuara, gjithsej 400, shprehin perceptimin se besimi i tyre te shkolla është i nivelit “të lartë”, thënë ndryshe 99.3% e tyre.

Tek mjedisi rural kemi dallime të theksuara në gjetje lidhur me faktorin besim. Familja e mjedisit rural del të ketë besim te shkolla dhe puna e saj për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. I të njëjtit nivel është edhe besimi i shkollës te familja.

Siç shihet, dallimi në gjetjet e studimit lidhur me besimin qëndron tek shkolla e mjedisit urban, e cila nuk shpreh besim te familja për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Në diskutimin e përmbledhur për mesataren dhe devijimin standard në pohimet e kategorive të besimit të familjes tek shkolla dhe anasjelltas, tek familja dhe shkolla e mjedisit urban dhe atij rural del se përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së besimit të familjes te shkolla sipas *familjes së mjedisit urban*, besimi te shkolla është: 2.8671 (DS=.34003), minimumi është 2 dhe maksimumi 3. Ndërsa tek *mësuesit e mjedisit urban*, përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së besimit të shkollës te familja, mesatarja e përgjigjeve të pohimeve është 2.384 dhe (DS=.2226) me minimumin 1 dhe maksimumin 3. Për sa u përket diferencave midis përgjigjeve për besimin e familjes te shkolla dhe anasjelltas sipas qëndrimeve të familjes urbane dhe perceptimeve

të mësuesve të të njëjtit mjedis, nuk rezultojnë të ketë diferenca të rëndësishme nga pikëpamja statistikore.

Ndërsa tek *familja e mjedisit rural* përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së besimit të familjes të shkolla, mesatarja e përgjigjeve të pohimeve është 1.4924 dhe (DS=.24839) me minimumin 1 dhe maksimumin 3, ndërsa tek *mësuesit e të njëjtit mjedis* përgjigja mesatare e përgjigjeve të pohimeve është 2.8586 (DS. 52532) me minimumin 7 dhe maksimumin 23. Në analizat përshkruese nuk rezultojnë diferenca statistikore si ndërmjet familjes dhe shkollës urbane ashtu edhe familjes dhe shkollës rurale.

Ndërsa çështja jonë studimore, nëse ekziston një marrëdhënie mes besimit dhe nivelit të takimeve shkollë-familje, është e ndarë mes familjes dhe mësuesve të të dyja mjediseve.

Sipas perceptimit të familjes së mjedisit urban dhe rural konstatojmë se besimi ndikon në përfshirjen e tyre në shkollë. Për mësuesit e të dyja mjediseve besimi tek familja nuk ndikon në nivelin e takimeve të tyre me familjen.

Tek familja e mjedisit urban, ndërlidhja e besimit me nivelin e takimeve është e nivelit të ulët, por statistikisht e rëndësishme ($r = .125$, $p < 0.01$). Tek familja rurale kemi ($r = .127$, $p < 0.11$).

Për mësuesit e të dyja mjediseve del se besimi tek familja nuk ndikon tek niveli i takimeve. Tek mësuesit e mjedisit urban ($r = .070$, $p = .230$) dhe tek mësuesit e mjedisit rural ($r = .096$, $p = .055$). Këto të dhëna pasqyrohen në Tabelën 74.

Rrjedhimisht, nga familjet dhe shkollat e studiuara në të dyja mjediset arrihet në konkluzionin se familja ka besim të shkolla dhe puna e saj për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Shkolla, me përjashtim të asaj urbane, gjithashtu ka besim të familja. Por, analiza korrelacionale na bën të kuptojmë se besimi i familjes tek shkolla dhe anasjelltas nuk ka ndikim të përfshirja e familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Nuk kemi marrëdhënie mes këtyre dy variablave as tek familja e as tek shkolla.

Arsyet mund të jenë të ndryshme. Matja e çështjeve morale konsiderohet shumë e vështirë.

Nga rezultatet e studimit del se faktorin besim mund ta shfrytëzojmë për të siguruar një përfshirje më të lartë të familjes në shkollë me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet shkollës Sigurisht që mungesa e besimit do ndikojë në të kundërt në mosnxitjen e familjes për një përfshirje/bashkëpunim më të lartë me shkollën.

5.5. DISKUTIME PËR KOMUNIKIMIN E SHKOLLËS ME FAMILJEN - FAKTOR PËR PËRFSHIRJEN DHE BASHKËPUNIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Diskutime për pyetjen: Cili është niveli i komunikimit të shkollës me familjen dhe a ekziston një marrëdhënie mes këtij faktori dhe nivelit të përfshirjes së familjes në shkollë? Për të marrë përgjigje për këtë pyetje është përdorur statistika përshkruese dhe ajo korrelacionale.

Perceptimin se komunikimi i shkollës në drejtim të familjes është i nivelit të mesëm dhe të lartë e gjejmë si tek familja ashtu dhe tek shkolla e të dyja mjediseve.

Perceptimet e *familjes urbane* për komunikimin e shkollës në drejtim të tyre paraqiten në Tabelën 36, sipas së cilës kuptojmë se komunikimi i shkollës me familjen e mjedisit urban është e nivelit mesatar, ku 72% e familjeve shprehin një qëndrim të tillë. Ndërsa 90% e *familjeve rurale* e perceptojnë të nivelit të lartë komunikimin e shkollës me familjen.

Edhe *mësuesit e mjedisit urban* në masën 88% e perceptojnë të nivelit të lartë dhe 72% e *mësuesve të mjedisit rural* e vlerësojnë të mesëm nivelin e komunikimit të tyre me familjen.

Rezultatet e studimit konfirmojnë se komunikimi ndërmjet shkollës dhe familjes së mjedisit urban sipas familjes është i nivelit mesatar, ndërsa sipas perceptimeve të mësuesve është i nivelit të lartë.

E kundërta ndodh tek familja rurale. Familja e percepton të nivelit të lartë komunikimin e shkollës me të, ndërsa shkolla e percepton atë si të ulët.

Përfundimisht, komunikimi i shkollës në drejtim të familjes, me qëllim bashkëpunimim, del të jetë në nivel mestar. Analizat e variablave na shpjen në konstatimin se shkolla jonë përpiqet ta bëjë sa më të lehtë komunikimin me familjen dhe komunikon me të në mënyra të shumëllojshme si: takime e prindër, e-maile, website, takime individuale, se ajo komunikon me familjen në intervale të rregullta dhe familja mund të kontaktojë me atë sa herë që e shih të nevojshme dhe të arsyeshme. Komunikimi i shkollës në drejtim të familjes perceptohet si i drejtë nga ana e familjes. Ne shpresojmë të jetë proaktiv.

Megjithatë, bazuar në rezultatet e studimit cilësor, komunikimi i mësuesve del të jetë edhe një ndër faktorët që stimulojnë dhunë ndërmjet nxënësve, sipas perceptimeve të familjes, e cila e potencon atë si një nga arsyet e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Edhe vëzhgimet tona në shkolla gjatë periudhës së studimit nuk gjetën komunikimin e pritur ndërmjet nxënësve dhe mësuesve. Supozojmë se komunikimi ndikon të dhuna ndërmjet nxënësve në shkollë edhe pse ndoshta jo me efekte të menjëhershme.

Në diskutimin e përmbledhur për mesataren dhe devijimin standard në pohimet e kategorive të komunikimit ndërmjet shkollës dhe familjes tek familja dhe shkolla e mjedisit urban dhe atij rural, kuptojmë se përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së komunikimit sipas *familjes së mjedisit urban* të shkollës është: 2.89 (DS=.302). Ndërsa tek *mësuesit e mjedisit urban* përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së komunikimit, mesatarja për përgjigjet e pohimeve është 2.879 dhe (DS=.33661) me minimumin 1 dhe maksimumin 3. Për sa u përket diferencave midis përgjigjeve për komunikimin sipas qëndrimeve të familjes urbane dhe perceptimeve të mësuesve të të njëjtit mjedis nuk rezulton të ketë diferencë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore.

Ndërsa tek familja e mjedisit rural, përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së informimit/komunikimit shkollë-familje, mesatarja e përgjigjeve të pohimeve tek *familja rurale* është 2.90 dhe (DS=.292) me minimumin 1 dhe maksimumin 3, ndërsa tek *mësuesit e të njëjtit mjedis* përgjigja mesatare për përgjigjet e pohimeve të komunikimit është 2.227 (DS. 4702) me minimumin 1 dhe maksimumin 3. Nuk

rezulton të ketë diferenca statistikore në analizat përshkruese si ndërmjet familjes dhe shkollës urbane ashtu edhe familjes dhe shkollës rurale.

Analiza e variablave të komunikimit të shkollës me familjen dhe nivelit të takimeve shkollë- familje tregon ndikimin që ka komunikimi mbi nivelin e takimeve shkollë- familje. Këto rezultate paraqiten në Tabelën 74. Rezultatet tregojnë se kjo marrëdhënie tek familja e mjedisit urban është ($r=.189$, $p<0.01$), tek familja rurale ($r=.126$, $p<0.01$). Tek mësuesit e mjedisit urban marrëdhënia e komunikimit dhe nivelit të takimeve shkollë- familje është ($r=.891$, $p<0.01$), ndërsa tek mësuesit e mjedisit rural ($r=.016$, $p<0.01$).

Komunikimi i drejtë i shkollës me familjen ndikon mbi përfshirjen dhe bashkëpunimin më të lartë të familjes me shkollën për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Rezultatet sugjerojnë shfrytëzimin e këtij faktori si një mundësi të mirë për përfshirjen e familjes në shkollë me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

5.6. DISKUTIME PËR INFORMIMIN E FAMILJES NGA SHKOLLA NË DREJTIM TË PARANDALIMIT TË DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Studimi ynë është fokusuar edhe në njohjen e faktorit të informimit të familjes nga shkolla në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve dhe, identifikon disa çështje të rëndësishme në këtë drejtim.

Duke pasur parasysh gjetjet e studimit cilësor, niveli i informimit të familjes nga shkolla është i pamjaftueshëm, madje i ulët. Familja nuk merr informacion nga shkolla për dhunën ndërmjet nxënësve, si dhe çfarë e karakterizon atë; cilat janë pasojat e saj; mundësitë e parandalimit; strategjitë për veprim të përbashkët, etj. Sipas gjetjeve të studimit, nuk kemi ndërveprim mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Pa ndërveprimin e të gjithë faktorëve edukativë, e në veçanti të shkollës dhe familjes, nuk mund të kemi parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve.

Në funksion të njohjes së faktit se ku fokusohet informimi i shkollës, intervistat pasqyrojnë se informimi i shkollës në drejtim të familjes ngelet në nivelin e informimit që lidhet vetëm me suksesin e nxënësve dhe disiplinën, por pa shkuar më tej. Gjejmë se shkolla nuk bart informacione për dhunën ndërmjet nxënësve në mënyrë të planifikuar. Diskutohet formalisht vetëm gjatë takimeve me prindërit pa qasje profesionale në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

Bazuar në gjetjet e intervistave, familja është shumë e prerë, duke u shprehur se nuk ka informim të mjaftueshëm nga shkolla për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve, dhe në radhë të parë për çdo shqetësim të shkollës në këtë drejtim. Nga familjet e intervistuar, 77% shprehin një shqetësim të tillë. Nga ana tjetër, tek mësuesit gjejmë perceptimin se ata ia ofrojnë familjes informacionin e mjaftueshëm në këtë drejtim.

Nga mësuesit e intervistuar, vetëm njëri prej tyre, shprehur në përqindje vetëm 2% u shpreh se shkolla nuk e informon familjen lidhur me dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë. Ndërsa 0% e drejtorëve të shkollave konsiderojnë se nuk japin informacion në drejtim të parandalimit të dhunës tek familja, qëndrim i cili nuk ofron fakte bindëse.

Analizat e gjetjeve sasiore pasqyrojnë nivelin të ulët të informimit të familjes nga shkolla. 62% e familjeve japin një perceptim të tillë. Tek *familja urbane*, niveli i informimit të tyre nga shkolla është i ulët. 30% e familjeve e perceptojnë informimin e shkollës në drejtim të saj të nivelit të mesëm. Nga 300 të anketuar gjithsej, vetëm 3.2% e tyre e perceptojnë informimin e shkollës në drejtim të familjes në nivelin të lartë.

Edhe sipas *mësuesve të mjedisit urban* informimi i familjes dhe shkollës është i “nivelit mesatar” sipas 64% të mësuesve të këtij mjedisi, ndërsa 22% e perceptojnë të nivelit “të lartë” informimin e tyre në drejtim të familjes. Në gjetjet e studimit për këtë faktor kemi qëndrim të njëjtë lidhur me informimin e shkollës në drejtim të familjes, pasi ai përcaktohet të mos jetë në nivelin e duhur/të lartë. Dallimi qëndron në faktin se shkolla shprehet se ai është në nivel të mesëm, ndërsa familja e mjedisit urban e percepton atë në nivel të ulët.

Sipas të dhënave të Tabelës 48, nga 393 *familje të anketua të mjedisit rural*, 36% e tyre e konsiderojnë “të ulët” nivelin e informimit të shkollës drejt tyre, ndërsa 34% të nivelit “të mesëm”. Qëndrimet e familjes së mjedisit rural për informimin e shkollës në drejtim të tyre nuk kanë dallime të theksuar në nivele. Informimi i familjes rurale nga shkolla e mjedisit rural sipas familjes së këtij mjedisi del të jetë ndërmjet nivelit të mesëm dhe atij të ulët.

Mësuesit e të njëjtit mjedis vlerësojnë të nivelit të mesëm informimin në drejtim të familjes. Nga 315 të anketuar, 117 ose (17.9%) prej tyre e perceptojnë të nivelit “të mesëm” informimin e tyre drejt familjes, 193 shprehin qëndrimin se ai është i nivelit të lartë dhe vetëm 5 nga mësuesit shprehen se ai është i nivelit të ulët. Sipas mësuesve të mjedisit rural, informimi i shkollës drejt familjes është i nivelit të lartë – ata e informojnë mjaftueshëm familjen.

Këtu kemi mospërputhshmëri të perceptimeve. Sipas gjetjeve të studimit, familja e të dyja mjedise shprehet se shkolla nuk e informon atë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Përderisa mësuesit e perceptojnë ndryshe këtë çështje, sipas tyre familja merr informacion të mjaftueshëm nga shkolla mbi çështjet që kanë të bëjnë me familjen dhe nxënësit.

Në diskutimin e përmbledhur për mesataren dhe devijimin standard në pohimet e kategorive të informimit të familjes nga shkolla, tek familja dhe shkolla e mjedisit urban dhe atij rural kuptojmë se përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së informimit të familjes nga shkolla sipas *familjes së mjedisit urban* të shkollës është: 2.6294 (DS=.5516), minimumi është 1 dhe maksimumi 3. Ndërsa tek *mësuesit e mjedisit urban*, përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së informimit të shkollës drejt familjes, mesatarja e përgjigjeve të pohimeve është 2.0973 dhe (DS=.58654) me minimumin 1 dhe maksimumin 3. Për sa u përket diferencave midis përgjigjeve për informimin e familjes nga shkolla dhe anasjelltas sipas qëndrimeve të familjes urbane dhe perceptimeve të mësuesve të të njëjtit mjedis, rezulton të ketë diferenca të rëndësishme nga pikëpamja statistikore.

Ndërsa tek *familja e mjedisit rural*, përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së informimit të familjes nga shkolla, mesatarja e përgjigjeve të pohimeve është 2.0178 dhe (DS=.84647) me minimumin 1 dhe maksimumin 3, ndërsa tek *mësuesit e të njëjtit mjedis* përgjigja mesatare për përgjigjet e pohimeve është 2.5968 (DS. 52272) me minimumin 1 dhe maksimumin 23. Rezulton se ka diferenca statistikore në analizat përshkruese, si ndërmjet familjes dhe shkollës urbane ashtu edhe familjes dhe shkollës rurale. Rezultate këto që pasqyrohen në Tabelat: 48 dhe 51.

Nga ana tjetër, analiza korrelacionale pasqyron ndikimin e informimit në përfshirjen/nivelin e takimeve mes shkollës dhe familjes. Tek familja e mjedisit urban kemi nivel të ulët të marrëdhënies së informimit me nivelin e takimeve me shkollën por statistiki është të rëndësishme. Gjithashtu edhe tek familja e mjedisit rural, marrëdhënia ndërmjet informimit dhe nivelit të përfshirjes së familjes në shkollë del të jetë statistiki është e rëndësishme ($r=.336$, $p < 0.01$), tek mësuesit e të njëjtit mjedis kjo marrëdhënie është me rëndësi statistikore edhe pse e ulët ($r=.133$, $p < 0.01$). Sipas gjetjeve tek familja rurale, marrëdhënia e informimit dhe nivelit të takimeve të saj me shkollën është një faktor me ndikim në përfshirjen e saj në shkollë ($r=.249$, $p < 0.01$), tek mësuesit e mjedisit rural ($r=.152$, $p < 0.01$). Këto rezultate pasqyrohen në Tabelën 74.

Nga rezultatet e studimit mund të konfirmojmë se informimi i familjes nga shkolla ndikon në përfshirjen dhe bashkëpunimin e familjes me shkollën. Si konkluzion informimi ndikon në nivelin e takimeve shkollë-familje. Informimi i mjaftueshëm i familjes nga shkolla mund ta nxisë përfshirjen e familjes në shkollë apo mund ta pengojë atë përfshirje për bashkëpunim në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

5.7. DISKUTIME PËR NDARJEN E DETYRAVE NDËRMJET SHKOLLËS DHE FAMILJES PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Rezultatet tregojnë se ndarja e detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet shkollës dhe familjes tek ne është e nivelit të ulët. Analiza e variablave të këtij faktori zbulon se sipas qëndrimeve të *familjes së mjedisit urban*, nga 298 familje të përfshira në studim, 115 (38.6%) perceptojnë se ndarja e detyrave mes tyre dhe shkollës është e nivelit "të ulët". Gjejmë se 111 (37.2%) familje nga shkollat e mjedisit urban e perceptojnë të nivelit "të mesëm" ndarjen e detyrave mes tyre dhe shkollës, dhe vetëm 72 prej tyre të nivelit "të lartë". Ndërsa 256 (65.0%) e *familjeve të mjedisit rural*, ndarjen e detyrave mes tyre dhe shkollës e perceptojnë "të ulët", 19.8% e perceptojnë "të mesëm" dhe 15.2% "të ulët". Këto gjetje të studimit paraqiten në tabelën 60.

Ndërsa perceptimet e *mësuesve të mjedisit urban* për ndarjen e detyrave ndërmjet saj dhe familjes paraqiten në tabelën 58 dhe përmes saj na bëhet e ditur se mësuesit e mjedisit urban e perceptojnë "të lartë" ndarjen e detyrave mes saj dhe shkollës. Nga gjithsej 300 mësues, 72% prej tyre e perceptojnë të tillë, 21% shprehin qëndrimin se ajo është e nivelit "të mesëm" dhe vetëm 2% e perceptojnë "të lartë" ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive shkollë-familje.

Sipas qëndrimeve të *mësuesve të mjedisit rural*, ndarja e detyrave mes tyre dhe familjes është e nivelit “të ulët”. Sipas 262 mësuesve të anketuar, 19% e perceptojnë atë “të mesëm” dhe 15% “të ulët”. Këto të dhëna paraqiten në tabelën 62.

Nga këto gjetje të studimit kuptojmë se ndarja e detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet familjes dhe shkollës për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë është e nivelit të ulët. Ndryshim përbëjnë vetëm mësuesit e mjedisit urban të cilët e paraqesin të nivelit të lartë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive mes tyre në drejtim parandalimit të dhunës.

Në diskutimin e përmbledhur për mesataren dhe devijimin standard në pohimet e kategorive së ndarjes, tek familja dhe shkolla e mjedisit urban dhe atij rural kuptojmë se përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes sipas *familjes së mjedisit urban* me shkollën është: 2.73 (DS=.494), minimumi 1 dhe maksimumi 3. Ndërsa tek *mësuesit e mjedisit urban*, përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes, mesatarja në përgjigjet e pohimeve është 1.8557 dhe (DS=.78022), me minimumin 1 dhe maksimumin 3. Për sa u përket diferencave midis përgjigjeve për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes sipas qëndrimeve të familjes urbane dhe perceptimeve të mësuesve të të njëjtit mjedis, rezulton të ketë diferenca të rëndësishme nga pikëpamja statistikore.

Ndërsa tek *familja e mjedisit rural*, përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes, mesatarja e përgjigjeve të pohimeve është 1.502 dhe (DS=.74564), me minimum 1 dhe maksimum 3. Ndërsa tek *mësuesit e të njëjtit mjedis*, përgjigja mesatare për përgjigjet e pohimeve është 6.2020 (DS. 224306) me minimumin 2 dhe maksimumin 11. Rezulton se ka diferenca statistikore në analizat përshkruese si ndërmjet familjes dhe shkollës urbane ashtu edhe familjes dhe shkollës rurale. Këto rezultate pasqyrohen përmes tabelave: 61 dhe 63.

Analiza e variablave ndërmjet ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiive mes shkollës dhe familjes tregon ndikimin që ka ky faktor mbi nivelin e përfshirjes dhe bashkëpunimit të familjes dhe shkollës në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Koeficientet e korrelacionit tregojnë se ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes sipas familjes urbane ndikojnë në nivelin e përfshirjes së familjes në shkollë, dhe ky ndikim ka një shkallë të lartë besueshmërie ($r=.184$, $p < 0.01$). Edhe sipas mësuesve të të njëjtit mjedis, ndarja e detyrave ndërmjet familjes dhe shkollës ndikon mbi nivelin e takimeve që do ketë familja me shkollën për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë ($r=.246$, $p < 0.01$). Edhe tek familja e mjedisit rural gjejmë se ky faktor ndikon mbi nivelin e takimeve shkollë-familje për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Gjetjet janë: ($r=.467$, $p < 0.01$), besueshmëri kjo e lartë statistikore. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes edhe tek mësuesit e mjedisit rural duket se korrelohet me një shkallë të lartë besueshmërie ($r=.194$, $p < 0.01$). Këto gjetje të studimit paraqiten në tabelën 74.

Edhe nga analiza e intervistave me familjet, mësuesit dhe drejtorët e shkollave kuptojmë se ndarja e detyrave mes shkollës dhe familjes nuk zë vendin e duhur në shkollë në fushën e bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe familjes, përkundër ndikimit të tij në përfshirjen e familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Ky fakt kuptohet edhe nga analiza e pyetësorëve. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes në shkollën tonë është e nivelit të ulët. Nga ana tjetër, studimi tregon ndikimin që ka ky faktor mbi nivelin e përfshirjes së familjes në shkollë për përfshirjen e familjes në shkollë me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Rezultatet e studimit tonë sugjerojnë vëmendje lidhur me këtë faktor.

5.8. DISKUTIME PËR VENDIMMARRJEN E FAMILJES NË SHKOLLË PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË

Një ndër pyetjet kërkimore ishte dhe: A është familja vendimmarrëse në shkollë dhe cila është marrëdhënia mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën?

Nga të dhënat e tabelës 64 konstatohet se *familja e mjedisit urban* e percepton të ulët nivelin e vendimmarrjes së saj në shkollë. Nga 298 familje të anketuara, 52% (155) të anketuar e vlerësojnë të nivelit “të ulët” vendimmarrjen e tyre në shkollë, ndërsa 48% (148) të anketuar e perceptojnë atë të nivelit “të mesëm”.

Tek *familja e mjedisit rural*, nga 394 familjarë të anketuar, 35.5% e familjeve të anketuara u janë përgjigjur pohimeve lidhur me vendimmarrjen e familjes në shkollë. Nga këta të anketuar, 64% prej tyre nuk kanë ofruar përgjigje për vendimmarrjen e tyre në shkollë. Nga përgjigjet në dispozicion konstatohet se 21% prej tyre e vlerësojnë të nivelit “të lartë” vendimmarrjen e tyre në shkollë dhe 13% “të ulët”. Perceptimi i familjes së mjedisit rural del i kundërt me atë të mjedisit urban për sa i përket vendimmarrjes së familjes në shkollë.

Sipas qëndrimeve të *mësuesve të mjedisit urban*, 68% e tyre shprehin se vendimmarrja e familjes në shkollë është e nivelit “të lartë”. 31% e perceptojnë atë të nivelit “të mesëm”, ndërkohë që nga sa duket nuk kemi mësues të cilët e vlerësojnë si të ulët vendimmarrjen e familjes në shkollë.

Edhe tek *mësuesit e mjedisit rural*, 36% e mësuesve nuk kanë shprehur qëndrim për vendimmarrjen e familjes në shkollë. Nga qëndrimet e 258 mësuesve, nga 400 gjithsej, 54% prej tyre e perceptojnë të jetë e nivelit “të mesëm” vendimmarrjen e familjes në shkollë dhe vetëm 9% e tyre shprehin se ajo është e lartë. Këto rezultate paraqiten në tabelën 71.

Bazuar në rezultatet e lartpërmendura del se vendimmarrja e familjes në shkollën e mjedisit urban është e nivelit të ulët sipas familjes, ndërsa sipas perceptimeve të shkollës ajo është e nivelit të lartë. Lidhur me këtë çështje rezulton se nuk kemi përputhshmëri të rezultateve ndërmjet mësuesve dhe familjes. Kjo çështje kërkon një trajtim dhe vëmendje të veçantë. Si studiuese supozojmë se nuk kemi njohje të këtij faktori nga shkolla.

Ndërsa tek mjedisi rural, si nga ana e mësuesve ashtu dhe nga ana e familjes, kemi refuzim të përgjigjes në përqindje të theksuar nga të anketuarit në studim. Nga gjetjet në dispozicion del se familja e percepton të nivelit të lartë vendimmarrjen e saj në shkollë, ndërsa mësuesit e perceptojnë të nivelit të mesëm vendimmarrjen e familjes në shkollë.

Në diskutimin e përmbledhur për mesataren dhe devijimin standard nga pohimet e kategorive mbi vendimmarrjen e familjes në shkollë, tek familja dhe shkolla e mjedisit urban dhe atij rural, kuptojmë se përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së vendimmarrjes sipas *familjes së mjedisit urban* në shkollën është: 5.2273 (DS=2.5739), me minimumin 2 dhe maksimumin 10. Ndërsa tek *mësuesit e mjedisit urban*, përgjigja mesatare për pohimet e vendimmarrjes, mesatarja nga përgjigjet e pohimeve është .3154 dhe (DS=.46547), me minimumin 1 dhe maksimumin 3. Për sa u përket diferencave midis përgjigjeve për vendimmarrjen sipas qëndrimeve të familjes urbane dhe perceptimeve të mësuesve të të njëjtit mjedis, nuk rezulton të ketë diferenca të theksuara dhe të rëndësishme nga pikëpamja statistikore. Të dhënat sipas tabelave 65 dhe 70.

Ndërsa tek *familja e mjedisit rural*, përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së vendimmarrjes së familjes në shkollë, mesatarja e përgjigjeve të pohimeve tek familja rurale është 3.5888 dhe (DS=1.90312) me minimumin 2 dhe maksimumin 10, ndërsa tek *mësuesit e të njëjtit mjedis*, përgjigja mesatare për përgjigjet e pohimeve të vendimmarrjes është 3.965 (DS=2.27024) me minimumin 2 dhe maksimumin 23. Nuk rezulton të ketë diferenca statistikore përmes analizave përshkruese si ndërmjet familjes dhe shkollës urbane ashtu edhe familjes dhe shkollës rurale.

Nëse familja ndihet jo vendimmarrëse, atëherë synuam të kuptojmë nëse kjo reflektohet edhe në nivelin e takimeve ndërmjet saj dhe shkollës. Rezultatet e studimit tregojnë se vendimmarrja e familjes në shkollë dhe niveli i takimeve ndërmjet shkollës dhe familjes në mjedisin urban sipas qëndrimeve të familjes janë ndryshore të cilat korrelojnë pozitivisht ($r=.323$, $p < 0.01$). Sipas qëndrimeve të familjes së mjedisit rural, kemi ($r=.249$, $p < 0.01$) që do të thotë se marrëdhënia nuk është e fortë por statistikisht e rëndësishme. Niveli i takimeve ndërmjet shkollës dhe familjes ndikohet nga vendimmarrja e familjes në shkollë. Vendimmarrja e familjes në shkollë është ndikuese mbi nivelin e takimeve ndërmjet shkollës dhe familjes edhe sipas mësuesve të mjedisit urban ($r=.447$, $p < 0.01$). Tek mësuesit e mjedisit rural kemi ($r=.250$, $p < 0.01$), që do të thotë se vendimmarrja ndikon mbi nivelin e takimeve shkollë-familje, sipas gjetjeve të pasqyruara në Tabelën 74.

Nga studimi ynë del se vendimmarrja e familjes në shkollë është faktor domethënës/ndikues në përfshirjen dhe takimet që do ketë shkolla me familjen. Nga ana tjetër, të dhënat përshkruese na japin të kuptojmë se shkolla jonë nuk qëndron mirë në përmbushjen e këtij faktori, pavarësisht ndikimit të fortë mbi përfshirjen e familjes në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

5.9 DISKUTIME PËR PËRVOJËN E FAMILJES ME SHKOLLËN - FAKTOR NË BASHKËPUNIMIN PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NDËRMJET NXËNËSVE NË SHKOLLË.

Studimi synoi të gjejë përgjigje dhe për pyetjen: Cila ishte përvoja e familjes me shkollën dhe cila është aktualisht marrëdhënia mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën? Përgjigje kjo e marrë nga statistika përshkruese dhe korrelacionale.

Studimi gjen se 59.7% e familjeve të mjedisit urban të anketuara e konsiderojnë të nivelit "të lartë" përvojën e tyre të mëparshme me shkollën, 34.2% të mesëm dhe vetëm 2% të ulët. Del se sipas familjes së mjedisit urban përvoja e mëparshme me shkollën ishte e nivelit të lartë. Kjo pasqyrohet në Tabelën nr. 52. Përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së përvojës së familjes urbane ishte 2.6094 (DS. 53166). Këto rezultate pasqyrohen në Tabelën 53.

Analiza e variablave të përvojës me shkollën tek familja urbane dhe nivelit të saj me shkollën tregon ndikimin që ka përvoja mbi nivelin e takimeve. Koeficientet e korrelacionit tregojnë se përvoja e familjes me shkollën nuk korrelohet me nivelin e takimeve ($r = .027$ $p = .645$).

Familja rurale e percepton të lartë përvojën e saj me shkollën. Nga 394 familje të anketuara, 257 prej tyre e perceptojnë të nivelit të lartë përvojën e tyre me shkollën, 120 "të ulët" dhe vetëm 17 (4.3%) e familjeve shprehën qëndrimin se ajo është "e ulët". Këto rezultate pasqyrohen në Tabelën 75.

Në diskutimin e përmbledhur për mesataren dhe devijimin standard për pohimet e kategorive së përvojës së familjes me shkollën, tek familja e mjedisit urban kuptojmë se përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së përvojës së familjes me shkollën, sipas familjes së mjedisit urban është: 2.6094 (DS=.53166), minimumi është 1 dhe maksimumi 3. Ndërsa tek familja e mjedisit rural, përgjigja mesatare për pohimet e kategorisë së përvojës së familjes me shkollën, mesatarja e përgjigjeve të pohimeve është 2.6091 dhe (DS=.7026), me minimumin 1 dhe maksimumin 3. Nuk rezulton të ketë diferenca statistikore në analizat përshkruese si ndërmjet familjes urbane dhe asaj rurale.

Analiza korrelacionale e këtij faktori me nivelin e takimeve familje-shkollë, tek familja e mjedisit rural tregon ndërlidhjen mes përvojës së familjes me nivelin e takimeve me shkollën dhe prej saj del se ky faktor nuk ndikon mbi nivelin e takimeve ($r = .082$ $p = .105$).

Përfundimisht, familja e të dyja mjedisëve ka përvojë të nivelit të lartë me shkollën por, përvoja e mëparshme me shkollën nuk është faktor ndikues për familjen në nivelin e takimeve me shkollën me qëllim parandalim e dhunës ndërmjet nxënësve.

Si përfundim, kapitulli na mundësoi të njihemi me rezultatet e studimit mbi dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë me tërë kompleksitetin e saj. Gjetjet e studimit tregojnë se shifrat për dhunën ndërmjet nxënësve janë shqetësuese. Dhuna psikike dominon mbi atë fizike. Arsyja e parë e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë është egoja, duke vijuar me rrjetet sociale, etj.; shkolla nuk ka strategji për përfshirjen e familjes në shkollë; shkolla gjithashtu nuk ka strategji për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Studimi ynë gjen se familja është e mirëpritur në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve; shkolla mbështet fort suksesin e nxënësve në shkollë; informimi i familjes nga shkolla për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë nuk është në nivelin e duhur; ndarja e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes gjithashtu nuk është në nivelin e duhur; në këtë nivel është edhe vendimmarrja e familjes në shkollë si edhe përvoja e familjes me shkollën.

Nga ana tjetër, gjetjet e studimit zbuluan marrëdhëniet mes nivelit të takimeve të familjes me shkollën dhe faktorëve të rëndësishëm të identifikuar në këtë drejtim. Del

se faktorët më të rëndësishëm dhe më ndikues në nivelin e takimeve janë mbështetja e suksesit të nxënësve dhe mirëpritja e familjes në shkollë, duke vijuar me informimin e familjes nga shkolla, ndarjen e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes, komunikimin e shkollës me familjen, vendimmarrjen e familjes në shkollë. Nuk kemi gjetur që besimi dhe përvoja e mëparshme e familjes me shkollën të jetë ndikues në nivelin e takimeve shkollë-familje.

Bashkëpunimi shkollë-familje është karakteristikë dhe çelësi i suksesit të shkollës efikase. Ky bashkëpunim reflektohet edhe në sjelljen e nxënësve. Prandaj, synimi ynë ishte të konstatojm nivelin dhe faktorët që ndikojnë në një përfshirje më të lartë të familjes në shkollë. Supozohet se këta faktorë ndikojnë për një nivel më të lartë të përfshirjes së familjes në shkollë. Këta faktorë, për nga rëndësia që kanë, ende nuk janë të njohur sa duhet. Konsiderojmë se gjetjet dhe rekomandimet e studimit tonë do të jenë në shërbim të shkollës dhe familjes, sidomos organeve më të larta të arsimit, për rëndësinë e këtyre faktorëve për shkollën në shërbim të përfshirjes më të lartë të familjes në shkollë, për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

7. 1. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Qëllimi i këtij kapitulli është që t'i ofrojë lexuesit një përmbledhje të shkurtër të studimit, konkluzionet bazuar në gjetjet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësim.

Çështjet e ngritura në këtë studim kanë të bëjnë me bashkëpunimin e shkollës dhe familjes, sidomos me rolin e faktorëve për përfshirje më të lartë të familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, me qëllim bashkëveprimin e tyre për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve jo duke vepruar ndaras në këtë çështje. Faktorët e rëndësishëm të identifikuar në këtë drejtim janë: Mirëpritja e familjes në shkollë, Besimi i familjes te shkolla dhe anasjellas, Komunikimi, Mbështetja e suksesit të nxënësit, Vendimmarrja e familjes në shkollë, Ndarja e detyrave shkollë-familje, Informimi dhe Përvoja e familjes me shkollën. Synimi i studimit është të vërtetojmë nivelin e këtyre faktorëve në shkollë dhe ndikimin e këtyre faktorëve në nivelin e takimeve mes shkollës dhe familjes, duke u nisur fillimisht nga njohja e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Bazuar në këtë fakt, përfundimet e këtij studimi dalin nga gjetjet e pyetjeve kërkimore, si:

- Cilat janë format e dhunës ndërmjet nxënësve? Cilat janë përmasat e saj? Cilat janë arsyet? Çfarë pasojash ka përdorimi i dhunës? Çfarë qëndrimesh mbahen ndaj dhunës? A ekzistojnë programe që merren drejtpërdrejt me parandalimin, studimin, rehabilitimin, etj?
- Cili është niveli i mirëpritjes së familjes në shkollë dhe çfarë korrelimi ka mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- Në çfarë niveli është komunikimi mes shkollës dhe familjes dhe çfarë

- korrelimi ka mes komunikimit dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- A janë dhe në çfarë niveli janë të informuar familja nga shkolla për dhunën ndërmjet nxënësve dhe çfarë korrelimi ka mes informimit dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- Cili është niveli i ndarjes së detyrave të shkollës me familjen dhe në çfarë korrelimi qëndron ajo me nivelin e takimit të familjes me shkollën;
- A është familja vendimmarrëse në shkollë dhe cila është marrëdhënia mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- Në çfarë niveli është mbështetja e suksesit të nxënësit nga shkolla dhe a ndikohet niveli i takimit të shkollës me familjen nga ky faktor;
- Në çfarë niveli është besimi i familjes te shkolla dhe çfarë korrelimi ka mes tij dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën;
- Cila ishte përvoja e familjes me shkollën dhe cila është marrëdhënia aktuale mes saj dhe nivelit të takimit të familjes me shkollën.

Siç shihet dhe nga pyetjet e studimit, përfundimi është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë do tu referohemi gjetjeve të studimit që kanë të bëjnë me dhunën ndërmjet nxënësve me tërë kompleksitetin e saj, dhe në pjesën e dytë do tu referohemi gjetjeve për faktorët e bashkëpunimit shkollë-familje, të cilët ne i konsiderojmë të domosdoshme në këtë bashkëpunim.

Rezultatet e studimit tonë tregojnë përputhje me rezultatet e studimeve të tjera të kryera tek ne. Ato tregojnë se 48% e nxënësve në shkollë kanë përjetuar dhunë qoftë *dhunë fizike a psikike ndërmjet nxënësve*, nga e cila del se dhuna psikike është më e theksuar se dhuna fizike dhe se dhuna psikike është ajo që i prin dhunës fizike. Pothuajse gjithmonë fillohet me dhunë psikike dhe kalohet në atë fizike. Ato janë në lidhje me njëra-tjetrën. Bazuar në përqindjen e lartpërmendur del se çështja është alarmante. Dhuna ndërmjet nxënësve del të jetë një fenomen i theksuar në shkollën tonë.

Për sa i përket aspektit gjinor, edhe pse ekziston perceptimi se dhuna është e theksuar dukshëm tek djemtë, në studimin tonë del se dhuna ndërmjet nxënësve nuk lidhet me gjininë. Ajo është e përhapur ndërmjet djemve po ashtu edhe ndërmjet vajzave. Në këtë aspekt kemi “barazi gjinore”. Dhuna në shkollë është shumë e përhapur edhe ndër vajzat/nxënëset. 12 mësues të intervistuar konsiderojnë madje se dhuna mes vajzave është në të njëjtën shkallë sa ajo mes nxënësve djem. Ndërsa vendi ku manifestohet më shumë dhuna ndërmjet nxënësve është ora e edukatës fizike dhe pushimi i madh.

Studimi identifikon frikën që ekziston tek nxënësit për ta raportuar dhunën sidomos tek mësuesit/shkolla. Kështu, një pjesë e denoncimeve të dhunës nuk ndodhin. Mos denoncimi nënkupton mos reagimin. Këtu paraqitet një problem tjetër, ai i heshtjes ndaj dhunës dhe mos reagimit serioz ndaj saj.

Nga intervistat me mësuesit dhe familjarët rezulton se më shumë vëmendje i kushtohet dhunës fizike e më pak asaj psikike. Shqetësimi bie mbi dhunën fizike. Këtu dhe del një çështje tjetër, ajo e mosnjohjes së pasojave të dhunës psikologjike ndërmjet nxënësve.

Studimi identifikon faktin se për familjen dhe nxënësit nuk është i qartë nocioni dhunë. Gjetjet e studimit tonë tregojnë se mungon njohja nocionit dhunë dhe formave

të tjera të sjelljes asociale të nxënësit. Edhe një numër i mësuesve nuk ishin në gjendje të përkufizonin dhunën. Disa prej tyre dhanë përgjigje shumë sipërfaqësore edhe pse ishin të sakta. Veçanërisht nuk njihet mirë dhuna psikike, përderisa dhuna përkufizohej kryesisht “ajo kur dikush të rrah”. Ndërsa njohja e nocionit dhunë është domosdoshmëri. Pse? Nëse nuk njohim nocionin dhunë atëherë nuk mund ti identifikojmë shenjat e para të dhunës. Identifikimi i tyre me kohë do të mundësonte marrjen e masave për parandalimin e saj nga shkolla dhe familja. Në të kundërtën, mos identifikimi dhe trajtimi me kohë do ta thelloj më tej atë. Pa njohjen e nocionit “dhunë” nuk mund të ketë parandalim të saj. Ndërsa përgjegjësia për parandalimin bie mbi familjen dhe shkollën, sidomos mbi këtë të fundit.

Duke u bazuar në gjetjet e këtij studimi për formën e dhunës ndërmjet nxënësve dhe njohjen e saj nga nxënësit, shkolla dhe familja, është menduar të jepen këto **rekomandime** praktike:

1. *Niveli i dhunës ndërmjet nxënësve* në shkollë del të jetë shumë shqetësues për familjen, shkollën dhe shoqërinë. Gjetjet e studimit tregojnë se 48% e nxënësve në shkollën tonë kanë përjetuar dhunë. Një gjendje e tillë me përmasa kombëtare kërkon reagim urgjent. Ajo kërkon rritjen e vëmendjes ndaj këtij problemi dhe domosdonë e kryerjes së një studimi në nivel kombëtar për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë, duke studiuar format dhe arsyet e shfaqjes së saj, në mënyrë që të hartohen programe me karakter parandalues për nxënësit, familjen dhe mësuesit.
2. Rezultatet e studimit argumentojnë *mosnjohjen e fenomenit dhunë* si nga nxënësit, e po ashtu edhe nga mësuesit dhe familja, sidomos aspektin psikik të saj. Rekomandimi tjetër i bazuar në gjetjet e studimit është se nxënësit, mësuesit dhe familja duhet të marrin informacion për nocionin “dhunë”, për format dhe pasojat e saj. Kjo kërkon ndërgjegjësimin e këtyre subjekteve për nocionin dhunë. Mos identifikimi i nocionit dhunë për ne si studiues është mjaft shqetësues duke ditur pasojat e kësaj mosnjohje. Në varësi të kësaj gjendjeje sugjerojmë se shkolla duhet të zbatojë plane, strategji, trajnime për mësuesit. Efektive do të ishte edhe përpilimi i një broshure dhe materialeve të tjera ndihmëse me informacionin e duhur për dhunën dhe pasojat e saj, të cilat duhet të jenë në dispozicion të familjes, mësuesve dhe nxënësve. I rekomandojmë shkollës organizimin e takimeve të veçanta ku të debatohet me familjen dhe ku të shkëmbehen informacione për dhunën ndërmjet nxënësve. Informimi i nxënësve të bëhet edhe përmes kurrikulës mësimore duke u edukuar me frymën e dashamirësisë dhe raportit pozitiv mes tyre.
3. Rekomandojmë gjithashtu që shkolla të hartojë një rregullore për sjelljen e nxënësit në shkollë, e cila tu vihet në dispozicion si atyre ashtu edhe familjes. Në përgjithësi, rekomandimi ynë është që ndërgjegjësimi dhe parandalimi i dhunës ndërmjet nxënësve të bëhet në mënyrë institucionale. Ndërgjegjësimi të bëhet nëpërmjet diagnostifikimit dhe trajtimit të dhunës ndërmjet nxënësve.
4. Rekomandojmë domosdonë e ndërmarrjes së fushatave sistematike në mënyrë që të arrijmë ndërgjegjësimin e nxënësve dhe familjes për pasojat e dhunës ndërmjet nxënësve e të cilat të shtrihen në fushën fizike, emocionale

dhe sidomos atë psikike. Të ndërjegjësohen për efektet e rënda të dhunës psikologjike.

Nga analiza tematike e të dhënave të pjesës cilësore të studimit, për sa i përket *arsyeve të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë*, arsyet e dhunës ndërmjet nxënësve të dala nga studimi ne i kemi ndarë në këto grupe: *arsyet që lidhen me moshën e nxënësit, klimën në shkollë, familjen dhe mungesën e strategjisë së shkollës për njohjen dhe parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve*.

Arsyet e dhunës ndërmjet nxënësve, të dala nga studimi, janë të ndryshme. Disa prej tyre janë: egoja e cila paraprin, xhelozia në përgjithësi, xhelozia për notat, dëshira për të qenë në vëmendje, rrjetet sociale, femrat/simpatitë e nxënësve. Një arsye tjetër e nxjerrë na shkolla është ajo se nxënësve më shumë iu flitet për të drejtat e më pak për detyrat e tyre. E lidhur ngushtë me këtë arsye del të jetë dhe fakti, sipas mësuesve, se nxënësve iu është dhënë liri e tepruar sidomos për shprehjen mendimeve të tyre, e cila më pas keqpërdoret.

Një arsye tjetër e identifikuar janë rrjetet sociale, sidomos facebook-u. Madje tek familja kjo është arsyeja e dytë pas egos.

Një arsye tjetër e identifikuar tek vajzat janë thashethemet, ndërsa tek djemtë vajzat/simpatitë ndaj tyre. Arsye tjetër është edhe hakmarrja për shokun, vëllain, por edhe krenaria.

Arsyeja që nxirret nga shkolla dhe familja është gjithashtu edhe vet familja, kultura e saj dhe qasja jo e drejtë në kontrollin dhe ndërmarrjen e masave reaguese ndaj problemit. 24 mësues të intervistuar konsiderojnë se arsye është dhe vet familja. Janë të rralla rastet kur nxënës nga një familje e interesuar për suksesin e nxënësit në shkollë të përjetojë dhunë me nxënës të tjerë. Kjo arsye na nxit edhe më shumë për ngritjen pedagogjike të familjes. Megjithëse në numër të vogël, por i regjistruar si arsye del të jetë dhe vet mësuesi, sipas familjes, me komunikimin e tij. Shqetësues është komunikimi i vrazhde i mësuesve, komunikimi jo i drejtë i tyre, por dhe komunikimi i ngurtësuar me nxënësin mund të bëhet një model i sjelljes së dhunshme tek nxënësit.

Një arsye del të jetë edhe ambienti në shkollë, gjegjësisht hapësira e vogël një numër të madh nxënësish. Sipas familjes del se mjedisi brenda shkollës është i pa këndshëm dhe jo shumë higjienik. Edhe ne si studiues gjatë vëzhgimit të shkollave në shumicën prej tyre hasëm një mjedis mjaft depresiv dhe jo tërheqës për nxënësit. Këto arsye identifikohen edhe nga perceptimet e familjes, nxënësve, mësuesve dhe drejtorëve të shkollave.

Një problem tjetër i identifikuar gjatë intervistave me mësues është qëndrimi që gjejmë me mësuesit se: *“nuk kemi mundësi ne si shkollë që t’i mbrojmë të gjithë nxënësit”*. Tek familja gjejmë qëndrimin edhe pse jo në formë të theksuar se: *“si mundet që shkolla ti ketë në kontroll gjithë ata fëmijë kur ne si familje nuk po mundemi”*. Këtu del edhe një arsye tjetër. Në këtë qasje shkolla si eksperte nuk mund të justifikohet. Asaj i është besuar edukimi dhe siguria e fëmijës në shkollë. Një besim i tillë arsyen e ka sidomos te profesionalizmi. Ndërsa me një qëndrim të tillë ndaj dhunës, profesionalizmi në parandalimin e saj vihet në pikëpyetje. Ndërsa përgjegjësia e shkollës për parandalimin e dhunës brenda shkollës është domosdoshmëri.

Lidhur me këtë gjejmë dhe faktin se shkolla mbikëqyret nga shërbimi policor për aktet e dhunës që ndodhin në mjediset e saj. Shtrohet pyetja, si mund ta bëjë shërbimi policor shkollën një vend të sigurt, kur një gjë të tillë nuk mund ta bëjë shkolla, e cila është e përgatitur për një gjë të tillë. A thua shërbimi policor është i përgatitur të bëjë një gjë të tillë? Sigurisht që jo! Dhuna ndërkohë duhet të parandalohet duke iu vënë përballë dhe jo duke pasur frikë prej saj. Duhet të ndodhë ndërgjegjësimi i nxënësve, familjes dhe shkollës për dhunën dhe pasojat që rrjedhin prej saj. Ajo mund të ndalohet duke bashkëpunuar shkolla me komunitetin në përgjithësi dhe sidomos me familjen. Ajo duhet ta përfshijë më shumë familjen në shkollë, përfshirje kjo e bazuar në strategji. Shkollës sonë i mungon qasja për ndërgjegjësimin e familjes dhe veçanërisht të nxënësve për pasojat e dhunës.

Një arsye tjetër e dhunës ndërmjet nxënësve del të jetë mosnjohja e nocionit dhunë nga nxënësit, familja madje edhe nga mësuesit.

Si konkluzion, arsyet janë nga të ndryshmet dhe ato më shumë kanë të bëjnë me nxënësin, duke mos injoruar në asnjë mënyrë arsyet të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me të. Në drejtim të përmirësimit të gjendjes **rekomandojmë**:

1. Lidhur me arsyet e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë del se ajo ndikohet nga *niveli i kulturës pedagogjike të familjes*. Në dobi të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve rekomandojmë ngritjen e kulturës pedagogjike të familjes. Shkolla dhe organet e tjera kompetente të punojnë në këtë drejtim. Shkolla të ketë jo vetëm vizion për një shkollë efikase, por dhe të hartojë dhe zbatojë plane, strategji, trajnime dhe aktivitete të ndryshme, sidomos politika për ngritjen e kulturës pedagogjike të familjes. Alternativat më të mira në këtë drejtim e të cilat i rekomandon literatura janë aktivitetet e ndryshme, takimet, grupet e punës të organizuara nga shkolla në bashkëpunim me familjen. Gjatë këtyre aktivitete mund të trajtohen tema të ndryshme ku familjet të mund të debatojnë dhe shkëmbejnë idetë e tyre. Aty familjet ballafaqohen me qasje të ndryshme lidhur me edukimin e fëmijëve të tyre duke evidentuar kështu të metat në procesin e parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Më pas këto takime mund të shërbejnë si informatorë shumë të rëndësishëm për familjen dhe shkollën për konfliktet ndërmjet nxënësve. Këto takime u japin nxënësve mesazhin e fuqishëm se familja po bashkëpunon me shkollën për çështje të ndryshme, përfshirë edhe parandalimin e dhunës ndërmjet tyre. Një mundësi tjetër në drejtim të ngritjes së kulturës pedagogjike të familjes është dhe ngritja e këndit të leximit dhe marrjes së informacioneve në shërbim të familjes. Në këtë drejtim, me qëllim ngritjen e kulturës pedagogjike të familjes, shkolla gjithashtu mund të organizojë veprimtari të cilat rrisin përfshirjen e familjes në shkollë. Ato mund të emërohen në mënyra të ndryshme si: “Ejani prindër!”, “Dita e familjes në shkollë”, të cilat do të bëjnë të mundur që klima në shkollë të perceptohet si më e hapur për familjen, e që në fakt bën që të jetë e tillë.
2. Një nga arsyet e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë është dhe numri i madh i nxënësve në shkollë, jo në përputhje me hapësirën e shkollës. Rekomandohet

të ndërmerren masa në këtë drejtim pasi shkolla e ka të pamundur të mbajë nën kontroll sjelljet e nxënësve dhe ndërkohë të realizojë aktivitete të ndryshme kreative shumë domethënëse edhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

3. Nga drejtuesit e shkollave kuptojmë se policia me uniformë qëndron kohë pas kohe në ambientet e shkollës, vendim ky i MASHT-it, si mjet për mbajtjen nën kontroll dhe parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. A është siguria në shkollë detyrë e policisë? Sigurisht që jo. Gjatë bisedës me fokus grupet ne kuptuam se si rezultat i një konflikti mes një nxënësi dhe mësuesit, policia reagoi duke e tërhequr mësuesin për krahu. Jemi të sigurt se prania e organeve të sigurisë në mjediset shkollore nuk është mesazh i mirë për nxënësit. Më tej, gjatë vëzhgimit në disa shkolla vumë re se ato janë të pajisura me kamera sigurie, por konsiderojmë se ato asesi nuk e zgjidhin problemin. Kamera humb intimitetin. Ajo bën që nxënësi të mos sillët “si unë”, bën që mos të jetë vetvetja, ndërsa ne sot si shkollë po synojmë vetveten. Kamera nuk ofron siguri. Sigurinë e krijon mjedisi ku vendoset kamera – shkolla. Sigurinë e sjell një shkollë me një mjedis të dashur, të punës, të vlerave, një shkollë e cila ka vizion, një shkollë e cila mbi të gjitha di si ta parandalojë dhunën.
4. Përderisa studimi ynë gjen se ka nxënës dhunues të cilët largohen për një kohë të shkurtër nga shkolla dhe kthehen përsëri atje duke shkaktuar frikë tek nxënësit e tjerë, atëherë është e domosdoshme ngritja e qendrave për rehabilitimin e tyre. Por nuk duhet të ndalemi vetëm këtu. Rekomandimi i dalë nga studimi është domosdoshmëria që shkolla të merret me rehabilitimin e nxënësve të cilët kanë qenë dhunues dhe me të dhunuarit. Ajo duhet të zbatojë programe, veprimtari të ndryshme me këta fëmijë, si me dhunuesit ashtu dhe me të dhunuarit, me qëllim rehabilitimin dhe risocializimin e tyre.
5. Rekomandohet përfshirja e shërbimit pedagogjik e psikologjik në shkollë, i cili mungon aktualisht. Mungojnë njohësit më të mirë dhe përgjegjës për çështjen e bashkëpunimit të shkollës me familjen për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Ky shërbim veç të tjerash duhet të merret me risocializimin e nxënësve të dhunshëm, pasi në të kundërt ata do vazhdojnë të mbeten personalitete problematike. Ky shërbim do të mbikëqyrë dhe identifikojë nxitësit dhunues dhe sjelljet e tyre agresive. E rëndësishme është që nxënësit të ndihen të mbikëqyrrur dhe të kontrolluar nga shkolla.
6. Për studimin tonë ishte me rëndësi edhe çështja nëse janë dhe në çfarë niveli janë të informuar nxënësit, shkolla dhe familja për pasojat e dhunës ndërmjet nxënësve. Gjejmë se mungon informimi në këtë drejtim. Atyre duket se iu mungon edhe informacioni për vet nocionin dhunë. Një pjesë e të anketuarve konsideronin se e njihnin nocionin, por gjatë intervistës doli se u mungonte

njohja e duhur dhe e thellë për dhunën. Vetë njohja e nxënësve dhe familjes me këto pasoja sigurisht që do shërbente madje dhe si element i fuqishëm dhe i domosdoshëm për parandalimin e dhunës mes nxënësve në shkollë.

Si konkluzion, mendoj se arsyet janë nga më të ndryshmet dhe se ato më shumë kanë të bëjnë me nxënësin, duke mos injoruar arsyet të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me të.

Për studimin tonë ishte me rëndësi edhe çështja nëse janë dhe në çfarë niveli janë të informuar nxënësit, shkolla dhe familja për pasojat e dhunës ndërmjet nxënësve. Gjejmë se mungon informacioni në këtë drejtim. Atyre del se iu mungon edhe informacioni për vet nocionin dhunë. Një pjesë e të anketuarve konsideronin se e njihnin nocionin, por gjatë intervistës doli se u mungonte njohja e duhur dhe e thelle, për dhunën. *Vetë njohja e nxënësve dhe familjes me këto pasoja sigurisht që do shërbente madje dhe si element i fuqishëm dhe i domosdoshëm për parandalimin e dhunës mes nxënësve në shkollë.*

Për sa u përket perceptimeve të shkollës, familjes dhe nxënësve për ***pasojat e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë***, studimi zbulon se pasojat nga dhuna e përjetuar mes nxënësve është më shumë e natyrës psikologjike, ndërsa pasojat psikologjike të dhunës ndërmjet nxënësve ngacmojnë nivelin e përgjithshëm të funksionimit emocional të nxënësve duke kultivuar sjellje të dhunshme. Për identifikimin e tyre nevojitet një studim i veçantë. Studimi ynë nuk mundi ti identifikojmë sa duhet pasojat e dhunës ndërmjet nxënësve. Ato nuk na u bënë të njohura nga nxënësit, familja dhe shkolla për ne si studiuese. Në përqindje shumë të vogël por evidente përbënte edhe tendenca për vetëvrasje. Më e theksuar ishte ideja e largimit nga shkolla. 72% e nxënësve ndihen të pasigurt në shkollë. Kjo flet për pasoja të theksuara të dhunës ndërmjet nxënësve.

Një nga çështjet e adresuara në këtë studim është edhe ***ekzistenca apo jo programeve shkollore për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë***. Studimi gjen se shkolla jonë nuk ka programe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, si programe afatshkurtra ashtu edhe programe afatgjata. Shkolla jonë gjithashtu nuk ka programe për rehabilitimin dhe risocializimin e nxënësve dhunues dhe të dhunuar. Ndërsa nëse nuk i trajtojmë drejt nxënësit ndaj të cilëve është ushtruar dhunë si edhe dhunuesit, atëherë kemi dy probleme në vazhdimësi. E para, nxënësit të cilët kanë përjetuar dhunë dhe nuk janë trajtuar do të vazhdojnë ta përjetojnë ndjenjën e frikës, tërheqjes në vetvete, humbjes së vetëbesimit e probleme të tjera të mundshme, ndërsa tek dhunuesit, nëse nuk trajtohen siç duhet, do tu forcohet tendenca për dhunë ndaj nxënësve të tjerë.

Nga kjo del se shkolla nuk e zgjidh dhunën ndërmjet nxënësve bazuar në programe të përshtatshme. Shkolla nuk posedon programe për trajtimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Zgjidhja e konflikteve bëhet në formën e marrëveshjeve mes familjes dhe shkollës. ***Ky është kazusi i parë i identifikuar në bashkëpunimin e shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.*** Dhe kazusi tjetër, ***nuk ka programe për përfshirjen efikase të familjes në shkollë për parandalimin dhe trajtimin e dhunës.*** Përfshirja e familjes në shkollë kryhet pa asnjë program apo strategji të përcaktuar.

Shkollës sonë gjithashtu i mungon qasja këshilluese dhe rehabilituese për fëmijët të cilët kanë përjetuar dhunë dhe ata të cilët kanë ushtruar dhunë tek nxënësit e tjerë.

Në studimin tonë tërheq vëmendjen edhe fakti se shkolla nuk ka organizuar trajnime, takime pune apo dhe veprimtari të tjera për stafin e shkollës lidhur me rëndësinë e përfshirjes sa më efektive të familjes në shkollë, apo edhe takime të posaçme me familjen për të diskutuar parandalimin e dhunës mes nxënësve, aq më pak të organizojë seminare, tribuna, kurse, apo mundësi të tjera së bashku me prindërit për parandalimin e dhunës mes nxënësve.

Përfundimisht, shkolla i qaset bashkëpunimit me familjen dhe në veçanti atij për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në mënyrë jo profesionale. Ajo punon pa programe të përshtatshme si për përfshirjen e familjes në shkollë ashtu dhe për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Asaj i mungon strategjia për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, edhe pse kemi studime, përgjithësisht mjaft sipërfaqësore, që raportojnë se dhuna ndërmjet nxënësve në shkollë është shqetësuese. Del se asnjë shkollë nuk ka strategji për parandalimin e dhunës. Kemi reagim të shkollës vetëm pasi ndodh dhuna. Bashkëpunon me familjen pasi ka ndodhur dhuna, por jo dhe për parandalimin e saj. Dhuna ndërmjet nxënësve në shkollë nuk trajtohet në mënyrë të drejtë dhe serioze, ndërkohë që ajo nuk trajtohet në tërë kompleksitetin e thellësinë e saj, në mungesë të planeve dhe strategjive në këtë drejtim.

Nga studimi ynë evidentohet edhe një fakt shqetësues, shkolla jonë nuk e trajton dhunën mes nxënësve përmes ekspertëve si psikologu apo punonjësi social i shkollës. Ata nuk janë pjesë e stafit të shkollës sonë. Këtu bëjnë përjashtim vetëm pesë shkolla.

Çështje e adresuar në këtë studim është edhe ***niveli i takimeve ndërmjet shkollës dhe familjes***. Studimi identifikon një përfshirje të ulët të familjes në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Përfshirja e familjes në shkollë është minimale. Del se mesatarja e frekuentimit të shkollës nga prindërit është dy herë gjatë një semestri për çështje që lidhen me suksesin e fëmijës por jo dhe për çështjen e parandalimit të dhunës.

Takimet mes shkollës dhe familjes mbesin në nivelin e raportimit të suksesit nga mësuesi, por jo dhe të informacioneve lidhur me arritjet më të mira të nxënësve, mënyrën e ndihmës së nxënësve nga familja për suksesin e nxënësit, mënyrën e parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve dhe krijimit të raporteve të shëndosha ndërmjet nxënësve. Edhe pse numri i takimeve ndërmjet shkollës dhe familjes nuk është tregues i cilësisë së bashkëpunimit, ai është shumë domethënës. Tek ne niveli i takimeve me shkollën del të jetë i ulët.

Intervistat na informojnë se madje një pjesë e familjeve me fëmijë problematikë nuk bashkëpunojnë me shkollën, edhe atëherë kur ftohen nga shkolla. Çfarë bën shkolla në këtë rast? Kjo mbetet çështje për tu studiuar.

Nga studimi ynë del se përfshirja e familjes në shkollë është një çështje mjaft e neglizhuar edhe pse njihet rëndësia e kësaj përfshirjeje për zhvillimin e fëmijës në përgjithësi e në sferën sociale të tij në veçanti.

Studimi identifikon edhe mungesën e një salle dedikuar takimeve të familjeve me mësuesin/kujdestarin e klasës. Del se një numër shumë i vogël shkollash kanë një vendtakim të caktuar. Në shumicën e shkollave takimet individuale me familjen

realizohen në korridore, në oborr apo mjedise të tjera. A mund të jenë produktive takimet në këto vendtakime? Jo. Kjo çështje kërkon zgjidhje urgjente.

Studimi ynë gjen se në shkollën tonë nuk kryhen përpjekje serioze në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve si dhe në drejtim të fuqizimit të bashkëpunimit të saj me familjen, përderisa mungon bashkëveprimi ndërmjet shkollës dhe familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve, përderisa dihet se pa trajtimin pedagogjik të këtyre dy faktorëve në veçanti dhe të gjithë faktorëve të tjerë pjesëmarrës në edukimin e nxënësit nuk mund të kemi rezultatet e dëshiruara në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

Gjetjet identifikuan se niveli i takimeve mes familjes dhe mësuesit është i ulët. Gjithashtu studimi ynë gjen se shkollës i mungojnë strategjitë për përfshirjen e familjes në të. Prandaj **rekomandohet që:**

1. Bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe familjes të jetë i planifikuar - gjetjet e studimit dëshmojnë se ai duhet bëhet në të kundërt. Të realizohet bashkëveprimi ndërmjet shkollës dhe familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Përfshirja e familjes në shkollë të bëhet në bazë të një programi bashkëpunues shkollë-familje. Nuk guxon që kjo përfshirje të jetë në baza individuale si nga mësuesit ashtu dhe familja, duke pasur kështu si rezultat përfshirjen vetëm të një pjese të familjes. Qasja e tyre në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve nuk guxon të jetë e ndarë, përderisa dihet se pa trajtimin pedagogjik të këtyre dy faktorëve në veçanti dhe të gjithë faktorëve të tjerë pjesëmarrës në edukimin e nxënësit si medieeve, komunitetit, etj nuk mund të kemi rezultat e dëshiruara. Për këtë, rekomandojmë që shkolla të hartojë plane për përfshirjen efikase të familje në shkollë në konceptimin e të cilave duhet të jetë pjesëmarrëse edhe familja.
2. Të planifikohen programe ndërgjegjësimi - tryeza dhe veprimtari të ndryshme sociale të cilat bëjnë që familja ta kuptojnë rëndësinë e përfshirjes dhe bashkëpunimit të saj me shkollën në parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve. Familja të ndiejë se shkolla po punon në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, se ajo ka besim dhe ka nevojë për ndihmë. Nëse këto programe vijnë nga shkolla, efekti i tyre do jetë shumë më i madh se sa kur kanë origjinë në media, literatura, etj, pa e injoruar rëndësinë të dytave. Nëse shkolla punon pa programe për përfshirjen e familjes në shkollë, vështirë se përfshirja mund të ndodhë, vështirë se familja do të ndihet pjesë e domosdoshme e shkollës, ose kjo do ndodhë tek një numër shumë i vogël i tyre.
3. Për ato familje të cilat nuk janë pjesë e shkollës, të cilat mësuesi i takon rrallë ose aspak, rekomandojmë që përgjegjësia të bjerë mbi shkollën, sepse asaj i takon që në bashkëpunim me organet kompetente dhe ekspertët e arsimit, të gjejë mënyra për përfshirjen e kësaj kategorie familjesh në shkollë. Për më tepër, ka shumë shanse që pikërisht fëmijët nga familje të tilla të mund të

jenë dhunues ose nxitës të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Analiza e studimit cilësor gjen se mësuesit kanë vështirësi të kontaktojnë pikërisht me familjet e nxënësve dhunues. Ato e refuzojnë ftesën e shkollës për takim.

4. Shkolla, të organizojë trajnime, takime pune dhe veprimtari të tjera edhe për stafin e shkollës në drejtim të përgatitjes së tyre për rëndësinë e përfshirjes efikase të familjes në shkollë në tërë kompleksitetin e saj. MASHT-i të organizojë programe trajnimi për mësuesit dhe drejtorët e shkollave për rëndësinë e përfshirjes së familjes në shkollë. Studimi ynë gjen mangësi në perceptimin e shkollës për bashkëpunim me familjen. Nuk mjafton vetëm vullneti dhe dëshira por të kryhet edhe përgatitja profesionale e mësuesve dhe drejtuesve të shkollës për përfshirjen dhe bashkëpunimin e tyre me familjen.
5. Rekomandimi i fundit në këtë drejtim, por ndër të parët për nga rëndësia, është përfshirja e parandalimit në kurrikulën mësimore, duke i ndërgjegjësuar kështu nxënësit për dhunën dhe pasojat e saj. Madje, ne si studiuese e konsiderojmë këtë si ndër rekomandimet me përparësi për parandalim e dhunës ndërmjet nxënësve.

Një problem i identifikuar gjatë studimit teorik të problemit tek ne del dhe fakti se janë të pakta studimet mbi dhunën ndërmjet nxënësve - ***mungesa e studimeve mbi dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë***, i cili është një kazus më vete për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Pjesa më e madhe e tyre është kryer nga OJQ të ndryshme, metodologjia e të cilave mund të mos jetë e drejtë, apo të kryera pa mbikëqyrje, etj. Faktet janë bërë pak ose aspak të njohura dhe kanë mbetur në nivelin formal ose interesin material të tyre. Neve na nevojitet një studim në nivel kombëtar. Një studim i realizuar drejt dhe i mbikëqyrur do të ofronte të dhëna të sakta dhe të duhura. Neve na mungon një studim i tillë në vendin tonë, dhe veçanërisht mbi përforcimin e bashkëpunimit shkollë-familje.

Gjatë shqyrtimit teorik të problemit, ***problem tjetër i identifikuar është dhe ai për sa i përket anës ligjore për bashkëpunimin shkollë-familje***. Legjislacioni mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nuk i parashikon në hollësi dënimet për ushtruesit e dhunës. Një e metë e madhe është se ai nuk i parashikon dispozitat për kompensim të nxënësve viktimë të dhunës. Përgjithësisht, ligjet nuk janë të specifikuar për kontekste të caktuara, ata janë në kontekst të përgjithshëm. Në të nuk janë paraparë as procedurat specifike lidhur me ankesat në rastet e dhunës ndaj nxënësve, atij i mungojnë rregullat procedurale specifike lidhur me dhunën ndërmjet nxënësve. Legjislacionit i mungon është edhe hartimi i dispozitës specifike lidhur me raportimin e çdo akti dhune ndërmjet nxënësve. Si përfundim, legjislacioni mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë nuk i trajton në mënyrë të detajuar por edhe tërësore aspektet e dhunës ndaj fëmijës në përgjithësi dhe të dhunës ndërmjet nxënësve në veçanti. Përgjithësisht, nenet e Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë duhet të fuqizojnë më shumë faktorin familje, dhe jo të shtrihen më shumë në sferën e dënimeve, ashtu siç i përshkruam brenda punimit.

Gjithashtu, studimi gjen se nxënësit, familja, por dhe mësuesit nuk e njohin qëndrimin e ligjit ndaj përdorimit të dhunës. **Rekomandojmë** që shkolla të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit për mundësinë e ndëshkimit ligjor ndaj atij që ushtron dhunë.

Përfundime për faktorët me rëndësi në përfshirjen dhe bashkëpunimin e familjes me shkollën në drejtëm të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve

Për sa u përket faktorëve për përfshirjen dhe bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, ku dhe përqendrohet studimi ynë, del në pah fakti se mirëpritja dhe mbështetja e suksesit, janë faktorët më të realizuar nga shkolla për bashkëpunimin me familjen. Gjejmë gjithashtu se ekziston në nivel të lartë besimi i familjes te shkolla, faktorë ky i rëndësishëm në bashkëpunim. Këto përfundime janë bazuar në qëndrimet e familjes dhe të shkollës. Që të dyja palët konsiderojnë se shkolla është në nivelin e duhur lidhur me këta faktorë.

Rezultatet e studimit tonë përshkruan shpesh në përfundimin lidhur me nivelin e faktorëve si: Mirëpritja e familjes në shkollë, Komunikimi i drejtë i shkollës ndaj familjes, Besimi i familjes te shkolla, Informimi i drejtë i shkollës drejt familjes, Mbështetja e suksesit të nxënësve, Ndarja e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes, Përvoja e familjes me shkollën, Vendimmarrja e familjes në shkollë, të cilat i konsiderojmë të jenë shumë domethënëse për përfshirjen më të lartë të familjes në shkollë dhe bashkëpunimin e suksesshëm për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, duke supozuar kështu se përfshirja e familjes në shkollë në mënyrë të vazhdueshme përbën çelësin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Përfundime për Mirëpritjen e familjes në shkollë, faktor me rëndësi për përfshirjen e shkollës në bashkëpunimin me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Për sa u përket perceptimeve të mësuesve dhe familjes për ***mirëpritjen e familjes në shkollë si faktor për përfshirjen dhe bashkëpunimin e shkollës dhe familjes***, analizat e rezultateve na bëjnë të kuptojmë se familja ndihet e mirëpritur në shkollë, dhe mësuesit e perceptojnë shkollën mirëpritëse për familjen në të dyja mjediset, si atë urban edhe në atë rural. Mirëpritja duket se është faktori më domethënës në nivelin e takimeve të familjes me shkollën, pas mbështetjes për sukses të nxënësve.

79% e familjeve të mjedisit urban e perceptojnë të nivelit "të lartë" mirëpritjen e tyre në shkollë, ndërsa 97% e familjeve rurale e perceptojnë të nivelit "të lartë" mirëpritjen e tyre në shkollë. 95.8% e mësuesve të mjedisit urban e konsiderojnë të nivelit "të lartë" mirëpritjen e familjes nga shkollë dhe 94% e mësuesve të mjedisit rural gjithashtu mendojnë se mirëpritja e familjes nga shkolla është e nivelit të lartë.

Për sa i përket çështjes së diferencave midis përgjigjeve për mirëpritjen e familjes në shkollë, sipas qëndrimeve të familjes rurale dhe urbane, dhe perceptimeve të mësuesve të mjedisit urban dhe rural, nuk rezulton të ketë diferenca të rëndësishme nga pikëpamja statistikore.

Një nga çështjet e tjera që adresohet në këtë studim është edhe lidhja që ekziston midis mirëprirjes dhe nivelit të takimeve shkollë-familje. Nga interpretimi i të dhënave kuptojmë se ndikimi i mirëprirjes mbi përfshirjen e familjes në shkollë ka shkallë të lartë besueshmërie statistikore dhe ndikon në përfshirjen e familjes në shkollë, ($r=.624$, $p < 0.01$ tek familja urbane), ($r=.876$, $p < 0.01$ tek mësuesit urbanë) ($r=.624$, $p < 0.01$ tek familja rurale) dhe ($r=.785$, $p < 0.01$ tek mësuesit e shkollës rurale). Gjejmë se tek të dyja mjediset, mirëpritja e familjes në shkollë dhe numri i kontakteve mes familjes dhe shkollës janë dy ndryshore të cilat kanë marrëdhënie të fortë dhe statistikiisht të rëndësishme. Këto të dhëna pasqyrohen në Tabelat: 19, 17, 20, 22.

Ndërkohë, vëzhgimi ynë në shkolla na bën ta shohim me skepticizëm rezultatin e dalë nga analiza e pyetësorëve. Në shkollë nuk hasim një sallë të posaçme për familjen dhe takimet e saj me mësuesit dhe stafin. Nuk hasim madje as ulëse për ta qoftë në korridoret apo oborret e shkollave, apo objektiva për bashkëpunim me familjen të cilat mund të paraqite dhe artistikiisht.

Si konkluzion arriam se familja ndihet e mirëpritur dhe ky fakt bën që ata të jenë më të përfshirë në shkollë për bashkëpunimin në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

Mirëpritja e familjes në shkollë duhet të nxisë përfshirjen për bashkëpunim me familjen. Supozohet se bashkëpunimi i shkollës me familjen sjell arritje më të larta akademike nga nxënësit dhe përmirësimi i sjelljes së tyre ndikon në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Bazuar në gjetjet e studimit *rekomandojmë*:

1. Rezultatet e studimit tonë tregojnë se mirëpritja e familjes në shkollë është shumë domethënëse për familjen. Gjithashtu, konstatohet se ajo rrit përfshirjen e familjes në shkollë. Atëherë, shkolla duhet ta përforcojë këtë faktor. Fillimisht dhe domosdoshmërisht të sigurohet në çdo shkollë një hapësirë e veçantë (sallë) për kryerjen e takimeve me familjet. Në këtë mënyrë e nxisim atë që të përfshihet në proces, por edhe e bindim për rëndësinë që ka ajo për shkollën. Studimi gjen se në shkollën tonë nuk është paraparë një vend i posaçëm për takime me familjen.
2. Ajo që bie në sy gjatë vëzhgimit në shkolla është fakti se në korridore nuk ekzistojnë ulëse për familjen. Rekomandojmë vendosjen e ulëseve “mirëprirëse” për familjen në korridore dhe oborre të shkollave, në shenjë mirëprirëse dhe ndjenje se ata janë pjesë e shkollës. Rekomandohet një mjedis tërheqës në shkollë. Në shkollat tona aktualisht përballësh me mjediset depresive, brenda dhe jashtë shkollës.
3. Bazuar në rezultatet e studimit në shkollë rekomandohet pajisja e bibliotekave ekzistuese të shkollës ose krijimi i një bibliotekë të veçantë brenda sallës për familjen e cila i ofron familjes literaturë për bashkëpunimin me shkollën në

drejtim të parandalimit të dhunës, por edhe për të tjera çështje me interes për nxënësit. Gjithashtu, t'u shpërndahen herë pas here familjeve materiale informative dhe udhëzuese për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Përfundime për mbështetjen e suksesit të nxënësit, faktor me rëndësi në përfshirjen e shkollës në bashkëpunimin me familjen në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Çështja tjetër e cila është marrë në konsideratë në këtë studim ka të bëjë me faktin nëse mbështetet dhe në çfarë niveli mbështetet sukcesi i nxënësve nga shkolla, si dhe a korrelojnë ky faktor me nivelin e përfshirjes së familjes në shkollë.

Analiza e të dhënave përshkruese të studimit ofron përfundime të rëndësishme për ***mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla*** si faktor ndikues për përfshirjen e familjes në shkollë. Qëndrimin e *familjes së mjedisit urban* e kuptojmë në kapitullin "Rezultatet e studimit", sipas së cilës nga 285 familje të anketuara del që 84.9% e tyre e perceptojnë të nivelit "të lartë" mbështetjen e suksesit të nxënësve nga shkolla, me përgjigje mesatare 2.999 dhe DS=. 059. Ndërsa nga 394 *familje të mjedisit rural*, 91.4% prej tyre e perceptojnë gjithashtu të nivelit "të lartë" mbështetjen e suksesit të fëmijëve të tyre nga shkolla, të dhëna këto të pasqyruara në Tabelën 26.

Gjetjet mbi mbështetjen e suksesit të nxënësve nga *mësuesit e mjedisit urban* janë ato që reflektohen në tabelën 29 në kapitullin "Rezultatet e studimit", nga e cila kuptojmë se 94% e *mësuesve të mjedisit urban* e perceptojnë të nivelit "të lartë" mbështetjen e suksesit të nxënësve nga ana e mësuesve. Ndërsa perceptimet e *mësuesve të mjedisit rural* për mbështetjen e suksesit të nxënësve nga ana e tyre, tregojnë mbështetje të lartë të suksesit të nxënësve nga shkolla. Madje, nuk kemi mësues të cili e konsideron se mbështetja e suksesit të nxënësve është në nivel të ulët. 91.4% prej tyre shprehin qëndrimin se e mbështesin lart suksesin e nxënësve në shkollë. Rrjedhimisht, gjetjet mbi mbështetjen e suksesit të nxënësve nga mësuesit në shkollën rurale pasqyrohen në tabelën 32. Studimi na bën të kuptojmë se mbështetja e suksesit të nxënësve në shkollën tonë është në nivel të lartë. Rezultate këto bindëse në mjedisin urban dhe atë rural, si nga familja ashtu dhe shkolla.

Ndikimi i mbështetjes së suksesit të nxënësve mbi nivelin e përfshirjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve nga ana statistikore është verifikuar me korrelacionin (Pearson), dhe konstatohet se ky ndikim ka një shkallë të lartë të besueshmërisë statistikore. marrëdhënie domethënëse tek familja dhe shkolla, gjetjet janë: ($r = .889$, $p < 0.01$ tek familja urbane), ($r = .568$, $p < 0.01$ tek familja rurale) dhe ($r = .793$, $p < 0.01$ tek mësuesit e shkollës rurale). Nga analiza e rezultateve të studimit, përfundimisht, mbështetja e suksesit të nxënësve ndikon mbi një nivel më të lartë të takimeve dhe përfshirjes së familjes në shkollë. Këto rezultate raportohen në tabelat: 28, 28, 31, 34.

Ky faktor duket se bën që familja të ketë më shumë kontakte në shkollën dhe se këto takime reflektojnë edhe në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Supozohet se takimet për suksesin e nxënësve të suksesshëm mund të shfrytëzohen për

mbajtjen e një kontakti të vazhdueshëm me familjen me shkëmbim informacioni për raportin e tij me moshatarët dhe konfliktet e mundshme.

Rezultatet e studimit vërtetojnë se mbështetja e suksesit të nxënësve ka rol të rëndësishëm në përfshirjen e familjes në shkollë. Ky faktor përbën një mundësi të mirë për bashkëpunimin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Prandaj **rekomandojmë** që:

1. Shkolla të njoftojë familjen për suksesin e nxënësit, jo vetëm në fund të semestrit dhe në dy takimet me prindër, por mësuesi të informojë edhe për çdo ndryshim lidhur me suksesin e nxënësit dhe ta mbajë familjen të mirinformuar në vazhdimësi. Kështu bëjmë që familja të kuptojë se shkolla e ka përfshirë atë në shkollë. Këto raportime të cilat shkolla i transmeton tek familja me shkrim, sa herë që paraqitet nevoja, duhet të përshkruajë edhe sjelljen e nxënësit. Të mos neglizhohet asnjë sjellje jo e mirë e nxënësit, dhe raportimi për suksesin të shoqërohet me raportim edhe për disiplinën dhe sjelljen e nxënësit në shkollë. Informim nuk duhet të neglizhohet, sidomos kur shkolla vëren reagime të pakontrolluara të nxënësit në raport me nxënësit e tjerë, reagime jo normale me mësuesit, tërheqjen e nxënësit në vete, bartjen e ndonjë arme në shkollë, rënien në mësim - si tregues i një gjendje jo të mirë të tij, ikjen e nxënësit nga ora e mësimit dhe çdo ndryshim tjetër të mundshëm të tij.
2. Drejtuesit e shkollës të planifikojnë teknika të ndryshme për përfshirjen e familjes në drejtim të mbështetjes së suksesit të nxënësve dhe paralel me këtë edhe në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Shkolla duke e përfshirë familjen bën që ajo të ndihet faktor me interes për shkollën në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.
3. Vlerësimi për sjelljet përshkruhet në librezat e nxënësve, por rekomandojmë që ajo të bëhet edhe transparente. Rekomandohet që të promovohen nxënësit e dalluar dhe me sjellje të mira, e në këtë drejtim t'u jepen mirënjohje edhe familjeve për kontributin e dhënë. Ndërsa, me familjet, fëmijët e të cilëve kanë shfaqur dhunë, shkolla të shtojë nivelin e bashkëpunimit, dhe të dy palët të angazhohen që nxënësi të përmirësojë sjelljet dhe suksesin në mësim.

Përfundime për besimin e familjes te shkolla, faktor me rëndësi në përfshirjen e shkollës në bashkëpunimin me familjen, për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Një faktor i identifikuar nga familja si ndikues në bashkëpunimin ndërmjet saj dhe shkollës në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë ishte edhe ***besimi i shkollës te familja për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.***

Nga interpretimi i të dhënave të familjes urbane pohohet se: *Familja e mjedisit urban* nga tërë kampioni i përfshirë, 83.2% prej tyre deklarojnë se besimi i tyre te

shkolla është i nivelit "të lartë". 12.8% e familjeve e percepton "të mesëm" nivelin e besimit të tyre te shkolla, dhe nuk kemi familje të cilat e konsiderojnë atë të nivelit të ulët. Bazuar në këto analiza konstatojmë se familja e mjedisit urban e percepton të lartë besimin e saj te shkolla. Ndërsa, niveli i besimit të *mësuesve të mjedisit urban* te familja dhe puna e saj për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve paraqitet të jetë e ulët. 87% e mësuesve të mjedisit urban e perceptojnë "të ulët" besimin e tyre ndaj familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. 21% "të mesëm", nga gjithsej 298 të anketuar. Besim ky bindshëm i lartë ndërmjet shkollës dhe familjes në mjedisin urban.

Sipas perceptimeve të *mësuesve të mjedisit rural*, gjejmë se 91.3% e tyre e perceptojnë "të lartë" besimin e tyre te familja, 5.5% "të mesëm" dhe 1.95 "e ulët". Këto gjetje pasqyrohen në tabelën 45. Ndërsa tabela nr. 41 tregon se të gjitha *familjet e mjedisit rural* nga 400 të anketuara, gjithsej shprehin perceptimin se besimi i tyre te shkolla është e nivelit "të lartë", do të thotë 99.3% e tyre.

Analiza e perceptimeve të familjes dhe shkollës së mjedisit urban dhe atij rural në lidhje me besimin e tyre te njëra-tjetra si faktor i rëndësishëm në bashkëpunim, bën të kuptojmë se ekziston një besim reciprok mes shkollës dhe familjes në drejtim të angazhimit për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Shkolla jonë ka besim te familja dhe angazhimi i saj në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, përjashtim këtu bënte shkolla urbane e cila doli të ketë nivel të "të ulët" besimi ndaj familjes. Gjithashtu kuptojmë se familja ka besim të plotë te puna e shkollës, profesionalizmi i saj për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Bazuar në gjetjet e studimit, besimin mund ta konsiderojmë si faktor të rëndësishëm dhe domethënës në përfshirjen më të lartë të familjes në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Studimi adreson edhe çështjen që lidhet me marrëdhënien e besimit si faktor në përfshirjen e familjes në shkollë. Studimi gjen marrëdhënie të rëndësishme statistikore mes besimit dhe nivelit të përfshirjes/takimeve mes shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Për sa i përket kësaj marrëdhënieje, për familjen del të jetë ndikues besimi në nivelin e takimeve që do kenë me shkollën. Në këtë rast pohojmë që rëndësia statistikore është $p < 0.05$. Nga kjo rrjedh që besimi ndikon në mënyrë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore në takimet e familjes me shkollën.

Për mësuesit e të dyja mjediseve, besimi i tyre te familja del të jetë në nivel të lartë por në asnjërin mjedis nuk është ndikues në nivelin e takimeve me familjen. Kjo na bën të kuptojmë se tek shkolla besimi në drejtim të familjes nuk ndikon në nivelin e takimeve që shkolla do ketë me të.

Gjetjet e studimit sugjerojnë që shkolla ta ruajë këtë nivel besimi tek familja, në mënyrë që të përforcohet përfshirja dhe bashkëpunimi në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

Ky është faktori më i realizuar nga shkolla. Në drejtim të besimit të familjes ndaj shkollës dhe anasjelltas, *rekomandojmë* shkollën të ruajë dhe përforcojë besimin e familjes te shkolla. Si? Vetëm përmes punës dhe angazhimit të saj për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, si dëshmi për familjen.

Përfundime për komunikimin e shkollës me familjen, faktor me rëndësi për përfshirjen e shkollës në bashkëpunimin me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Si përfundim, lidhur me komunikimin e shkollës me familjen, faktor për përfshirjen dhe bashkëpunimin shkollë-familje në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve, ai del të jetë i nivelit e lartë, dhe atij mesatar. 72% e familjeve urbane e perceptojnë të nivelit mesatar komunikimin e shkollës drejt saj. Ndërsa, 90% e familjeve rurale e perceptojnë të nivelit të lartë komunikimin e shkollës me familjen. Mësuesit e mjedisit urban, gjithashtu, 88% e tyre e perceptojnë të nivelit të lartë dhe 72% e mësuesve të mjedisit rural e vlerësojnë të mesëm nivelin e komunikimit të tyre me familjen.

Analizat e pohimeve të variablave na shpjen në konstatimin komunikimi mbetet të përmirësohet në aspektin profesional, duke konstatuar se ajo nuk komunikon me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve; për organizimin e aktiviteteve të ndryshme në shkollë; komunikimi mes këtyre dy subjekteve bashkëpunues nuk shtrihet më shumë në format e ndryshme të mundshme të komunikimit, etj. Konsiderojmë se këto fakte reflektojnë në një bashkëpunim të duhur dhe në vetë nivelin e takimit të shkollës me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.

Si tek familja ashtu dhe tek shkolla e të dyja mjedisëve vërejmë se ka një lidhje të mirëfilltë ndërmjet komunikimit dhe niveleve të takimit të shkollës dhe familjes. Ndikimi i komunikimit mbi nivelin e takimit të shkollës me familjen është verifikuar nga ana statistikore me koeficientet e korrelacionit (Pearson), ku dhe kuptojmë se komunikimi bën që familja të jetë më shumë e përfshirë në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Në këtë rast pohojmë se rëndësia statistikore për komunikimin është $p < 0.05$. Rezultatet tregojnë se kjo marrëdhënie tek familja e mjedisit urban është ($r=.189, <0.01$), tek ajo rurale ($r=.126, p <0.01$). Tek mësuesit e mjedisit urban marrëdhënia e komunikimit dhe nivelit të takimeve shkollë-familje është ($r=.891, p <0.01$), ndërsa tek mësuesit e mjedisit rural ($r=.016, p <0.01$). Nga kjo rrjedh që ky faktor ndikon në mënyrë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore në përfshirjen e familjes në shkollë.

Nga konkludimi i të dhënave përmes analizës cilësore nga të gjithë të intervistuarit, pengesë në komunikimin e familjes me shkollën del të jetë mungesa e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë. Rikonstatojmë se shkolla jonë nuk e ka të përfshirë shërbimin e konsulencës në shkollë për diskutimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës dhe për tu marrë me çështjen e parandalimit si dhe për çështjen e bashkëpunimit të shkollës me familjen. Në studimin tonë, kjo del një ndër arsyt e dhunës ndërmjet nxënësve. Parandalimi duhet të përfshijë familjen, mësuesit, mediat dhe të gjithë faktorët e tjerë, por përkundër kësaj është absurd të mendohet një parandalimi i suksesshëm pa shërbimin e konsulencës në shkollë, shërbim ky i cili i mungon shkollë sonë.

Nisur nga gjetjet e studimit, komunikimi i shkollës dhe familjes është në nivelin mesatar. Meqë studimi konstaton se ky komunikim është përgjegjës për dhunën ndërmjet

nxënësve, dhe me qëllim të përmirësimit të tij *rekomandojmë*:

1. Komunikim sistematik me familjen. Në këtë mënyrë do të bëjmë që familja të jetë më shumë e përfshirë në shkollë. Ajo do kuptojë çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës ndaj të tjerëve dhe të të tjerëve ndaj fëmijës së saj. Nga ana tjetër, nxënësit do të kuptojnë se shkolla dhe familja janë në marrëdhënie të vazhdueshme komunikimi. Por, në këtë drejtim t’i bëhet e ditur familjes se ky komunikim sistematik nuk nënkupton ardhjen e saj në shkollë jashtë orareve të parapara nga mësuesit, pos rasteve emergjente.
2. Të shfrytëzojë shkolla mundësitë e shumta të komunikimit, jo vetëm takimet me prindër por dhe e-mailet, mesazhet telefonike, vizitat në shtëpi, etj. Qëllimi i shfrytëzimit të këtyre mundësive është që t’i mundësohet familjes, përkundër kohës së tyre të kufizuar, që të jetë në dijeni mbi sjelljen e nxënësit. Tjetra, të komunikohet më shumë me familjen, sepse vetëm komunikimi është çelësi i suksesit për bashkëpunim. Pra, të nxitet komunikimi i shkollës me familjen. Nëse nuk identifikohet dhe komunikohet për sjelljen jo të mirë të nxënësve, atëherë ajo nuk mund të parandalohet. Kështu shkolla promovon komunikimin me familjen për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë. Si të arrihet kjo? Rekomandojmë shkollën të jetë e hapur me familjen për çdo shqetësim të saj që ka të bëjë me dhunën mes nxënësve.
3. Rezultatet e studimit sugjerojnë se njëra nga arsyet e dhunës ndërmjet nxënësve është dhe sjellja dhe komunikimi i mësuesve me nxënësit. Disa mësues përdorin masa represive disiplinore. Perceptimi haset tek disa familje, sipas të cilëve komunikimi duhet të diskutohet edhe me shërbimin higjienik në shkollë. Çështje kjo e cila nuk lejohet të injorohet. Rezultatet rekomandojnë që mësuesit dhe shkolla të ndërjegjësohen që sjellja e tyre reflekton tek nxënësit. Ata duhet jenë model i sjelljes jo të dhunshme, i tolerancës, ndihmës, respektit dhe raportit të shëndoshë e të sinqertë me nxënësit. Ata duhet të promovojnë anti-dhunën. Ata kanë rol të rëndësishëm në krijimin e klimës pozitive në shkollë. Mësuesit të reflektojnë qëndrim jo të dhunshëm ndaj nxënësve në shkollë.
4. Të iniciohen nga shkolla takime me tema të caktuara ndërmjet nxënësve dhe të diskutohen ato bashkë me familjen duke identifikuar kështu fakte dhe probleme të mundshme për dhunën ndërmjet nxënësve. Në këtë mënyrë shkolla do të tërheqë ide shumë dobiprurëse për të në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Këto takime, debate, komunikime mes shkollës dhe familjes përçojnë mesazhe shumë të forta tek nxënësit. Ata kuptojnë se këto dy subjekte kryesore në edukimin e tyre janë në vazhdimësi në kontakt dhe dijeni, komunikojnë për sjelljen e tyre në shkollë. Këto dy subjekte kanë dhe masat e caktuara ndëshkuese në rast dhune me nxënësit tjerë. Këto subjekte e kuptojnë çdo akt dhune ndërmjet nxënësve dhe nuk i tolerojnë ato.

Këtu dhe ndodh parandalimi.

5. Mësuesit dhe shkolla në përgjithësi duhet të jenë shembull i komunikimit të drejtë, si me nxënësit, e po ashtu me familjen dhe më gjerë. Komunikimi i shkollës me nxënësit, familjen dhe shoqërinë, duhet të shërbejë si model. Në këtë drejtim, rekomandojmë të ndërmerren masa nga Ministria e Arsimit për trajnimin e mësuesve, të organizuara nga shkolla, të cilat do të ndikojnë në njohjen më të mirë të komunikimit dhe rëndësisë së tij në drejtim të nxënësve dhe familjes duke reflektuar më pas në përvojat e tyre praktike. Trajnimet sigurisht janë në shërbim edhe të drejtuesve të shkollës, për aftësinë komunikuese të tyre me stafin e shkollës dhe familjen në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.
6. Drejtuesi i shkollës duhet të menaxhojë një komunikim të drejtë ndërmjet vetë mësuesve në shkollë. Gjatë vëzhgimeve në shkolla del se ai duhet të fokusohet dhe në këtë drejtim. Kjo marrëdhënie brenda shkollës vlerësohet se mund të ndikojë dhe tek sjelljet e nxënësve. Pra, duhet të nxitet, të lypset dhe të praktikohet komunikimi i drejtë, i shëndoshë dhe bashkëpunues ndërmjet vetë mësuesve dhe stafit të shkollës në tërësi. Ndërveprimet e subjekteve në shkollë të jenë model për nxënësit.

Përfundime për informimin e familjes drejt shkollës, faktor me rëndësi për përfshirjen e shkollës në bashkëpunimin me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Gjetje me rëndësi të studimit ishin edhe ato për informimin e familjes nga shkolla dhe anasjelltas, si faktor për përfshirjen dhe bashkëpunimin shkollë-familje në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Rezultatet e këtij studimi pasqyruan faktin se informimi i familjes nga shkolla nuk është në nivelin e duhur. Siç tregohet nga studimi, informimi i familjes nga shkolla për çështje në përgjithësi të cilat kanë të bëjnë me nxënësin, edhe lidhur me ato që kanë të bëjnë me dhunën, tek familjet nuk perceptohet i mjaftueshëm, madje del në nivel të ulët. Familja, nuk merr informacion për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Nga anë tjetër, shkolla konsideron se qëndron mirë në këtë drejtim.

Tek ky faktor kemi mospërputhje në qëndrime. Analizat e gjetjeve sasiore demonstrojnë se: 62% e *familjeve urbane* kanë perceptimin se informimi i tyre nga shkolla është i ulët. 30% e familjeve e percepton të nivelit të mesëm informimin e shkollës drejt saj, dhe nga gjithsej 300 të anketuar vetëm 3.2% e tyre e perceptojnë të nivelit të lartë informimin e shkollës drejt familjes. Edhe sipas *mësuesve të mjedisit urban*, informimi i familjes dhe shkollës është i nivelit mesatarë sipas 64% të mësuesve të këtij mjedisi, dhe 22% e perceptojnë të nivelit “të lartë” informimin e tyre në drejtim të familjes. Sipas të dhënave të tabelës 66, nga 393 *familje të anketua të mjedisit rural*, 36% e familjeve të mjedisit rural informimin e shkollës drejt tyre e perceptojnë të

nivelit "të ulët", ndërsa 34% të nivelit "të mesëm". Qëndrimet e familjeve të mjedisit rural për informimin e shkollës drejt tyre nuk kanë dallime të theksuar në nivele. Informimi i familjes nga shkolla në shkollën rurale sipas familjes së këtij mjedisi del të jetë ndërmjet nivelit të mesëm dhe atij të ulët. Mësuesit e të njëjtit mjedis e vlerësojnë të nivelit të mesëm informimin drejt familjes. Nga 315 të anketuar, 117 (17.9%) prej tyre e perceptojnë të nivelit "të mesëm" informimin e tyre drejt familjes, 193 shprehin qëndrimin se ai është i nivelit "të lartë" dhe vetëm 5 nga mësuesit thonë se ai është "i ulët". Sipas mësuesve të mjedisit rural, informimi i shkollës drejt familjes del të jetë i nivelit "të lartë" – ata e informojnë mjaftueshëm familjen.

Nga studimi del se nuk kemi bashkëveprim, ose ai nuk është i drejtë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, përderisa mungon shkëmbimi i informacioneve në këtë drejtim. Sferat e veprimit të nxënësit mbeten të ndara. Familja përmes informimit për dhunën ndërmjet nxënësve nuk ndikohet nga shkolla në drejtim të parandalimit.

Shkolla jonë, informimin e familjes e vendos në nivel të arritjeve të nxënësve në shkollë, madje vetëm në komunikimin e suksesit të nxënësve, por jo dhe në informimin e familjes për mënyrën efikase të bashkëpunimit të familjes me nxënësin për ndërgjegjësimin e tyre për dhunën ndërmjet nxënësve. Informimi shtrihet kryesisht dhe pothuajse vetëm në nivelin e arritjeve të nxënësit. Niveli i informimit të familjes nga shkolla lidhur me dhunën ndërmjet nxënësve del të jetë shqetësim për familjen. Ndërsa nëse familjet, fëmijët e të cilëve ushtrojnë dhunë, ose, fëmijët e së cilave janë të dhunuarit, janë më të përfshira (pranishme) në shkollë, ato do të jenë të mirë informuara për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës. Pastaj, kur jemi të mirë informuar për sjelljen e fëmijës në shkollë, qoftë për ngacmimet, fyerjet e çdo problem të fëmijës sonë në raport me fëmijët e tjerë, do të ndodhë edhe bashkëpunimi me shkollën dhe parandalimi për dhunën e mundshme mes fëmijës sonë dhe të tjerëve.

Të dhënat përshkruese na bëjnë të kuptojmë se shkolla e informon familjen në mënyrë shumë formale, ndërsa të dhënat cilësore pasqyrojnë mungesë informacioni. Sipas analizës së intervistave, shkolla nuk ofron aspak informacion për familjen në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Nga ana tjetër, të dhënat korrelacionale na bëjnë të kuptojmë se informimi është një faktor domethënës me rëndësi statistikore për nivelin e takimeve shkollë-familje. Arsyeja e korrelimit na bën të mendojmë për ngritje të nivelit të informimit në shkollë, të cilin ne si studiuese e konsiderojmë si parësor. Mungesa e informacionit, qoftë e shkollës drejt familjes si dhe e familjes drejt shkollës, për dhunën ndërmjet nxënësve dhe parandalimin e saj, shpie në mungesë rezultatesh në sferën parandaluese, në dështim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Nuk mund të imagjinohet parandalimi pa informacione të tërthorta.

Studimi gjen se shkolla jo kënaqshëm e informon familjen për çështjet në përgjithësi. Informimi i shkollës drejt familjes del të jetë i mangët. Rekomandojmë:

1. Informimi për bashkëpunimin e shkollës dhe familjes është një proces i dyanshëm. Familja duhet ta mbajë shkollën të informuar mirë për çdo ndryshim në sjelljet e fëmijës. Informimi i familjes nga shkolla për çdo sjellje dhe ndryshim të saj tek nxënësit në raport me nxënësit e tjerë dhe në përgjithësi. Mësuesi,/shkolla të mos anashkalojë asnjë ndryshim në sjelljen e nxënësit,

qoftë edhe atëherë kur nuk duket e rëndësishme në pamje të parë. Në këtë drejtim, mendojnë në ndryshimet që i hasim në aspektin emocional dhe fizik të nxënësit në raport me të tjerët, në mënyrën e komunikimit, në informacionet e mundshme të ofruara për sjelljet e nxënësit, për suksesin e tij, etj. Në drejtim të dhënies së informacioneve të tilla familjes, rekomandohet takimi direkt dhe individual me familjen. Identifikimi dhe shkëmbimi i informacioneve, reagimi me kohë ndaj sjelljes së dhunshme të nxënësit, sigurisht do jetë mënyra më e mirë për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve në bashkëpunim me familjen

2. Shkolla duhet medoemos ta informojë familjen për mënyrën se si të punojë me fëmijën në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Në këtë mënyrë përpos informimit do të arrihet edhe ndërgjegjësimi dhe niveli më i lartë i bashkëveprimit të familjes dhe shkollës për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, përfshirjen më të lartë të familjes në shkollë, atë të cilën po synojmë si studiuese për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve. Në këtë drejtim, shkolla mund të veprojë në mënyra të ndryshme, si aktiviteteve të ndryshme të organizuara në shkollë si për nxënësit ashtu dhe për familjen, përmes fletushkave ofruar familjes, mësuesve dhe nxënësve, broshurave me sqarime të detajuara për dhunën dhe parandalimin e saj. Një mundësi tjetër është që shkolla mund t'i paraqesë thëniet e ndryshme për raporte pozitive ndërmjet nxënësve në korridore dhe mësonjëtoje të shkollës, dhe çka është më e rëndësishmja, t'u jepen në shfrytëzim familjeve, botime lidhur me metodat alternative të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.
3. Shkolla të organizojë konferenca me familjen në të cilat do të diskutohet dhe shkëmbehen informacione për dhunën dhe hapat për parandalimin e saj. Në shkollë kemi prindër të profesioneve të ndryshme. Të angazhohen edhe ata në konferenca/aktivitete p.sh. prindërit mjekë, policë, pedagogë, artistë, të cilët mund të bëjnë një projekt anti-dhunë për nxënësit, por edhe të propozojnë ide që mund t'i jetësojnë bashkërisht në praktikë. Medoemos duhet të nxirren rekomandime përkatëse nga konferenca.
4. Rezultatet e studimit sugjerojnë informimin e familjes për arsyen e dhunës ndërmjet nxënësve siç është interneti dhe rrjetet sociale. Tek fokus grupi, kjo del arsye e parë për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë. Në këtë drejtim rekomandohet bashkëpunimi me familjen në drejtim të ndërgjegjësimit të familjes për këtë burim të arsyes të dhunës ndërmjet nxënësve dhe mbajtjen në kontroll të fëmijës në shfrytëzimin e tij cilësor. Drejtuesit e shkollës duhet të gjejnë teknika për informimin e familjes për këtë faktor të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, duke përfshirë të gjitha familjet, jo vetëm ato familje të cilat janë të rregullta në takimet me prindër ose ato individuale. Një mundësi e mirë në këtë drejtim mund të jenë programet e ndryshme për informim të drejtë të shkollës –familjes për pasojat e rrjeteve sociale dhe lojërave me

përmbajtje të dhunshme në internet dhe në televizion.

5. Shkolla, gjithashtu mund t'i ofrojë familjes informacion specifik lidhur me aktivitetet që mund të bëjnë me fëmijët jashtë shkollës për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve. Mësuesit mund të japin informacione të dobishme edhe për krijimin e mjedisve në shtëpi që nxit sjelljen pozitive të fëmijëve, të tilla si caktimi i kohës për detyrat e shtëpisë, angazhimi në lexim në kohën e lirë dhe eksplorimi i temave mësimore të mëtejshme, si dhe kufizimi i kohës përpara televizorit apo video-lojërave.

Përfundime për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet shkollës dhe familjes, faktor me rëndësi në përfshirjen e shkollës për bashkëpunim me familjen me qëllim parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Analiza e variablave të këtij faktori zbulon se sipas qëndrimeve të *familjeve të mjedisit urban*, nga 298 familje të përfshira në studim, 115 (38.6%) perceptojnë se ndarja e detyrave mes tyre dhe shkollës është e nivelit "të ulët". Gjejmë se 111 (37.2) familje të shkollës së mjedisit urban e perceptojnë të nivelit të mesëm ndarjen e detyrave mes tyre dhe shkollës, dhe vetëm 72 prej tyre të nivelit "të lartë". Ndërsa 256 (65.0%) e *familjeve të mjedisit rural*, ndarjen e detyrave mes saj dhe shkollës e perceptojnë "të ulët", gjetje këto të studimit të paraqitura në tabelën 84. Ndërsa, nga gjithsej 300 mësues të mjedisit urban, 72% prej tyre e perceptojnë "të lartë" ndarjen e detyrave mes tyre dhe familjes. Sipas qëndrimeve të *mësuesve të mjedisit rural*, ndarja e detyrave me tyre me familjen është e nivelit "të ulët" sipas 262 nga gjithsej 400 mësues të anketuar.

Familja dhe shkolla pohuan se ndarja e detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet familjes dhe shkollës në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, nuk ndodh. Në këtë qëndrim përjashtim bënte shkolla e mjedisit urban, sipas së cilës ajo me familjen i ndajnë detyrat dhe përgjegjësitë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Kjo mospërputhje në qëndrime në këtë rast nuk duhet të injorohet. Përderisa shkolla e mjedisit urban konsideron se e përmbush këtë detyrim të saj dhe nga ana tjetër kemi mohimin e familjes, atëherë si duket mungon nga vetë shkolla njohja e detyrave dhe përgjegjësive të saj në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Në mbështesim qëndrimin e familjes në këtë rast, nisur nga konstatimi i studimit cilësor se familja nuk kishte asnjë takim me shkollën për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, atëherë as detyrat dhe përgjegjësitë nuk janë ndarë. Parandalimi është bërë ndaras nga këta dy faktorë edukativë. Në këtë drejtim shkolla del të jetë vetëkritike. Sipas saj, ndarja e detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet shkollës dhe familjes është e nivelit të ulët. Tek mjedisi rural, lidhur me këtë faktor, kemi përputhje të qëndrimeve ndërmjet shkollës dhe familjes.

Nga ana tjetër, studimi konstaton se ndarja e detyrave dhe përgjegjësive ndërmjet shkollës dhe familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë është ndikues në nivelin e takimeve ndërmjet familjes dhe shkollës. Madje kjo ndërlidhje del të jetë e fortë. Gjetje këto të studimit të paraqitura në Tabelat: 80, 83, 86 dhe 89 në

rubrikën “Rezultatet e studimit”

Çështja e cila mund të nxirret si konkluzion është se shkolla nuk bën ndarje të detyrave dhe përgjegjësi me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë, përkundër konstatimit se ky faktor ndikon në nivelin e takimeve ndërmjet shkollës dhe familjes. Familja duhet të njihet me të drejtat dhe detyrimet e saj në shkollë në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Pa njohjen e tyre edhe në rast të paraqitjes së problemeve, familja nuk do të dijë se cilat janë detyrat dhe detyrimet e saj në situata të caktuara.

Ndarja e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes, sipas studimit tonë nuk është në nivelin e duhur, pavarësisht rëndësisë. Pra, ajo është në nivelin e ulët. Nga ana tjetër, gjejmë se ky faktor ndikon në përfshirjen e familjes në shkollë.

Në drejtim të përmirësimit të gjendjes **rekomandojmë:**

1. Shkolla ta vendosë si prioritet ndarjen e detyrave mes saj dhe familjes në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Nisur nga fakti se mësuesit vetë shprehin qëndrimin se ndarja e detyrave mes tyre dhe familjes nuk është në nivelin e duhur, rekomandojmë njohjen e mësuesve me mundësitë e ndarjes së detyrave me familjen dhe rëndësinë e kësaj ndarjeje.
2. Familja që në fillimet e saj në shkollë të njihet me të drejtat dhe detyrimet e saj, me politikën e shkollës, me të drejtat dhe detyrimet në drejtim të parandalimit të dhunës mes nxënësve. Ky informacion mund të bartet në mënyra të ndryshme, si përmes fletushkave, përmes aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga shkolla, web-faqe në internet. Njohja e familjes me detyrat dhe detyrimet e saj në shkollë mund të bëhet edhe nëpërmjet posterave të ndryshme të shfaqura në mësonjëtoaren për takime me familjen (salla të cilat mungojnë në shkollën tonë) dhe materialeve të tjera të shtypura.
3. Studimi ynë tregon se shkolla ka probleme pikërisht me familjet, fëmijët e të cilave janë problematikë dhe shkaktojnë dhunë tek nxënësit e tjerë. Shkolla del të dorëzohet para familjeve të tilla. Rekomandojmë gjetjen e mënyrave për një bashkëpunim më të thellë me familje të tilla. Këto familje duhet ta kuptojnë se kanë detyra por dhe detyrime ndaj shkollës. Të përpilohet një plan strategjik në këtë drejtim për informimin e këtyre familjeve në drejtim të tejkalimit dhe parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve. Shkolla në bashkëpunim me ekspertët e arsimit të gjejë rrugët dhe mënyrat se si të punojë më shumë me këtë kategori familjesh.
4. Familja të njihet me aspektin ligjor të arsimit fillor, përmes së cilit njihet me të drejtat, detyrimet dhe detyrat e saj, por edhe me sanksionet që dalin në rast të shfaqjes së dhunës tek nxënësit në shkollë. Kjo njohje do ta lehtësonte mjaft punën e shkollës.

Përfundime për përvojën e familjes me shkollë, faktor me rëndësi në përfshirjen e shkollës në bashkëpunim me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Nga analiza e të dhënave të pjesës sasiore të studimit për sa i përket perceptimit të familjeve për përvojën e tyre me shkollën kemi: 59.7% e *familjeve të mjedisit urban* të anketuara, e konsiderojnë në nivelin "të lartë" përvojën e tyre të mëparshme me shkollën. Nga 394 *familje rurale* të anketuara, 257 prej tyre e perceptojnë të nivelit të lartë përvojën e tyre me shkollën, 120 "të ulët" dhe vetëm 17 (4.3%) familje shprehin qëndrimin se ajo është "e ultë". Këto rezultate pasqyrohen në tabelën 75.

Nuk rezulton të ketë diferenca statistikore në analizat përshkruese si ndërmjet familjes urbane dhe asaj rurale. Konstatohet se përvoja e familjes me shkollën perceptohet e lartë nga familjet, por, nuk del ndikuese në përfshirjen e familjes në shkollë. Analiza korrelacionale tregon ndërlidhjen e përvojës së familjes me nivelin e takimeve me shkollën dhe del se ky faktor nuk është ndikues në nivelin e takimeve ($r = .082$, $p = .105$, tek urbania), ($r = .027$, $p = 0.645$ tek ruralja).

Përfundime për vendimmarrjen e familjes në shkollë, faktor me rëndësi në përfshirjen e shkollës në bashkëpunimin me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Çështja e fundit e cila është adresuar në këtë studim është ***Vendimmarrja e familjes në shkollë, faktor për përfshirjen dhe bashkëpunimin shkollë-familje në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve***, dhe ajo del të jetë e nivelit të ulët. Shkolla del se nuk e përfshin familjen në vendimmarrje në mënyrë të mjaftueshme. Familja nuk ndihet vendimmarrëse në shkollë, ajo gjithashtu nuk angazhohet në aktivitetet dhe organizimet e ndryshme shkollore; nuk përfshihet në aktivitetet e shkollës; në marrjen e vendimeve për kurrikulën mësimore; politikat e shkollës në përgjithësi, kodin e veshjes, etj.

Madje vendimmarrja e familjes në shkollë duket se është në nivel tejet të ulët. Këtë pohim e bazojmë në opinionet e familjes dhe shkollës. Të dyja këto subjekte në bashkëpunim pohojnë se vendimmarrja e familjes në shkollë nuk është në nivelin e duhur. Këtu kemi përputhje në perceptimet e familjes dhe shkollës në të dyja mjediset. 52% e familjeve urbane e perceptonte "të ulët" vendimmarrjen e tyre në shkollë. Tek familja rurale, 35.5% e familjeve të anketuara përgjigjen në pohimet e vendimmarrjes së familjes në shkollë. 64% prej tyre nuk kanë ofruar përgjigje për vendimmarrjen e tyre në shkollë. Sipas qëndrimeve të *mësuesve të mjedisit urban*, 68% e tyre shprehen se vendimmarrja e familjes në shkollë është e nivelit "të lartë". Edhe tek *mësuesit e mjedisit rural*, 36% e mësuesve nuk shprehen qëndrim për vendimmarrjen e familjes në shkollë. Nga qëndrimet e 258 mësuesve nga 400 gjithsej, 54% e tyre e perceptojnë të jetë e nivelit "të mesëm" vendimmarrja e familjes në shkollë.

Çështja që mund të nxirret si konkluzion është pikërisht fakti se familja ndihet e përjashtuar në vendimmarrjen e saj në shkollë. Ky fakt na bënë të mendojmë nëse kuptohet drejt nga shkolla rëndësia e vendimmarrjes së familjes në të, dhe tjetra, si mundet që familja të ndihet ndikuese në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë përderisa ajo del se nuk është vendimmarrëse në shkollë.

Vendimmarrja, informimi i familjes drejt shkollës dhe anasjellas, dhe ndarja e detyrave ndërmjet shkollës dhe familjes për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve, gjejmë se janë faktorët të cilët e pengojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin ndërmjet shkollës dhe familjes për parandalim të dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë. Këta tre faktorë janë të porealizuar nga shkolla. Nga ana tjetër, këta faktorë janë ndikues në përfshirjen e familjes në shkollë për bashkëpunim në drejtim të parandalimit të dhunës ndërmjet nxënësve.

Rezultatet e dala nga studimi ynë tregojnë se përfshirja e familjes në vendimmarrje është e nivelit të ulët, pohim i mbështetur nga familja, por dhe nga vetë shkolla. Në këtë kontekst, **rekomandojmë:**

1. Në shkollën tonë nuk i është kushtuar rëndësi e mjaftueshme vendimmarrjes së familjes në shkollë. Prandaj rekomandojmë që shkolla ta promovojë këtë aspekt të bashkëpunimit. Ajo duhet ta përfshijë familjen në procesin e vendimmarrjes për kurrikulat mësimore, çdo organizim që ndodh në shkollë e i cili përfshin edhe nxënësit, për kodin e veshjes, caktimin e detyrave dhe detyrimeve të nxënësve në shkollë, marrjen e vendimeve për angazhimin e nxënësve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj. I sugjerohet shkollës përfshirja më të madhe e familjes në vendimmarrje dhe në zbatimin e tyre duke iu treguar kështu atyre rëndësinë që ka kjo përfshirje. Pra, duhet të promovohet përfshirja e vendimmarrjes së familjes në shkollë.
2. Rekomandojmë që drejtuesit e shkollave të ndërgjegjësohen për mundësitë e shumta të vendimmarrjes së familjes në shkollë, duke parë se gjatë intervistave me drejtorët e shkollave të krijohet përshtypja se ky faktor nuk njihet sa duhet, me gjithë rëndësinë që ka, si dhe mungon informacioni për mënyrën dhe mundësitë e angazhimit të familjes në vendimmarrje.

1. Adams.M. Curts, Forsyth.B.Patrick, Mitchell.M.Rozanne.(2009):The Formation of Parent-School Trust: *A Multilevel Analysis*. EAQ

ANEKSE

Instrumentet e përdorura për studimin empirik të problemit. Ky aneks përfshin: Pyetësonin për familjen; Pyetësonin për mësues; Guida e intervistës për drejtues të shkollave; Guida e intervistës me familjen; Guida e intervistës me mësues; Guida e intervistës me nxënës; Pyetje për nxënësit në fokus grup.

E nderuara familje,

Pyetësoni që keni në dorë është ndërtuar për të grumbulluar të dhëna në lidhje me studimin e bashkëpunimit të shkollës me familjen. Nga ju pritët të kontribuoni në këtë drejtim, duke ju dhënë mundësinë për të treguar se çfarë po bëni ju dhe shkolla për të mirën e nxënësve tuaj.

Pyetësoni është anonim, kështu që prej jush kërkohet të mos shënoni emrin tuaj në asnjë vend të tij.

*Faleminderit për bashkëpunimin,
Vlora Sylaj*

Në pyetjet në vazhdim vendos shenjën X në vetëm njërën nga alternativat (katrorët).

Mirëpritja e familjes nga shkolla

V.1 Unë ndjehem i mirëpritur në takimet që kam me mësuesin e fëmijës sim.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.2 Mësuesi tregon respekt ndaj meje kur jam në shkollë, për të trajtuar probleme të ndryshme të ngacmimeve/dhunës mes nxënësve.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.3 Mësuesi më trajton njësoj si trajton edhe prindërit e tjerë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.4 Mësuesi nuk bën dallime mes prindërve, pavarësisht nivelit arsimor, kulturor, social, etj.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.5. Në shkollë kemi një sallë të caktuar ku mund të takohemi me mësuesin e fëmijës sim.	1.	Po	
	2.	Jo	

Komunikimi efektiv

<p>V.6. Mësuesi na e bën të lehtë komunikimin me të për probleme të ndryshme të ngacmimeve/dhunës.</p> <p>Mes fëmijës sim dhe fëmijëve të tjerë.</p>				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

<p>V.7. Mësuesi rregullisht më informon për aktivitetet e ndryshme në shkollë, çështje të ndryshme për ngacmimet/ dhunën mes nxënësve.</p>				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

<p>V.8. Mësuesi komunikon me ne si familje në mënyra të shumëfishta: (p.sh.me e-mail, telefon, website, takime rinore, fletores së punës, vizitës në shtëpi etj.).</p>				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

<p>V.9. Mësuesi më ndihmon mua ti zgjidh problemet që kanë të bëjnë me fëmijën tim dhe ndonjë fëmijë tjetër.</p>				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

<p>V.10. Unë mund të komunikoj me mësuesin sa herë kam nevojë për dhunën që ushtrojnë fëmijët e tjere ndaj fëmijës sim.</p>				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Informacionet e familjes

V.11. Mësuesi/kujdestari i klasës më ka treguar cilat janë mundësitë e bashkëpunimit (takimet prindërore, takimet individuale, telefoni, website, vizitat në shtëpi.)				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.12. Mësuesi/kujdestari i klasës më ka njoftuar me politikat e shkollës në rast të dhunës mes nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.13. Mësuesi/kujdestari i klasës më ka ofruar informacion për ekzistencën dhe numrin e Këshillave të Prindërve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Mes V.14. Mësuesi/kujdestari i klasës më ka treguar funksionet e këtyre Këshillave.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.15. Unë e njoh (e kam lexuar) Ligjin "Mbi arsimin fillor në Kosovë".				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Besimi i familjes ndaj shkollës

V.16. Unë kam besim te shkolla se do bëjë më të mirën për fëmijën tim për të parandaluar dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.17. Unë kam besim te shkolla se do më informoj për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës tim ndaj fëmijëve të tjerë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.18. Unë kam besim te shkolla se do më informoj për çdo ndryshim në sjellje tek fëmijët e tjerë ndaj fëmijës sim.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.19. Roli im si prind konsiderohet i rëndësishëm nga mësuesi/kujdestari i fëmijës sim në bashkëpunimin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Eksperienca e mëparshme

V.20. Unë si familje i kam vlerësuar shumë të dobishme takimet me mësuesin e fëmijës tim, për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Mes V.21. Mësuesi/kujdestari i klasës së fëmijës sim të mëparshëm ka bërë më të mirë për tejkalimin e problemeve eventuale mes fëmijës sim dhe fëmijëve të tjerë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.22. Mësuesi/kujdestari i klasës së fëmijës sim të mëparshëm ka reaguar atëherë kur unë nuk nuk i jam përgjigjur ftesës së tij për takim.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi

V.23. Mësuei kërkon nga unë që shqetësimet e caktuara të fëmijës sim me ndonjë fëmijë tjetër t'i diskutojmë me shërbimin e konsulencës në shkollë (psikologun, pedagogun,...)				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.24 Mësuesi/kujdestari i klasës m'i ka bërë të qarta objektivat dhe detyrat që duhen realizuar për parandalimin e dhunës eventuale mes fëmijës sim dhe fëmijëve të tjerë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Vendimmarrja

Mes V.25. Unë marr pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë që kanë të bëjnë me kurrikulën, kodin e veshjes, organizimin e vizitave të fëmijëve jashtë shkollës.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.26. Unë marr pjesë në vendimet që merren në shkollë për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Mbështetja e suksesit të nxënësit

V.27. Mësuesi/kujdestari i fëmijës tim më informon në vazhdimësi për suksesin e fëmijës sim.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.28. Mësuesi/kujdestari i klasës më kontakton mua vetëm kur fëmija nuk ecën mirë në mesime.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.29. Fëmija im nxitet nga mësuesit të bëjë më të mirën në mesime.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.30. Problemet në të nxënë, kur paraqiten te fëmija im, i zgjidhim bashkë me mësuesit.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Komentet tuaja eventuale: _____

PYETËSOR PËR MËSUES

I nderuar mësues,

Pyetësi që keni në dorë është ndërtuar për të grumbulluar të dhëna në lidhje me studimin e bashkëpunimit të shkollës me familjen. Nga ju pritët të kontribuoni në këtë drejtim duke ju dhënë mundësinë për të treguar se çfarë po bëni ju dhe shkolla për të mirën e nxënësve tuaj.

Pyetësi është anonim, kështu që prej jush kërkohet të mos shënoni emrin tuaj në asnjë vend të tij.

*Faleminderit për bashkëpunimin,
Vlora Sylaj*

Mirëpritja e familjes në shkollë

V.1. Unë e bëj familjen të ndihet pjesë e shkollës.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.2 Unë tregoj respekt ndaj prindërve kur ata janë në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.3 Unë të gjithë prindërit i trajtoj njësoj.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.4 Unë nuk bëj dallime mes prindërve pavarësisht nivelit të tyre arsimor, kulturor, social etj.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.5. A ka shkolla juaj një sallë të posaçme ku ju realizoni takimet me prindër?	1.	Po		
	2.	Jo		

Komunikimi i mësuesve me familjen

V.6. Unë ua bëj të lehtë prindërve komunikimin me mua.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.7. Unë komunikoj me prindërit në mënyra të ndryshme, si: e-mail, përmes telefonit, sms-ve, drejtëpërdrejt, etj.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.8. Unë komunikoj me prindërit për çdo problem (çështje) në sjelljen e fëmijës.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.9. Prindërit mund të takohen me mua sa herë që kanë nevojë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.10. Unë komunikoj me prindërit për çdo problem (çështje) në sjelljen e fëmijës.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Informimi i mësuesit/kujdestarit drejt familjes

V.11. Unë i kam treguar familjes cilat janë mundësitë e bashkëpunimit me mua (takimet prindërore; Takimet individuale; sms-të; e-mail, etj.)				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.12. Unë e kam njoftuar familjen me politikat e shkollës në rast të dhunës mes nxënësve.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.13. Unë e kam njoftuar familjen me vendimet e shkollës në rast të dhunës mes nxënësve.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.14. Unë i kam ofruar familjes informacion rreth ekzistencës dhe numrit të Këshillave të Prindërve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.15. Unë e kam njoftuar familjen se cili është funksioni i këtyre Këshillave.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.16. Unë e njoh (e kam lexuar) ligjin “Mbi arsimin fillor në Kosovë”.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Besimi i mësuesit te familja

V.17. Unë kam besim te familja se do të bëj më të mirën për fëmijën për të parandaluar dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.18. Unë kam besim te familja se do të më informoj për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës tim ndaj fëmijëve të tjerë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.19. Unë kam besim te familja se do të më informojë për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijëve të tjerë ndaj fëmijës sim.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.20. Roli im si mësues, besoj se konsiderohet shumë i rëndësishem nga familja në bashkëpunimin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet shkollës dhe familjes

V.21. Unë kërkoj që shqetësimet e familjes për fëmijën, që kanë të bëjnë me sjelljen e fëmijës dhe të tjera, t'i diskutoj me shërbimin e konsulencës (psikologun, pedagogun).				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.22. Unë ia kam bërë të qarta familjes detyrat dhe përgjegjësitë e saj të cilat duhet t'i realizoj në bashkëpunim me mua në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Vendimmarrja e familjes në shkollë

V.23. Familja merr pjesë në vendimet e rëndësishme në shkollë që kanë të bëjnë me kodin e veshjes, kurrikulën, vizitat e ndryshme, organizimet në shkollë etj.).				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.24. Familja merr pjesë në marrjen e vendimeve për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Mbështetja e suksesit të nxënësve

V.25. Unë e informoj në vazhdimësi familjen për suksesin e nxënësit në shkollë.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.26. Unë kontaktoj familjen jo vetëm kur fëmija nuk ecën mirë në mësim.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.27. Unë e nxit nxënësin që të bëjë më të mirën në mësim.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

V.28. Problemet e nxënësit në të nxënë i zgjidhim bashkë me familjen.				
Plotësisht dakord	Dakord	I pavendosur	Jo dakord	Aspak dakord

Komentet tuaja eventuale: _____

GUIDA PER INTERVISTIMIN E PRINDERVE

Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollë, bashkëpunimi me shkollën në parandalimin e saj

1. Çfarë nënkuptoni ju me dhunën? Çfarë është dhuna për juve?
2. Çfarë lloj dhune fizike ka përdorur fëmija juaj me nxënësit tjerë në shkollë? Jepni shembuj nëse keni.
3. Çfarë lloj dhune psikologjike (ofendime, kërcënime, izolim, terrorizim, ftohtësi, inate, ironi etj.) kanë përdorur ndaj fëmijës tuaj fëmijët /nxënësit e tjerë në shkollë? Jepni shembuj.
4. A ka ndodhur që ndonjë nga nxënësit tjerë të ketë bërë me trupin e fëmijës tuaj gjëra që juve nuk ju kanë pëlqyer? A dini t'u kenë ndodhur nxënësve tjerë gjëra të tilla në shkollë?
5. Për çfarë arsyeje (pse) e kanë përdorur dhunën fizike dhe psikologjike nxënësit ose fëmija juaj në shkollë?
6. A ju ka ndodhur vetë (ose a keni dëgjuar) që dhuna fizike e përdorur nga nxënësit mes tyre të ketë qenë e rëndë, serioze (me pasoja të rënda)? (Tregojnë histori (raste të plota) lidhur me këtë: kush e përdori dhunën, pse, cilat qenë pasojat etj.).
7. A keni informacion se ku, në cilin ambient të shkollës ndodh më shumë dhuna ndërmjet nxënësve?
8. A dihen raste tipike të dhunës të cilat janë trajtuar nëpërmjet bashkëpunimit tuaj me shkollën?
9. A ka pasur efekt trajtimi i dhunës së nxënësve, përmes bashkëpunimit të shkollës me familjen?
10. Çfarë karakteristikash ka bashkëpunimi shkollë-familje për trajtimin e dhunës?
11. Cilët janë iniciatorët në trajtimin e dhunës së nxënësve nëpërmjet bashkëpunimit shkollë-familje? Cilët janë mbështetësit? Pra, çfarë rolesh kryejnë mësuesit dhe çfarë rolesh kryejnë prindërit kur bashkëpunojnë për trajtimin e dhunës së nxënësve?
12. A mund të thoni, sa takime realizoni me mësuesin/kujdestaren e fëmijës suaj brenda një gjysmë viti?

GUIDA PER INTERVISTIMIN E MËSUESVE

Dhuna fizike dhe psikologjike në shkollë, bashkëpunimi me familjen në parandalimin e saj

1. Çfarë nënkuptoni me dhunën ju si mësues? Çfarë është dhuna për juve?
2. Çfarë lloj dhune fizike kanë përdorur nxënësit tuaj me nxënësit e tjerë në shkollë? Jepni shembuj nëse keni.
3. Çfarë lloj dhune psikologjike (ofendime, kërcënime, izolim, terrorizim, ftohtësi, inate, ironi etj.) kanë përdorur ndaj nxënësit tuaj, nxënësit e tjerë në shkollë? Jepni shembuj.
4. A ka ndodhur që ndonjë nga nxënësit e tjerë të ketë bërë me trupin e nxënësit tuaj gjëra që juve nuk ju kanë pëlqyer? A dini t’u kenë ndodhur nxënësve tjerë gjëra të tilla në shkollë?
5. Për çfarë arsyeje (pse) e kanë përdorur dhunën fizike dhe psikologjike nxënësit tuaj në shkollë?
6. A ju ka ndodhur vetë (ose a keni dëgjuar) që dhuna fizike e përdorur nga nxënësit mes tyre të ketë qenë e rëndë, serioze (me pasoja të rënda)? (Tregoni histori (raste të plota) lidhur me këtë: kush e përdori dhunën, pse, cilat qenë pasojat etj.)
7. A keni informacion, ku, në cilin ambient të shkollës ndodh më shumë dhuna ndërmjet nxënësve?
8. A dihen raste tipike të dhunës të cilat janë trajtuar nëpërmjet bashkëpunimit tuaj me familjen?
9. A ka pasur efekt trajtimi i dhunës së nxënësve përmes bashkëpunimit tuaj dhe shkollës me familjen?
10. Çfarë karakteristikash ka bashkëpunimi shkollë-familje për trajtimin e dhunës?
11. Cilët janë iniciatorët në trajtimin e dhunës së nxënësve nëpërmjet bashkëpunimit shkollë-familje? Cilët janë mbështetësit? Pra, çfarë rolesh kryejnë mësuesit dhe çfarë rolesh kryejnë prindërit kur bashkëpunojnë për trajtimin e dhunës së nxënësve?
12. A mund të thoni, sa takime realizoni me familjen e nxënësit tuaj brenda një gjysmë viti shkollor? Është fjala me një familje në gjysëmvetor.

GUIDA PER INTERVISTIMIN E DREJTUESVE TË SHKOLLËS:

1. Si do ta prezantoni parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkolla nga shkolla juaj?
2. Si do të prezantoni bashkëpunimin me familjen në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve?
3. Si do të veproni nëse familja është indiferente në bashkëpunimin për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë?
4. A ka shkolla juaj strategji/program në drejtim të përfshirjes së familjes në shkollë?
5. Cilat janë politikat e shkollës në rast të ngacmimeve/dhunës mes nxënësve?
6. A ka shkolla juaj strategji për parandalimin e dhunës në shkollë?
7. A keni organizuar aktivitete, trajnime me familjen për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë?
8. Ju si drejtues, si e mbikëqyrni bashkëpunimin e shkollës dhe familjes? Cilat janë metodat tuaja në këtë drejtim?

GUIDA PER INTERVISTIMIN E FEMIJEVE

Dhuna fizike dhe psikologjike ndërmjet nxënësve në shkollë

1. Çfarë nënkuptoni me dhunë?
2. Çfarë lloj dhune fizike kanë përdorur ndaj jush shokët/nxënësit në shkollë? Jepni shembuj.
3. Çfarë lloj dhune psikike kanë përdorur ndaj jush, shokët/nxënësit e tjerë në shkollë? Jepni shembuj.
4. Çfarë lloj dhune fizike kanë përdorur ndaj shokëve tuaj të klasës/shkollës, nxënësit e tjerë në shkollë? Jepni shembuj.
5. Nga ajo që keni dëgjuar ose parë vetë çfarë lloj dhune psikologjike (ofendime, kërcënime, izolim, ironi, terrorizim, ftohtësi, inate, ironi etj.) kanë përdorur nxënësit e tjerë ndaj shokëve tuaj të klasës/shkollës?) Jepni shembuj.
6. A ka ndodhur që ndonjë nga shokët tuaj të ketë bërë me trupin tuaj gjëra që juve nuk ju kanë pëlqyer? A dini t'u kenë ndodhur shokëve tuaj gjëra të tilla në shkollë ose jashtë shkollës? (abuzimi seksual brenda e jashtë shkollës).
7. A ka ndodhur që shokët tuaj të kenë ushtruar dhunë mbi ju jashtë shkollës?
8. Ku, në cilin ambient të shkollës ndodh më shumë dhuna ndërmjet nxënësve?
9. Për çfarë arsyeje (pse) e kanë përdorur dhunën fizike dhe psikologjike ndaj jush ose ndaj shokëve tuaj në shkollë?
10. A ju ka ndodhur vetë (ose a keni parë apo dëgjuar nga shokët tuaj të klasës/shkollë) që dhuna fizike e përdorur nga nxënësit të ketë qenë e rëndë, serioze (me pasoja të rënda)? *(Ju lutem, tregoni histori të plota lidhur me këtë: kush e përdori dhunën, pse, cilat qenë pasojat etj.)*
11. Sipas mendimit tuaj përse ndodh të përdoret dhuna fizike e psikike ndaj jush në shkollë, për çfarë arsye?
12. Cilat janë sipas mendimit tuaj pasojat e përdorimit të dhunës fizike dhe psikologjike mbi ju, nga shokët apo nxënësit tjerë të shkollës? A keni pasoja të dukshme të dhunës së përdorur?

PYETJET NË TË CILAT JANË FOKUSUAR SEANCAT E FOKUS GRUPIT

1. Çfarë nënkuptoni me dhunë?
2. Çfarë lloj dhune fizike kanë përdorur ndaj jush shokët/nxënësit në shkollë? Jepni shembuj.
3. Çfarë lloj dhune psikike kanë përdorur ndaj jush , shokët/nxënësit tjerë në shkollë? Jepni shembuj.
4. Çfarë lloj dhune fizike kanë përdorur ndaj shokëve tuaj të klasës/shkollës, nxënësit e tjerë në shkollë? Jepni shembuj.
5. Nga ajo që keni dëgjuar ose parë vetë çfarë lloj dhune psikologjike (ofendime, kërcënime, izolim, ironi, terrorizim, ftohtësi, inate, ironi etj.) kanë përdorur nxënësit e tjerë ndaj shokëve tuaj të klasës/shkollës?) Jepni shembuj.
6. A ka ndodhur që ndonjë nga shokët tuaj të ketë bërë me trupin tuaj gjëra që juve nuk iu kanë pëlqyer? A dini t'u kenë ndodhur shokëve tuaj gjëra të tilla në shkollë ose jashtë shkollës? (abuzimi seksual brenda e jashtë shkollës).
7. A ka ndodhur që shokët tuaj të kenë ushtruar dhunë mbi ju jashtë shkollës?
8. Ku, në cilin ambient të shkollës ndodh më shumë dhuna ndërmjet nxënësve?
9. Për çfarë arsyeje (pse) e kanë përdorur dhunën fizike dhe psikologjike ndaj jush ose ndaj shokëve tuaj në shkollë?
10. A ju ka ndodhur vetë (ose a keni parë apo dëgjuar nga shokët tuaj të klasës/shkollë) që dhuna fizike e përdorur nga nxënësit të ketë qenë e rëndë, serioze (me pasoja të rënda)? *(Ju lutem, të tregoni histori të plota lidhur me këtë: kush e përdori dhunën, pse, cilat qenë pasojat etj.)*
11. Përse ndodh kjo sipas mendimit tuaj, të përdoret dhuna fizike e psikike ndaj jush në shkollë, për çfarë arsye?
12. Cilat janë sipas mendimit tuaj pasojat e përdorimit të dhunës fizike dhe psikologjike mbi ju nga shokët apo nxënësit tjerë të shkollës? A keni pasoja të dukshme të dhunës së përdorur?

ANEKSI II

Tabela 84. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e mirëpritjes së familjes në shkollë, tek familja urbane

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	286	96.0
	Excluded ^a	12	4.0
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 85. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e mirëpritjes së familjes në shkollë

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.856	5

Tabela 86. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e mirëpritjes së familjes në shkollë, tek familja rurale.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	394	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	394	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 87. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e mirëpritjes së familjes në shkollë.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.758	5

Tabela 88. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e mirëpritjes së familjes në shkollë, tek mësuesit urban.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	298	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 89. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e mirëpritjes së familjes në shkollë.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.614	5

Tabela 90. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e mirëpritjes së familjes në shkollë, tek mësuesit rural.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	400	99.3
	Excluded ^a	3	.7
	Total	403	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 91. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e mirëpritjes së familjes në shkollë.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.442	5

Tabela 92. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e komunikimit të shkollës me familjen në shkollë, tek familja urbane.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	286	96.0
	Excluded ^a	12	4.0
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 93. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e komunikimit të shkollës me familjen.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.768	5

Tabela 94. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e komunikimit të shkollës me familjen në shkollë, tek familja rural.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	394	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	394	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 95. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e komunikimit të familjes me shkollën.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.763	5

Tabela 96. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e komunikimit të shkollës me familjen në shkollë, tek shkolla urbane.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	298	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 97. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e komunikimit të shkollës me familjen.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.647	4

Tabela 98. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e komunikimit të shkollës me familjen në shkollë, tek shkolla rurale.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	400	99.3
	Excluded ^a	3	.7
	Total	403	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 99. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e komunikimit të shkollës me familjen

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.676	4

Tabela 100. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e informimit të shkollës me familjen në shkollë, tek familja urbane

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	286	96.0
	Excluded ^a	12	4.0
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 101. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e informimit të shkollës me familjen.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.817	7

Tabela 102. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e informimit të shkollës me familjen në shkollë, tek familja rurale.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	394	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	394	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 103. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e informimit të shkollës me familjen.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.852	6

Tabela 104. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e informimit të shkollës me familjen në shkollë, tek shkolla urbane.

		N	%
Cases	Valid	298	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 105. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e informimit të shkollës me familjen

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.791	6

Tabela 106 . Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e informimit të shkollës me familjen në shkollë, tek shkolla rurale.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	400	99.3
	Excluded ^a	3	.7
	Total	403	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 107. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e informimit të shkollës me familjen.

Reliability Statistics			
Cronbach's Alpha	N of Items		
.815	5		

Tabela 108. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e mbështetjes së suksesit të nxënësve nga shkolla, tek familja urbane.

		N	%
Cases	Valid	286	96.0
	Excluded ^a	12	4.0
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 109. Koefficienti alfa i Kronbahut për variablin e mbështetjes së suksesit të nxënësve.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.723	5

Tabela 110. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e mbështetjes së suksesit të nxënësve tek familja rurale.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	394	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	394	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 111. Koefficienti alfa i Kronbahut për variablin e mbështetjes së suksesit të nxënësve.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.851	5

Tabela 112. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e mbështetjes së suksesit të nxënësve tek mësuesit e mjedisit urban.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	297	99.7
	Excluded ^a	1	.3
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 113. Koefficienti alfa i Kronbahut për variablin e mbështetjes së suksesit të nxënësve.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.850	4

Tabela 114. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e mbështetjes së suksesit të nxënësve tek mësuesit e mjedisit rural.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	399	99.0
	Excluded ^a	4	1.0
	Total	403	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 115. Koefficienti alfa i Kronbahut për variablin e mbështetjes së suksesit të nxënësve.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.766	3

Tabela 116. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e besimit të familjes në shkollën sipas familjes së mjedisit urban.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	286	96.0
	Excluded ^a	12	4.0
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 117. Koefficienti alfa i Kronbahut për variablin e besimit të familjes te shkolla.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.774	3

Tabela 118 Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e besimit të familjes te shkolla sipas familjes së mjedisit rural.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	394	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	394	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 119. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e besimit të familjes te shkolla.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.766	3

Tabela 120. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e besimit të shkollës në mjedisin urban.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	296	99.3
	Excluded ^a	2	.7
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 121. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e besimit të shkollës te familja.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.730	3

Tabela 122. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e besimit të shkollës së mjedisit rural.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	399	99.0
	Excluded ^a	4	1.0
	Total	403	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 123. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e besimit të familjes te shkolla.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.792	3

Tabela 124. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet shkollës dhe familjes, tek familja urbane.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	296	99.3
	Excluded ^a	2	.7
	Total	298	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 125. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet shkollës dhe familjes.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.730	3

Tabela 126. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet shkollës dhe familjes, tek familja rurale.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	394	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	394	100.0
a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.			

Tabela 127. Koeficienti alfa i Kronbahut për variablin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet shkollës dhe familjes.

Reliability Statistics	
Cronbach's Alpha	N of Items
.924	3

Tabela 128. Të dhëna përshkruese për besueshmërinë, për variablin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet shkollës dhe familjes, tek shkolla urbane.

Case Processing Summary			
		N	%
Cases	Valid	296	99.3
